



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**(Auditim Financiar dhe
Përputhshmërie)**

“GARDA E REPUBLIKËS”

Tiranë, Shtator 2019



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	PËRMBAJTJA E LËNDËS	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
II.	HYRJA (Të dhënat mbi raportin e auditimit).....	3-7
	a. Objektivat dhe qëllimi.	
	b. Identifikimi i çështjes.	
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	d. Përgjegjësitë e audituesve	
	e. Kriteret e vlerësimit	
	f. Standardet e auditimit.	
	g. Metodot e auditimit	
	i. Dokumentimi i rezultateve të auditimit.	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	7-11
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	
	1. Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....	11- 25
	2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	25-33
	3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	34-92
	4. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit:.....	92-107
	5. Prokurimet e fondeve publike.....	107-139
	6. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	139-154
	7. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme ¹ .	
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....	59-60
VI.	DOKUMENTACIONI SHOQËRUES	
	Aneksi 1: Lista e proceseve gjyqesore të ndjekur nga institucioni	
	Aneksi 2: Mbi vlerësimin e riskut	
	Aneksi 3: Sqarim rreth llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga klsh.	
	Aneksi 4: Qasja dhe metodologjia e auditimit	
	Aneksi 5: Vlera e llogarisë 602/7 “shpenzime për detyrime dhe kompensime legale	
	Aneksi 6: Lista e armëve	

¹ Auditimi i mëparshëm daton në vitin 2005



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I/a. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi në Gardën e Republikës (GR), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Njohjen me aktivitetin ekonomiko-financiar të Gardës dhe organizimin e funksionimit sipas rregulloreve të miratuara,
2. Vlerësimin dhe funksionimin sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit,
3. Auditimin e pasqyrave financiare të Gardës, si dhe
4. Auditimin e procedurave të prokurimeve

I/b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
1.	-Rregullorja e brendshme e GR është miratuar në vitin 2006 dhe nuk është në koherencë me dispozitat ligjore që normojnë kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar publik, pasi rregullorja nuk është rishikuar pas miratimit të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar -Disa pozicione dhe emërtesa funksionesh dhe pozicionesh të përfshira dhe referuara në Rregulloren e Brendshme, (miratuar nga Ministri Brendshëm me Urdhrin nr.2594, datë 24.10.2006), si dhe Rregulloren e Personelit (miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.66, datë 14.01.2014) nuk përputhen ose mungojnë në Vendimin nr. 445, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, limit organik, dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në GRSH”, i ndryshuar me VKM nr. 66, datë 07.02.2018. -Disa referenca ligjore të përfshira në dokumentin “Rregullorja e Gardës së Republikës” janë akte të shfuqizuara	FQ 25-33	I MESËM	Nga ana e strukturave përgjegjëse të Gardës së Republikës në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme të rishikohen dhe përmirësohen dispozitat e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit të Gardës së Republikës, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm me nr. 2594, datë 24.10.2006, që të harmonizohet ajo me kuadrin përkatës ligjor dhe dispozitat e tjera në fuqi dhe mbi këtë bazë të kryhet përmirësimi, azhurnimi i saj dhe miratimi i rregullores së re nga Ministri i Brendshëm
2.	- Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të IT. (p.sh. Ndryshohen fjalëkalimet rregullisht, fireëall-et, hyrje e kufizuar në të dhënat IT, etj.). Sistemi i IT, mbulohet tërësisht nga struktura e brendshme, Sektori i Komunikimit dhe Elektronikës në vartësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. - Brenda Gardës së Republikës nuk ka një sistem rezervë (back-up) IT të përshtatshëm, plan rekuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë.	FQ 25-33	I MESËM	Nga Garda e Republikës në kuadër të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masat për identifikimin dhe analizën e risqeve të mundshme, për arritjen e objektivave dhe përcaktimin e mënyrave se si ky rrezik mund të shmangët ose të minimizohet, duke pasqyruar, angazhimin e drejtpërdrejtë në evidencimin, regjistrimin, shqyrtimin, përgatitjen dhe raportimin e masave të programuara për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.
3.	- Gjatë përgatitjes së PBA-së, Faza II, treguesit e performancës për Objektivin 3 “Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës”, paraqiten në numër total, në një kohë kur bëhet fjalë për produkte të ndryshme, të cilët duhen trajtuar si tregues të veçantë brenda objektivit përkatës. Vetëm kështu ato i shërbejnë qëllimit të planifikimit në vetvete, i cili nis me vendosjen e objektivave të qarta, të besueshme, të matshme dhe të	FQ 11-25		Me qëllim respektimin e parimeve të qeverisjes buxhetore ³ të cilat përbëjnë një “praktikë të mirë” për tu ndjekur dhe zbatuar, por edhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, rekomandojmë marrjen e masave nga subjekti që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore të mbahet parasysh: -lidhja e ngushtë mes buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme; si

³ “Parimet e qeverisjes buxhetore”, sipas OECD



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
	arritshme. - Nga auditimi mbi realizimin e buxhetit për vitin 2017, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,729,622 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,634,555 mijë lekë (ose 95% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 5% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është buxheti në rritje nga viti 2016 në 2017, i cili pasohet edhe nga realizimi faktik në rritje për dy vitet te njëpasnjëshme. Edhe pse buxheti përfundimtar është rritur gjatë vitit ushtrimor 2017, realizimi faktik i zërave për këtë vit, ka qenë nën planin përfundimtar me 85,437 mijë lekë më pak. Nga auditimi mbi realizimin e buxhetit për vitin 2018, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,713,164 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,491,338 mijë lekë (ose 87% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 13% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është që shpenzimet korrente dhe kapitale paraqesin më pak luhatje mes fazave, objekt vlerësimi², në krahasim me një vit më parë			dhe - planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi aktiv
4.	- Nuk ka një sistem informatik informacioni, monitorimi që u siguron drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë. Aktualisht kryhet me një kordinator i cili mbledh dhe raporton tek drejtuesit dhe në Ministrii, për nivelin e realizimit të objektivave të materializuara në produkte. - Nuk ka një procedurë të veçantë të shkruar nga menaxhuesit, përtej legjislacionit në fuqi për ruajtjen nga përdorimi i paautorizuar për aktivet e rëndësishme (me vlerë) dhe aktivet afatgjata (përfshirë të dhënat personale). Gjithashtu nuk ka manual procesesh ose rregullore për proceset kryesore operationale dhe financiare i cili të specifikojë qarkullimin e dokumentacioni	FQ 25-33	I LARTË	Garda, strukturat menaxhuese të marrin masat të hartojnë rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, në përshatje me strukturën dhe objektivat e institucionit duke e plotësuar dhe harmonizuar me kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe miratuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar
5.	Evidentimi material e sasior i armatimit në Gardën e Republikës mbahet nga Sektori i Armatimit, ku janë pasqyruar armatimet në sasi dhe përdoruesit e tyre, referuar tipologjive së regjistrave të miratuar me udhëzime të veçanta të Ministrit të Brendshëm. Nga sektori armatimit të institucionit, dokumentacioni i hyrjes dhe daljes së mallrave e materialeve (armë, municione e pajisje), nuk plotësohet i rregullt sa i përket çmimit dhe vlerës së mallit, siç e përmban formati i miratuar i dokumentit (emërtesa, njësia, sasia, çmimi, vlera. etj.). Gjithashtu edhe regjistrimi i dokumentacionit në librat e llogarisë kryhet vetëm për lëvizjet sasiore të këtyre mallrave pa përcaktuar sipas emërtesës së artikullit edhe çmimin përkatës. Nga verifikimi i të dhënave me zgjedhje që janë shënuar në fletën e inventarit për armatim e municion të datës 26.6.2018, evidentohet se, nuk është regjistruar, kontabilizuar dhe përfshirë në llogaritë e aktiveve të GR kundërvlera për armët luftarake të tipit “pistoletë”, (përkatësisht pistoletë mod. 54 janë 1071 copë, pistoletat 9 m/m makarov janë 136 copë; ato 9 m/m Kirikale janë 100 copë; cloock 17 janë 116 copë dhe cloock 19 për 70 copë; berreta FS 92 janë 395 copë, berreta stoeger janë 53 copë, etj.etj.), që nuk janë vlerësuar me çmimin e tyre dhe nuk janë përfshirë në librat e kontabilitetit. Gjithashtu, evidentohet se, nuk është regjistruar, kontabilizuar dhe përfshirë në llogaritë e aktiveve të GR kundërvlera për armët luftarake të llojit automatikë (mod 56 janë 161 copë, automatikët mod 56 q-druri janë 1454 copë,	FQ 34-92	I LARTË	- Komandanti i Gardës së Republikës të marrë masa, programojë detyrat sipas afateve dhe të ngrejë grupet e vlerësimit të armatimit dhe municionit që ka në inventar dhe administrim institucioni. Komisioni në bashkëpunim me Sektorin e Armatimit në GR, për mallrat e materialet (armë, municione e pajisje), të regjistruar në ditarët e llogarisë të bëjë menjëherë përcaktimin e çmimit të tyre dhe në vijimësi dokumentacionin hyrje dhe dalje ta plotësojë të rregullt duke përcaktuar çmimin e artikullit dhe vlerën e mallit në faturë - Nga ana e Sektorit të Financës, rezultatet e vlerësimeve të kryera në shërbimin e armatimit, të pasqyrohen në evidencën kontabile që do të mbyllet për vitin 2019, duke evidentuar vlerën e plotë e të saktë të armatimit dhe municioneve, sipas çmimit së blerjes, apo dhe referuar çmimeve të tregut për armatimin e trashëguar në vite apo të dhuruar,

² Realizimi faktik 2017, buxheti fillestar 2017, buxheti përfundimtar 2017; dhe realizimi faktik 2018



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSI A	REKOMANDIMI
	automatikët mod. 56 metal janë 749 copë, automatike scorpions 4 copë, automatike trofe 3 copë, Mitraloz i lehtë mod 56- copë 86, mitraloz MG 3 për 10 copë, mod. 57 për 17 cope, mod. 53 për 9 copë), etj.			konformë rregullave kontabile dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi armatimin
6.	Përsa u përket armëve të evidentuara më parë të pa dorëzuara nga shtetasit e pajisur vite më parë në bazë të dispozitave që aktualisht janë shfuqizuar, për GR rezultojnë një numër armësh të pa grumbulluara e administruara pranë këtij institucioni, për të cilat edhe pse janë lënë rekomandime të përsëritura nga Ministria e Brendshme, të pranuar, por të pa zbatuara plotësisht, nuk është mundur kthimi dhe administrimi i tyre në depot ushtarake të këtij institucioni. Sektori i armatimit i GR, nuk ka marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për gjetjen e adresave të personave, bërjen dhe dokumentimin e kallëzimit penal për të gjithë personat si dhe nuk ka kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës së armës nga personat e rezultuar me armatim të pa dorëzuar apo të humbur	FQ 34-92	I LARTË	Sektori armatimit dhe pajisjeve në GR, për armët që janë në administrim nga shtetas të ndryshëm (<i>ish punonjës të GR apo funksionarë të subjekteve politike</i>) që rezultojnë ende të pa dorëzuara (<i>pa u bërë hyrje në depot e GR</i>) si dhe armët që janë në proces hetimi e gjykimi penal, për të cilat nuk janë ndjekur rrugët e duhura ligjore për marrjen hyrje të tyre si rezultat edhe i dokumentimit e regjistrimit të tyre në ditarë të vjetër të llogarisë për periudhën para vitit 2000, të marrë masat e menjëhershme që këto armë: - t'i evidentojë e regjistrojë në një libër të veçantë, në të cilin të përshkruaj të dhënat e plota të shtetasit dhe të armës, - të bëjë rakordimin e shumave të përgjithshme në ditarët e llogarisë mod.28, si dhe të dokumentojë e administrojë edhe ecurinë e procesit administrativ e ligjor të ndjekur. Komandanti i GR tu kërkojë zyrtarisht drejtorive vendore të policisë së shtetit për të gjetur adresat e personave që janë pajisur me armët luftarake dhe të ndiqen procedurat deri në bërjen hyrje në depot e GR të armatimit dhe municionit të furnizuar sipas dispozitave që aktualisht kanë rënë nga fuqia.
7.	Konstatuam se, mungon një përcaktim i saktë dhe rigoroz nga ana e MFE mbi rastet, tipologjitë dhe natyrën e investimeve që do të njihen si të rëndësishme së veçantë dhe do përdoren letërkredite, meqenëse investimet, kur prokurohen nuk kanë një referim të tillë. Ngurtësimi i fondeve dhe kryerja e pagesave për furnitura që konsiderohen të realizuara brenda vitit ushtrimor (<i>sipas Regjistrimit të Realizimit të Prokurimeve Publike të AK</i>), por që në fakt bëhen hyrje në njësinë shpenzuese vitin pasardhës, tregon për procese që nuk janë planifikuar siç duhet nga ana e strukturës përgjegjëse në institucionin e qeverisjes së përgjithshme (Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme). Përdorimi i letër kredive nga institucioni, në masën e plotë të investimit, çënon parimin kryesor të realizimit të buxhetit atë të transparencës dhe besueshmërisë, të përcaktuara nga neni 4 i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe neni 40 i tij	FQ 92-107	I LARTË	Institucioni Gardës së Republikës, të kërkojë pranë Ministrisë së Brendshme, (<i>si autoriteti ku është vendosur në strukturë Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara</i>) që, në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të përgatitësin nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, duke specifikuar rastet, mënyrat dhe masën e përdorimit të letër kredive nga institucionet buxhetore, pasi mungon një përcaktim i saktë dhe rigoroz mbi tipologjitë dhe natyrën e investimeve që do të njihen si të rëndësishme së veçantë dhe që mund të aktivizojnë përdorimin e instrumentit të letërkredive, për të shmangur përdorimin abuziv të tij.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

I/c. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion mbi përputhshmërinë (i pakualifikuar)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Gardës së Republikës, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Gardës së Republikës, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës. Nga auditimi u rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i Gardës së Republikës, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Baza për opinionin e përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar.

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i Gardës në mënyrë që:

- Garda e Republikës, të kërkojë pranë Ministrisë së Brendshme, (si autoriteti ku është vendosur në strukturë Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara) që, në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të përgatisin nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, duke specifikuar rastet, mënyrat dhe masën e përdorimit të letër kredive nga institucionet buxhetore, pasi mungon një përcaktim i saktë dhe rigoroz mbi tipologjitë dhe natyrën e investimeve që do të njihen si të rëndësishme të veçantë dhe që mund të aktivizojnë përdorimin e instrumentit të letër-kredive, për të shmangur përdorimin abuziv të tij.

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pakualifikuar)

Ne audituam pasqyrat financiare të Gardës së Republikës, më datë 31.12.2018, të cilat përbëhen nga Pozicioni Financiar, Performanca Financiare, Pasqyra e Fluksit të Arkës, Fondet neto, Investimet e Aktivitet Afatgjatë si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i Gardës sa i takon:

- programimit të detyrave sipas afateve dhe ngritjes së grupeve të vlerësimit të armatimit dhe municionit që ka në inventar dhe administrim institucioni;
- evidentimit të plotë dhe të saktë në evidencën kontabël që do të mbyllet për vitin 2019, të armatimit dhe municioneve sipas rezultateve e vlerësimeve të kryera në shërbimin e armatimit;
- evidentimit dhe regjistrimit në një libër të veçantë të armëve që janë në administrim nga shtetas të ndryshëm (*ish punonjës të Gardës së Republikës (GR) apo funksionarë të subjekteve politike*) që rezultojnë ende të pa dorëzuara (*pa u bërë hyrje në depon e GR*) si dhe armët që janë në proces hetimi e gjykimi penal, për të cilat nuk janë ndjekur rrugët e duhura ligjore për bërjen “hyrje” të tyre si rezultat edhe i dokumentimit e regjistrimit të tyre në ditarë të vjetër të llogarisë për periudhën para vitit 2000.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Drejtimi i Gardës së RSH^{së} është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Gardës së RSH^{së}, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.



II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 340/2, datë 29.05.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.06.2019 deri në datë 15.07.2019, në subjektin (emri i subjektit të audituar) për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datë 31.12.2018.

u krye auditimi “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Gardën e Republikës” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- A... J..., Përgjegjës Grupi
- B... Z..., Auditues
- Q... C..., Auditues
- P... R..., Auditues

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi veprimtarinë e Gardës së Republikës, Tiranë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 01.01.2018, deri 31.12.2018.

Bazuar të dhënave të marra në subjekt, fondet e trajtuar, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, u identifikuan fushat e auditimit të cilat janë;

- a. planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar;
- b. marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, krijimi dhe përdorimi i fondit të veçantë, etj.;
- c. hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Ligjshmëria dhe saktësia e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit;
- d. planifikim dhe realizimi i prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime;

a) Titulli:

Raporti i Auditimit të Përputhshmërisë në Gardën e RSH.

b) Marrësi:

Ky Raport i adresohet Gardës së RSH.

c) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Ky auditim ka për qëllim kryerjen e auditimi të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) me qëllim një vlerësimi i përgjithshëm të të përputhshmërisë së aktivitetet të parashikuara në programin e auditimit me kaudrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe vlerësimin e mjedisit të kontrollit dhe procedurave të kontrollit të lidhura me transaksione individuale. Menaxhimi është përgjegjës për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm që siguron përputhshmërinë me ligjet dhe rregullat.

Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë project, lidhen me auditimin mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit; zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave; administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, si dhe auditimin e llogarive vjetore për institucionin (të mbyllura për vitin 2017, dhe për vitin 2018).

Auditimi duke qenë pjesë jetike e një sistemi rregullator, ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

Objektivat e këtij auditimi konsistojnë në:

- Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

- Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e shpenzimeve dhe të ardhurave janë:

- *Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.*

- *Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.*

- *Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.*

d) Identifikimi i çështjes:

1. Garda e Republikës së Shqipërisë është strukturë me status të veçantë në Ministrinë e Rendit Publik, që ka për mision ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe të rezidencave, të përcaktuara në këtë ligj. Ajo varet nga Ministri i Rendit Publik.

Aktivitetet që do të jenë object vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari I KLSH-së, në programin e auditimit nr. 340/2, datë 29.05.2019

e) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Drejtimi i Gardës së RSH^{së} është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

f) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objekti ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Gardës, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

g) Kriteret e vlerësimit:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

- Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”;

- Ligji nr. 109/2017, dt. 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
- ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014,
- Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,
- Ligji nr. 8869, dt. 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës” i ndryshuar,
- Ligj nr. 9366, dt. 31.03.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

h) Standardet e Auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Përputhshmërisë, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”;
- ISSAI 1000-2999 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 1300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”;
- INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”; INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”;

i) Metodatat e auditimit.

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar se si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Puna e auditit të brendshëm u bë pjesë efektive e mjedisit të kontrollit, duke dhënë ndihmesë në drejtim të risqeve të punës në mënyrë të strukturuar dhe dha siguri për operacionet dhe procedurat e kontrollit.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, shumat e autorizuara për vitet 2017 dhe 2018, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

j) Dokumentimi i rezultateve të auditimit.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Manualit të Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesive dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

III. PËSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Garda e Republikës së Shqipërisë është strukturë me status të veçantë në Ministrinë e Rendit Publik, që ka për mision ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe të rezidencave, të përcaktuara në ligjin nr. 8869, dt. 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës” i ndryshuar. Ajo varet nga Ministri i Rendit Publik.

2. Garda e Republikës është person juridik, buxheti i së cilës është zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik.

Garda e Republikës së Shqipërisë ruan e mbron:

- a) Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, si dhe familjet e tyre.
- b) Personalitetet e huaja, që vijnë në vendin tonë, në rang të njëjtë me personalitetet shqiptare të shkronjës “a” dhe “c”.
- c) Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, zëvendëskryetarët e Kuvendit, anëtarët e Këshillit të Ministrave, Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e SHISH-it, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Guvernatorin e Bankës së Shtetit, Avokatin e Popullit, Kryetarin e KQZ-së, kryetarin e partisë më të madhe të maxhorancës parlamentare, kryetarin e partisë më të madhe të opozitës parlamentare dhe Kryetarin e Bashkisë së Tiranës.
- ç) Rezidencat presidenciale, të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave, si dhe seli e rezidenca të tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
- d) Banesat e personaliteteve të përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

- a. Objekt i këtij auditimi është rregullshmëria dhe përputhshmëria e operacioneve financiare të Gardës përgjatë vitit 2017 dhe 2018;
- b. Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Gardës, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit
- c. Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të Gardës me qëllim dhënien e opinionit, është shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit.

Më poshtë po paraqesim disa nga gjetjet kyçe të auditimit dhe impakti i tyre tek pasqyrat financiare:

➤ Evidenca kontabël mbahet me programin Financa 5 por nuk përfshihet në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) ku mund të mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit; të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike; të dhëna për raporte financiare dhe statistika; etj.

➤ Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të IT. (p.sh. Ndryshohen fjalëkalimet rregullisht, **fireëall-et**, hyrje e kufizuar në të dhënat IT, etj.). Sistemi i IT, mbulohet tërësisht nga struktura e brendshme, Sektori i Komunikimit dhe Elektronikës në vartësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

➤ Brenda Gardës së Republikës nuk ka një sistem rezervë (back-up) IT të përshtatshëm, plan rekuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

➤ Gjatë përgatitjes së PBA-së, Faza II, treguesit e performancës për Objektivin 3 - “Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës”, paraqiten në numër total, në një kohë kur bëhet fjalë për produkte të ndryshëm (konkretisht: produkti B “Mjete transporti të reja të blera”, produkti C “Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime perëndimore”, dhe produkti G “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës”, të cilët duhen trajtuar si tregues të veçantë brenda objektivit përkatës. Vetëm kështu ato i shërbejnë qëllimit të planifikimit në vetvete, i cili nis me vendosjen e objektivave të qarta, të besueshme, të matshme dhe të arritshme.

➤ Nga auditimi u konstatua se nga njëra PBA në tjetrën përgjithësisht ka vijueshmëri në përkufizimin dhe trajtimin e produkteve për secilin objektiv, përveç:

- Produktit 2 “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës në Gardën e RSH”, për objektivin 3⁴, i cili ishte Produkti G, në PBA-në e mëparshme;

- Produktit 3 “Godinë e ri konstruktuar dhe shesh i asfaltuar” / Objektiv 3, i cili ishte Produkti D në PBA-në e mëparshme;

- Produktit 4 “Magazinë dhe oficinë e ri konstruktuar në Komandën e Gardës” / Objektiv 3, i cili në fakt në PBA 2018-2020 ishte Produkti F i të njëjtit objektiv.

- Produktet: C “Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime perëndimore”, E “Rrugë të asfaltuara” nuk janë parashikuar më në PBA 2019-2020

Mospasja e vijueshmërisë edhe në listimin e produkteve respektive brenda të njëjtit objektiv, vështirëson krahasueshmërinë mes zërave, e cila merr rëndësi kur bëhet fjalë për monitorime dhe/ose vlerësime të parashikimeve.

➤ Nga auditimi mbi realizmin e buxhetit për vitin 2017, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,729,622 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,634,555 mijë lekë (ose 95% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 5% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është buxheti në rritje nga viti 2016 në 2017, i cili pasohet edhe nga realizimi faktik në rritje për dy vitet të njëpasnjëshme. Edhe pse buxheti përfundimtar është rritur gjatë vitit ushtrimor 2017, realizimi faktik i zërave për këtë vit, ka qenë nën planin përfundimtar me 85,437 mijë lekë më pak.

Nga auditimi mbi realizmin e buxhetit për vitin 2018, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,713,164 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,491,338 mijë lekë (ose 87% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 13% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është që shpenzimet korrente dhe kapitale paraqesin më pak luhatje mes fazave, objekt vlerësimi⁵, në krahasim me një vit më parë.

➤ Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, janë të pasqyruara në llog. 202 “Studime dhe kërkime” projekti dhe plan vendosja në vlerën 2,878,200 lekë investim i cili ka përfunduar, si rezultat duhej që vlerës së investimit ti shtohet dhe vlera e projektit (2,411,400 lekë) dhe rilevimit të plan vendosjes (466,800 lekë).

➤ Në pasqyrat financiare Formatit 7/a, kolona 7 pakësime gjatë vitit ushtrimor “Nxjerrje jashtë përdorimit” janë pasqyruar pakësime të aktiveve:

a. “**Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune**” në vlerën 1,005,583.03 lekë nga të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit me fletëdaljet dhe procesverbalet përkatëse pa u miratuar nga titullari i Gardës në vlerën 985,183 lekë.

b. “**Inventar ekonomik**” në vlerën 66,360 lekë nga të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit me fletëdaljet dhe procesverbalet përkatëse pa u miratuar nga titullari i Gardës në vlerën 37,080 lekë.

c. **Aktive** të shkarkuara me fletë dalje (Gjashtë) sipas procesverbaleve të mbajtura nga komisionet në vlerën **2,627,840.4** lekë të cilat duhej të kalonin si shpenzime gjatë kohës kur janë

⁴ Objektiv 3: “Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës”

⁵ Realizimi faktik 2017, buxheti fillestar 2017, buxheti përfundimtar 2017; dhe realizimi faktik 2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

përdorur në rastin konkret duhej të konsideroheshin si diferenca inventari dhe më tej të procedohej nga titullari nëse do të kalonin në shpenzime ose do të konsideroheshin si mungesa inventari.

➤ Llog. 4342 “*Të tjera operatione me shtetin (të drejta)*” zënë shumën 113,945 mijë lekë; Në pasiv në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2018 nuk rakordon në analizë në vlerën **3,000,000** lekë. Llogaria “*Operatione me shtetin (të drejta)*” është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit).

➤ Nga auditimi rezulton se, nga subjekti për vlerën e klientëve dhe furnitorëve nuk është dërguar letër konfirmimi për llogaritë e pagueshme, për të verifikuar nëse vlerat e tyre janë në përputhje me shënimet e kontabilitetit. Mosrakordimi me klientët dhe furnitorët mundëson edhe riskun e pagesave të parregullta, si dhe prezantimin jo të saktë e të plotë të detyrimeve në pasqyrat financiare.

➤ Tepricat e llogarisë 520, “*Disponibilitete në thesar*” dhe të llogarisë 466, “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” si llogari specifike në sektorin publik, në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve dhe duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat nuk janë paraqitur dhe strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

➤ Në pasqyrën e performancës financiare Formati 2, “*Shpenzime të tjera*”, Llog. 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” paraqitet në vlerën 14,926,139 lekë pa u saktësuar pozicioni i çeljes së llogarisë nga viti i mëparshëm, transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85, “*Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor*” të vitit 2017 prej 3,819,815 në llogarinë 12, “*Rezultatet e mbartura*”.

➤ Formati 5 “*Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore*” është plotësuar relacioni shpjegues por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

➤ Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e Komandantit të Gardës nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme drejtuesit. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve.

➤ Nga auditimi i hartimit të kontratave të furnizimit me karburante u konstatua se janë hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, pasi kriteret e vlerësimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje nuk është çmimi më i ulët, bazuar në çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri.... elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi, marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje. Gjithashtu kontratat e mësipërme janë hartuar duke mos respektuar Dokumentet Standarde të Tenderit.

➤ Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si “*taksa e markimit*” si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën **1,012,927** lekë me tvsh në kundërshtime me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 77, pika 5 dhe Pika 6.

➤ Nga projektuesi “.....” Tiranë është hartuar projekti dhe preventivi “*Rikonstruksioni i Njesisë speciale në Gardën e Republikës*” me vlerën 21,973,753 lekë pa tvsh. Zërat e preventivit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

janë hartuar referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015. Për një pjesë zërash të punimeve të preventivit çmimet janë hartuar me analiza punimesh referuar UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” por analizat nuk janë bashkëngjitur preventivit. Kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”,

➤ Nga auditimi i procedurave të prokurimeve rezultoi se operatorët ekonomikë ofertues një pjesë zërash të preventivit të ofertës nuk e kanë shoqëruar me analizat e çmimeve kjo në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12.

➤ Nuk ka një sistem informatik informacioni, monitorimi që u siguron drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë. Aktualisht kryhet me një kordinator i cili mbledh dhe raporton tek drejtuesit dhe në Ministrinë, për nivelin e realizimit të objektivave të materializuara në produkte. Gjithashtu nuk ka një procedurë të veçantë të shkruar nga menaxhuesit, përtej legjislacionit në fuqi për ruajtjen nga përdorimi i paautorizuar për aktivet e rëndësishme (me vlerë) dhe aktivet afatgjata (përfshirë të dhënat personale). Gjithashtu nuk ka manual procesesh ose rregullore për proceset kryesore operacionale dhe financiare i cili të specifikojë qarkullimin e dokumentacionit.

➤ Nga auditimi rezulton se raportet e monitorimit nuk publikohen në **web-in** e Gardës së Republikës dhe as në **web-in** e Ministrisë së Brendshme, gjithashtu raportet e monitorimit nuk kanë informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe UMF nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësinë e Qeverisjes Qendrore”.

Në mënyrë të përmbledhur rezultatet e auditimit, konstatimet dhe gjetjet si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. **Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit:**

1.a Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Auditimi i programimit dhe realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të Gardës së RSH, u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

-**Ligjet:** nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; nr.130/2015, datë 57.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017” dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit; nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018” dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit;

-**Udhëzimet e Ministrisë së Financave:** nr.10, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020”; nr. 7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”; nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit”, udhëzimi plotësues nr.2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018” dhe “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”; nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, me ndryshime.

Programi 03150 “Garda e Republikës” i shërben ruajtjes së Presidentit të RSH, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit si dhe familjet e tyre, personalitete të larta të këtij rangui që vizitojnë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

vendin tonë, Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, zv/kryetarët e Kuvendit, anëtarët e KM, Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e KLSH, Guvernatorin e BSH, Avokatin e Popullit, Kryetaren e KQZ, Kryetarin e Mazhorancës, Kryetarin e partisë më të madhe të opozitës parlamentare, Kryetarin e Bashkisë, Tiranë si dhe banesat e tyre, familjet, selitë dhe rezidencat si dhe objektet.

Politika e Programit është përmirësimi më tej i sigurisë së personaliteteve vendase dhe të huaja si dhe sigurimin e objekteve të rëndësisë së veçantë në një nivel sigurie maksimale të mundshme.

Qëllimi i Politikës së Programit është: Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së personaliteteve vendas dhe të huaj si dhe në rritjen e shkallës së sigurisë për objektet e rëndësisë së veçantë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese, duke siguruar përputhje me standardet më të larta evropiane në fushën e sigurisë së personaliteteve të lartë shtetërore deri në vitin 2020.

Objektivat e Politikës së Programit janë:

1. Rritja e nivelit të sigurimit të Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë në një nivel 2 % më të lartë se ai i vitit 2016 duke arritur nivelin 90 %.
2. Menaxhim efektiv i burimeve njerëzore dhe financiare duke synuar në përmirësimin e kriterëve të rekrutimit të gardistëve profesionistë si dhe përdorimin ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore të akorduara.
3. Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës.
4. Freskimi i Rezervave të Emergjencës për të përmirësuar standardet e Objekteve të Kohës së Veçantë.

Treguesit e fazës së parë të programimit për PBA 2018-2020 janë dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme me shkresën nr. 599/5, datë 14.04.2017

Treguesit e fazës së dytë të programimit për PBA 2018-2020 janë dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme me shkresën nr. 599/9, datë 15.08.2017

Viti 2017

Gatë vitit 2017, është hartuar PBA për vitin 2018-2020, në përputhje me legjislacionin përkatës, sa i takon hartimit dhe formulimit të deklaratave të politikave të programeve buxhetore, të cilat janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, brenda afateve ligjore.

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2020, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Struktura buxhetore për programin e vetëm që menaxhon Grada, për qëllime të PBA-së paraqitet e ndarë sipas 8 produkteve.

Udhëzimi plotësues nr. 10/3, datë 13.07.2017 “Për përgatitjen e PBA 2018-2020” dikton se përgatitja e kërkesave të rishikuara të mbajë në konsideratë se, pjesë integrale e Deklaratës së Politikës së Programit 2018-2020, do të jenë edhe treguesit e performancës për çdo objektiv të programit. Këta tregues të performancës përkufizohen si tregues sasiorë/cilësorë që masin progresin e bërë në përmbushjen e qëllimit të objektivave. Në vijim udhëzimi citon se, **si tregues performance do të shërbejnë krahas produkteve** të planifikuara, edhe tregues të tjerë të matshëm të lidhur me to.

Objektivat e Politikës së Programit të cilësuar në Deklaratë janë si më poshtë vijon:

Objektivat	Përshkrimi
Objektivi 1	Do të synojmë rritjen e nivelit të sigurimit të Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë në një nivel 2 % më të lartë se ai i vitit 2016 duke arritur nivelin 90 %.
Objektivi 2	Menaxhim efektiv i burimeve njerëzore dhe financiare duke synuar në përmirësimin e kriterëve të rekrutimit të gardistëve profesionistë si dhe përdorimin ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore të akorduara.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Objektivi 3	Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës
Objektivi 4	Freskimi i Rezervave të Emergjencës për të përmirësuar standartet e Objekteve të Kohës së Veçantë.

Burimi: Tabela e përgatitur nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi rezultoi se:

- **Objektivi 2** “Menaxhim efektiv i burimeve njerëzore dhe financiare duke synuar në përmirësimin e kriterëve të rekrutimit të gardistëve profesionistë si dhe përdorimin ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore të akorduara”, dhe

- **Objektivi 4** “Freskimi i Rezervave të Emergjencës për të përmirësuar standartet e Objekteve të Kohës së Veçantë”,

paraqitur në Deklaratën e Politikës së Programit, nuk kanë si pjesë integrale të tyre, treguesit e performacës/produktet, të cilët kanë për qëllim të masin progresin e bërë në drejtim të përmbushjes së objektivit vetë, në kundërshtim kjo me sa udhëzon Udhëzimi plotësues nr. 10/3, datë 13.07.2017 “Për përgatitjen e PBA 2018-2020”.

Gjithashtu rezultoi se gjatë përgatitjes së PBA-së, Faza II, treguesit e performancës për objektivin 3, paraqiten në numër total, në një kohë kur bëhet fjalë për produkte të ndryshëm (konkretisht: produkti B “Mjete transporti të reja të blera”, produkti C “Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime perëndimore”, dhe produkti G “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës”), të cilët duhen trajtuar si tregues të veçantë brenda objektivit përkatës. Vetëm kështu i shërbejnë qëllimit të planifikimit në vetvete, i cili nis me vendosjen e objektivave të qarta, të besueshme, të matshme dhe të arritshme.

Nga vlerësimi i hartimit të kërkesave në PBA 2018-2020, përgjatë të dy fazave të procesit, rezultoi se, nuk ka pasur ndryshime nga njëra fazë në tjetrën përveç shtimit të produktit E “Rrugë të asfaltuara”, në shumën 4,000 mijë lekë, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës aktuale në Komandën e Gardës në kushtet e transferimit të trupave në Komandën e re, si në tabelën në vijim:

Tabela: Tavanet PBA 2018-2020 (për vitin 2018)

në mijë lekë

Objektivat	Përshkrimi	Faza 1	Faza 2
Objektivi 1	Do të synojmë rritjen e nivelit të sigurimit të Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë në një nivel 2 % më të lartë se ai i vitit 2016 duke arritur nivelin 90 %.		
Produkti A	Personalitete VIP vendas dhe të huaj, të ruajtur nga Garda	1,352,769	1,352,769
Objektivi 3:	Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës		
Produkti B	Mjete transporti të reja të blera		
Viti 2018	Zëvendësimi I teknikës egzistuese shumë të amortizuar me mjete të reja transporti	9,000	9,000
Viti 2019	Zëvendësimi I teknikës egzistuese shumë të amortizuar me mjete të reja transporti	18,431	18,431
Viti 2020	Zëvendësimi I teknikës egzistuese shumë të amortizuar me mjete të reja transporti	50,000	50,000
Produkti C	Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime perëndimore		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Viti 2018	Sigurimi I pistoletave të reja me qëllim zëvendësimin e armatimit egzistues që është më I rëndë në përdorim dhe vrasës	10,000	10,000
Viti 2019	Sigurimi I pistoletave të reja me qëllim zëvendësimin e armatimit egzistues që është më I rëndë në përdorim dhe vrasës	-	-
Viti 2020	Sigurimi I pistoletave të reja me qëllim zëvendësimin e armatimit egzistues që është më I rëndë në përdorim dhe vrasës	-	-
Produkti D	Rikonstruksion I objektit të amortizuar		
Viti 2018	Rikonstruksioni I godinës, ana ndërtimore e amortizuar, prishje suvatimesh egzistuese, F.V dyer dhe dritare duroalumini, rrjet I furnizimit me uje, hedhje dhe ndërtim I ri I KUB dhe KUZ.	-	-
Viti 2019	Rikonstruksioni I godinës, ana ndërtimore e amortizuar, prishje suvatimesh egzistuese, F.V dyer dhe dritare duroalumini, rrjet I furnizimit me uje, hedhje dhe ndërtim I ri I KUB dhe KUZ.	-	-
Viti 2020	Rikonstruksioni I godinës, ana ndërtimore e amortizuar, prishje suvatimesh egzistuese, F.V dyer dhe dritare duroalumini, rrjet I furnizimit me uje, hedhje dhe ndërtim I ri I KUB dhe KUZ.	-	-
Produkti F	Objekt I rindërtuar		
Viti 2018	Ndërtim I magazinave dhe oficinës në kushtet e transferimit të trupave në venddislokimin e ri	-	-
Viti 2019	Ndërtim I magazinave dhe oficinës në kushtet e transferimit të trupave në venddislokimin e ri	11,569	11,569
Viti 2020	Ndërtim I magazinave dhe oficinës në kushtet e transferimit të trupave në venddislokimin e ri	-	-
Produkti G	Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambjentet e punës		
Viti 2018	Blerje e pajisjeve të reja për përmirësimin e infrastrukturës	13,569	13,569
Viti 2019	Blerje e pajisjeve të reja për përmirësimin e infrastrukturës	-	-
Viti 2020	Blerje e pajisjeve të reja për përmirësimin e infrastrukturës	-	-
Produkti E	Rrugë të asfaltuara		
Viti 2018	Përmirësimi I infrastrukturës aktuala në Komandën e Gardës në kushtet e transferimit të trupave në Komandën e re	-	4,000
Viti 2019	Përmirësimi I infrastrukturës aktuala në Komandën e Gardës në kushtet e transferimit të trupave në Komandën e re	-	-
Viti 2020	Përmirësimi I infrastrukturës aktuala në Komandën e Gardës në kushtet e transferimit të trupave në Komandën e re	-	-

Burimi: Përgatiti grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi u konstatua se, tavanet e parashikuara në artikujt 600 dhe 601 nën gjykimin e subjektit nuk i përballojnë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e qëllimit të produktit A të programit të Gardës. Në këto kushte, kërkesa e paraqitur për këtë produkt sipas artikujve përkatës ka tejkaluar tavanin e parashikuar për këto zëra me 60,163 mijë lekë, konkretisht tavanin i miratuar është 1,138,339 lekë, ndërsa kërkesa në PBA është 1,449,501 lekë.

Viti 2018

Dokumenti i PBA-së 2019-2021 (faza I) për programin e Gardës së Republikës është dërguar në Ministrinë e Brendshme me shkresën nr. 2206/3, datë 27.04.2018, në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 252, datë 13.04.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2020, për Ministrinë e Brendshme”, UMFE nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA” si dhe bazuar në UMFE nr. 7/1, datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”; ndërsa dokumenti i PBA-së 2019-2021 (faza II) është dërguar në Ministrinë e Brendshme me shkresën nr. 2206/6, datë 20.08.2018.

Nga auditimi u konstatua se nga njëra PBA në tjetrën përgjithësisht ka vijueshmëri në përkufizimin dhe trajtimin e produkteve për secilin objektiv, përveç:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- Produktit 2 “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës në Gardën e RSH”, për objektivin 3⁶, i cili ishte Produkti G, në PBA-në e mëparshme;
 - Produktit 3 “Godinë e rikonstruktuar dhe shesh I asfaltuar” / Objektivi 3, i cili ishte Produkti D në PBA-në e mëparshme;
 - Produktit 4 “Magazinë dhe oficinë e rikonstruktuar në Komandën e Gardës”/ Objektivi 3, i cili në fakt në PBA 2018-2020 ishte Produkti F i të njëjtit objektivi.
 - Produktet: C “Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime perëndimore”, E “Rrugë të asfaltuara” nuk janë parashikuar më në PBA 2019-2020
- Mos pasja e vijueshmërisë edhe në listimin e produkteve respektive brenda të njëjtit objektivi, vështirëson krahasueshmërinë mes zërave

Në buxhetin e vitit 2018, janë shtuar shpenzimet e planifikuara vjetore, më tepër nga sa ishin parashikuar në PBA 2018-2020, konkretisht për zërat në:

- shpenzime korrente (artikujt 600, 601, 602 dhe 606), për Produktin 1 “Raporte për menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore” / Objektivi 2, në shumën totale prej 187,400 mijë lekë;
- për shpenzime kapitale (artikulli 231), për Produktin 1 “Mjete transporti të reja të blera” / Objektivi 3, çelur 42,200 mijë lekë më shumë (nga 9,000 mijë lekë që ishin parashikuar në PBA (faza II), çelur 51,200 mijë lekë);
- çelur për shpenzime kapitale (artikulli 231), për Produktin 2 “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës në Gardën e RSH” / Objektivi 3, çelur shpenzime kapitale (artikulli 231) në shumën 50,000 mije lekë (të paparashikuara në PBA 2018-2020) nga 13,569 mijë lekë që ishin parashikuar në PBA 2018-2020;
- për shpenzime kapitale (artikulli 231), për produktin 3 “Godinë e rikonstruktuar dhe shesh I asfaltuar” / Objektivi 3, janë çelur fonde nga buxheti i vitit 2018, në shumën 8,800 mijë lekë (të paparashikuara në PBA 2018-2020).

Tabela: Viti 2018 sipas PBA 2019-2021

në mijë lekë.

Objektivat sipas produkteve	Tavani	Kërkesa	Diferenca
Objektivi 1			
Produkti 1	1,282,600	1,304,277	21,677
Objektivi 2			
Produkti 1	187,400	196,600	9,200
Objektivi 3			
Prdukti 1	18,431	18,431	-
Produkti 2	-	-	
Produkti 3	-	-	
Prdukti 4	11,569	11,569	
TOTAL	1,500,000	1,530,877	30,877

Përgatiti: Grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se Garda e RSH, në dokumentin e PBA 2019-2021 (Faza I) ka tejkaluar tavanet e parashikuara respektivisht:

- Për Produktin 1, në shumën 21,677 mijë lekë,
- Për produktin 1/objektivi 2, në shumën 9,200 mijë lekë

⁶ Objektivi 3: “Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës”




KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Në mënyrë të sintetizuar, po ju paraqesim në Grafikon e mëposhtëm ecurinë e zërave për shpenzimet kapitale dhe atyre korrente nga realizimi faktik 2017, PBA 2018-2020 (parashikimi për vitin 2018), buxheti i vitit 2018, deri në realizimin faktik për vitin 2018.

Grafiku nr. 1 Planifikimi i buxhetit dhe ecuria e tij



1.b Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Programimi i buxhetit të Gardës është i ndarë në **8** produkte kryesore, dhe secili nga produktet është i ndarë në aktivitetet e veta. Llogaritjet për përgatitjen e buxhetit bëhen duke u nisur nga një bazë të dhënash të mëparshme.

Viti 2017

Për vitin 2017, në zbatim të pikës 23, të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme”, Ministria e Punëve të Brendshme (aktualisht Ministria e Brendshme) me shkresën nr. 8703, datë 16.12.2016 ka dërguar tabelat për buxhetin e miratuar sipas artikujve kryesore, që përbëjnë strukturën buxhetore të Gardës (ndër të tjerë).

Nga auditimi rezultoi se Garda ka bërë detajimin e buxhetit në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku për vitin 2017 janë çelur nga buxheti i shtetit shuma prej 1,329,710 mijë lekë të shpërndara sipas zërave më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2017	Çeljet	Pesha %
Paga	908,494	68%
Sigurime	184,275	14%
Mallra dhe shërbime	173,000	13%
Transferta familjare	27,000	2%
Shpenzime kapitale	36,941	3%
Total	1,329,710	

Shpenzimet kapitale në vlerën totale prej 36,941mijë lekë i takojnë 2 projekteve që janë : “Rikonstruksioni i Njesisë speciale Garda e Republikës” në shumën 10,000 mijë lekë dhe “Ndërtim zyra dhe ambientet pune në Komandën e Gardës” në shumën 26,941 mijë lekë.

Në vijim, gjatë vitit buxhetor 2017, ky plan buxheti është rishikuar disa herë, duke rezultuar në përfundim me një shtesë prej 485,349 mijë lekë, e shpërndarë si më poshtë vijon:

Viti 2017

në mijë lekë

Artikuj	Fakt 2016	Buxheti fillestar	Buxheti I rishikuar	Shtesa /
---------	-----------	-------------------	---------------------	----------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

		2017	2017	pakesime fondi
Shpenzime korente	1,265,020	1,292,769	1,647,918	
600	908,314	908,494	992,494	84,000
601	155,577	184,275	164,275	(20,000)
602	182,998	173,000	467,684	294,684
606	18,131	27,000	23,465	(3,535)
shpenzime kapitale	64,938	36,941	167,141	
231	64,938	36,941	167,141	130,200
TOTAL	1,329,958	1,329,710	1,815,059	485,349

Ndryshimet/shpërndarjet/rialokimet e ndodhura në buxhetin e vitit 2017 janë si vijon:

- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 50,000 lekë mbështetur në shkresën nr. 335/4, datë 03.02.2017, ku Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar çeljen e Fondit të Veçantë për Gardën e RSH, në shumën totale prej 50,000 mijë lekë;
- ✓ Shtuar artikulli 602 me shumën 160,011,479 lekë, mbështetur në njoftimin e Ministrisë, dërguar me shkresën nr. 8996, datë 08.02.2017, në zbatim të VKM nr. 22, datë 18.01.2017 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme, nga fondi i rezervës së shtetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011”
- ✓ Shtuar artikulli 600 me shumën 29,000,000 lekë dhe 601 me shumën 5,000,000 lek, mbështetur në shkresën nr. 2057/7, datë 11.05.2017 të MPB, për rritjen e pagave që është bërë në mbështetje të Udhëzimit plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”
- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 190,000 lekë mbështetur në shkresën nr. 3453/4, datë 22.05.2017 të MPB, në vijim të shkresës së MF nr. 6403/1, datë 16.05.2017 “Përgjigje mbi kërkesën për përdorim fondi të veçantë” është miratuar ky fond
- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 170,000 lekë mbështetur në shkresën nr. 5864/4, datë 14.08.2017 të MPB, në vijim të shkresës së MF nr. 10804/1, datë 03.08.2017 “Mbi kërkesën për përdorim dhe akordim fondi të veçantë”
- ✓ Me shkresën nr. 5614/3, datë 05.09.2017 të MPB, mbështetur në shkresën e MF nr. 10427/1, datë 01.08.2017 “Përgjigje mbi kërkesën për transferim fondit” janë bërë rialokime fondesh duke shtuar fonde në shumën 25,000 mijë lekë dhe 5,000 mijë lekë në artikujt 600 dhe 602, dhe pakësuar me 25,000 mijë lekë dhe 5,000 mijë lekë artikujt 601 dhe 606;
- ✓ Shtuar artikulli 231 me shumën **50,000,000 lekë** mbështetur në Aktin Normativ nr. 2, datë 16.08.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 130, të buxhetit të vitit 2017”. Kjo shtesë ka shkuar për projektin “Shërbimi i armatimit” mbështetur në shkresën nr. 6208/8, datë 07.09.2017 “Njoftim mbi rishpërndarje fondesh të shpenzimeve kapitale në zbatim të **Aktit Normativ nr. 2**”
- ✓ Shtuar artikulli 600 me shumën **10,000,000 lekë** mbështetur në shkresën e MPB nr. 6208/9, datë 07.09.2017 “Njoftim mbi rishpërndarje fondesh të shpenzimeve korente në zbatim të **Aktit Normativ nr. 2**” ;
- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 734,985 lekë, mbështetur në shkresën nr. 6854/4, datë 17.10.2017 për çelje fondi të veçantë në programin e Gardës së RSH;
- ✓ shtuar artikulli 606 me shumën 160,150 lekë, mbështetur në shkresën nr. 7979/3, datë 22.11.2017 është bërë çelje për përdorim fondi të veçantë
- ✓ Shtuar artikulli 600 në shumën **20,000,000 lekë** mbështetur në **Aktin Normativ nr. 3**, datë 06.11.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar”;
- ✓ Shtuar artikulli 231 me shumën **80,200,000 lekë** mbështetur në **Aktin Normativ nr. 3**, datë 06.11.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar”. Shpenzimet kapitale janë 75,000 mijë lekë për “Blerje makinash për Gardën”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

dhe shuma prej 5,200 mijë lekë “Ndërtim zyrash dhe ambiente pune” në Komandën e Gardës;

- ✓ Shtuar artikulli 602 me shumën 129,672,594 lekë mbështetur në VKM nr. 743, datë 13.12.2017 “Për një shtesë fondi dhe një ndryshim në Vendimin nr. 22, datë 18.01.2017 të KM “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për MPB, nga fondi rezervë i buxhetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011”. Sa më sipër në zbatim të udhëzimit nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” dhe shkresës së MF nr. 16087/4, datë 08.01.2018
- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 160,000 lekë , mbështetur në shkresën e MPB nr. 9208/3, datë 17.01.2018, dalë në zbatim të shkresës së MF nr. 18592/1, datë 15.01.2018.

Viti 2018

Për vitin 2018, në zbatim të pikës 23, të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme”, Ministria e Punëve të Brendshme (aktualisht Ministria e Brendshme) me shkresën nr. 9509, datë 18.12.2017, ka dërguar tabelat për buxhetin e miratuar sipas artikujve kryesore, që përbëjnë strukturën buxhetore të Gardës (ndër të tjerë).

Nga auditimi rezultoi se Garda ka bërë detajimin e buxhetit në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku për vitin 2018 janë çelur nga buxheti i shtetit shuma prej 1,329,710 mijë lekë të shpërndara sipas zërave më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2018	Çeljet	Pesha %
Paga	1,025,641	65%
Sigurime	177,128	11%
Mallra dhe shërbime	233,000	15%
Transferta familjare	27,000	2%
Shpenzime kapitale	110,000	7%
Total	1,572,769	

Në vijim, gjatë vitit buxhetor 2018, ky plan buxheti është rishikuar disa herë, duke rezultuar në përfundim me një shtesë prej 485,349 mijë lekë, e shpërndarë si më poshtë vijon:

Artikuj	Fakt 2017	Buxheti fillestar 2018	Buxheti I rishikuar 2018	Diferenca Shtesa / pakesime fondi
Shpenzime korente	1,634,556	1,462,769	1,504,404	41,635
600	992,494	1,025,641	1,059,041	33,400
601	164,275	177,128	183,728	6,600
602	454,927	233,000	228,000	(5,000)
606	22,860	27,000	33,635	6,635
Shpenzime kapitale	158,766	110,000	159,000	49,000
230	-	-	-	-
231	158,766	110,000	159,000	49,000
TOTAL	1,793,322	1,572,769	1,663,404	90,635

Ndryshimet/shpërndarjet/rialokimet e ndodhura në buxhetin e vitit 2018 janë si vijon:


- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 138,200 lekë mbështetur në shkresën nr. 975/3, datë 07.03.2018, ku Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar çeljen e Fondit të Veçantë për Gardën e RSH;
- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 200,000 lekë mbështetur në shkresën nr. 2301/3, datë 03.05.2018, ku Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar çeljen e Fondit të Veçantë për Gardën’

- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 475,450 lekë mbështetur në shkresën nr. 5186/3, datë 25.07.2018, ku Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar çeljen e Fondit të Veçantë për Gardën
- ✓ Shtuar artikulli 600 dhe 601 respektivisht me shumën **33,400,000 lekë dhe 6,600,000 leke** mbështetur në shkresën e MPB nr. 6915/1, datë 29.08.2018 “Njoftim mbi ndryshimin e fondeve për shpenzime korente dhe nr. të punonjësve në zbatim të **Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018**”;
- ✓ Shtuar artikulli 231 me shumën 50,000,000 lekë, mbështetur në shkresën nr. 6562/11, datë 07.08.2018 “Mbi detajimin e fondeve në zbatim të **Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018**” dhe shkresës nr. 6617/3, datë 21.09.2018 “Njoftim mbi ndryshimin e fondeve për shpenzime kapitale në zbatim të Aktit Normativ nr. 1, datë 26.07.2018”;
- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 130,000 lekë mbështetur në shkresën nr. 7600/3, datë 30.10.2018 “Njoftim për çelje fondi të veçantë”;
- ✓ Me shkresën e MB nr. 10113, datë 10.12.2018, mbështetur në shkresën e Ministrisë së Financave nr. 20540/1, datë 03.12.2018 “Transferim fondi për vitin 2018” është shtuar artikulli 606 me 5,000,000 lekë dhe pakësuar me po të njëjtën vlerë artikulli 602;
- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 498,200 lekë , mbështetur mbi shkresën nr. 10078/2, datë 27.12.2018 “Njoftim për çelje fondi të veçante”, në vijim të shkresës së MFE nr. 22040/1, datë 26.12.2018 “Akordim fondi për përdorim fondi të veçante”;
- ✓ Shtuar artikulli 606 me shumën 58,200 lekë , mbështetur mbi shkresën nr. 10399/1, datë 31.12.2018 “Njoftim për çelje fondi të veçante”, në vijim të shkresës së MFE nr. 22324/1, datë 27.12.2018 “Akordim fondi për përdorim fondi të veçante”;
- ✓ Pakësuar artikulli 231 për projektin “Blerje e mjeteve të transportit” me shumën 1,000,000 lekë, në mbështetje të shkresës së MB NR. 10638/5, DATË 31.12.2018 “Njoftim mbi ndryshimin e fondeve për shpenzime kapitale në zbatim të Aktit Normativ nr. 2, datë 19.12.2018”.

1.c Realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2017

Nga auditimi mbi realizimin e buxhetit për vitin 2017, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,729,622 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,634,555 mijë lekë (ose 95% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 5% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është buxheti në rritje nga viti 2016 në 2017, i cili pasohet edhe nga realizimi faktik në rritje për dy vitet te njëpasnjëshme. Edhe pse buxheti përfundimtar është rritur gjatë vitit ushtrimor 2017, realizimi faktik i zërave për këtë vit, ka qenë nën planin përfundimtar me 85,437 mijë lekë më pak. Në mënyrë grafike ecuria e shpenzimeve sipas dy kategorive: korrente dhe kapitale, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Përgatiti: Grupi i auditimit, KLSH



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Ndërsa në tabelën më poshtë paraqitet më e detajuar ecuria e zërave të buxhetit respektivisht sipas realizimit faktik të vitit 2016, buxhetit fillestar 2017, buxhetit të rishikuar, dhe realizimin faktik për vitin 2017:

Pasqyra nr. 1 Te dhëna per buxhetin e vitit 2017

Në mijë lekë

Artikuj	Fakt 2016	Buxheti fillestar 2017	Buxheti I rishikuar 2017	Fakt 2017	Realizimi %
Shpenzime korente	1,265,020	1,292,769	1,647,918	1,634,555	99%
600	908,314	908,494	992,494	992,494	100%
601	155,577	184,275	164,275	164,275	100%
602	182,998	173,000	467,684	454,927	97%
606	18,131	27,000	23,465	22,860	97%
shpenzime kapitale	64,938	36,941	167,141	95,067	57%
231	64,938	36,941	167,141	95,067	57%
TOTAL	1,329,958	1,329,710	1,815,059	1,729,622	95%

Burimi: Sektori i Financës, GR

Nga krahasimi i artikujve specifike me fondet e buxhetuara, respektive u konstatua se,

- Shpenzimet për paga janë realizuar në masën 100% ndaj buxhetit të rishikuar, konkretisht në shumën 992,494 mijë lekë; por nëse e krahasojmë këtë zë me buxhetin fillestar ai na rezulton me një shtesë prej +9% ose realizuar 84,000 mijë lekë më shumë sa u parashikuan në buxhetin fillestar 2017;
- Shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën 164,275 mijë, ose 100% ndaj buxhetit përfundimtar; por krahasuar me buxhetin fillestar ky zë rezultoi rreth 11% më pak ose -20,000 mijë lekë më pak.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime u realizuan në shumën 454,927 mijë lekë ose 97% e planit përfundimtar; por krahasuar me buxhetin fillestar ky zë u realizua rreth 163% më shumë ose 281,927 mijë lekë më shumë nga sa planifikuar fillimisht.
- Shpenzimet për transferta të brendshme u realizuan në shumën 22,860 mijë lekë ose 97% ndaj planit përfundimtar, pra me një realizim prej 3% më pak nga sa ishte planifikuar; ndërsa krahasuar me buxhetin fillestar ky zë u realizua rreth 15% më pak, ose 4,140 mijë lekë më pak nga sa planifikuar fillimisht;
- Shpenzimet kapitale për vitin 2017, u realizuan në shumën 95,067 mijë lekë ose rreth 57% e buxhetit përfundimtar (-72,074 mijë lekë më pak); ndërsa krahasuar me buxhetin fillestar ky zë rezultoi me një tejkalim prej +58,126 mijë lekë (ose 157% më shumë).


Viti 2018

Nga auditimi mbi realizimin e buxhetit për vitin 2018, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,713,164 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,491,338 mijë lekë (ose 87% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 13% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është që **shpenzimet korrente dhe kapitale paraqesin më pak luhatje mes fazave, objekt vlerësimi⁷, në krahasim me një vit më parë.**

Në mënyrë grafike ecuria e shpenzimeve për vitin 2018, sipas dy kategorive: korrente dhe kapitale, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

⁷ Realizimi faktik 2017, buxheti fillestar 2017, buxheti përfundimtar 2017; dhe realizimi faktik 2018

Grafiku nr. 2: Ecuria e shpenzimeve, 2018



Nga krahasimi i artikujve specifike me fondet e buxhetuara, respektive, sikundër paraqitet në tabelën në vijim, u konstatua sa më poshtë vijon:

Pasqyra nr. 2

Artikuj	Fakt 2017	Buxheti fillestar 2018	Buxheti I rishikuar 2018	Fakt 2018	Realizimi %
Shpenzime korente	1,634,556	1,462,769	1,504,404	1,491,338	99%
600	992,494	1,025,641	1,059,041	1,059,036	100%
601	164,275	177,128	183,728	183,728	100%
602	454,927	233,000	228,000	225,714	99%
606	22,860	27,000	33,635	22,860	68%
Shpenzime kapitale	158,766	110,000	159,000	221,826	140%
231	158,766	110,000	159,000	221,826	140%
TOTAL	1,793,322	1,572,769	1,663,404	1,713,164	103%

Burimi: Sektori i Financë, GR

- **Shpenzimet për paga** janë realizuar në masën 100% ndaj buxhetit të rishikuar, konkretisht në shumën 1,059,036 mijë lekë; nëse e krahasojmë këtë zë me buxhetin fillestar ai na rezulton me një shtesë prej +3% ose realizuar 33,395 mijë lekë më shumë nga sa u parashikuan në buxhetin fillestar 2018

Në këtë artikull kemi katër shtesa fondesh dhe konkretisht :

- Shtesë fondi në masën 29.000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.6152/1, datë 3.5.2017 “Kthim përgjigje” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.2057/7, datë 11.5.2017 “Njoftim mbi detajimin e fondeve për shpenzime personeli në zbatim të paketës ligjore të pagave të vitit 2017”.

- Shtesë fondi në masën 25.000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.10427/1, datë 1.8.2017 “Përgjigje mbi kërkesën për transferim fondi”, dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.5614/3, datë 5.9.2017 “Njoftim për transferim fondi”.

- Shtesë fondi në masën 10.000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.11721/34, datë 7.9.2017 “Mbi miratimin e detajimit të ndryshimeve të Aktit Normativ të Buxhetit të vitit 2017 për shpenzimet korente” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.6208/9, datë 7.9.2017 “Njoftim mbi rishpërndarje fondesh të shpenzimeve korente në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 16.8.2017”.

- Shtesë fondi në masën 20.000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.16148/94, datë 6.12.2017 “Mbi miratimin e detajimit të ndryshimeve të Aktit Normativ të Buxhetit të vitit 2017 për shpenzimet korente” dhe shkresën e Sekretarit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme nr.8414/7, datë 11.12.2017 “Njoftim mbi rishpërndarjen e fondeve të shpenzimeve korente në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 6.11.2017”.

- **Shpenzimet për sigurime shoqërore** u realizuan në masën 183,728 mijë, ose 100% ndaj buxhetit përfundimtar; por krahasuar me buxhetin fillestar ky zë rezultoi rreth 4% më shumë ose +6,600 mijë lekë më tepër.

Në këtë artikull kemi një shtesë dhe një pakësim fondi, konkretisht :

- Shtesë fondi në masën 5.000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.6152/1, datë 3.5.2017 “Kthim përgjigje” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.2057/7, datë 11.5.2017 “Njoftim mbi detajimin e fondeve për shpenzime personeli në zbatim të paketës ligjore të pagave të vitit 2017”.

- Pakësim fondi në masën 25.000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.10427/1, datë 1.8.2017 “Përgjigje mbi kërkesën për transferim fondi”, dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.5614/3, datë 5.9.2017 “Njoftim për transferim fondi”.

- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** u realizuan në shumën 225,714 mijë lekë ose 99% e planit përfundimtar; krahasuar me buxhetin fillestar ky zë u realizua rreth 97% ose -7,286 mijë lekë më pak nga sa planifikuar fillimisht.

Në këtë artikull kemi tre shtesa fondesh, konkretisht :

-Shtesë fondi në masën 160.011.479 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.607/4, datë 2.2.2017 “Mbi akordimin e fondeve në zbatim të VKM nr.22, datë 18.1.2017” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.8996/8, datë 8.2.2017 “Njoftim për shtesë fondi në zbatim të VKM-së nr.22, datë 18.1.2017”. Kjo shtesë fondi lidhet me zbatimin e vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes tragjike të 21 janarit të vitit 2011.

-Shtesë fondi në masën 5.000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.10427/1, datë 1.8.2017 “Përgjigje mbi kërkesën për transferim fondi”, dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.5614/3, datë 5.9.2017 “Njoftim për transferim fondi”.

-Shtesë fondi në masën 129.672.594 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.16087/4, datë 8.1.2018 “Zbatim i VKM-së nr.743, datë 13.12.2017” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme nr.8996/3, datë 17.1.2018 “Njoftim për shtesë fondi sipas VKM-së nr.743, datë 13.12.2017”. Kjo shtesë fondi lidhet me zbatimin e vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes tragjike të 21 janarit të vitit 2011.

- **Shpenzimet për transferta për buxhetet familjare dhe individët** u realizuan në shumën 22,860 mijë lekë ose 68% ndaj planit përfundimtar; ndërsa krahasuar me buxhetin fillestar ky zë u realizua rreth 15% më pak, ose 4,140 mijë lekë më pak nga sa planifikuar fillimisht. Ajo që vihet re në zërin “Tarnsferta te brendshme” është që buxheti fillestar dhe realizimi faktik, për të dy vitet e njëpasnjëshëm 2017, 2018 është i pandryshuar, konkretisht planifikuar fillimisht 27,000 mijë lekë dhe realizuar 22,860 mijë lekë, pra në të dy vitet realizuar rreth 15% më pak nga sa planifikuar fillimisht. Pavarësisht kësaj institucioni ka vijuar që në të dy këta vite ta rishikojë buxhetin për këtë zë, konkretisht duke e ulur në 23,465 mijë lekë në vitin 2017, dhe duke e rritur 33,635 mijë lekë në vitin 2018).

Në këtë artikull kemi shtatë lëvizje fondesh, gjashtë shtesa fondi që lidhen me përdorimin e fondit të veçantë në masën 1.465.135 lekë, dhe një pakësim fondi në masën 5.000.000 lekë si vijon:

- Shtesë fondi në masën 50.000 lekë ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.825/1, datë 31.1.2017 “Përgjigje mbi kërkesën për përdorim fondi të veçantë” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.335/4, datë 3.2.2017 “Njoftim për çelje fondi të veçantë”.

- Shtesë fondi në masën 190.000 lekë ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.6403/1, datë 16.5.2017 “Përgjigje mbi kërkesën për përdorim fondi të veçantë” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.3453/4, datë 22.5.2017 “Njoftim për çelje fondi të veçantë”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- Shtesë fondi në masën 170.000 lekë ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.10804/1, datë 3.8.2017 “Mbi kërkesën për përdorim dhe akordim fondi të veçantë” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.5864/4, datë 14.8.2017 “Njoftim për çelje fondi të veçantë”.

- Pakësim fondi në masën 5.000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.10427/1, datë 1.8.2017 “Përgjigje mbi kërkesën për transferim fondi”, dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.5614/3, datë 5.9.2017 “Njoftim për transferim fondi”.

- Shtesë fondi në masën 734.985 lekë ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.13319/1, datë 12.10.2017 “Mbi kërkesën për përdorim dhe akordim fondi të veçantë” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme nr.6854/4, datë 17.10.2017 “Njoftim për çelje fondi të veçantë”.

- Shtesë fondi në masën 160.150 lekë ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.15180/1, datë 17.11.2017 “Mbi kërkesën për përdorim dhe akordim fondi të veçantë” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme nr.7979/3, datë 22.11.2017 “Njoftim për çelje fondi të veçantë”.

- Shtesë fondi në masën 160.000 lekë ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.18592/1, datë 15.1.2018 “Mbi kërkesën për përdorim dhe akordim fondi të veçantë” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme nr.9208/3, datë 17.1.2018 “Njoftim për çelje fondi të veçantë”.

- **Shpenzimet kapitale** për vitin 2018, u realizuan në shumën 221,826 mijë lekë ose rreth 62,826 mijë lekë më shumë buxheti përfundimtar (40% më shumë). Tejkalimi i buxhetit në fakt lidhet me çeljen e dy Letër Kredive (LC), pranë, konkretisht:

1. në favor të shpk në vlerën 60.426.000; dhe
2. në favor të shpk në vlerën 3.273.600 lekë

Sa më sipër gjithashtu argumenton edhe mospërputhje, në pasqyrat financiare të vitit 2018 midis formatit nr.6 për investimet dhe burimet e financimit me formatin nr.3 për lëvizjet e “...” për vlerën 63.699.600 lekë (diferenca midis 221.825.957 lekë formati nr.6 dhe 158.126.357 lekë formati nr.3), pasi vlera prej 63.699.600 lekë është paguar në formën e letër kredisë (LC) në muajin dhjetor 2017, ndërsa mallrat (mjete transporti) janë lëvruar në muajt shkurt, mars 2018.

Për të njëjtën arsye, edhe në llogarinë ushtrimore të vitit 2017, formati nr.5 për lëvizjet “....” paraqitet me një vlerë më të madhe se sa formati nr.4 për shpenzimet e burimeve për investime në vlerën e sipërcituar, pra 63.699.600 lekë.

Për artikullin 231, gjatë vitit 2018 rezultuan tre shtesa fondesh në masën 130.200.000 lekë të detajuara si më poshtë :

- 50.0000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave nr.11721/33, datë 7.9.2017 “Në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 16.8.2017” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme nr.6208/8, datë 7.9.2017 “Njoftim mbi rishpërndarje fondesh të shpenzimeve kapitale në zbatim të Aktit Normativ nr.2, datë 16.8.2017”.

- 75.0000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.16148/39, datë 21.11.2017 “Njoftim mbi rishpërndarjen e fondeve të shpenzimeve kapitale në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 6.11.2017” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme nr.8414/11, datë 30.11.2017 “Njoftim mbi rishpërndarje fondesh të shpenzimeve kapitale në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 6.11.2017”. Ky fond u akordua për projektin me kod M 160982 “Blerje makina për Gardën”.

- 5.2000.000 lekë, ardhur me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.16148/39, datë 21.11.2017 “Njoftim mbi rishpërndarjen e fondeve të shpenzimeve kapitale në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 6.11.2017” dhe shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme nr.8414/11, datë 30.11.2017 “Njoftim mbi rishpërndarje fondesh të shpenzimeve kapitale në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 6.11.2017”. Ky fond u akordua për projektin me kod M 160264 “Ndërtim zyra dhe ambiente pune në Komandën e Gardës”.

Diferenca prej 8.374.682 lekë është kursim në prokurime



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore, nuk u auditua pasi nën gjykimin profesional të audituesit, si dhe mbështetur në Metodologjinë e auditimit (përzgjedhjen e kampioneve sipas formulave të aplikuara, bashkëngjitur anekseve të këtij projekti) zëri ishte tërësisht jomaterial dhe çështje për auditim rezultuan 0 (zero).

Titulli i Gjetjes 10: Mbi kujdesin në planifikimin e buxheteve

	1. Gjatë përgatitjes së PBA-së, Faza II, treguesit e performancës për Objektivin 3 - “Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës”, paraqiten në numër total, në një kohë kur bëhet fjalë për produkte te ndryshëm (konkretisht: produkti B “Mjete transporti të reja të blera”, produkti C “Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime perëndimore”, dhe produkti G “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës”, të cilët duhen trajtuar si tregues të veçantë brenda objektivit përkatës. Vetëm kështu ato i shërbejnë qëllimit të planifikimit në vetvete, i cili nis me vendosjen e objektivave të qarta, të besueshme, të matshme dhe të arritshme. 2. Nga auditimi u konstatua se nga njëra PBA në tjetrën përgjithësisht ka vijueshmëri në përkufizimin dhe trajtimin e produkteve për secilin objektiv, përveç: - Produktit 2 “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës në Gardën e RSH”, për objektivin 3, i cili ishte Produkti G, në PBA-në e mëparshme; - Produktit 3 “Godinë e ri konstruktuar dhe shesh I asfaltuar” / Objektivi 3, i cili ishte Produkti D në PBA-në e mëparshme; - Produktit 4 “Magazinë dhe oficinë e ri konstruktuar në Komandën e Gardës”/ Objektivi 3, i cili në fakt në PBA 2018-2020 ishte Produkti F i të njëjtit objektiv. - Produktet: C “Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime perëndimore”, E “Rrugë të asfaltuara” nuk janë parashikuar më në PBA 2019-2020 Mospasja e vijueshmërisë edhe në listimin e produkteve respektive brenda të njëjtit objektiv, vështirëson krahasueshmërinë mes zërave, e cila merr rëndësi kur bëhet fjalë për monitorime dhe/ose vlerësime të parashikimeve. 3. Nga auditimi mbi realizmin e buxhetit për vitin 2017, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,729,622 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,634,555 mijë lekë (ose 95% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 5% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është buxheti në rritje nga viti 2016 në 2017, i cili pasohet edhe nga realizimi faktik në rritje për dy vitet te njëpasnjëshme. Edhe pse buxheti përfundimtar është rritur gjatë vitit ushtrimor 2017, realizimi faktik i zërave për këtë vit, ka qenë nën planin përfundimtar me 85,437 mijë lekë më pak. Nga auditimi mbi realizmin e buxhetit për vitin 2018, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,713,164 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,491,338 mijë lekë (ose 87% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 13% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është që shpenzimet korrente dhe kapitale paraqesin më pak luhatje mes fazave, objekt vlerësimi, në krahasim me një vit më parë.
Situata	
Kriteri	Udhëzimi plotësues nr. 10/3, datë 13.07.2017 “Për përgatitjen e PBA 2018-2020”, ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, ligji nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”.2



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Ndikimi/Efekti:	Gjatë përgatitjes së PBA-së, treguesit e performancës nuk trajtohen si tregues të veçantë brenda objektivit përkatës për ti shërbyer qëllimit të planifikimit, për vendosjen e objektivave të qarta, të besueshme, të matshme dhe të arritshme.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Me qëllim respektimin e parimeve të qeverisjes buxhetore të cilat përbëjnë një “praktikë të mirë” për tu ndjekur dhe zbatuar, por edhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, rekomandojmë marrjen e masave nga subjekti që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore të mbahet parasysh: - lidhja e ngushte mes buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme; si dhe - planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi aktiv.
Afati për zbatim:	Në vijimësi

Titulli i gjetjes:	Në vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezulton se raportet e monitorimit të buxhetit nuk publikohen dhe kanë informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse.
Situata1:	Nga auditimi rezulton se raportet e monitorimit nuk publikohen në Ëeb-in e Gardës së Republikës dhe as në Ëeb-in e Ministrisë së Brendshme, gjithashtu raportet e monitorimit nuk kanë informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungon një analizë me argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre. Nuk është e paraqitur Performanca e produkteve e lidhura me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva.
Situata 2	Nuk ka një sistem informatik informacioni, monitorimi që u siguron drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë. Aktualisht kryhet me një kordinator i cili mbledh dhe raporton tek drejtuesit dhe në Ministri, për nivelin e realizimit të objektivave të materializuara në produkte. Nuk ka një procedurë të veçantë të shkruar nga menaxhuesit, përtej legjislacionit në fuqi për ruajtjen nga përdorimi i paautorizuar për aktivet e rëndësishme (me vlerë) dhe aktivet afatgjata (përfshirë të dhënat personale). Gjithashtu nuk ka manual procesesh ose rregullore për proceset kryesore operacionale dhe financiare i cili të specifikojë qarkullimin e dokumentacionit.
Kriteri:	Monitorimi i buxhetit në përputhje me UMF nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësinë e Qeverisjes Qendrore”, paragrafi 49.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e një analizë me argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe mungesa e një sistemi informatik informacioni ndikon në masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e këtyre



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	produkteve.
Rëndësia	I ulët
Rekomandime	Nga Garda e Republikës të hartohen Raportet e Monitorimit për zbatimin e buxhetit, të cilat duhet të përmbajnë një informacionin të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, raportimin lidhur me ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave të politikës që trajtojnë nëpërmjet treguesve të performancës përkatëse në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm si dhe çdo problematikë të rezultuar, duke specifikuar dhe masat e nevojshme për adresimin e tyre në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Garda, strukturat menaxhuese të marrin masat të hartojnë rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, në përshtatje me strukturën dhe objektivat e institucionit duke e plotësuar dhe harmonizuar me kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe miratuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave:

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Për periudhën **01.01.2017 deri 31.12.2017**, numri i punonjësve të Gardës së Republikës ka ndryshuar nga 1.333 punonjës në organikë në GR, në 1387 punonjës më 15.2.2017. Më hollësisht:

- **VKM nr.103, datë 15.2.2017** “Për një ndryshim në VKM nr.612, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, organizimin, varësinë strukturore dhe limitin organik të Gardës së Republikës së Shqipërisë, si dhe për njehsimin e funksioneve organike sipas nivelit të gradave”, të ndryshuar”, Garda e Republikës përbëhet nga **1.387 punonjës garde**. Nga këto: 1 madhor, 132 të lartë, 182 të mesëm, 1057 të ulët dhe 15 punonjës civilë..

Referuar përcaktimeve të pikes nr.1, të Urdhërit të MPB me nr.160, datë 21.3.2017 “Për ndryshimin e numrit të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2017”, urdhërohet reduktimi i numrit të punonjësve në programin buxhetor “Policia e Shetit” me 54 punonjës, si dhe shtohet në programin “Garda e Republikës” me 54 punonjës. Si pasojë, numri I përgjithshëm I punonjësve të GR nga 1.333 që ishte depozituar në thesar, duke reflektuar shtesat sipas këtij urdhëri të ministrit (prej + 54), arrin në **1.387 punonjës garde**.

- **VKM nr.445, datë 22.5.2017** “Për miratimin e strukturës e të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e republikës së Shqipërisë”, Garda e Republikës ka në structure të miratuara 1.358 pozicione punësimi. Nga këto: 1 madhor, 133 të lartë, 176 të mesëm, 1034 të ulët dhe 14 punonjës civilë..Në këtë VKM është bërë dhe njehsimi i funksioneve organike sipas gradave në institucionin e GR.

Bazuar në përcaktimet e vënë në shkresën e Ministrisë së Punëve të Brendshme me nr.5471/2, datë 25.7.2017 “Njoftim për ndryshim numri punonjësish”, në zbatim të VKM nr.445, datë 22.5.2017 “Për miratimin e strukturës e të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, konfirmohet numri I përgjithshëm prej 1358 punonjësish, mbështetur dhe nga ana e Ministrisë së Financave me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

shkresën me nr.9775/1, datë 20.7.2017 “Për një ndryshim në numrin e punonjësve të Gardës së Republikës”, ku Garda e Republikës ka numrin e miratuar të punonjësve prej **1.358 punonjës garde**.

Në analize të shkresës së Ministrisë së Brendshme me nr.8414/20, datë 19.12.2017 “Njoftim për miratim ndryshimi numri punonjësish”, referuar Udhezimit polotesues me nr. 8, date 13.1.2017 “Për zbatimin e buxhetit të shtetit 2017” dhe shkresës së MF me nr. 16875/1 datë 05.12.2017 knumri i punonjësve shtesë për njësinë shpenzuese të gardës së Republikës është + 50 punonjës.

Paraqitet kjo situatë e numrit të punonjësve në organikë dhe në fakt për vitin 2017 sipas muajve:

Pasqyra nr. 4

	Fakti 2017				plani	diferenca
	Bashkëshorte	Civilë	Ushtarak	Gjithsej		
Janar	1	14	1300	1315	1358	-43
Shkurt	1	15	1303	1319	1358	-39
Mars	1	14	1300	1315	1358	-43
Prill	1	14	1298	1313	1358	-45
Maj	1	14	1302	1317	1358	-41
Qershor	1	14	1294	1309	1358	-49
Korrik	1	14	1299	1314	1358	-44
Gusht	1	14	1295	1310	1358	-48
Shtator	1	14	1298	1313	1358	-45
Tetor	1	14	1309	1324	1358	-34
Nentor	1	14	1304	1319	1408	-89
Dhjetor	1	14	1309	1324	1408	-84

(Burimi: Sektori i Finances, GR)

Për vitin 2018:

Për periudhën 01.01.2018 deri 07.02.2018, është vijuar me zbatimin e përcaktimeve të VKM nr.445, datë 22.5.2017 “Për miratimin e strukturës e të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e republikës së Shqipërisë”

- Për periudhën nga 07.02.2018 e në vazhdim Garda e Republikës ka funksionuar me miratimin e organikës me vendimin nr.66, datë 07.02.2018, “Për disa ndryshime në Vendimin nr.445, datë 22.05.2017 të KM “Për miratimin e strukturës e të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktimet për Gardën e Republikës 1.408 punonjës garde.

Gjatë periudhës së auditimit kemi mosplotësim të organikës, si rezultat i lëvizjeve të personelit duke marrë punonjës të rinj për arsye të lirimeve të punonjësve dhe daljes në reformë.

Paraqitet kjo situatë e numrit të punonjësve në organikë dhe në fakt për vitin 2018, sipas muajve:

Pasqyra nr. 5

	Fakt 2018				plani	diferenca
	Bashkëshorte	Civilë	Ushtarak	Gjithësej		
Janar	1	14	1304	1319	1408	-89
Shkurt	1	14	1304	1319	1408	-89
Mars	1	14	1343	1358	1408	-50
Prill	1	14	1333	1348	1408	-60
Maj	1	14	1311	1326	1408	-82
Qershor	1	14	1300	1315	1408	-93
Korrik	1	14	1321	1336	1408	-72
Gusht	1	14	1328	1343	1408	-65



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Shtator	1	14	1330	1345	1408	-63
Tetor	1	14	1331	1346	1408	-62
Nentor	1	14	1332	1347	1408	-61
Dhjetor	1	14	1331	1346	1408	-62

(Burimi; Sektori i Finances, GR)

Konkluzion nga analiza e plotësimit të numrit të punonjësve:

Gjatë periudhës së auditimit 2017 dhe 2018 rezultoi se nuk është plotëuar organika e miratuar me VKM dhe urdhrat e dalë në zbatim të tyre, si rezultat i lëvizjeve të personelit duke marrë punonjës të rinj për arsye të lirimeve të punonjësve dhe daljes në reformë,

b. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Nga auditimi me përzgjedhje të listëpagesave dhe listëprezencave të muajve Prill, Maj, Qershor 2017 në drejtim të trajtimit të punonjësve me paga dhe të ardhura të tjera u konstatua se :

- ***Për muajin Prill 2017***, janë trajtuar me paga sipas listëprezencës dhe sipas listëpagesës **1,313** punonjës në vlerën 63,573,187 lekë, nga të cilët 1,298 punonjës ushtarakë dhe 14 punonjës civilë (fuqi punëtore sipas strukturës). Janë trajtuar me pagë 1 bashkëshorte në shumën 31,188 lekë dhe 40 punonjës në reformë në shumën 846,322 lekë. Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga 1313 punonjës të trajtuar me listë pagesë, po i njëjti numër figuron dhe në listë prezencën e hartuar nga çdo strukturë sipas emërtesës.

- ***Për muajin Maj 2017***: Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga **1,317** punonjës të trajtuar me listë pagesë në listë prezencë figurojnë 1,317 punonjës në vlerën 63,067,745 lekë, nga të cilët 1,302 punonjës ushtarakë dhe 14 punonjës civilë (fuqi punëtore sipas strukturës). Janë trajtuar me pagë 1 bashkëshorte në shumën 31,188 lekë dhe 40 punonjës në reformë në shumën 846,322 lekë. Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga 1317 punonjës të trajtuar me listë pagesë, po i njëjti numër figuron dhe në listë prezencën e hartuar nga Çdo strukturë sipas emërtesës.

- ***Për muajin Qershor 2017***, janë trajtuar me paga sipas listëprezencës dhe listëpagesës **1309** punonjës në vlerën 62,811,369 lekë, nga të cilët 1,294 punonjës ushtarakë dhe 14 punonjës civilë (fuqi punëtore sipas strukturës) në shumën 482,240 lekë. Janë trajtuar me pagë 1 bashkëshorte në shumën 31,188 lekë dhe 42 punonjës në reformë në shumën 970,022 lekë. Likuidimi është kryer me urdhërshpenzime në vlerë totale 63,781,996 lekë me bankat e nivelit të dytë. Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga 1,309 punonjës të trajtuar me listë pagesë në listë prezencë figurojnë 1,309 punonjës.

U kryen sondazhe për kryqëzimin e informacionit të administruar në listëpagesat dhe në listëprezencat respektive për vitin 2018 dhe rezultoi:

- ***Për muajin Maj 2018***, janë trajtuar me paga sipas listëprezencës dhe listëpagesës 1,326 punonjës në vlerën 66,616,232 lekë nga të cilët 1,311 punonjës ushtarakë dhe 14 punonjës civilë (fuqi punëtore sipas strukturës). Janë trajtuar me pagë 1 bashkëshorte dhe 89 punonjës në reformë. Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga 1,326 punonjës të trajtuar me listë pagesë në listë prezencë figurojnë 1,326 punonjës.

- ***Për muajin Gusht 2018***, janë trajtuar me paga sipas listëprezencës dhe listëpagesës 1,343 punonjës në vlerën 67,641,694 lekë nga të cilët 1,328 punonjës ushtarakë dhe 14 punonjës civilë (fuqi punëtore sipas strukturës). Janë trajtuar me pagë 1 bashkëshorte dhe 134 punonjës në reformë. Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga 1,343 punonjës të trajtuar me listë pagesë në listë prezencë figurojnë 1,343 punonjës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- *Për muajin Tetor 2018*, janë trajtuar me paga sipas listëprezencës dhe listëpagesës **1,346** punonjës në vlerën 68,062,249 lekë, nga të cilët 1,331 punonjës ushtarakë dhe 14 punonjës civilë (fuqi punëtore sipas strukturës). Janë trajtuar me pagë 1 bashkëshorte dhe punonjësit e dalë në reformë. Likuidimi është kryer me urdhërshpenzime me bankat e nivelit të dytë. Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga 1,346 punonjës të trajtuar me listë pagesë në listë prezencë figurojnë 1.346 punonjës.

- *Për muajin Nëntor 2017*, janë trajtuar me paga sipas listëprezencës dhe listëpagesës **1,347** punonjës në vlerën 68,569,445 lekë nga të cilët 1,332 punonjës ushtarakë dhe 14 punonjës civilë (fuqi punëtore sipas strukturës). Janë trajtuar me pagë 1 bashkëshorte dhe punonjësit në reformë. Likuidimi është kryer me urdhërshpenzime me bankat e nivelit të dytë. Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga 1,347 punonjës të trajtuar me listë pagesë në listë prezencë figurojnë 1,347 punonjës.

- *Për muajin Dhjetor 2018*, janë trajtuar me paga sipas listëprezencës dhe listëpagesës **1,346** punonjës në vlerën 68,540,230 lekë, nga të cilët 1,331 punonjës ushtarakë dhe 14 punonjës civilë (fuqi punëtore sipas strukturës). Janë trajtuar me pagë 1 bashkëshorte dhe punonjësit në reformë. Likuidimi është kryer me urdhërshpenzime me bankat e nivelit të dytë. Listëpagesa u krahasua me listëprezencën ku nga 1,346 punonjës të trajtuar me listë pagesë në listë prezencë figurojnë 1,346 punonjës.

Nga krahasimi sa më sipërm, rezulton se përputhje midis listëprezencës dhe listëpagesës mujore për pagesat e kryera për punonjësit e institucionit. Përpilimi dhe administrimi i listëpagesave të pagave dhe trajtimeve të tjera janë bërë në zbatim të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" dhe kërkesave të përcaktuara në pikën 69, të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*". Trajtimi i punonjësve me paga dhe të ardhura të tjera, është bërë mbi bazën e dokumentacionit të plotë mbështetës si dhe të listëprezencave të firmosura nga komandantët e njësisë, shefat e sektorëve dhe të konfirmuara nga shefi i sektorit të personelit. Në listëprezencë është evidentuar prezenca në punë e punonjësve, apo të dhëna mbi arsyet e mosprezencës (me leje të zakonshme, mungon, me raport mjeksore, etj) si dhe ishte bërë gjurma e kontrollit nga sektori i burimeve njerëzore për listprezencat e përpiluara dhe janë nënshkruar rregullisht nga Shefi i Sektorit të burimeve Njerëzore z....., Shefi i Sektorit të Finances z..... si dhe për periudhën e audituar me zgjedhje, pagesat janë autorizuar rregullisht nga Komandanti i Gardës.

Nga shqyrtimi i funksionimit të sistemit të pagave dhe shpërblimeve rezulton se, listpagesat në Gardën e Republikës janë administruar dhe mbajtur si në versionin dhe formatin elektronik, ashtu dhe version hard copy (dokumenta fizike), referuar listëprezencave sipas drejtorive, njësisë, zyrave dhe sektorëve dhe dërguar në sektorin e buxhet financës për pagesë. Pagesat përshkruajnë ditët e punës, pagën për gradë, shtesë page për funksion, pagën bazë, shtesat sipas llojit: vjetërsi, vështirësi, kompensime, shpërblime, etj, ndalesat sipas llojeve, tatimi sigurime shoqërore, shëndetësore dhe suplementare, debitorë dhe në fund pagën neto. Listëpagesat firmosen nga specialistja e buxhet financës e cila përpilon ato, nga shefi i sektorit të buxhet financës (nëpunësi zbatues), shefi i sektorit të burimeve njerëzore dhe miratohen nga Komandanti i Gardës (nëpunësi autorizues

Konstatim:

Për çdo muaj nga Sektori i Burimeve njerëzore të Gardës së Republikës janë përgatitur nga Sektori dhe miratuar nga Komandanti i Gardës së Republikës urdhrat mujore "për pagesën e pagave të personelit oficer, nënoficer, dhe punonjësve civil të GR për vitin 2018". Në struktura të këtij urdhri janë listuar punonjësit me raporte për paaftësi të përkohshme në punë, punonjësit që kanë munguar pa arsye, ato me leje pa të drejtë page, punonjësit e liruar para kohe nga detyra nxjerrë oficer (nënoficer) në rezervë, punonjësit e pezulluar, punonjësit që duhen trajtuar me pagesë për shtesë mbi pagë për punën e kryer gjatë turnit të dytë dhe të tretë., etj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Listë prezencat dhe pagesat e tyre, u korespondojnë periudhave nga data 1 e muajit deri më datën 28, kjo referuar përcaktimeve të pikës nr 1 të lidhjes I, të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 387, datë 29.3.2007 “Për mënyrën e pasqyrimit të prezencës në punë në Ministrinë e Brendshme”.

Në vlerësimin e auditueve shtetëror të KLSH-së, përcaktimet e **urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 387, date 29.0.2007 “Për mënyrën e pasqyrimit të prezencës në punë në ministrinë e brendshme”**, kanë disiplinuar dhe rregulluar procedura të menaxhimit të aparatit /stafit të Ministrisë së Brendshme në atë kohë. Referuar lidhjes nr.1, “Mbi mënyrën e pasqyrimit të prezencës në punë në MB” që shoqëron këtë urdhër, thuhet se *“çdo datë 28 (26 për muajin shkurt), të gjithë drejtorët e drejtorive duhet të dorëzojnë listë prezencat e drejtorive të tyre pranë drejtorëve të përgjithshëm nga të cilët varen”*. Ky urdhër ka si fokus aparatin e MB dhe nuk specifikohet detyrimi që njësitë e vartësisë të rregullojnë veprimet sipas tij.

Ky përcaktim, duke lënë si datë të fundit të listëprezencës datën 28 të çdo muaji, nuk pasqyron në mënyrë të drejtë dhe korrekte pjesëmarrjen dhe kontributin në punë të çdo punonjësi të Gardës së Republikës për gjithë periudhën e muajit, duke lënë jashtë këtij pasqyrimi në kohë periudhën 28-30 apo 28-31 të çdo muaji. Këto përcaktime janë në kundërshtim me Nenin 110, pika 1 e Kodit të Punës që përcakton se: *“punëdhënësi detyrohet të paguajë pagën e zakonshme për atë lloj pune të caktuar”, si dhe paragrafet 69-71 të Udhëzimit të Ministrit të Financave me Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar me udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11 datë 06.05.2016 dhe nr.20 datë 17.11.2014, ku përcaktohet se:*

“69. Listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listeprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij.

70. Përmbledhja e listë pagesave, e cila shoqëron urdhërin për shpenzimin e pagave, duhet të nënshkruhet nga Nëpunësi Zbatues dhe nga Nëpunësi Autorizues ose i deleguari i tij.

71. Të dhënat për të përcaktuar të drejtën e punonjësit për pagë, kur ai nuk punon për shkak ndërprerjeje në punë jo për fajin e tij, të lejes së zakonshme, të pjesëmarrjes në kurse trajnimi, për paaftësi të përkohshme në punë, për kryerjen e detyrave të tjera shtetërore ose shoqërore, vërtetohen me dokumente të miratuara me akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.”

Si dhe neni 33, pika 1, të ligjit nr. 8869, date 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës”, që sanskionon se “Koha e punës e punonjësve të Gardës **njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës publike**, me përjashtim të përcaktimeve të shprehura në këtë ligj” si dhe kërkesat e Udhëzimit të perbashekt të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 16, date 13.12.2016 “Për formën, elementet dhe plotësinë e borderorë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Auditimi i saktësisë së llogaritjes së pagave të punonjësve, respektimi i kërkesave ligjore në llogaritjen e pagës bazë dhe shtesave mbi pagë .

Trajtimi i punonjësve me paga nga 01.01.2017 deri më 31.12.2018, është bërë konform VKM të ndryshuara si më poshtë :

1. *Pagesa e punonjësve ushtarakë*, për periudhën mars 2017 e në vijim. është bërë në zbatim të është bërë në zbatim të VKM nr.179 datë 08.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.561, datë 16.08.2006” sipas lidhjeve nr.1, 2 dhe 3 ku përcaktohen niveli i pagave për gradë, në përputhje me rolin dhe gradat, “Për pagat e punonjësve të Gardës së Republikës”.

2. *Pagesa e punonjësve mbështetës*, për periudhën është bërë në bazë të VKM nr.202, datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.717, datë 23.06.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të disa institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

Janë trajtuar me pagë sipas klasave 14 punonjës të shërbimeve mbështetëse të cilët kanë përfituar shtesë për dëmshmëri shëndeti dhe shtesë për vjetërsi në punë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nga trajtimi i punonjësve me vjetërsi në punë u konstatua se, llogaritja e vjetërsisë së punonjësve ishte kryer sipas vjetërsisë në punë të punonjësve duke i verifikuar vitet e punë në librezë për çdo punonjës me urdhrin e personelit për pagesë dhe pagesa për vjetërsi ishte kryer në vite pune herë 1% të pagës bazë për çdo vite pune.

Nga auditimi i pagesës së punonjësve ushtarakë dhe mbështetës u konstatua se pagesa është kryer në rregull për periudhën e audituar me përzgjedhje (*muaji prill-Qershor 2017 dhe Tetor-Dhjetor 2018*).

Trajtimi i punonjësve me pagë për mbikohë pune (orë suplementare). Për periudhën objekt auditimi punonjësit nuk janë trajtuar me pagë për mbikohën e kryerjes së punës/shërbimit.

Trajtimi financiar i punonjësve për punë të vështirë e dëme shëndeti.

Nga auditimi i trajtimit të punonjësve me dëmshmëri shëndeti u konstatua se :

- Janë trajtuar **41 punonjës ushtarakë**, ku pozicionet (*specialist niveli ulët komunikimi, radist, motorrist, xhenerik, mekanik, elektroaut, baterist, axhustator, magazinjer karburanti dhe kimist*) janë trajtuar me 3,000 lekë/muaj, pozicionet (*infirmier e mjek*) me 2,000 lekë/muaj dhe pozicionet (*operator, sekretar protokollist, arkivist*) me 1,000 lekë/muaj. Trajtimi është në zbatim të VKM nr. 621, datë 07.09.2006, lidhja nr.3, ku përcaktohen shtesat për punë të vështirë e dëmshmëri shëndeti,

- Janë trajtuar **14 punonjës mbështetës** kjo në zbatim të VKM nr.717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar me VKM nr.610, datë 24.07.2013 dhe shkresave përkatëse të ardhura nga Ministria e Shëndetësisë “Për miratimin e shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin”, Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale”. Pagesa e punonjësve që trajtohen me dëmshmëri shëndeti është e rregullt.

Trajtimi i punonjësve me kompensim ngarkese, (shpërblim mujor të punonjësve me më shumë se 3 persona në ngarkim në familje).

Nga auditimi i kryer në drejtim të trajtimit të punonjësve me kompensime, u konstatua se për periudhën nën auditim, nga ana e Gardës së Republikës, janë trajtuar me shpërblim mujor për ngarkesë punonjës dhe dokumentacioni në dosje ishte i rregullt e i plotë.

Trajtimi i punonjësve me kompensim ngarkese është kryer në zbatim të kërkesave të përcaktuara në VKM nr.499, datë 13.08.1998 “Për shpërblimin mujor të punonjësve me më shumë se 3 persona në ngarkim në familje”. Punonjësit janë trajtuar nga 500-1500 lekë.

Auditimi i krijimit dhe përdorimit të fondit të veçantë, vlerësimi i dokumentacionit justifikues në përdorimin e tij. Auditimi i shpërblimeve të tjera, për dalje në pension, bazueshmëria ligjore e pagesës së tyre .

U auditua i gjithë dokumentacioni justifikues bashkëngjitur urdhër shpenzimit për trajtimin e punonjësve me ndihma ekonomike dhe shpërblime. Për periudhën 01.01.2017 deri 31.12.2017, janë trajtuar me ndihme ekonomike 36 punonjës në vlerën 1,528,058 lekë. Për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2018, janë trajtuar me ndihmë ekonomike 41 punonjës në vlerën 1,909,043 lekë. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është praktika e plotë miratimi për celje fondi nga Ministria e Financës, urdhri i komandantit dhe dokumentacioni justifikues i ndihmës ekonomike.

Auditimi i trajtimit të bashkëshorteve me pagë.

Për periudhën nga 01.01.2017 deri 31.12.2017 është trajtuar me pagë bashkëshorti një person. Znj., e trajtuar me pagë bruto mujore 26,400 lekë dhe neto 23,443 lekë për periudhën 01.01.2017 deri më 28.02.2017, kurse pas datë 01.03.2017 me ndryshimin e pagës minimale në shkallë vendi, është trajtuar me pagë bruto mujore prej 36,000 lekë dhe neto 31,188 lekë. Nga ana e grupit të auditëve u auditua dosja e bashkëshortes ku u konstatua se dokumentacioni në dosje ishte i plotë dhe i rregullt.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Trajtimi i punonjësve me reformë.

Për periudhën objekt auditimi (viti 2017 dhe 2018) janë trajtuar **215** punonjës me reformë. Për punonjësit e dalë në reformë u pa dokumentacioni bashkëngjitur listë pagesës mujore, urdhri i komandantit për punonjësit e nivelit të ulët dhe urdhri i Ministrit të Punëve të Brendshme për punonjësit e nivelit të lartë. Pagesa është kryer në përputhje me Ligjin Nr.10142, datë 15.05.2009, neni 12, pika 1,2,3, që përcakton se: *“Punonjësit të cilët nxirren në lirim marin një shpërblim në masën e 2 pagave të menjëhershme referuese mujore dhe pas këtij fillon trajtimi financiar me pagë kalimtare, jepet kur përfituesi ka jo më pak se 3 muaj shërbim e cila llogaritet në masën 50% të pagës referuese mujore dhe fillon në muajin e tretë nga data e nxjerrjes në lirim, e cila zgjat për aq muaj sa përfituesi ka vjetërsi shërbimi por jo më shumë se 24 muaj”*.

Auditimi i pagesës së detyrimeve ndaj degës së tatimeve, për të tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe suplementare të punonjësve.

Listëpagesat, në pjesën e ndalesave, kanë pasqyruar ndalesat mujore për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare si dhe tatimin mbi të ardhurat personale që paguhen nga punëmarrësit. Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe suplementare, që paguhen nga punëmarrësi, është bërë e saktë, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale është bërë e saktë konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare të llogaritura për punëmarrësit dhe punëdhënësin, si dhe tatimi mbi të ardhurat e llogaritur për punëmarrësin, ishte derdhur në organet tatimore përkatëse bërë brenda afatit ligjor dhe nuk ka pagesa penalizimesh për mosderdhje në afat. Për periudhën e audituar përllogaritja e tatimit mbi të ardhurat është bërë konform kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar.

Përllogaritja e detyrimeve të punonjësve për sigurimin suplementar ishte bërë konform kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.10142, datë 15.05.2009 *“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të RSH”* dhe në aktin Normativ nr.05, datë 10.11.2010 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10142, datë 15.05.2009”*. Përllogaritja e pagesës së sigurimeve shëndetësore është bërë konform kërkesave të përcaktuara në VKM nr.1114, datë 30.07.2008 të ndryshuar me VKM nr.73, datë 12.02.2014.

Auditimi i bazueshmërisë ligjore të shpenzimeve të kryera për dietat e punonjësve.

Për periudhën nga 01.07.2017 deri më 31.12.2018, punonjësit e institucionit kanë kryer shërbime jashtë vendbanimit të tyre. Pagesat e urdhëreshërbimeve janë bërë në zbatim të VKM nr.997 datë 10.12.2010 *“Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”* i ndryshuar dhe VKM nr.870, datë 14.12.2011 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”*. Auditimi i dokumentacionit të dietave u krye me përzgjedhje të rastësishme.

Nga auditimi i dokumentacionit bashkëngjitur urdhërpagesës rezultoi se shërbimi është kryer mbi bazën e autorizimit të nxjerrë nga drejtori i DPLSH, zv/komandanti, etj. *“Për angazhim me shërbim të efektivit të Gardës së Republikës”* ku janë përcaktuar datat, ora dhe punonjësi që do të kryejë shërbimin. Bashkëngjitur urdhëreshërbimit të hartuar sipas formatit të duhur dhe të konfirmuar nga nëpunësi udhëtues, nëpunësi zbatues e nëpunësi autorizues janë dhe dokumentat të tjera mbështetëse si fatura tatimore e fjetjes në hotel e fatura e kasës fiskale (për rastet e trajtimit me dietë të plotë). Dokumentet mbështetëse janë të hartuara konform akteve në fuqi.

Për vitin **2017** janë shpenzuar 47,798,306 lekë dieta brenda vendit dhe 284,146 lekë dieta për udhëtime jashtë vendit dhe për vitin 2018 janë shpenzuar 56,268,302 lekë dieta brenda vendit dhe 435,400 lekë dieta për udhëtime jashtë vendit (grup nënoficerësh kurs një mujor në Turqi).

Për çdo rast ka urdhër të Ministrit të Brendshëm për dërgimin me shërbim jashtë shtetit, i pasuar më pas me Urdhërin e Komandantit të Gardës për qëllimin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Auditimi i pagesës së detyrimeve ndaj degës së tatimeve, për të tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe suplementare të punonjësve.

Listëpagesat, në pjesën e ndalesave, kanë pasqyruar ndalesat mujore për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare si dhe tatimin mbi të ardhurat personale që paguhen nga punëmarrësit. Llogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe suplementare, që paguhen nga punëmarrësi, është bërë e saktë, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale është bërë e saktë konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore e suplementare të llogaritura për punëmarrësit dhe punëdhënësin, si dhe tatimi mbi të ardhurat e llogaritur për punëmarrësin, ishte derdhur në organet tatimore përkatëse bërë brenda afatit ligjor dhe nuk ka pagesa penalizimesh për mosderdhje në afat. Për periudhën e audituar përlllogaritja e tatimit mbi të ardhurat është bërë konform kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar.

Për vitin 2017 janë paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 164,274,908 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 183,727,990 lekë. Përlllogaritja e detyrimeve të punonjësve për sigurimin suplementar ishte bërë konform kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.10142, datë 15.05.2009 *“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të RSH”* dhe në aktin Normativ nr.05, datë 10.11.2010 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10142, datë 15.05.2009”*. Përlllogaritja e pagesës së sigurimeve shëndetësore është bërë konform kërkesave të përcaktuara në VKM nr.1114, datë 30.07.2008 të ndryshuar me VKM nr.73, datë 12.02.2014.

Titulli i Gjetjes 1: **Nevoja për rishikim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 387, datë 29.3.2007 “Për mënyrën e pasqyrimit të prezencës në punë në Ministrinë e Brendshme”.**

Situata:	Për çdo muaj nga Sektori i Burimeve Njerëzore të Gardës së Republikës janë përgatitur nga Sektori dhe miratuar nga Komandanti i Gardës së Republikës urdhrat mujore “Për pagesën e pagave të personelit oficer, nënoficer, dhe punonjësve civil të GR për vitin 2018”. Listë prezencat dhe pagesat e punonjësve të Gardës, u korrespondojnë periudhave nga data 1 e muajit deri më datën 28, kjo referuar përcaktimeve të pikës nr. 1, lidhja I, të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 387, datë 29.3.2007 <i>“Për mënyrën e pasqyrimit të prezencës në punë në ministrinë e brendshme”</i>. Përcaktimet e urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 387, datë 29.0.2007 <i>“Për mënyrën e pasqyrimit të prezencës në punë në ministrinë e brendshme”</i>, kanë disiplinuar dhe rregulluar procedura të menaxhimit të aparatit /stafit të Ministrisë së Brendshme në atë kohë. Referuar lidhjes nr.1, “Mbi mënyrën e pasqyrimit të prezencës në punë në MB” që shoqëron këtë urdhër, thuhet se <i>“çdo datë 28 (26 për muajin shkurt), të gjithë drejtorët e drejtorive duhet të dorëzojnë listë prezencat e drejtorive të tyre pranë drejtorëve të përgjithshëm nga të cilët varen”</i>. Ky përcaktim, duke lënë si datë të fundit të listëprezencës datën 28 të çdo muaji, nuk pasqyron në mënyrë të drejtë dhe korrekte pjesëmarrjen dhe kontributin në punë të çdo punonjësi të Gardës së Republikës për gjithë periudhën e muajit, duke lënë jashtë këtij pasqyrimi në kohë periudhën 28-30 apo 28-31 të çdo muaji.
-----------------	---



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Kriteri:	-Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; -Nenin 110, pika 1 e Kodit të Punës që përcakton se: <i>"punëdhënësi detyrohet të paguajë pagën e zakonshme për atë lloj pune të caktuar"</i>, -paragrafët 69-71 të Udhëzimit të Ministrit të Financave me Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar me udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11 datë 06.05.2016 dhe nr.20 datë 17.11.2014; -neni 33, pika 1, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës”; -Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 16, datë 13.12.2016 “Për formën, elementet dhe plotësinë e borderove së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti	Ky përcaktim, duke lënë si datë të fundit të listëprezencës datën 28 të çdo muaji, nuk pasqyron në mënyrë të drejtë dhe korrekte pjesëmarrjen dhe kontributin në punë të çdo punonjësi të Gardës së Republikës për gjithë periudhën e muajit, duke lënë jashtë këtij pasqyrimi në kohë periudhën 28-30 apo 28-31 të çdo muaji.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Nga ana e Gardës së Republikës të kërkohet pranë Ministrisë së Brendshme rishikimi dhe përmirësimi i të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 387, datë 29.3.2007 “Për mënyrën e pasqyrit të prezencës në punë në ministrinë e brendshme”, si urdhër që nuk është në përputhje me kuadrin rregullues në fushën e marrëdhënies së punës dhe për më tepër se ky urdhër ka si fokus aparatin e MB dhe nuk specifikohet detyrimi që njësitë e vartësisë të rregullojnë veprimet sipas tij.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	<i>Menjëherë</i>

3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare:

- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet, bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë.
- Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë.
- Inventarizimi i pronës shtetërore.

U shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

- Dokumentacioni mbështetës i veprimeve dhe transaksioneve financiare:

U audituan me zgjedhje (dy muji parë 2017 dhe veprimet të tjera me zgjedhje si dhe gjashtëmuji dytë 2018) në lidhje me dokumentacionin e bankës për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2018. Nga auditimi rezultoi se urdhërit shpenzimet janë hartuar dhe nënshkruar rregullisht dhe se ato janë shoqëruar me dokumentacionin justifikues, janë të kontabilizuara në ditarin e bankës dhe ekstrakti i bankës rakordon me situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit. Në ditarin e bankës të çdo muaji ishin kryer artikujt kontabël të mbylljes, ku ishin prerë fletë kontabilizimit të brendshme për pagesat e bankës, konformë ligjit mbi kontabilitetin.

U auditua likuidimi nga banka i detyrimeve të GR ndaj operatorëve si, dhe, nga ku rezultoi se këto pagesa kishin bashkangjitur faturën përkatëse për likuidimet e kryera për faturat në bazë të kontratave të lidhura, me nënshkrimet nga personat përgjegjës apo konfirmimet mbi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

shumat e faturuara nga sektoret perkates brenda GR (nga një punonjës i caktuar, duke kryer kështu dhe rakordimet për shumën e faturuar).

Dokumentacioni është regjistruar në mënyre kronologjike. Mbajtja e regjistrimeve kronologjike është kryer nëpërmjet ditarëve të arkës, bankës, ditarëve të magazinës, etj. Është bërë rakordimi i vazhdueshëm me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet. Ditarët ishin regjistruar në librat sintetikë ku dhe kanë rezultuar shifrat që janë hedhur në bilancet e periudhave. Në përgjithësi në regjistrimin e transksioneve dhe pasqyrimin e tyre në librat dhe evidencën kontabile është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Rregjistrimet kontabile janë kryer sipas programit “Financa 5”, duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse. Veprimet janë azhurnuar periodikisht, dhe llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, neni 6, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, i ndryshuar.

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve për vitet 2018 dhe 2017 ka rezultuar sa vijon:

Banka 2018:

I. Me urdhër shpenzimin nr. 384, dë 05.06.2018, të nënshkruar nga NA z..... dhe NZ z....., është kryer likuidimi në shumën prej 52,718 lekë, për z..... si kompensim për veshjen civile në vlerë, (me shënimin *diferencë*). Kjo pagesë është kryer në referim të VKM nr. 136, datë 11.02.2009, Urdhërit të MPB me nr. 136, datë 5.2.22010 i ndryshuar, Urdheri i Komandantit të Gardës me nr. 48/1 datë 24.3.2017 dhe urdhrit nr. 1935 datë 12.03.2018. Nuk u konstatua ndonjë parregullsi në procedurën dhe përlllogaritjet e kryera.

II. Me urdhër shpenzimin nr. 398, datë 07.06.2018, të nënshkruar nga NA z..... dhe NZ z....., është kryer likuidimi për subjektin privat “....” SHPK në shumën 780,000 leke me TVSH, me objekt “Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit”, sipas faturës tatimore nr.12, datë 29.05.2018.

Për palën blerëse, fatura është nënshkruar nga shefi sektorit të transportit z..... Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

1. Urdhër prokurimi për blerje me vlera të vogla nr. 202/9, datë 17.04.2018, me fondin limit 656,600 lekë pa TVSH, nënshkruar nga titullari i autortetit kontraktor me objekt: shërbime për nevoja të sektorit të transportit, bazuar në memo-n pa datë, të përgatitur dhe drejtuar Komandantit të GR nga major- shef i zyrës së prokurimit dhe togere-specialiste ligjore. Mbi këtë bazë është hartuar ftesa për ofertë me nr. 202/10, datë 17.04.2018 dërguar në APP, ku janë përcaktuar specifikimet teknike për ndryshime konstruktive të dy automjeteve mercedes benz sprinter për punimet veshje tapicerie, ndriçim kabine, veshje dysHEMEJE, hapje montim xhama anësor dhe për derën e pasme, vendosje sediljesh për pasagjerë. Është kerkuar në ftesën për ofertë që që operatori ekonomik fitues të dorëzojë pranë AK licensën VII.3.B.1; licensën VII.3.B.3; certifikatë ISO 90001: 2008/2015 dhe ISO 39001/2012; kontratë pune me llamarinist dhe saldator si dhe vendonodhja e servisit brenda territorit të Tiranës.
- Procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, për zhvillimin e procedurës së blerjes në sistem elektronik me datën 20.4.2018, ku kanë marrë pjesë 5 ofertues dhe pas kontrollit të ekstraktit të regjistrit tregtar ka rezultuar se operatori “...” SHPK nuk ka në objektin e veprimtarisë këtë objekt prokurimi dhe oferta e këtij subjekti është refuzuar. Operatori “.....”, oferta e të cilit është shpallur fituese, është tërhequr nga procedura, edhe poashtu, operatori ekonomik “....” (pf) ka bërë njoftimin në sistem se tërhiqet nga procedura. Si përfundim, me datën 23.4.2018 sipas procesverbalit nr.4, operatori ekonomik “....” SHPK është njoftuar për shpalljen si fitues dhe me këtë subjekt komisioni blerjeve te vogla me perberje, dhe vendosi ti kerkoje plotësimin e gjithë kërkesave të AK të caktuara në ftesën për oferte për dokumentacionin e kerkuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- Sipas Formularit për njoftimin e fituesit, (protokolluar në institucionin e GR me nr. 202/5 prot, date 23.4.2018) është njoftuar operatori ekonomik për shpalljen fitues për këtë procedurë prokurimi.
- Nga ana e OE “.....” SHPK (përfaqësuar e nënshkruar nga ana e administratorit Andi Marku) është lëshuar një certifikatë garancie me datën 29.5.2018 për një periudhë 6 mujore për rparimet mbi ndryshimin konstruktive të dy mjeteve të transportit.

Si qetjetje u konstatua se:

1. Mungon situacioni për punimet e kryera, por është mjaftuar me fletëdaljen e lëshuar nga subjekti, në kundërshtim me kërkesat që burojnë nga Udhëzimi nr. 30, datë 26.12.2011 “PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK”.

III. Me urdhër shpenzimin nr. 524 , datë 11.7.2018, të nënshkruar nga NA z. dhe NZ z....., është kryer likuidimi i faturës tatimor të shitjes për subjektin privat “.....” sh.p.k në shumën prej 6,246,072 lekë, sa kryer blerje të artikujve për stërvitjen. Kjo pagesë është kryer në mbështetje të kontratës nr.26, date 13.6.2018 si dhe fatures tatimore me nr.757 date 29.6.2018, bërë hyrje në autoritetin kontraktot ... me ... nr. 4, date 01.07.2018. Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Urdhër prokurimi për blerje me vlera të vogla nëpërmjet SPE me nr. 2322, datë 30.04.2018, me fondin limit 5,208,150 lekë pa TVSH, nënshkruar nga titullari AK me objekt: “*blerje materiel për stërvitjen sipas procedures “Kerkese per propozim”*”. Njësia e prokurimit përbëhet nga, dhe, ndersia sipar urdhrit me nr. 2322/2 date 30.04.2018 eshte ngritur komisoni per vleresimin e ofertave me perberje z.....-kryetar,-anetar dhe –anetar.
- Procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Vleresimit të Ofertave dhe Formularit të Njoftimit të Fituesit (me nr. 2322/6 prot., datë 25.5.2018, të nënshkruar nga titullari AK, ka rezultuar se në zhvillimin e procedurës së blerjes në sistem elektronik me datën 14 maj 2018, kanë marrë pjese 4 operatorë ekonomikë “...” shpk me ofertë ekonomike 5,191,800 lekë pa TVSH, “...” shpk me ofertë ekonomike 0 leke,”.....” shpk me oferte ekonomike 0 leke dhe “...” Person fizik me oferte ekonomike 5,205,060 lekë pa TVSH. Janë skualifikuar tre operatorët: “...” shpk *„(nuk ka paraqitur mostrat para hapjes se procedures date 14.5.2018, ora 10.00); “.....” shpk dhe “.....” shpk (nuk ka paraqitur asnje dokument dhe as ofertën ekonomike)*. Si përfundim oferta e operatorit “...” (person fizik) është konsideruar e suksesshme në vlerën 5,205,060 lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 17.05.2018, ka bërë evidentimin dhe shqyrtimin e dokumentave ligjorë administrativ dhe kualifikues të shoqërisë konkurese brenda afatit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 39, të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”. KVO-ja ka kualifikuar operatorin “.....” pf pasi përmbush kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit, ndërsa për operatorët ekonomik: “.....” shpk, “.....” shpk, dhe “.....” shpk janë evidentuar këto mangësi:

- Operatori ekonomik “.....” shpk nuk plotëson të gjithë kriteret për kualifikim. OE nuk ka paraqitur përpara hapjes së procedurës (deri më datë 14.05.2018 para orës 10.00) mostrat, për artikujt me numër rendor: 2, 9, 10, 11, 19, 20, 24, 33 dhe 36 të specifikuar në specifikimet teknike (secili nga ofertuesit duhej të dorëzonte një listë me mostrat e artikujve të kërkuar në DST), si dhe rezulton sipas P/V se nuk ka paraqitur Çertifikatat e kërkuara ISO 22301:2012 -Sistemi i menaxhimit të Vazhdueshmërisë së Biznesit; Çertifikimin ISO 28001:2007 të sistemit të menaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimeve të vlefshme; si dhe fletë-analizat për testimin e lëndës së parë nga një laborator i akredituar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike për artikullin “Kanatjere shumëngjyrëshe”.

- Operatori ekonomik “.....” sh.p.k nuk plotëson kriteret për kualifikim, pasi sipas komisionit ky operator nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni dhe nuk ka paraqitur ofertën ekonomike.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- Operatori ekonomik “.....” sh.p.k nuk i plotëson kriteret për kualifikim. Ky operator nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni me përjashtim të NIPT-it si dhe nuk paraqitur ofertën ekonomike.

Kualifikimi për operatorin fitues është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor me nënshkrimin në raportin përmbledhës të datës 25.05.2018. Për sa sipër, me operatorin ekonomik të shpallur fitues është lidhur kontrata nr.26, datë 13.06.2018 me vlerë 6.246.072 lekë me tvsh. Lidhja e kontratës është bërë brenda afateve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 58 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, bashkëlidhur është sigurimi i kontratës në vlerën 624.978 lekë datë 07.06.2018, 10% e vlerës së kontratës.

Konstatime:

1. Bazuar në praktikën më të mira profesionale konstatohet se, “ISO 9001-2008 përfaqëson pikën e referimit, e njohur në nivel global, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së bizneseve të të gjithë sektorëve dhe të të gjitha përmasave. Normat e familjes ISO 9000 janë udhëzime se si një ndërmarrje duhet të veprojë, për të siguruar dhënien e një shërbimi cilësor d.m.th që i përgjigjet asaj që kërkohet nga klienti. Certifikimi sipas kësaj familje normash është një certifikim sistemi dhe jo produkti, d.m.th nuk certifikohet malli ose shërbimi që do të ofrohet, por sistemi i administrimit të operatorit ekonomik.

Auditimi vlerëson se janë administruar këto licensa në momentin e lidhjes së kontratës (si fotokopje të noterizuara) dhe këto certifikata ISO për subjektin “.....” sh.p.k (personi fizik ‘.....’), janë lëshuar nga operatorë privat si vijon:

- ✓ ISO 22301:2012 -sistemi i menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit të sigurimit social, lëshuar nga operatori privat “....”;
- ✓ ISO 9001:2015 –certifikate e sistemit të menaxhimit të cilësisë lëshuar nga operatori privat “.....”;
- ✓ ISO 14001:2015 –certifikate e sistemit të menaxhimit mjedisor, lëshuar nga operatori privat “.....”;
- ✓ ISO 28001:2007 –certifikate e sistemit të menaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimit lëshuar nga operatori lëshuar nga operatori privat “.....”;
- ✓ ISO 18001:2007 –certifikate e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe shëndetit në punë, lëshuar nga operatori privat “.....”;

Në fakt në specifikimet teknike janë kërkuar ISO 9001:2008 (dhe jo ISO 9001: 2015); ISO 14001/2004 (dhe jo ISO 14001/2015) si dhe nuk është kërkuar certifikata ISO 18001:2007. Nga krahasimi i të dhënave nga ana e AK mbi plotësimin e specifikimeve teknike për blerjen e artikujve për stërvitjen në v.2017 dhe 2018 dhe ato të ofruara nga OE fitues rezulton:

Specifikimet teknike DST 2017	Specifikimet teknike DST 2018	OE 2018
ISO 9001:2008	ISO 9001:2008	ISO 9001:2015
ISO 28001:2007	ISO 28001:2007	ISO 28001:2007
ISO 14001:2004	ISO 14001:2004	ISO 14001:2015
ISO 18001:2007	ISO 22301:2012	ISO 22301:2012
x	x	ISO 18001:2007

Për sa sipër konstatohet se, nga ana AK nuk janë përditësuar standardet e kërkuara mbi specifikimet teknike të mallrave dhe operatorëve. Nuk ka gjurmë mbi faktin se autoritetet lëshuese janë organizma të njohur të akreditimit, duke vepruar në mospërmbushje të plotë të përcaktimeve të nenit 30,”Kërkesat e cilësisë”, të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku thuhet se:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”⁸

2. Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

Në vlerësimin e grupit të auditimit të KLSH-së, duhet një vlerësim i kujdesshëm i sistemit të kërkesave që duhen vendosur përpara operatoreve ekonomikë duke argumentuar domosdoshmërinë e tyre, pasi një numër i këtyre certifikatave mund të jenë të panevojshme për objekin e prokurimit dhe se ato mund të kufizojnë dhe ngushtojnë hapësirat për pjesëmarrjen e lirë të operatoreve ekonomikë në konkurimin publik.

2. Për një pjesë artikujsh në specifikimet teknike të dhëna në DST mungojnë të dhëna të rëndësishme, si p.sh.

✓ Artikulli nr. 18 i Specifikimeve Teknike, “Gira force me pesha të ndryshme 7,5 – 30 kg”, për copë 10 (i referohet artikullit nr. 21 në FH e magazinës me nr.4, datë 1.7.2018, mungojnë të dhënat që të përcaktojnë specifikat e këtij artikulli (peshat dhe dimensionet).

✓ Artikulli nr. 28, “Veshje trupore për zbritje alpinistike”, për sasinë 10 copë, artikulli nr. 29, “Veshje gjysëm trupore për zbritje alpinistike”, për sasinë 30 copë, artikulli nr. 30, “Veshje të thjeshta trupore për zbritje alpinistike”, për sasinë 30 copë, mungon specifikimi i masave trupore të blera për këtë artikull, por pa dhënë asnjë specifikim se si kërkohet dhe po ashtu dhe në FH e magazinës

✓ Artikulli nr. 36 “Kanoiere shumëngjyrëshe”, mungon specifikimi i ngjyrave, masave trupore të këtij artikulli pa dhënë asnjë specifikim se si kërkohet dhe po ashtu dhe si sei janë marrë në dorëzim dhe bërë hyrje (referuar FH së magazinës me nr. 4, dt 01.07.2019).

✓ Artikulli nr. 37 “Komplet sportiv veror”, mungon specifikimi i masave trupore të këtij artikulli, pa dhënë asnjë specifikim se si kërkohet dhe po ashtu dhe në FH e magazinës.

✓ Artikulli nr. 38 “Kupa të ndryshme” (zcopë 30) dhe me nr. 39 “medalje të ndryshme”, (copë 30) mungon specifikimi se si kërkohen këto artikuj dhe po ashtu dhe në FH e magazinës.

3. Në zbatim të përcaktimeve të dokumentave të tenderit nga OE janë dërguar kampionet e /mostrat e mallrave nga ana e subjektit “....” shpk, (referuar procesverbelit të administruar në dosjen e prokurimit me nr. 2322/3 datë 14.05.2018 dhe të hartuar nga ana e përgjegjesit të zyrës së prokurimeve si dhe përfaqësuesi i OE “.....”, z.....).

Në fakt nuk janë kërkuar fotografi apo katalogje për mostrat dhe nuk gjendet asnjë gjurmë për të konfirmuar se mallrat e sjella janë të njëjta me kamionin e paraqitur, (pavaresisht **se ekziston** një procesverbal i pritjes së mallrave, i mbajtur me datën 01.07.2018, i nënshkruar nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave të përbërë nga, dhe përgjegjësi material, por nuk ka një gjurmë të kthimit të tyre. Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës nr. 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” të DST, si dhe mungon evidentimi i procesit të kthimit të tyre në fletën inventariale të dosjes e cila mbyllet me nr.26.

- Në procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallrave, komisioni shprehet mbi marrjen në dorëzim të mallrave konform specifikimeve teknike, por nuk shprehet në procesverbal me një listim të plotë të mallrave dhe specifikimeve teknike të dokumentuara në DST. Këto janë *veprime dhe mosveprime jo sipas të gjitha kërkesave të ligjit të prokurimit, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit të MF nr.92, datë 29.12.2011, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, listës së proceseve të punës për prokurimet me vlerë të lartë, Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 e tij.*

IV. Me urdhër shpenzimin nr. 645, datë 03.09.2018, të nënshkruar nga NA dhe NZ, është kryer likuidimi i faturës tatimore me nr. 1800347754, datë 28.08.2018 me emertesen shpenzime taksa automjetesh në shumën prej **1,000 lekë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Kjo pagesë është kryer për institucionin DSHTRR Tiranë, dhe bazohet në **faturen e gjobës** me nr. Serial 1590303, e lidhur me automjetin me targë MB 442 AA (sipas pasqyres së nënshkruar nga shefi sekt. Transportit z..... dhe mirtiar nga Zv/Drejtori Sherbimeve Mbështetëse z..... (për faturen 1800347754, dt 28.8.2018)

V. Me urdhër shpenzimin nr. 764, datë 18.10.2018, të nënshkruar nga NA dhe NZ, është kryer likuidimi i faturës tatimor të shitjes për shoqërinë private **“...” sh.p.k** në shumën **prej 2,014,080 lekë**. Kjo pagesë është kryer në mbështetje të procedurës së prokurimit dhe kontratës me nr.25, date 13.06.2018, praktikës së blerjes përmes sistemit elektronik të prokurimit dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Urdhër prokurimi për blerje me vlera të vogla nr.2323, datë 30.4.2018, me fondin limit 1,992,942 lekë pa TVSH, me objekt: **“Blerje artikuj të ndryshëm për marrëdhëniet me publikun”**. Lloji i procedurës së prokurimit është “kërkesë për propozim”
- Procesverbali i mbajtur nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, për zhvillimin e procedurës së blerjes në sistem elektronik me datën 15.5.2018, ku oferta e operatorit “.....” shpk , midis tre operatoreve pjesëmarrës në prokurim është identifikuar si oferta e suksesshme dhe është shpallur fituese për vlerën 1,900,000 lekë pa TVSH. Për sa sipër, është dërguar njoftimi i kontratës së nënshkruar në APP me shkresën nr. 2323/9, datë 13.06.2018, me vlerë përfundimtare të kontratës prej 2,290 mijë lekë me TVSH.
- Fatura tatimore me nr. 1121, date 01.10.2018 bërë hyrje në magazinë artikujt sipas FH me nr. 12, date 04.10.2018, për 41 artikuj për për vlerën 1,678,400 lekë pa TVSH ose 2,014,080 lekë me TVSH.
- Procesverbali nr. 2, date 04.10.2018 për pritjen e mallit nënshkruar nga komisioni,, dhe pergjegjesi material

Konstatime:

1.Janë hartuar dhe nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Mallrave dy procesverbale, për të njëjtën sasi dhe vlerë, por në dy data të ndryshme, (i pari për të vërtetuar se artikujt e furnizuar janë sipas sasisë së kërkuar dhe i dyti për të konfirmuar se ato janë në përputhje me specifikimet teknike). Komisioni i pranimit të mallrave i ngritur me urdhrin e Komandantit të GR me nr. 1969/3 datë 01.10.2018 nuk është shprehur në procesverbal se, OE nuk ka furnizuar gjithë nomenklaturën e mallrave sipas kontratës nr. 25, datë 13.06.2018. Më konkretisht:

-P/V nr. 1 për pritjen e mallit **datë 01.10.2018**, për 41 artikuj me vlerë 2,014,080 lekë (nënshkruar nga,, dhe pergjegjesi material) konfirmohet sasia si dhe

-P/V nr. 2 për pritjen e mallit datë **04.10.2018**, për 41 artikuj me vlerë 2,014,080 lekë (nënshkruar nga,, dhe pergjegjesi material) , ku konfirmohen plotësimi i specifikimeve teknike të mallrave. Bashkëlidhur është Fatura e shitësit nr.1121, është e datës 01.10.2018 dhe situacioni perkates, kurse FH e magazinës së GR është me nr. 12 të datës 4 tetor 2018. Edhe në FH e magazinës data e dokumentit të subjektit është shënuar 4 tetor 2018.

2. Proces-verbali i pritjes së mallit nuk konfirmon plotësimin e specifikimeve teknike për çdo artikull të furnizuar, por ka një tabelë ku referohen artikujt, sasi të dhe çmimet sipas artikujve.Në procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallrave, komisioni shprehet mbi marrjen *në dorëzim të mallrave konform specifikimeve teknike, por nuk shprehet në procesverbal me një listim të plotë të mallrave dhe specifikimeve teknike të dokumentuara në DST. Këto janë veprime dhe mosveprime jo sipas të gjitha kërkesave të ligjit të prokurimit, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimit të MF nr.92, datë 29.12.2011, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, listës së proceseve të punës për prokurimet me vlerë të lartë, Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 e tij.*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

3. Nuk ka gjetur zbatim të plotë kontata e lidhur midis palëve, pasi referuar proces-verbalit të marrjes në dorëzim të mallrave, AK është furnizuar me 41 artikuj, nga 54 artikuj sipas Dokumentave Standarde dhe Aneksit të Kontratës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 1, pika 2, të Kontatës me nr.25, datë 13.6.2018 të lidhur midis AK (përfaqësuar nga z.....) dhe OE (përfaqësuar nga z.....), ku pjesë integrale e kontratës janë lista me sasinë e artikujve sipas specifikimeve teknike. Kjo listë perbehen nga 54 artikuj dhe afati i levrimit është 150 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës datë 13.6.2018 (neni 2, pika 2 e Kontratës).

Pra, nuk janë furnizuar sipas FD nr. 1121, datë 01.10.2018 gjithësej 13 artikuj me vlerë 265,920 lekë brenda afatit 150 ditë, që përkon me datën 9.11.2018.

Në këto kushte AK, bazuar në nënin 14 të Kontratës, duhet të kishte nderprerë kontratën meqenëse kontraktori ka dështuar në furnizimin me mallra brenda afatit të përcaktuar dhe rënë dakord dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 4 të Kontatës, duhet të ishte llogaritur dëmi për dorëzimin e vonuar në masën 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontatatës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës”. Pra duhet të ishte konfiskuar sigurimi i kontratës në referim të nenit 13 të kësaj kontrate për dëme në dorëzimin e vonuar të mallrave.

Rezulton se me datën 24 dhjetor 2018 është prerë FH me nr. 18, datë 24.12.2018 ku janë bërë hyrje 13 artikujt e mbetur.

Perllogaritja:

- ✓ ***Nga data 09.11.2018 deri më datën 24.12.2018: vlera e pa furnizuar 265,920 x 44 ditë (nga data 9/11/2018 - 24.12.2018) x 4/1000= 46,802 lekë që përbën detyrim për akëtim nga subjekti privat “.....” shpk.***

Nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë kërkuar specifikime për kushtet e veçanta ISO për artkujt e funrizuar, siç është vepruar në raste të tjera.

Dokumentacioni mbështetes transaksioneve të arkës në lekë dhe valutë :

- Për vitin 2017, është operuar me **arkën në lekë dhe në euro**. Janë prerë gjithsej 9 mandat arkëtime për lëvizje në lekë, me objekt pjesëmarrje në tender/ tërheqje dokumentesh me datat 12 maj dhe 5 shtator dhe dhjetor 2017 me vlerë të përgjithshme 4,850 lekë, shumë kjo që është derdhur tërësisht në bankë dhe pasqyruar në transaksionet e degës së thesarit. Gjendja e arkës me datën 31.12.2017 është zero lekë.

- Për arkën në **valutë (Euro)**, për vitin 2017, janë realizuar dy tërheqje nga banka, perkatesisht me MA nr. 01, datë 09.03.2017 për 217,5 Euro dhe MA nr. 02, datë 20.04.2017 për 890 Euro. Gjithesej janë tërhequr nga banaka Raiffeisen dhe janë arketuar në GR në shuma 1,107.5 Euro për të cilën janë kryer janë prerë 6 mandat pagesa vlera **1,107.5 euro**, të gjitha për dieta jashtë vendit (2 persona në Greqi dhe 4 persona në Kosovë). U krye auditimi i dokumentacionit për shpenzimet e dietave për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë shtetit dhe rezultoi se dokumentacioni është i plotë. Për pagesat e kryera jashtë shtetit (rasti i Kosovës), bashkëlidhur me M/P është urdhëri i Ministrit të Punëve të Brendshme me **nr. 144**, datë **17.03.2017**, ku në pikën nr. 1 të tij, është përcaktuar që: **“Garda e Republikës të dergojë me shërbim jashtë shtetit, në Republikën e Kosovës, për të realizuar sigurinë fizike të Kryeministrit të RSh gjatë vizitës së tij në Kosove, nga data 16.2.2017 deri më 18.2.2017 katër personat...”**. Pra, urdhëri i Ministrit të Punëve të Brendshme është lëshuar një muaj pasi është kryer shërbimi nga efektivet e Gardes se Republikës.

- Për vitin 2018, është operuar vetëm me **arkën në lekë**. Eshtë prerë gjithsej një mandat arkëtim për lëvizje në lekë, (perkatesisht MA me nr. 01, datë 30.01.2018 me objekt tërheqje dokumentesh me vlerë totale 500 lekë dhe është derdhur në thesar po kjo shumë me M/P e datës 26.12.2018. Gjendja e arkës me datën 31.12.2018 është zero lekë.

- Për arkën në **valutë (Euro)**, për vitin 2018, nuk rezulton të jetë kryer asnjë transksion. U krye auditimi i dokumentacionit për shpenzimet e dietave për punonjësit që dërgohen me shërbim jashtë shtetit (2017) dhe rezultoi se dokumentacioni është i plotë. Për lëvizjet e arkës në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

lekë dhe në valutë, janë mbajtur librat e arkës, të cilat janë të nënshkruara nga punonjësja e ngarkuar me mbajtjen e dokumentacionit të arkës zj. dhe të kontrolluara e të konfirmuara rregullisht nga Shefi i Sektorit të Financës z.....

U auditua me zgjedhje Verifikimi i Zbatimit të Kontratave, të lidhura nga ana e autoritetit kontraktor, në kuadër të mbështetjes me dokumentacionin respektiv justifikues që shoqëron udhrrë dhpenzimet e kaluar në degën e thesarit dhe rezultoi:

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i transaksioneve të bankës për vitin 2017:

Nga auditimi i shpenzimeve operative konstatohet se janë dokumentuar rregullisht veprimet dhe çdo transksion është bazuar në dokumentacionin e nevojshëm për likuidimin e kryer nga ana e Sektorit të Financës së GR.

U auditua me zgjedhje **procesi i lidhjes së kontrates deri në likuidimin e mallrave për prokurimet e perqendruara të kryera nga ana e Ministrisë së Brendshme** dhe që janë kontraktuar dhe vijuar me procedurat e marrjes në dorëzim dhe likuidimit nga ana e GR. Konkretisht, u audituan **kontrata me nr.45, nr. 46 dhe nr. 48, datë 28.12.2017 dhe rezultoi:**

I. Kontrata nr.45, datë 26.12.2017 “Blerje uniforma veshmbathje e elemente të tjerë përbërëse të tyre” në vlerën 12.180.240 lekë me TVSH, kohëzgjatja deri më 31.12.2017 nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Kontrata është lidhur midis Operatorit Ekonomik “.....” Elbasan, përfaqësuar nga z..... dhe Komandantit të Gardës z., autorizuar rregullisht nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme znj..... (sipas shkresës nr.26 / 8, datë 11.12.2017), praktikë kjo në referim të Urdhër prokurimit me nr. 28, datë 30.8.2017 të nënshkruar nga SP i Ministrisë së Brendshme. Fondi limit sipas Urdhër Prokurimit është 10,176,543 lekë pa TVSH.

Bashkëlidhur dokumentacionit të pagesave dhe asaj të administruar në dosjen e Sektorit të Prokurimeve me nr. 2 /2017), janë formulari i njoftimit të fituesit (botuar në Buletinin e APP me nr. 46, datë 20.11.2017, shtojcat e specifikimeve teknike, sigurimit të kontratës datë 20.12.2017 në vlerën 1.218.024 lekë.

Referuar specifikimeve teknike të tenderit dhe formularit/ shtojcës nr. 12, afati i levrimit të mallrave (uniforma dhe veshmbathje dhe elemente të tjerë përbërës të tyre) është përcaktuar 30 ditë nga lidhja e kontratës.

Në dosjen e prokurimit janë regjistruar dhe arkivuar disa kërkesa të OE “.....”:

- Kërkesa e datës 20.12.2017, (protokolluar në GR me nr. 1633/18, datë 21.12.2017), sipas së cilës operatori ekonomik i shpallur fitues, shprehet se është dakord të lidhë kontratën e furnizimit të uniformave dhe veshmbathjeve për Gardën e Republikës, sipas afatit të caktuar në shtojcën nr. 12 të DST. Institucioni i Gardës së Republikës i ka kthyer përgjigje administratorit z..... me shkresën nr. 1633/19 datë 21.12.2017, ku nënvizon se GR ka hartuar draft kontratën, por me ndryshimin që afati i levrimit të jetë deri me dt 31.12.2017.
- Përfundimisht është nënshkruar kontrata me nr. 45, datë 26 dhjetor 2017, ku në nenin 2, pika 2 e saj është shënuar afati i levrimit deri me datën 31.12.2017, pra brenda 6 (gjashtë) ditësh.

Sipas përcaktimeve të nenit 77, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të MF “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, paragrafi “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, për mbikqyrjen dhe realizimin e kontratës, është ngritur komisioni me urdhrin e Komandantit të Gardës nr.221, datë 03.02.2017 “Për pritjen dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara”, me përberje z.,, dhe

Për sa sipër, Autoriteti Kontraktor ka nënshkruar kontratën e furnizimit me datën 26 dhjetor dhe afat realizimi shumë të shkurtër, duke krijuar riskun e anomalive dhe parregullsive në cilësinë e furnizimit të një artikulli shumë të rëndësishëm për institucionin. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat dhe përcaktimet e vëna në formularin nr. 10 “Specifikimet teknike” (faqe 14 deri



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

147 e dosjes nr.2/2017 të Sektorit të Prokurimit), në lidhje me **kontrollin cilësor në procesin e prodhimit të uniformave dhe veshmbathjeve për punonjësit e GR**. Ky kontroll i cilësisë është nënvizuar **pothuajse për çdo artikull që është prokuruar**, ku vendoset detyrimi i GR që për të siguruar përmbushjen e detyrimeve mbi cilësinë ajo do **“të ndjekë dhe kontrollojë procesin e prodhimit në fabrikën prodhuese të atij artikulli”**. Kjo si për prodhimin e artikujve bluza pambuku me menge të gjata, bluza pambuku me mëngë të shkurtera, grada gjoksi të qëndisura, këmbisha, kostum oficeri (100 komplete), kostum për shërbim e stërvitje vere (500 komplete), kostum për shërbim e stërvitje dimri (600 komplete), xhupa $\frac{3}{4}$ sintetik cope 500, kostum ceremoniali vere 10 komplete, kostum ceremoniali dimri 30 komplete, etj.

Konstatohet se,

- Në përbërje të Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave nuk ka ekspertë të fushës (inxhinierë të tekstilit). Komisioni përbëhet nga dy oficerë të logjistikës dhe një shofer, duke mos zbatuar përcaktimet e paragrafit nr.43, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ku thuhet se “Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material”.
- Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e vëna në specifikimet teknike të DST, paragrafi “Kolaudimi dhe marrja në dorëzim” për secilin nga 19 artikuj të prokuruar, duhet të zbatoheshin detyrimet e vendosura për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave, ku përkatësisht thuhet se: “Pranimi të gjithë sasisë së artikullit... të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e porositësit do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merren gjatë procesit të kolauditimit për të gjithë sasinë e produktit të gartshëm të dorëzuar në magazinë. Teknikisht, kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të fletë analizave laboratorike të lëshuara nga institucionet e autorizuar, kryerjen direkt të matjeve dhe provave fizike të mostrave përfaqësuese të sasisë së mallit të dorëzuar, dhe krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik, kampionit të ofruar dhe modelit të miratuar.”
- Konstatohet se nuk ka gjetur zbatim neni 9, pika 1 “Kushtet e pranimi të mallit”, ku thuhet se “Para pranimi të mallit, AK nëpërmjet Komisionit të pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit, ekzaminon, inspekton dhe teston mallrat brenda 10 ditëve nga dorëzimi i tij në vendin e AK”. AK është mjaftuar vetëm me raportet e testimit të kryera dhe dorëzuara nga ana e OE, pa kryer testim dhe analiza në laborator të vecante për cilësinë e tyre.
- Bashkëlidhur pagesës është Certifikata e origjinës, pa datë (shënuar muaji dhjetor 2017), nënshkruar nga administratori z....., ku thuhet se uniformat i përgjigjen standardit të kërkuar dhe se origjina e prodhimit është siguruar nga firma “.....” shpk., por pa specifikuar asnjë të dhënë për origjinën e këtyre artikujve / furniturave dhe mallrave.

Sa sipër, përgjegjësi bie mbi Komisionin e Pranimi të Mallrave i përbërë nga, dhe

-Likujdimet për zbatimin e kontratës janë kryer sipas urdhër shpenzimeve të nënshkruara rregullisht dhe kaluara në Degën e Thesarit, si më poshtë vijon duke u bere hyrje me 3 dokumente FH :

Urdhër-Shpenzimi nr.929, datë 29.12.2017, vlera **1.197.432** lekë, sipas faturës tatimore me nr.59 (nr. Serial 29198059), datë 28.12.2017, për 10 artikuj që janë bërë hyrje sipas fletë hyrjes së GR me nr.4, datë 29.12.2017, shuma 1,197,432 lekë .

Urdhër-Shpenzimi nr.156, datë 6.3.2018, vlera **3.702.748** lekë, Faturë tatimore nr.60 (nr. Serial 46695060), datë 10.01.2018, fletë hyrje nr.1, datë 10.01.2018.

Urdhër-Shpenzimi nr.201, datë 21.3.2018, vlera **1.000.000** lekë, Faturë tatimore nr.60 (nr. Serial 46695060), datë 10.01.2018, fletë hyrje nr.1, datë 10.01.2018 për 13 artikuj.

Urdhër-Shpenzimi nr.220, datë 5.4.2018, vlera **3.560.688** lekë, Faturë tatimore nr.60 (nr. Serial 46695060), datë 10.01.2018, fletë hyrje nr.1, datë 10.01.2018



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Urdhër-Shpenzimi nr.227, datë 5.4.2018, vlera **2.035.955** lekë, Faturë tatimore nr.59 (nr. Serial 46695059), datë 20.01.2018, fletë hyrje nr.2, datë 20.01.2018 për 6 artikuj, me vlerë të fatures dhe FH prej 2,2,80,060 lekë.

Për mosrespektimin e afateve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar midis palëve, me nr. 45, datë 26.12.2017, neni 4 "likujdimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar", ku për çdo ditë vonese parashikohet 4/000 e vlerës korresponduese të kontratës që ka mbetur pa zbatuar nga çmimi total i kontratës, që përlogaritët prej **683.417 lekë**, si penalitet për dorëzim me vonesë të mallit. Nga ana e AK janë kryer përlogaritjet dhe janë aplikuar/mbajtur rregullisht penalitetet për likduim të vonuar të mallrave.

Bashkëlidhur USH është dokumentacioni i plotë justifikues, Raportet e Testimit të lëshuara nga Fakulteti i Inxhinierise Mekanike, (Departamenti i Tekstilit dhe Modes0 me datë 05.01.2018 për kampionet nr. A-2-15/4 për stof teriatali; Raportet e Testimit date 05.01.2018 për kampionet nr. A-2-16/2 për pëlhurë; Raportet e Testimit date 05.01.2018 për kampionet nr. A-2-16/1 për puplinë me ngjyrë bezhë të mbyllur; procesverbali i marrjes në dorëzim për verifikimin në sasi dhe cilësi i nënshkruar nga komisioni datë 29.12.2017, datë 10.1.2018, datë 20.1.2018, në të cilën shprehen se mallrat e funizuara janë përputhje me specifikimet teknike.

■ **I.Kontrata nr.46, datë 28.12.2017 "Blerje autoveturë për Gardën e Republikës" në vlerën 64.902.000 lekë me TVSH**, Referuar percaktimeve të nenit 2, pika nr. 2 "Afati i levimit" të kësaj kontrate është rënë dakord që grafiku i furnizimit do të jetë:

- Për **2 mjete** nga lidhja e kontratës deri më 31.12.2017,
- Për **27 mjete** nga lidhja e kontratës deri më 28.02.2018 (kjo në bazë të kërkesës nga operatori ekonomik me datën 22.12.2017, për shtyrjen e afatit kohor për shkak të kushteve klimaterike të rënduara për transportimin e tyre).

Kontrata është lidhur midis OE "....." sh.p.k përfaqësuar nga z..... dhe Komandantit të Gardës i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MB me shkresë nr.44/9 datë 21.12.2017. Njoftimi i fituesit është sipas shkrës me nr. 44/9 datë 19.12.2017.

Referuar dokumentyave standarde furnizimi do të mbyllet me datën 31.12.2017, mirëpo nga OE "....." sh.p.k me datën 22.12.2017 (prot në GR me nr. 2425, datë 22.12.2017) është dërguar një kërkesë, ku njoftohet "shtyrja e afatit " për furnizimin e autoveturave të kontraktuara , kjo e arsyetuar për shkak të kushteve klimaterike shumë të rënduar në Detin Mesdhe dhe dallgëzimit dhe erez se fortë", ku thuhet se parashikohet ardhja e 29 mjeteve brenda datës 5/2/2018.

Sipas nenit 12 të kontratës, likujdimi nga ana e AK do të kryhet, për 2 mjete në shumën 4.476.000 lekë me urdher xhirimi, kurse për shumën 60,426 mijë lekë me letër kredi (L/C).

Bashkëlidhur dokumentacionit të bankes janë formulari i sigurimit të kontratës prane sha datë 28.12.2017 në vlerën 6.490.200 lekë.

Për mbikqyrjen dhe realizimin e kontratës, është ngritur komisioni me urdhër të Komandantit të Gardës nr. 345, datë 6.2.2018 "Për pritjen dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara", kjo pasi në vitin 2018 janë marrë mjetet në dorëzim dhe kryer procedurat për hyrjen e këtyre aktiveve ". Sa më sipër, është vepruar sipas kërkesave të Kreut IX, neni 77, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 të MF "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kreu III, kapitulli "Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara".

Likujdimet për zbatimin e kontratës janë kryer si vijon:

- Urdhër-shpenzimi nr.923, datë 29.12.2017, vlera 2.238.000 lekë, për, sipas Fatures Tatimore me nr. 135, datë 28.12.2017, bërë hyrje me FH nr. 47, datë 28.12.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.924, datë 29.12.2017, vlera 2.238.000 lekë, për, sipas Fatures Tatimore me nr. 136, datë 28.12.2017, bërë hyrje me FH nr. 48, datë 28.12.2017.
- Urdhër-shpenzimi nr.930, datë 29.12.2017, vlera 60.426.000 lekë. Ky urdhërshpenzimi ka të bëjë me çeljen e letër kredisëshpk në bankën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nga ana e institucionit GR është raportuar periodikisht në Ministrinë e Brendshme mbi "Gjendjen/Levizjet e L/C për shpk", dhe rezulton se, të gjithë furnizimet janë kryer me flete hyrjet e dates 13 shkurt 2018. Kjo është reflektuar dhe në pasqyrën e raportimit, mbi gjendjen e llogarisë 01012685, ku janë ndryshmet e L/C për kompaninë, dhe se me datën 1/3/ 2018 gjendja e saj paraqitet e mbyllur.

Bashkëlidhur Urdhër-shpenzimeve është dokumentacioni i plotë justifikues, procesverbali i marrjes në dorëzim për verifikimin në sasi dhe cilësi i nënshkruar nga komisioni, në të cilën shprehen se automjetet e funizuara janë përputhje me specifikimet teknike.

II-Kontrata nr.48, datë 29.12.2017 "Blerje fuoristradë për Gardën e Republikës" në vlerën 3.273.600 lekë me TVSH. Referuar percaktimeve të nenit 2, pika nr. 2 "Afati i levirimit" të kësaj kontrate është rënë dakord që grafiku i furnizimit do të jetë nga lidhja e kontratës deri më 28.02.2018 (kjo në bazë të kërkesës të bërë nga ky operator ekonomik me datën 22.12.2017, për shtyrjen e afatit kohor për shkak të kushteve klimaterike të rënuara për transportimin e tyre), dhe Aneks Kontrate nr.10, datë 01.03.2018 (sipas kërkesës së dërguar nga ky operator ekonomik me datën 28.02.2018, për shtyrjen e afatit kohor për shkak të kushteve klimaterike të rënuara për transportimin e tyre, do të bëhet me rrugë tokësore). Kontrata është lidhur midis OE "....sh.p.k përfaqësuar nga z..... dhe Komandantit të Gardës së Republikës, autorizuar rregullisht nga Sekretari i Përgjithshëm i MB sipas shkresës me nr.44/9, datë 21.12.2017. Bashkëlidhur pagesave është administruar formulari i sigurimit të kontratës datë 29.12.2017, në vlerën 327.360 lekë prane shoqërisë "....." sh.a.

Referuar dokumentave standarde dhe Botimit të njoftimit të fituesit në Buletin e APP me nr. 52, datë 29.12.2017, furnizimi do të mbyllet me datën **31.12.2017**, nga "..... sh.p.k, por në nenin 2 të Kontrates, bazuar në kërkesën e OE, është caktuar deri më **28.2.2018**.

Pavaresisht këtij tejkalimi të afateve të furnizimit të mallrave nga DST (prej mbi dy muajsh), rezulton se nga OE "...." me datë 28.02.2018, (prot në GR me nr. 54/9 prot, datë 28.02.2018) është dërguar një kërkesë, ku kerkohet të shtyhet ky afat dhe 7 ditë të tjera, d.m.th deri më 7.3.2018, në shkresën "Kerkese për shtyrje afati", kjo e arsyetuar se për shkak të kushteve klimaterike shumë të rënuara në rruget nderkombetare nga Sllovenia për në Tiranë janë të pakalueshme, etj. Për sa sipër, është ndryshuar afati i furnizimit sipas kontratës me nr. 10, datë 01.03.2018.

Sipas nenit 12 të kontratës, likuidimi nga ana e AK do të kryhet, me letër kredi (L/C) e miratuar nga ana e MFE me nr. 19259/1, datë 28.12.2017 brenda 15 ditësh nga marrja në dorëzim të mallit. Për mbikqyrjen dhe realizimin e kontratës, është ngritur komisioni me urdhër të Komandantit të Gardës nr. 345, datë 6.2.2018 sepse në 2018 janë marrë mjetete hyrje "Për pritjen dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara", në bazë të përcaktimeve të kreut "IX", neni 77, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të MF "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kreu "III", kapitulli "Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara".

-Likuidimet për zbatimin e kontratës janë kryer sipas Urdhër-Shpenzimi nr.931, datë 29.12.2017, vlera 3.273.600 lekë. Ky urdhërshpenzimi është bazuar në çeljen e letër kredisë "....." shpk.

Nga ana e institucionit GR është raportuar periodikisht në Ministrinë e Brendshme mbi "Gjendjen / Lëvizjet për L/C për "..... shpk", dhe rezulton se gjithë furnizimet janë kryer me flete hyrjet e datës 06 mars 2018, dhe në pasqyrën e raportimit, gjendja e llogarisë 01012685 ku janë ndryshmet e LC për kompaninë "..... shpk", me datën 31/3/ 2018 gjendja e saj paraqitet e mbyllur.

Bashkëlidhur USH është dokumentacioni i plotë justifikues, procesverbali i marrjes në dorëzim për verifikimin në sasi dhe cilësi i nënshkruar nga komisioni, në të cilën shprehen se mallrat e funizuara janë përputhje me specifikimet teknike.

Konstatohet se nuk ka një konfirmim nga autoritet shtetërore mbi ekzistencën e situatës së forcës madhore për gjithë periudhën e shtyerjeve të kontratës.

Nga auditimi i dokumentacionit, si dhe përdorimit të këtij instrumenti pagese vërejtje se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nëse do të analizojmë përcaktimet mbi L/C do të ndeshen përkufizime të përafërta, që kanë si emërues garantimin e eksportuesit në tregtinë e jashtme nga ana e importuesi (që janë OE privatë):

- ✚ “Letër Kredia është një angazhim i pakthyeshëm nga ana e bankës lëshuese për të paguar përfituesin (palën që dërgon mallin), sapo nga ana e tij paraqiten dokumentat e kërkuara sipas letër kredisë, në kohën e caktuar, dhe pas përmbushjes së çdo kushti tjetër të aplikueshëm. **Letrat e kredisë përdoren vetëm në tregtinë ndërkombëtare, të cilat përfshijnë vlera të konsiderueshme midis një furnitori (eksportuesi) në një vend (shtet) dhe një blerësi (importuesi) në një vend tjetër (shtet tjetër) për vlera monetare të konsiderueshme...**”-(... bank);
- ✚ “Kredia Dokumentare ose ndryshe Leter Kredia është një instrument pagese i lëshuar nga një bankë me kërkesën e klientit të saj....Leter Kredite janë një instrument me i sigurt dhe me efektive në kryerjen e pagesave **ne trasaksionet e tregtisë ndërkombëtare**. Përdorimi i Leter Kredive nuk kufizohet vetëm në kryerjen e pagesave për blerjen e mallrave, por gjithashtu edhe për blerjen e shërbimeve dhe implementimin e projekteve specifike”-..... bank).
- ✚ “Letër kreditë janë **formë garancie** mundësuar nga banka duke i dhënë garanci pjesëmarrësve **në tregtinë e jashtme** që pagesat për mallra dhe/ose shërbime të kryhen nëse plotësohen disa kushte të caktuara”- (...).

Rezulton se, nga ana e autoritetit kontraktor është marrë miratimi nga ana e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave z..... sipas shkresës me nr. 19259/1, datë 28.12.2017, (protokolluar në GR me nr. 9676/2 datë 28.12.2017), kjo në referim të përcaktimeve të Udhezimit të ministrisë së Financave me nr.2, datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, **paragrafi nr. 147**. Konkretisht, në pikën nr.147 të udhëzimit përcaktohet se, “Ndalohej përdorimi i formës së ngurtësimit në llogari të klientit për të gjitha kontratat (investime, shërbime). Në lidhjen e kontratave për investime nuk lejohet të parashikohet dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies, përveç rasteve kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/nënligjor. Në këto raste paradhënia mund të jetë deri në 10%, por jo më shumë se kufiri i garancisë së kontratës. **Përrjashtimet nga ky rregull mund të bëhen vetëm për kontrata të rëndësishme të veçantë (për investime dhe shërbime) dhe vetëm me miratim paraprak të Ministrit të Financave.** Kushti i kontratës i lidhur në kundërshtim me këtë parashikim, është i pavlefshëm dhe nuk ekzekutohet”. **Mungon një përcaktim i saktë dhe rigoroz nga ana e MFE mbi rastet, tipologjitë dhe natyrën e investimeve që do të njihen si të rëndësishme të vecante, meqenëse ato, kur prokurohen nuk kanë një referim të atillë.**

Audituesit KLSH-së sjellin në vëmendje se, ngurtësimi i fondeve dhe kryerja e pagesave për furnitura që konsiderohen të realizuara brenda vitit ushtrimor (sipas Regjistrimit të Realizimit të Prokurimeve Publike të AK), por që në fakt bëhen hyrje në njësinë shpenzuese vitin pasardhës, tregon për procese që nuk janë planifikuar siç duhet nga ana e struktureve përgjegjëse në institucionin e qeverisjes së përgjithshme (Drejtoria e Prokurimeve të Përqëndruara në Ministrinë e Brendshme) dhe çënon parimet e zbatimit të buxhetit. Përdorimi i letër kredive nga institucioni, në masën e plotë të investimit, çënon parimin kryesor të realizimit të buxhetit atë të transparencës dhe besueshmërisë, të përcaktuara nga neni 4 i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe neni 40 i tij, ku thuhet përkatësisht se, “e drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës”, pasi institucioni ka deklaruar investime/shpenzime të kryera si të realizuara për vitin 2017, ndërkohë që transaksionet financiare (mekanizmi L/C dhe hyrja e mallrave dhe produkteve) janë kryer efektivisht gjatë vitit 2018.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i transaksioneve të bankës për vitin 2018 janë audituar me sqajdhje zbatimi i kontratës me nr. 20 dhe 21,dhe rezultoi si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

I.Kontrata nr.20, datë 05.06.2018 “Blerje fuoristradë 4x4 me kalueshmëri të lartë për Gardën e Republikës” në vlerën 42.840.000 lekë me TVSH dhe me afat lëvrimi/furnizimi brenda **60 ditëve** nga nënshkrimi i kontratës. Objekti i kontratës ka të bëjë me furnizimin e 6 (gjashtë) autoveturave fuoristradë.

Kontrata është nënshkruar rregullisht midis OE “...”sh.p.k përfaqësuar nga z..... dhe Komandantit të Gardës, i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme me shkresën nr.5/10 datë 22.05.2018. Bashkëlidhur pagesave është administruar formulari i sigurimit të kontratës datë 01.06.2018 në vlerën 4.248.000 lekë. Kjo praktikë likujdimi dhe marrje në dorëzim të automjeteve, i referohet urdhërit të prokurimit me nr. 05, datë 12.03.2018 të lëshuar nga Ministria e Brendshme (nënshkruar nga ana e SP znj.....). Referuar këtij urdhri, Loti nr. III është “Blerje fuoristrade 4x4 me kalueshmeri te larte per GR” me FL= 36,499,998 lekë pa TVSH. dhe Loti nr. IV përfshin “Blerje automjeteve per GR” me FL= 6,164,001 lekë pa TVSH.

Pjesë e dosjes janë deklaratat e lëshuara dt 9.4.2018 nga OE “...”sh.p.k sipas së cilës mjetet janë sipas normave dhe standardeve të BE, deklarata e servisit për gjithë periudhën e garancisë, si dhe është administruar në dosje deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.

Nga ana e MB / Drejtoria e Prokurimeve të Perqendruara me shkresën nr. 5/10 prot, datë 22.05.2018 është lëshuar “Autorizim për lidhje kontrate”.

Me furnizuesin “...shpk” është lidhur një marrëveshje shtesë e kontratës së faktoringut me nr. 293 kol dhe 13391 rep, datë 21.11.2013, kjo nënshkruar para noterit me datën 25.5.2018 me shoqërinë juridike “...” sha, ku dorëzanë të kësaj marrëveshje janë z..... dhe z.....

Sigurimi i kontratës së furnizimit është kryer me datën 01.06.2018 pranë shoqërisë “...” sha në shumën 4,284 mijë lekë.

Paralelisht, është lidhur dhe marrëveshja për barrët siguruese midis shoqërinë juridike “...se” sha dhe OE “...” shpk, ku barrëdhënësi merr përsiper limitin e financimit së bashku me komisionet e aplikueshme për llogari të institucionit të GR.

Likujdimet për zbatimin e kontratës janë bërë për “.....”, në bazë të nenit 12 të kontares nr. 20, datë 5.6.2018 sipas ketyre urdhër shpenzimeve që vijnë:

- Urdhërshpenzimi nr.420, datë 19.6.2018, vlera 7.140.000 lekë, sipas Faturës tatimore bashkëlidhur pageses me nr. serial 53035052, datë 11.6.2018 nënshkruar nga z..... si përfaqësues i blerësit dhe *fletë hyrjes së GR me nr.28, datë 12.6.2018.*
- Urdhërshpenzimi nr.421, datë 19.6.2018, vlera 7.140.000 lekë, Faturë tatimore nr.53035053, datë 11.6.2018, *fletë hyrje nr.29, datë 12.6.2018.*
- Urdhërshpenzimi nr.422, datë 19.6.2018, vlera 7.140.000 lekë, Faturë tatimore nr.53035054, datë 11.6.2018, *fletë hyrje nr.30, datë 12.6.2018.*
- Urdhërshpenzimi nr.423, datë 19.6.2018, vlera 7.140.000 lekë, Faturë tatimore nr.53035055, datë 11.6.2018, *fletë hyrje nr.31, datë 12.6.2018.*
- Urdhërshpenzimi nr.424, datë 19.6.2018, vlera 2.640.000 lekë, Faturë tatimore nr.53035056, datë 11.6.2018, *fletë hyrje nr.32, datë 12.6.2018.*
- Urdhërshpenzimi nr.499, datë 2.7.2018, vlera 4.500.000 lekë, Faturë tatimore nr.53035056, datë 11.6.2018, *fletë hyrje nr.32, datë 12.6.2018.*
- Urdhërshpenzimi nr.500, datë 2.7.2018, vlera 5.500.000 lekë, Faturë tatimore nr.53035057, datë 11.6.2018, *fletë hyrje nr.33, datë 12.6.2018.*
- Urdhërshpenzimi nr.566, datë 1.8.2018, vlera 1.640.000 lekë, Faturë tatimore nr.53035057, datë 11.6.2018, *fletë hyrje nr.33, datë 12.6.2018.*

Nga auditimi rezultoi se bashkëlidhur USH janë administruar dokumentet e plota justifikuese, procesverbali i marrjes në dorëzim për verifikimin në sasi dhe cilësi i nënshkruar nga komisioni, në të cilën shprehen se mallrat e furnizuara janë përputhje me specifikimet teknike. *Janë mbajtur procesverbalet e marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara, si dhe janë administruar rregullisht garancia për automjetin, e lëshuar nga OE “...” shpk, Akti i gjendjes teknike të mjetit.* Për mbikqyrjen dhe realizimin e kontratës, është ngritur komisioni me urdhër të Komandantit të Gardës nr.2099, datë 03.04.2018 “Për pritjen dhe marrjen në dorëzim të aktiveve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

të furnizuara”, kjo në sipas përcaktimeve të kreut IX, neni 77, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Udhëzimit të MF me nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III, kapitulli “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

Për këtë objekt prokurimi nga Drejtoria e Standarteve dhe Monitorimit të Cilësisë e Agjencisë së Blerjeve të përqëndruara (Ministria e Brendshme), në zbatim të urdhrit nr. 673 datë 4.7.2018 të MB është ngritur grupi i punës për moonitomin e zbatimit të kontraes. Për sa sipër është bërë monitorimi i kësaj kontrate dhe me shkresën nr.673/3, datë 10.08.2018”, është dërguar në GR “Raporti për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës”. me shkresën nr.673/3, datë 10.08.2018, ku nuk janë konstatuar parrregullsi.

II.Kontrata nr.21, datë 05.06.2018 “Blerje automjete për Gardën e Republikës” në vlerën 7.056.000 lekë me tvsh, kohëzgjatja 60 ditë nga lidhja e kontratës. Kontrata është lidhur midis OE “;.....” sh.p.k përfaqësuar nga z.Illir ZEKA dhe Komandantit të Gardës së Republikës Z.....Nga ana e MB/Drejtoria e prokurimeve të Perqendruara me shkresën nr. 5/10 datë 22.05.2018 është lëshuar “Autorizim për lidhje kontrate”.

Bashkëlidhur formulari i sigurimit të kontratës datë 01.06.2018 në vlerën 705.600 lekë pranë shoqërisë sha.

Praktika i referohet urdhërit të prokurimit me nr. 05, datë 12.03.2018 të lëshuar nga Ministria e Brendshme (nënshkruar nga ana e SP znj.....). Referuar këtij urdhëri, Loti nr. IV është ““**Blerje automjete për Gardën e Republikës**” me fondin limit 5,880 mijë lekë pa TVSH, ose 7,056,000 lekë me TVSH..

Pjesë e dosjes janë deklaratat e lëshuara dt 09.04.2018 nga z..... administrator i OE “....”sh.p.k sipas së cilës mjetet janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST dhe se mbulohet servisi brenda periudhës së garancisë; deklarata e servisit e po asaj date, si dhe specifikimet teknike të automjeteve dhe deklarata e kryerjes së shërbimeve të riparimit gjatë gjithë periudhës së garancisë. Pjesë e dosjes është dhe Marrëveshja e Kontrates së me nr. 13391 rep dhe 4208 kol, datë 21.11.2013 midis sha furnizuesit shpk dhe dorezanesve z..... dhe

Për zbatimin e kontraes është njoftuar APP me shkresën nr. 70/16, datë 03.08.2018.

Për mbikqyrjen dhe realizimin e kontratës, është ngritur komisioni me urdhër të Komandantit të Gardës nr.2099, datë 03.04.2018 “Për pritjen dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara”, kjo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kreun “IX”, neni 77, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të MF “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, kapitulli “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

-Likujdimet për zbatimin e kontratës janë kryer me Urdhër Shpenzimin nr.567, datë 1.8.2018, në vlerën 7.056 mijë lekë. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është administruar dokumentacioni i plotë justifikues:

-Fletë hyrjet e magazinës me nr.41, 42 dhe 43, datë 18.7.2018 të lëshuara mbështetur mbi fatura tatimore të OE me nr. Serial 64710232, 64710233, 64710234 (dhe nr. 439, 440, 441), datë 18.7.2018).

-Procesverbalet e marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara (nr. 3, datë 18.7.2018; nr. 3, datë 18.7.2018; nr. 1, datë 18.7.2018; nr. 2, datë 18.7.2018);

-Akt mbi gjendjen teknike mjeti për verifikimin në sasi dhe cilësi i nënshkruar nga komisioni, në të cilën shprehen se mallrat e funizuara janë përputhje me specifikimet teknike (nr. 49, datë 18.7.2018; nr. 50, datë 18.7.2018; nr. 48, datë 18.7.2018).

LIKUJDIMI I VENDIMEVE GJYQESORE:

Për **vitin 2017**, u krye auditim i plotë i procedurës së likidimit të Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë nga ku rezultoi se janë likuiduar me 48 urdhërpagesa shuma prej **289,770,037** lekë. Nga shuma e mësipërme, vlera prej 289,014,709 është likuiduar në zbatim të VKM nr.22 datë 10.01.2017, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për MPB, nga fondi rezervë i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

buxhetit të shtetit, përshlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 Janarit”, i ndryshuar, ndersa shuma prej 669,364 lekë, është për shlyerjen e Vendimeve Gjyqësore të Gjykatës së Apelit Tiranë për dy punonjës së Gardës së Republikës, (përkatësisht pagesë për z.... dhe).

Lidhur me proceset gjyqësore që janë zhvilluar gjatë vitit 2018 e në vazhdim na rezulton se janë ndjekur pranë shkallëve të ndryshme të gjyqësorit proceset, sipas listes së pasqyruar në anekset e këtij raporti;

Nga auditimi i kryer në drejtim të likuidimit të vendimeve gjyqësore për **ngjarjet e 21 Janarit 2011**, rezultoi se pagesat e kryera janë mbështetur me dokumentacionin justifikues përkatës, (si në Urdhrin e Komandantit të Gardës së Republikës për likuidim sipas personave, Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kërkesën e personave përfitues së bashku me numrat e llogarive personale, VKM për akordimin e fondit dhe likuidimin e personave përfitues për Vendimet e Gjykatës, shkresat e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për akordimin e fondeve për likuidim, kërksat e zyrave të përmbartimit dhe urdhër pagesa për likuidim për çdo person përfitues).

U analizuan disa nga këto urdher shpenzime dhe rezultoi se bashkëlidhur pagesave janë praktikatat respektive dokumentare. Më konkretisht:

- ✚ 1. Me urdhërpagesën **nr.525, datë 17.07.2018**, është likuiduar subjekti privat „.....” shpk Lushnje në shumën **1,680,101 lekë si shpenzime dhe tarife përmbartimore**.

Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Kjo pagesë është kryer sipas kërkeses për venie në ekzekutim të kreditorëve, dhe për venie në zbatim të vendimit nr.944 (80-2017-960) të lëshuar me datën 10.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Prokurë e posacme e datës 25.8.2014 plëshuar pranë Zyres Noteriale Fier me nr. 1757 rep dhe 664/2 kol datë 25.8.2014 për autorizim të av. për cesthejn civile, demshperblim për humbjen e jetes se të ndjerit, kundra Gardes se Re[publikës dhe Ministrise se Brendshme.
- Vendimi nr.944 (80-2017-960) të lëshuar me datën 10.03.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt shperblimi i dëmit të plotë jo pasuror, biologjik, moral ekzistencial si dhe spnezime të tjera të arsyeshme e të arsyeshme e të nevojshme për shkak të humbjes së jetës së të ndjerit, i vrarë me 21 janar 2011 për detyrimin në shumën **22,917,741 lekë**.
- Fature tatimore e shpk me nr. 2 datë 03.01.2018 në vlerën 1,680,101 lekë.
- Urdher i Komandantit të Gardes se Republikes me nr. 1922 datë 9.3.2018
- Venie në sekuestro nr.1647/2 datë 7.3.2018

- ✚ 2. Me urdhërpagesën **nr.526, datë 17.07.2018**, është likuiduar subjekti privat „.....” shpk Lushnje në shumën **216,000 lekë si shpenzime gjyqësore**.

Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Urdher i Komandantit të Gardes se Republikes me nr. 1922 datë 9.3.2018
- Vendim me nr. 102 regjistri datë 31.01.2017 të Gjykatës Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për ndreqje gabimi në vendimin nr.944 (80-2017-960) të lëshuar me datën 10.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në kërkesë familjare, dhe
- Sipas këtij vendimi ku Garda e Republikes dhe MPB janë person i tretë, janë korigjuar shpenzimet gjyqësore nga 417 mijë lekë në shumën 633 mijë lekë dhe pikerisht për diferencën 216 mijë leke është prerë urdher shpenzimi.
- Nuk ka faturë tatimore e shpk për këtë pagesë.

Nga ana e institucionit GR dhe **shoqerise përmbartimore** janë mbajtur këto korrespondenca shkresore:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- ✓ Shkresa e “.....” me nr. 32 prot, datë 08.01.2018 (protokolluar ne Gardën e Republikës me nr. 50/1, datë 09.01.2018) drejtuar debitoreve solidarë GR dhe MB për vlerën e mbetur te detyrimit për ekzekutim të plotë vtë vendimit gjyqësor të formës së prerë.
- ✓ Shkresa e GR me nr. 469/2 datë 22.2.2018 drejtuar Degës së Thesarit Tiranë (znj.....) në lidhje me kërkesat me nr. 325 dhe 326 datë 21.2.2018 të shoqërisë ... për vendosjen e masës së sekuestros konservative;
- ✓ Informacioni/ shkresa e GR me nr. 470/2, datë 22.02.2018 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MB Znj..... në lidhje me shoqërinë përmbartimore Group dhe kërkesat e perseritura për shlyerjen e vendimeve gjyqësore për hamiljet e viktimave të përfshira në ngjarjet e 21 janarit 2011 si dhe ekzekutimin e detyrueshëm të dy vendimeve gjyqësore, atij me nr. 6148/2016 për të ndjerin Z..... për shumën 23,698,824 lekë dhe vendimit gjyqësor me nr. 944/201 për të ndjerin për shumën 25,230,842 lekë;
- ✓ Shkresa e Degës së Thesarit Tiranë me nr. 1646/2 datë 27.2.2018 drejtuar GR në lidhje me zbatimin e urdhrës nr.78928 prot datë 16.2.2018 përndryshe do të kalohet në vendosjen e sekuestros konservative;
- ✓ Shkresa e Degës së Thesarit Tiranë me nr. 4415/4, datë 11.6.2018 drejtuar GR në lidhje me detyrimet ndaj kreditorëve,,,,etj.
- ✓ Informacioni/ shkresa e GR me nr. 2594/2, datë 07.06.2018 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të MB Z.... në lidhje me shoqërinë përmbartimore Group dhe kërkesat e perseritura për shlyerjen e vendimeve gjyqësore për hamiljet e viktimave të përfshira në ngjarjet e 21 janarit 2011 si dhe ekzekutimin e detyrueshëm të dy vendimeve gjyqësore, atij me nr. 6148/2016 për të ndjerin Z..... për shumën 23,698,824 lekë dhe vendimit gjyqësor me nr. 944/201 për të ndjerin për shumën 25,230,842 lekë;
- ✓ Shkresa e GR me nr. 50/4 prot, datë 07.06.2018 drejtuar përmbartuesit ..., shoqëria përmbartimore “.....” për disponim të dokumentacionit origjinal të dy vendimeve gjyqësore.
- ✓ Lajmërimi për ekzekutim vullnetar të detyrimit etj.

Konstatimi:

a. Nga ana e GR janë kryer detyrimet ligjore që rrjedhin nga zbatimi i :

-VKM nr. 22, datë 18.01.2017 „Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017 për MPB nga fondi rezerve i BSH për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011” si dhe

- VKM nr. 743, datë 13 dhjetor 2017 ”Për një ndryshim në VKM nr. 22, datë 18.01.2017 „Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017 për MPB nga fondi rezerve i BSH për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011”.

B. Shuma prej 1,896,101 lekë si pasojë e shpenzimeve të palikuidara nga mosçelja e fondeve dhe bërja e tyre efektive në kohë është një detyrim shtesë nga ana e shoqërisë përmbartimore „..... Group”, përbën një shpenzim pa efektivitet për fondet e buxhetit të shtetit, e lidhur me veprimet dhe miosveprimet e strukturave pergjegjese, me vonesën në hartimin dhe miratimin e projekt vendimit për KM si dhe faktit se fondet janë bërë efektive më 27 dhjetor 2017, dhe po këtë datë janë prokurat e familjarëve (shiko shkresa nr 2594/2 datë 7/6/2018 e GR për MB).

- ✚ 3. Me urdhërpagesën **nr.527, datë 17.07.2018**, është likuiduar subjekti privat „...” shpk Lushnje në shumën **1,680,101 lekë si shpenzime dhe tarifë përmbartimore**.

Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Kjo pagesë është kryer sipas kërkesës për venie në ekzekutim të kreditorëve, dhe për venie në zbatim të vendimit nr.944 (80-2017-960) të lëshuar me datën 10.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- Prokure e posacme e dates 25.8.2014 plëshuar pranë Zyres Noteriale Fier me nr. 1757 rep dhe 664/2 kol date 25.8.2014 per autorizim te av. per cesthejn civile, demshperblim për humbjen e jetes se te ndjerit, kundra Gardes se Re[ublikës dhe Ministrise se Brendshme.
- Vendimi nr.944 (80-2017-960) të lëshuar me daten 10.03.2017, të Gjykates Administrative të Shkalles së Parë Tiranë, me objekt shperblimi i dëmit të plotë jo pasuror, biologjik, moral ekzistencial si dhe spnezime te tjera të arsyeshme e të arsyeshme e te nevojshme për shkak të humbjes së jetës së të ndjerit, i vrarë me 21 janar 2011 per detyrimin në shumën **22,917,741 lekë**.
- Fature tatimore e ... shpk me nr. 2 date 03.01.2018 në vlerën 1,680,101 lekë.
- Urdher i Komandantit te Gardes se Republikes me nr. 1922 date 9.3.2018
- Venie nen sekuestro nr.1647/2 date 7.3.2018

- ✚ 4. Me urdhërpagesën **nr.723, datë 03.10.2018**, janë likuiduar shpenzimet e tarifave gjyqësore për llogari të Gjykatës së Rrehtit Gjyqësor Tiranë në shumën **563,222 lekë**.

Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Kerkese padi me nr.3265, date 19.09.2018 në ngarkim të të paditurit ..., për detyrimi e palës paditëse ti kthejë Gardes se Republikës shumën prej 55, 843,252 lekë si dëmshpërblim i paguar nga ky institucion për shkaktimin e humbjes se jetes se te ndjerit në ngjarjet e 21 janarit 2011 si dhe shumat 240 mijë lekë për shërbimin e avokatëve, 120 mijë lekë për shërbimin e ekspertëve, 40 mijë lekë për shërbimin e psikologut dhe 78 mijë për shërbimin përmbarimor (.... Group).
- Faturë tatimore per arketim me nr.1 date 28.09.2018

- ✚ 5. Me urdhërpagesën **nr.724, datë 03.10.2018**, janë likuiduar shpenzimet e tarifave gjyqësore për llogari të Gjykatës së Rrehtit Gjyqësor Tiranë në shumën **661,524 lekë**.

Kjo pagesë është kryer sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur:

- Kerkese padi me nr.3264, date 19.09.2018 në ngarkim të të paditurit, për detyrimi e palës paditëse ti kthejë Gardes se Republikës shumën prej 65, 356,267 lekë si dëmshpërblim i paguar nga ky institucion për shkaktimin e humbjes se jetes se te ndjerit në ngjarjet e 21 janarit 2011 si dhe shumën 680 mijë për shërbimin përmbarimor privat.
- Faturë tatimore per arketim me nr.2, date 28.09.2018

Konstatim:

1. Referuar VKM nr 22, datë 18.01.2017 dhe VKM nr. 743, datë 13.12.2017 rezultojnë se janë parashikuar shumat respektive për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore, përkatësisht:

-Sipas VKM nr.22, datë 18.01.2017,shuma 160,011,479 lekë dhe

-Sipas VKM nr.743, datë 13.12.2017 shuma 129,672594 lekë.

Gjithsej: 289,684,073 lekë

1. Nga shqyrtimi i lidhejs nr. 1, që shoqëron VKM nr.22, datë 18.01.2017 si dhe lidhjes nr. 1/1, që shoqëron VKM nr.743, datë 13.12.2017 konstatohet se vendimet gjyqësore të shënuara në këto tabela kanë data të njëjta në të dy statet, por u referohetn numrave të ndryshëm të këtyre vendimeve. Konkretisht:

<i>VKM nr.22, datë 18.01.2017 përfshin këto vendime gjyqësore në lidhjen e tij</i>	<i>VKM nr.743, datë 13.12.2017 përfshin këto vendime gjyqësore në lidhjen e tij</i>
Vendimi nr. 2719 , datë 28.7.2016	Vendimi nr. 3968 , datë 28.7.2016
Vendimi nr. 6189 , datë 21.12.2016	Vendimi nr. 6148 , datë 21.12.2016



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Vendimi nr. 6337 , datë 28.12.2016	Vendimi nr. 6292 , datë 28.12.2016
Vendimi nr. 6300 , datë 27.12.2016	Vendimi nr. 6242 , datë 27.12.2016

Vlera e llogarisë 602/7 “Shpenzime për detyime dhe kompensime legale” paraqitet në shumën prej **289,770,037 lekë dhe nga kjo, vlera prej 289,014,709 lekë përfaqëson shpenzimet për ngjarjet e 21 janarit 2011**. Konstatohet se janë kryer likuidime për Vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me **46 Urdhër Shpenzime në shumën 289,014,709 lekë, për të cilat nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Gardës së Republikës (si palë të paditura), nuk është bërë ankimimi dhe ndjekja në të gjithë shkallët e gjyqësorit.**

Konstatimi:

Sa më sipër, likuidimet e vendimeve gjyqësore janë kryer pa ankimuar në gjithë shkallët e gjyqësorit, prandaj, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 452 Kodit të Procedurës Civile, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, i ndryshuar në të cilin është përcaktuar se “Mund të ankimohen në gjykatën e apelit **të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj**”, nen i cili nuk përjashton institucionin e GR të mos ushtrojë të drejtën ankimit ndaj vendimeve gjyqësore për aq kohë sa, këto vendime sjellin pasoja financiare në buxhetin e shtetit; si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kreu II/2, pika 62, ku thuhet: “***Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi***”.

Konstatim: Është kryer likuidimi i z....., sipas urdhershpenzimit me nr. 635, datë 28.08.2018 për zbatim të Vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë Tiranë me nr. 45/1 datë 3.7.2018 dhe Urdhrit të Komandantit me nr. 2984, datë 01.08.2018 në shumën 81,379 lekë, përsi rillogaritje për pagën kalimtare të kerij ish-punonjësi me gradën nënkolonel. Të dhënat dhe efektet financiare përkatëse nuk përfshihen në data bazen e përgatitur për ndjekje nga ana e Sektorit Juridik të GR.

Konstatim: Për likuidimin e 2 vendimeve gjyqësore në vitin 2017 në vlerë 669,364 lekë, nuk është bërë gjurma e auditimit për nxjerrjen e përgjegjësive administrative para likuidimit të këtyre vendimeve. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 62 të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” ku përcaktohet që “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi” dhe pikën 38 të Udhëzimit të MB nr.459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme”. Mbajnë përgjegjësi administrative për këto veprime nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.

Per likuidimet e kryera gjate vitit 2018 e në vijim është korrigjuar kjo parregullsi dhe per urdher shpenzimet e kaluara në degën e thesarit per proceset gjyqësore në përgjithësi është hartuar gjurma e auditimit. Për këtë u testua USH nr. 60, datë 13.03.2018 për shumën 369,280 lekë me përfites Evelina Bekteshi, përfaqësues i z.Fatos Skeja, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit me nr. 2344, datë 02.11.017.

Detyrimet që janë likuiduar për vendimet gjyqësore të formës së prerë për vitin 2018 janë ekzekutuar me 13 urdhershpenzime për **5,328,102 lekë**, që në mënyrë të detajuar pasqyrohen në vijim:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Ekstremitetet e urdhërshpenzi mit		Vlera	Përshkrimi i veprimit	Ekstremitetet e Vendimit të Gjykatës					
				Shkalla e parë		Apeli		Gjykata e Lartë	
				Nr	Datë	Nr	Datë	Nr	Datë
60	13.03.2018.	369,280	Kësti i parë i pagesës për kreditorin	7407	16.12.2014.	3839	20.09.2017.		
282	25.04.2018.	400,000	Kësti i dytë i pagesës për kreditorin						
329	17.05.2018.	400,000	Kësti i tretë i pagesës dhe përfundimtar për kreditorin						
367	23.05.2018.	669,280	Kësti i parë i pagesës për kreditorin	714	24.02.2014.	4972	30.11.2017.		
368	28.05.2018.	380,000	Shpenzime gjyqësore për rastin ...	6292	28.12.2016.				
400	07.06.2018.	500,000	Kësti i dytë i pagesës për kreditorin	714	24.02.2014.	4972	30.11.2017.		
522	10.07.2018.	176,167	Kësti i parë i pagesës për kreditorin.....	1613	26.03.2015.	3205	05.07.2017.		
525	17.07.2018.	1,680,101	Tarifë përbarimore për shoqërinë ...Group shpk, tragjedia e 21 janarit	944	10.03.2017.				
526	17.07.2018.	216,000	Ndreqje gabimi të vendimit të gjykatës, çështja, të afërmit,	102	31.10.2017.				
527	17.07.2018.	78,928	Tarifë përbarimore për vendimin nr.6148, datë 21.12.2016,	6148	21.12.2016.				
558	30.07.2018.	176,167	Kësti i dytë i pagesës për kreditorin	1613	26.03.2015.	3205	05.07.2017.		
635	28.08.2018.	81,379	Pagesë në favor të					45/1	03.07.2018.
732	11.10.2018.	100,800	Pagesë në favor të	2941	09.06.2016.	2047	17.05.2018.		

(Burimi: GR, Sektori Financës).

- **INVENTARIZIMI I PRONËS SHTETËRORE, VLERËSIMI, NXJERRJET JASHTË PËRDORIMIT DHE ASGJESIMI I AKTIVEVE:**

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm i kontrollit në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë shpenzuese, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të tyre, dhe realizohet sipas procedurave të miratuara me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

-Komisionet e ngarkuara me kryerjen e inventarizimeve fizike kanë përpiluar informacione /relacione lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, ia kanë kaluar për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues, siç cilëson pika 85/ c e Udhëzimit të MF nr.30/2011 me ndryshimet.

Inventarizimi i v.2017:

Gjatë periudhës 25.10.2017 deri më 10.11.2017 në zbatim të urdhrave të Komandantit të Gardes z..... janë kryer procedura në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve në dispozicion të GR, si vijon:

- me urdhrin nr. 2008, datë 20.10.2017, është ngritur Komisioni Qendror i Inventarizimit të aktiveve për njësinë shpenzuese GR, i përbërë nga,,,dhe Këto komisione janë suportuar dhe nga 8 (tetë) grupet e inventarizimit për inventarin në depo dhe magazinë e shërbimit të kazermimit, ushqimit, transportit veshmbathjes, arkes së institucionit, xhenjos, bibliotekës, magazinën e pjesëve të ndërrimit, shërbimin shëndetësor, pikat autonome et. etj. Në zbatim të këtij urdhri



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

është bhortuar dhe miratuar grafiku i kontrollit të gjendjeve fizike të artikujve sipas shërbimeve dhe është miratuar nga ana e Komandantit të Gardës së Republikës plani i Punës për inventarizimin e pasurisë. Nga ana e personave materialisht përgjegjës janë plotësuar deklaratat mbi konfirmimin e faktit se nuk ka materiale të pa dokumentuara dhe janë nanshkuar rregullisht gjendjet fizike të çdo artikulli.

- sipas urdhërit nr.690/1 date 11.4.2017 është ngritur Komisioni për Nxjerrjen nga Përdorimi, heqjen nga inventari, ndryshimin e formes fillestare dhe asgjesimin e tyre, me perberje z.....,,,, dhe
- Me shkresen nr. 2467, date 29.12.2017 është informuar Ministria e linjës administrative (MB) mbi inventarizimin e 22 objekteve dhe nuk ka patur asnjë diference nga gjendja kontabile e artikujve të inventarizuar.

Inventarizimi i v.2018:

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2018 në zbatim të urdhrave të Komandantit të Gardës z..... janë kryer procedura në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve në dispozicion të GR, si vijon:

- me urdhrin nr. 3701, datë 09.10.2018, është ngritur Komisioni Qendror i Inventarizimit dhe Vleresimit të Aktiveve për njësinë shpenzuese GR, i përbërë nga z..... -kryetar,-anetar, dhe znj..... Ky komision është suportuar dhe nga 6 (gjashtë) grupet e inventarizimit për inventarin në depo dhe magazinë e shërbimit të ushqimit, kazermimit, transportit, mjete lundruese, veshmbathjes, arkes së institucionit, xhenjos, bibliotekes, magazinën e pjesëve të ndërrimit, shërbimit shëndetësor, pikat autonome etj. Në zbatim të këtij urdhëri është hartuar dhe miratuar grafiku i kontrollit të gjendjeve fizike të artikujve sipas shërbimeve dhe është miratuar nga ana e Komandantit të Gardës së Republikës plani i Punës për inventarizimin e pasurisë date 09.10.2018. Nga ana e personave materialisht përgjegjës janë plotësuar deklaratat mbi konfirmimin e faktit se nuk ka materiale të pa dokumentuara dhe fletet e inventarizimit janë nanshkuar rregullisht bazuar në gjendjet fizike të çdo artikulli.
- Në pikën nr. 11 të këtij urdhëri është ngritur Komisioni për Nxjerrjen nga Përdorimi, heqjen nga inventari, ndryshimin e formes fillestare dhe asgjesimin e tyre, me perberje,,,,,,
- Me shkresen nr. 4282, datë 31.12.2018 është informuar Ministria e Brendshme mbi përfundimin e procesit të inventarizimit për 25 objekte dhe nuk ka patur asnjë diferencë midis gjendjes kontabile dhe artikujve fizikë të inventarizuar.
- Në zbatim të urdhrit të komandantit të GR me nr. 3706, datë 09.10.2018 “Për inventarizimin, vleresimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të Gardës së Republikës”, nga data 01.11.2018 deri me 30.11.2018 nga komisioni i ngritur për këtë qëllim janë kryer për 25 autovetura, të tipeve dhe vitprodhimeve të ndryshme, dy mikrobuzet, dhe në emertese të titulluar “test elektronik” (viti hyrjes 2002 dhe jashtë funksionit), për të cilat janë hartuar procesverbalet e vleresimit së bashku me relacionet bazuar në gjendjen teknike të mjeteve për tu nxjerre nga përdorimi. Ky proces është finalizuar me një memo që i është drejtuar Komandantit të Gardës dhe është miratuar prej tij për të propozuar MB vijimin e procedurave të miratimit, sipas Udhëzimit të MPB për këtë qëllim.
- Me shkresen nr. 4138/1 prot, datë 11.12.2018 këto propozime i janë dërguar për kompetencë SP të MB z....., por deri në datën e kryerjes së auditimit nuk ka një përgjigje për të përmbyllur këtë procedurë..

Konstatime:

1. Sipas përcaktimeve të pikës nr. 3 të Urdhrit të Komandantit të GR me nr. 2008, të datës 20.10.2017, përcaktohet se Inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve do të realizohet gjatë periudhës tetor- nëntor 2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Për sa sipër, konstatohet se kanë gjetur zbatim afatet e inventarizimit, të caktuara në dy akte të lëshuara nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe konkretisht:

-Referuar pikës nr.4 të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme Nr. 1151, datë 16.07.2007, “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”, i ndryshuar, përcaktohet specifikisht se:

“Vlerësimi të kryhet gjatë muajve shtator-tetor ndërsa asgjësimi i vlerave materiale të kryhet gjatë muajit nëntor të cdo viti ushtrimor. Për raste të veçanta kur paraqitet nevoja për vlerësimin e mallrave që prishen e demtohen, vlerësimi dhe asgjësimi mund të bëhen dhe jashtë këtij afati”.

-si dhe përcaktimeve të pikës nr. 6 të Udhëzimit të MPB me nr. 226, datë 08.05.2015 sipas të cilit *“inventarizimi i aktiveve realizohet në tremujorin e fundit tetor-dhjetor të cdo fundviti buxhetor”.*

2. Nga shqyrtimi i të dhënave të procesit të inventarizimit rezulton se, në lidhje me inventarizimin e materialeve rikupero (në sektorin e transportit) janë gjendje 2147 artikuj, pa vlerësim. Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e pikës nr. 19, të Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme Nr. 1151, datë 16.07.2007, “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Mbeturinat e përfituara nga nxjerrja jashtë përdorimit të materialeve administrohen në llogari të veçantë të vlerësuara me çmimin e tregut. Çmimet vendosen me komision të krijuar në çdo rast me urdhër të titullarit”.

Nga ana e komisioneve respektive janë hartuar procesverbalet e inventarizimit apo të vlerësimit të cilat janë nënshkruar rregullisht, në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Nga komisioni i inventarizimit janë nënshkruar rregullisht inventaret e zyrave dhe magazinave dhe depove në prezencë të personit të ngarkuar me përgjegjësi materiale, ku janë evidentuar sasitë fizike të mallrave e materialeve dhe ato kontabile. **Nga ana e Komisionit qendror të inventarizimit janë hartuar relacionet përmbledhëse**, të cilat janë miratuar rregullisht nga Komandanti i Gardes për aktivet që janë në kompetencë të tij ose janë marrë miratimet e Ministrit të Brendshëm për ato aktive që në Udhëzim i janë lënë për miratim Ministrit.

Në referencë me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme Nr. 1151, datë 16.07.2007, “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme”, nga Ministri i MPB është lëshuar urdhri nr. 161, datë 21.03.2017 “Për nxjerrje nga përdorimit të mjeteve të transportit”, ku përfshihen dhe 10 mjete të transportit të GR.

Me urdhrin nr. 690/1, datë 11.04.2017 Komisioni i tjetërsimit dhe asgjësimit të mjeteve të transportit ka ndjekur procedurën për **10 automjete** (nga këto: tetë autovetura, një kamion dhe një mikrobuz) të GR dhe mbi këtë bazë janë prerë fletedalejet e shkarkimit të artikujve nga magazina/kontabiliteti sipas grupit të aktivitetit. Rezulton se nga ana e institucionit të GR janë prerë fletedalejet për automjetet duke i çregjistruar nga kontabiliteti për vlerën e tyre të mbajtur në librat e llogarisë krahas mbajtjes së procesverbaleve të tjetërsimit nënshkruar nga 7 antaret e Komisionit, sipas FD nr.2 deri në nr.11, të datës 11 prill 2017. Nga sa sipër, ka gjetur zbatim paragrafi nr. 100, i UMF nr. 30/2010 i ndryshuar, për numrin e personave në komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit: *“Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë, kryetari i këtij komisioni përcaktohet nga Titullari dhe anëtarë përcaktohen nga kryetari, në vartësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafët 111 deri 118 të këtij udhëzimi”.*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nga ana e grupit të auditimit u vlerësua gjurma e auditimit/ procedurat për automjetet e transportit, të miratuara nga Ministri i Punëve të Brendshme për të dalë nga përdorimi e të asgjësuar dhe rezultojnë:

- ✓ Miratimi i listës së automjeteve për dalje nga përdorimi është sipas Urdhrit të Ministrit nr. 161, datë 21.03.2017 “Për nxjerrje nga përdorimi të mjeteve të transportit”.
- ✓ Me shkresën nr.2362, datë 23.03.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm të MB u është dërguar të gjitha njësive shpenzuese për zbatim Urdhri i Ministrit të Punëve të Brendshme nr.161, datë 21.03.2017 “Për nxjerrjen nga përdorimi të mjeteve të transportit”, shoqëruar me udhëzimet përkatëse praktikën që duhet të ndjekin ato.

Nga ana e Komisionit janë mbajtur Procesverbalet e zmontimit të mjeteve si dhe procesverbalet e asgjësimit të materialeve në mjetin e dale nga përdorimi, dokumenta të miratuara nga ana e titullarit të institucionit. Nga ana e z.....-shef i sektorit të transportit dhe-kryetar i komisionit të asgjësimit të mjeteve është hartuar me datën 23.6.2017 relacioni për Komandantit në GR, ku thuhet materialet (nyje e agregate) u bënë hyrje në magazinë, pjesa tjetër e materialeve të trajtohen konforme UMF nr.30/2011. Për sa siper është prirë FH nr. 10, datë 23.07.2017 ku perfshihen *hekur skrap 12,083 kg, bateri kg 211, dinamo copë 4, motorino copë 2, goma cope 8, etj.*

Në fund të procesit krahas hartimit të procesverbaleve të asgjësimit, nga komisioni i përbërë kanë konfirmuar asgjësimin me “copëtim, djegie, thyerje, prerje etj të aseteve (automjete), dhe referuar fotografive të automjeteve bashkëlidhur praktikës dëshmohej kjo situatë e copëtimit dhe demolimit të këtyre automjeteve.

Nga dalja jashtë përdorimit dhe asgjësimi janë bere hyrje skrap (hekur) në sasinë 12,093 kg, për të cilën nuk ka asnjë vlerësim në kontabilitet, konstatohen se për periudhën objekt auditim nga ana e KLSH-së **evidentohen mosveprime në procesin e zhvillimit të ankandit për skrapin e përfutur nga asgjësimi i mjeteve të transportit, në kundërshtim pikën 109 të Udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,** Bazuar në relacionin e hartuar nga Sektori i Sherbimit të Transportit, (shkresa me nr. 292/1 prot, datë 11.04.2019), evidentohet se pas përfundimit të procedurave të tjetërsimit në magazinat e **rikuperove** të GR sipas sektoreve ndodhen një sasi të konsiderueshme materialeve të riciklueshme/ skrap për të cilat nuk janë kryer procedurat e vlerësimit. i përfutur sipas procedurës së **çmontimit të 10 mjeteve të transportit të miratuara jashtë përdorimi** sipas Urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 161, datë 21.03.2017.

Konstatime:

Konkluzioni i grupit të auditimit mbi kryerjet e analizimi i rezultateve të inventarizimit të aktiveve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit e asgjësimit të tyre, është se:

- a) **Nga krahasimi i të dhënave të mjeteve që dalin jashtë përdorimit (sipas lidhjes që i bashkëlidhet Urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 161, datë 21.03.2017), rezultojnë se ka disa mosperputhje si vijon:**

Vlera e mjetit **Magnum BL3** e vitit 1999 me targe TR 3920 I është **2 milionë** lekë në tabelën përmbledhëse që shoqëron urdhrin nr. 161, mirëpor është shkarkuar sipas FD nr. 2, datë 11.4.2017 (nenshkruar nga T.Memishaj) për **20 milionë lekë**. Po për këtë vlerë është shkarkuar në analizën e veprimeve për llogari të sektorit logjistik.

Në total nga mbledhja e shumave të FD nr.2, datë 11/4/2017 deri tek nr. 11, datë 11.4.2017 paraqitet vlera e shkarkimeve prej 34,472,810 leke, e njëjta me shumën e pasqyruar në aneksin nr.6 të bilancit (pakesimet nga nxjerrja jashtë përdorimit) për 34,472,810 lekë.

Nr.	Nr.llog.	EMËRTIMI	Gjendje në celje të ushtrimit	Shtesa gjatë vitit ushtrimor				Pakësime gjatë vitit ushtrimor				Gjendja në mbyllje të ushtrimit
				Blerje e krijuar me	Shtesa pa pagesë	Lëvizje brenda	Gjithësej	Shitje	Nxjerrë jashtë përdorimit	Pakësime	Gjithësej	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

				pagesë	Jashtë sistemi	Brenda sistemi	aktiveve				të tjera		
a	B	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1		I. TE PA TRUPEZUARA	5,655,977	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5,655,977
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	5,655,977	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5,655,977
4	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4/1	230	Shpenz. per rritjen e aktiv. qendr. patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5		II. TE TRUPEZUARA	1,008,053,240	95,066,718	80,195,737	0	0	175,262,455	0	34,764,670	8,028,481	42,793,151	1,140,522,544
6	210	Toka, troje, Terene	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	211	Pyje, Kullota Plantacione	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	212	Ndertime e Konstrukione	297,929,872	41,041,518	0	0	0	41,041,518	0	0	0	0	338,971,390
9	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	5,766,983	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5,766,983
10	214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	202,051,617	49,549,200	841,832	0	0	50,391,032	0	264,500	4,200	268,700	252,173,949
11	215	Mjete transporti	453,221,641	4,476,000	68,061,264	0	0	72,537,264	0	34,472,810	7,964,281	42,437,091	483,321,814
12	216	Rezerva shtetore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi	240,000	0	120,000	0	0	120,000	0	0	60,000	60,000	300,000
14	218	Inventar ekonomik	48,843,127	0	11,172,641	0	0	11,172,641	0	27,360	0	27,360	59,988,408
17	24	Aktive te Qend. te trupezuara te demtuara	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
18	28	Caktime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTAL I (I+II)			1,013,709,217	95,066,718	80,195,737	0	0	175,262,455	0	34,764,670	8,028,481	42,793,151	1,146,178,521

(Burimi: Sektori i Financës, GR, aneksin nr.6 i bilancit kontabël, v.2017).

a) ka mangësi e parregullsi për vlerësimin e skrapit të bërë hyrje pa çmim dhe vlerë dhe që nuk është pasqyruar për rrjedhje në pasqyrat financiare të GR për v.2017 dhe 2018. Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 226, datë 08.05.2015 “Për përcaktimin e përgjegjësi në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, nxjerrjes nga përdorimi dhe kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësisë shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme”.

b) referuar shkresave nr. 292 dhe 295 date 9.4.2019 vlerësohet se sipas sektoreve (atij logjistik, te transportit dhe të armatimit) janë gjendje hekur 29,134 kg; alumin 217 kg; plumb 1920 kg, dhe bateri 6995 kg. Krijimi i një nomenklature të tillë të artikujve pa vlerësim kontabël tregon për një proces që nuk është ndjekur në vijimësi sipas kërkesave të vlerësimit të aktiveve, përcaktuar në VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, aktet e tjera të dala nga Ministria e Financave për këtë qëllim si dhe përcaktimet e pikes nr. 19, te UMB me nr. 1151, datë 16.07.2007, sipas të cilit: “mbeturinat e perfituara nga nxjerrja jashtë përdorimit e materialeve administrohen në llogari të veçantë me çmimin e tregut. Çmimet vendosen me komision të krijuar për çdo rast me urdhër të titullarit”.

c) ka vonesa të pajustificuara në kryerjen e proceduarve të ankandit për shitjen e skrapit të përfituar nga asgjësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve (Mjete transporti, etj) , proces i kryer gjatë vitit 2016 dhe përfunduar pjesërisht gjatë vitit 2017.

Konstatime për procesin e inventarizimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve materiale 2017-2018:

1. Procedurat e inventarizimit janë kryer bazuar në urdhrat administrativë të titullarit të institucionit GR mbi bazën e të cilit është kryer inventarizimi, përkatësisht me ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi i MPB me nr. 226, date 08.05.2015 “Për përcaktimin e përgjegjësi në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, verësimit, nxjerrjes nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

përdorimi si dhe kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësisë shpërndarë të MPB”. Janë kryer me korrektesë praktikën dokumentare të këtij procesi, megjithatë nga analiza e dokumentacionit të disponuar grupit të auditimit rezulton se ka dhe mangësi në zbatimin e dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

2. Procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit për dalje jashtë përdorimit, si dhe asgjësimi janë kryer nga komisione të rishikuara (jo nga të njëjtët anëtarë komisioni në dy vite rradhazi), veprime këto në pajtueshmëri me *paragrafin* nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, që nënvizon se, “*Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision*”.

3. Në përgjithësi ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”, pika 30 që formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, ka përfshirë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

4. Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2017 nuk janë përfshirë në procesin e inventarizimit si dhe nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e institucionit, në kundërshtim me *paragrafin* nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues*”.

Kjo situatë është korrigjuar pjesërisht, ku për vitin 2018, në dosjen e inventarizimit administrohet një realcion i datës 10.11.2017 përgatitur nga ana e Komisionit të Katërt. Nga shqyrtimi i këtyre kartelave dhe relacioneve konstatohet se:

✚ Për automjetet, mjetet e blindurara si dhe mjetet lundruese rezultojnë se në disa raste sipas inventarit kontabel dhe kartelave të magazines mjetet mbahen me targat e mëparshme, kurse në fakt ato mbajnë targa të reja të sistemit të MB. Psh,
-për mjetin mitsubishi pajero me targe me ndryshimet e reja mban targa;
-për mjetin benz me targe, me ndryshimet e reja mban targa, -për mjetin toyota land cruiser me targe, me ndryshimet e reja mban targa,
- për mjetin volksvagen golf III me targe, me ndryshimet e reja mban targa, etj.

✚ Është konstatuar se në njësinë e katërt, janë përfshirë në fletet e inventarit 3 (tre) mjete të blinduara me targa,, në një kohë që kjo njësi nuk i ka patur efektivisht në inventar, sepse në zbatim të Urdhrit të Komandantit të Gardës nr. 2828, datë 13.11.2014 këto mjete figurojnë pranë njësisë speciale.

Për sa sipër, nga ana e Sektorit të Shërbimeve të transportit dhe Sektorit të financës duhet të koordinohen veprimet për të korrigjuar situatat e pasqyruara më lartë.

5. Nga auditimi i procesit të inventarizimit të karburanteve, rezultoi se nga magazinieri është nënshkruar deklarata nr. 1 dhe nr.2 se nuk ka materiale që nuk janë bërë hyrje dhe dalje, është fiksuar numri i FD dhe FH së fundit dhe se gjendja e karburantit është kontrolluar nga komisioni për sasitë në administrim të magazinierit.

Nga intervista me Shefin e Sektorit të Karburanteve dhe Magazinierit dëshmohet se nuk ka asnjë diferencë nga sasitë dhe vlerat për inventarin fizik kundrejt atyre sipas kontabilitetit. Në fakt auditimi vëren se në magazinë janë gjendje në datën e inventarizimit 06.11.2018, tollona benzine në sasinë 9760 litra me çmimin 122,304 lek/ litri dhe tollona naftë Eurodiesel në sasinë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

5500 litra me çmimin 136.690 lekë. Pjesa e teter e karburanteve me emertimet benzine 95 okthane etj janë në sistem dhe bazohen në procedurat standarde të punës për furnizimin me tollona elektronike të personalizuar dhe kartat gold për shoferet e GR. Në detyrat e specialistit të karburantit (i cili është personi i vetëm që logohet dhe mund të mbushë kartat e shofereve përdorues me sasi karburanti përmes aplikacionit të furnizim-shpërndarjes), thuhet (pika 6 e këtij dokumenti) se specialisti “*duhet të dijë në çdo kohë gjendjen sasuiore të karburantit që ka në administrim*”. Në fakt për këto sasi, nënshkruarn magazinieri i cili nuk kryen efektivisht furnizim dhe shpërndarje, pasi këtë proces e mbyll shefi i sektorit të karburanteve dhe nënshkrimi në këto formularë nga magazinieri është një proces formal e gati gati fiktiv. Nga ana e Komisionit nuk është printuar sasia e karburantit gjendje në sistem, (e pa përdorur) si dhe sasia gjendje në çdo automjet, me qëllim që të hartohet bilanci total i karburantit për institucionin GR. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi magazinieri dhe komisioni i inventarizimit.

6. Ka gjetur zbatim paragrafi nr. 100, i UMF nr. 30 / 2010 i ndryshuar, për numrin e personave në komisionin e nxjerrjes jashtë përdorimit: “*Komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhet nga jo më pak se 5 vetë, ..., në vartësi të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të dhëna në paragrafët 111 deri 118 të këtij udhëzimi*”, meqenese sipas percaktimeve të pikës nr. 16 dhe 23 të UMB nr. 226, datë 08.05.2015 “*Për percaktimin e përgjegjesive për menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, veresimit, nxjerrjes nga përdorimi si dhe kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësive shpërnduese të MPB*”, ku percaktojnë se Komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi duhet të ketë jo më pak se 7 veta.

Konstatime:

1. Nuk ka gjetur zbatim për vitin 2017 (megjithatë, është **korigjuar kjo situatë për v.2018**) përcaktimi i pikës nr. 8, të këtij Udhëzimi, sipas të cilit “Titullarët e njësive shpërnduese (NA i nivelit të dytë) të krijojnë një komision të vetëm për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve prej jo më pak se 3 (tre) personash dhe se “Kryetar i Komisionit caktohet NZ i Njesisë Shpërnduese”.

2. Nuk është finalizuar procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2018 në të gjithë komponentet e tij. Rezulton se, me shkresën nr. 4138/1 prot, datë 11.12.2018 të institucionit të GR, i janë dërguar Ministrisë së Brendshme propozimet për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve, që sipas pikës nr. 12/1 të Ministrit të Brendshëm me nr. 226, datë 08.05.2015 “Për përcaktimin e përgjegjësive në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisionit të inventarizimit, vlerësimin nxjerrjes nga përdorimi si dhe kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësive shpërnduese të sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme”. Në nomenklaturën e aktiveve të propozuara për nxjerrje nga përdorimi bëjnë pjesë dhe 32 automjete. Deri në datën e mbajtjes së këtij raporti, edhe pse kanë kaluar mbi 7 (shtatë) muaj, nuk ka asnjë veprim dhe përgjigje nga institucioni epror i MB.

Auditimi i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve.

Per vitin 2017

Për periudhën nga 01.07.2017 deri me 31.10.2018, nga institucioni, janë nxjerrë jashtë përdorimit të aktive të qëndrueshme të trupëzuara në shumën **34,764,670 lekë** si më poshtë:

- Llog 214 “*Instalime teknike, makineri, pisje, vegla pune*” 264,500 lekë, (sektori i kazermimit). 25.000 lekë kartë telefonike Alcatel CTE, 70.000 lekë Asure ID7 express card softëare, 39.600 lekë (6 sete x 6.600 lekë) Data card 534000 color ribbon, 38.400 lekë (4 x 9.600) 4 pako Datacard plasti ID cards 500 card pack, 116.500 lekë materiale të imëta.

- Llog 215 “*Mjete transporti*” vlera 34,472,810 lekë, (sektori i transportit, 10 mjete të dala jashtë përdorimit), e trajtuar më poshtë.

- Llog 218 “*Inventar ekonomik*” vlera 27,360 lekë, trofe MIXGD 06 (2520) 5.040 lekë (2 copë x 2.520 lekë), materiale të tjera të imëta 22.320 lekë (15,5 metër katror x 1.440 lekë).

.U auditua procedura e nxjerrjes jashtë **përdorimit të mjeteve të transportit** me Urdhër të MB nr.161, datë 21.3.2017 “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve të Transportit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Procedurat janë bazuar në Urdhërin e Komandantit të Gardës nr. 690/1, datë 11.4.2017 “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve të transportit, heqjen nga inventari, ndryshimin e formës fillestare dhe asgjësimin e tyre” si dhe në Memo nr. 690/2, datë 23.6.2017 “Relacion mbi zmontimin e disa automjeteve të nxjerra jashtë përdorimit”.

✓ 1 - Procesverbal nr.1, datë 14.4.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje ZBË828C0000002799, me targë, Autoveturë e blinduar 4 x 4 tip “Magnum BL-3”.

✓ Procesverbal nr.1/1, datë 14.4.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 2 - Procesverbal nr.2, datë 18.4.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje ËV2ZZZ70ZËH117947, me targë, Volksäagen Transporter.

✓ Procesverbal nr.2/1, datë 18.4.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 3 - Procesverbal nr.3, datë 20.4.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje JMBONV440XJ001463, me targë, Mitsubishi Pajero 2.5.

✓ Procesverbal nr.3/1, datë 18.4.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 4 - Procesverbal nr.4, datë 24.4.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje ËFONXXGCANS85410, me targë, Ford Escort.

✓ Procesverbal nr.4/1, datë 24.4.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 5 - Procesverbal nr.5, datë 26.4.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje ËVËZZZ1HZRP095655, me targë, Volksäagen Golf.

✓ Procesverbal nr.5/1, datë 26.4.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 6 - Procesverbal nr.6, datë 28.4.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje ËBADF710XOBS19654, me targë, BMË 525.

✓ Procesverbal nr.6/1, datë 28.4.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 7 - Procesverbal nr.7, datë 2.5.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje ËVËZZZ31ZMB307717, me targë, Volksäagen Passat.

✓ Procesverbal nr.7/1, datë 2.5.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 8 - Procesverbal nr.8, datë 4.5.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje SALLJGMF8MA155326, me targë, Land Rover.

✓ Procesverbal nr.8/1, datë 4.5.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 9 - Procesverbal nr.9, datë 8.5.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje 7823392, me targë, Ifa.

✓ Procesverbal nr.9/1, datë 8.5.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

✓ 10 - Procesverbal nr.10, datë 15.6.2017 “Për zmontimin e mjetit të dalë jashtë përdorimit”, për mjetin me numër shasje ËDB1400321A009669, me targë, Mercedes Benz 500.

✓ Procesverbal nr.10/1, datë 8.5.2017 “Për asgjësimin e materialeve në mjetin e nxjerrë jashtë përdorimit”.

Auditimi i procedurave të inventarizimit të shërbimit të armatimit:

Për periudhën nga 01.07.2017 deri më deri më 31.12.2018, u auditua me zgjedhje dokumentacioni i hartuar nga sektori armatimit dhe paisjeve për administrimin dhe lëvizjen e armëve, municioneve si dhe procesin e inventarizimit të tyre. Për periudhën objekt auditimi, sektori i armatimit është i organizuar me 4 punonjës (specialisti i llogarisë, 1 specialist teknik, 1 specialist magazinier dhe shefi i sektorit) dhe sektori përgjigjet në organigramë përpara Drejtorit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Shërbimeve Mbështetëse. Konstatohet se, lëvizja e aktiveve (armë dhe municione) në institucionin e GR, kryhet e dokumentohet nga vetë sektori i armatimit e paisjeve në bazë të detyrave dhe përgjegjësi të personelit sipas funksioneve të ngarkuara, të pasqyruara në Manualin e procesve të punës dhe Rregulloren e brendshme të institucionit (Kreu 10, rregullat e shërbimit të armatimit). Për dokumentimin, ruajtjen dhe regjistrimin në llogari të armatimit dhe municionit veprohet në zbatim të ligjit organik nr.8869, datë 22.05.2003 “Për GR” i ndryshuar, VKM nr.830, datë 22.03.2005 “Për paisjen e punonjësve të GR me armatim dhe mjete të posacme” si dhe ligjeve e aktve ligjore për menaxhimin financiar.

Audituesit e KLSH-së vlerësojnë se për periudhën e audituar, sektori i armatimit ka të administruar librat specifik të llogarisë për regjistrimin e dokumentacionit hyrje dalje të armëve, municionit dhe paisjeve, (*libri mod.28, libri mod.35 për regjistrimin e armëve e municioneve të shpërndara në efektiv, libri mod.37 për regjistrimin e numrave dhe gërmës së armëve në administrim nga institucioni*). Libra të cilat janë të sekretuar dhe të administruar të rregullt dhe përshkruajn të gjitha transaksionet e kryera me armëtimin dhe municionin në administrim si për periudhën e audituar (01.01.2017-31.12.2018) edhe për ato para kësaj periudhe specifike e sektorit të armatimit dhe paisjeve (*pra transaksionet janë të regjistruara në mënyrë kronologjike për gjithë periudhat me mbartjet e periudhave të mëparshme*). Sektori i armatimit dhe paisjeve, dokumentacionin e lëvizjes së armëve, municionit dhe paisjeve (*fletë hyrje e dalje*) i përpilon të ndara në, hyrje e dalje të jashtme (*për mallra e material të marra nga jashtë institucionit me blerje apo kalime kapitale*) dhe në hyrje e dalje të brendshme (*për lëvizje të brendshme për personelin dhe shkarkimin e municionit të konsumuar në qitje*).

Konstatim.

Nga auditimi i pasqyrave financiare si dhe verifikimi i dokumentacionit që administrohet nga Sektori i Armatimit, konstatohet se, nuk është pasqyruar në evidencën kontabile të njësisë, e gjithë vlera e armatimit që përdor institucioni i Gardës së Republikës. Evidentimi material e sasior i armatimit në Gardën e Republikës mbahet nga Sektori i Armatimit, ku janë pasqyruar armatimet në sasi dhe përdoruesit e tyre, referuar tipologjive së regjistrave të miratuar me udhëzime të veçanta të Ministrit të Brendshëm.

Nga sektori armatimit të institucionit, dokumentacioni i hyrjes dhe daljes së mallrave e materialeve (*armë, municione e paisje*), **nuk plotësohet i rregullt sa i përket çmimit dhe vlerës së mallit, siç dhe përmban formati i miratuar i dokumentit (emërtesa, njësia, sasia, çmimi vlera etj)**. Gjithashtu edhe regjistrimi i dokumentacionit në librat e llogarisë kryhet vetëm për lëvizjet sasiore të këtyre mallrave **pa përcaktuar sipas emërtesës së artikullit edhe çmimin përkatës**

Mbajtja në këtë mënyrë e armatimit është ***trashëguar ndër vite***, duke ju referuar Rregullores së shërbimit të armatim-municionit të vitit 1990, ku regjistrimi dhe mbajtja e armatimmunicionit ka qenë e klasifikuar sekret. Nga verifikimi i llogarise analitike të aktiveve nr.214, “ Instalime teknike, pajisje e vegla pune” me dt 31.12.2018 ekspozohet kjo situatë për 717 armë pistoleta me vlerë në kontabilitet prej 54,506,840.00 lekë:

PISTOLETA	100.00	cope	69,950.000	6,995,000.00
PISTOLETA BERETA	76.00	cope	65,520.000	4,979,520.00
PISTOLETA BERETA	115.00	cope	65,520.000	7,534,800.00
PISTOLETA BERETA	1.00	cope	65,520.000	65,520.00
PISTOLETA BERETA	5.00	cope	70,800.000	354,000.00
PISTOLETA BERETA	3.00	cope	65,520.000	196,560.00
PISTOLETA BERETA	34.00	cope	65,520.000	2,227,680.00
PISTOLETA BERETA	24.00	cope	65,520.000	1,572,480.00
PISTOLETA BERETA	2.00	cope	70,800.000	141,600.00
PISTOLETA BERETA	18.00	cope	69,600.000	1,252,800.00
PISTOLETA BERETA	53.00	cope	60,000.000	3,180,000.00



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

PISTOLETA GLOCK 17 GEN 4	109.00	cope	96,000.000	10,464,000.00
PISTOLETA GLOCK 19 GEN 5	70.00	cope	96,000.000	6,720,000.00
PISTOLETA GLOCK	4.00	cope	129,816.000	522,880.00
PISTOLETA 9*19% GLOCK 34	70.00	cope	90,000.000	6,300,000.00
Pistolet Beretta 9x19 mm 92 FS	33.00	cope	60,606.061	2,000,000.00
Gjithsej	717.00			

(Burimi: GR. Sektori i Finances, Analiza e llogarisë nr. nr.214, "Instalime teknike, pajisje e vegla pune" me datën 31.12.2018)

Në fakt, nga verifikimi i të dhënave me zgjedhje që janë shënuar në fletën e inventarit për armatim e municion të datës 26.6.2018, evidentohet se, nuk është regjistruar, kontabilizuar dhe përfshirë në llogaritë e aktiveve të GR kundërvlera për armët luftarake të tipit "pistoletë", përkatësisht pistoletë mod 54 janë 1071 copë, pistoletat 9 mm makarov janë 136 copë; ato 9 mm Kirikale janë 100 copë; cloock 17 janë 116 copë dhe cloock 19 për 70 copë; berreta FS 92 janë 395 copë, berreta stoeger janë 53 copë, etj.etj., që nuk janë vlerësuar me çmimin e tyre dhe nuk janë përfshirë në librat e kontabilitetit.

Për artikullin automatik në lloarinë e Gr është vetëm ky zë:

AUTOMATIK 9*19%	136.00	cope	240,000.000	32,640,000.00
-----------------	--------	------	-------------	---------------

(Burimi: GR. Sektori i Finances, Analiza e llogarisë nr. nr.214, "Instalime teknike, pajisje e vegla pune" me datën 31.12.2018)

Në fakt, nga verifikimi i të dhënave me zgjedhje që janë shënuar në fletën e inventarit për armatim e municion të datës 26.6.2018, evidentohet se, nuk është regjistruar, kontabilizuar dhe përfshirë në llogaritë e aktiveve të GR kundërvlera për armët luftarake të llojit automatikë mod 56 b.thikë janë 161 copë, automatikët mod 56 q-druri janë 1454 copë, automatikët mod 56 metal janë 749 copë, automatike scorpions 4 copë, automatike trofe 3 copë, et. Gjithashtu, nuk janë pasqyruar në llogari vlera për armët Mitraloz i lehtë mod 56- copë 86, mitraloz MG 3 për 10 ciopë, mod 57 per 17 cope, mod 53 per 9 cope, etj.

Përfundimisht, rezulton se, armatimi i vjetër mbahet vetëm në sasi **pa vlerën përkatëse kontabile të armatimit, duke bërë që të mos kemi një vlerë reale të armatimit në administrim të Gardës së Republikës dhe duke denatyruar vlerën e përgjithshme kontabile të kësaj pasurie, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e:**

- ✓ **ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.26, datë 28.12.2007 .**

- ✓ **pikes nr. 2.2, të VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël", sipas të cilit:**

"Çdo dokument justifikues duhet të përmbajë:

- *emërtimin e dokumentit, numrin rendor (ose serial), si dhe datën;*
- *emërtimin e njësisë ekonomike dhe të njësisë organizative brenda saj që lëshon dokumentin, formën juridike dhe adresën e njësisë ekonomike;*
- *tregimin e personit ose të njësisë administrative që urdhëron kryerjen e veprimit, të personit që ekzekuton veprimin, si dhe, në vartësi të organizimit të lëvizjeve të vlerave e të veprimeve financiare, tregimin dhe firmën e personit që merr në ngarkim vlerat materiale apo monetare;*
- *përshkrimin e përmbajtjes së objektit të veprimit apo të ngjarjes tjetër dhe, në varësi të natyrës së këtyre të fundit, treguesit sasiore e verorë;*
- *veprimet për shitjen e sendeve, furniturat, punimet dhe shërbimet e kryera për një veprimtari*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

ekonomike, profesionale apo administrative dokumentohen, në çdo rast, me faturë.

Përveç të dhënave të karakterit të përgjithshëm të treguara më sipër, fatura duhet të përmbajë gjithashtu:

- emërtimin e plotë dhe adresën e blerësit;
- emërtimin e saktë të mallrave dhe furniturave apo të punimeve e shërbimeve të kryera;
- **çmimin e faturimit për njësi;**
- **sasitë e faturuara**".

✓ pikës nr. 36, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "**Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik**" i ndryshuar, sipas të cilit: "Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, **treguesit sasiorë dhe ato të vlerës**, ..., që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative...".

✓ pikës nr. 26, kreu III, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "**Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik**" i ndryshuar, sipas të cilit: "Çdo njësi publike duhet të **krijojë dhe të përditësojë** një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar".

✓ pikës nr. 26, kreu III, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "**Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik**" i ndryshuar, sipas të cilit: "Për hyrjet e aktivave të dhuruara dokumentacioni shoqëruar përbëhet nga marrëveshja/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njësitë donatore; faturën që identifikon mallrat **dhe vlerën e tyre**; dokumentet e zhdoganimit dhe Certifikatën e origjinës (në rast importi); procesverbalin e marrjes në dorëzim të konfirmuar nga sektori i shërbimeve. Në rastet kur **dhurimet në natyrë të aktiveve nga donatorë të ndryshëm jepen vetëm në sasi (pa çmim apo kosto), ato pranohen nga njësia përfituese dhe titullari autorizon vlerësimin e tyre.**"

✓ Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "**Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare**", ku në pikën nr.48 thuhet se "Njohja është procesi i përfshirjes në pasqyrat financiare, të një zëri që plotëson përkufizimin e një aktivi, detyrimi, të ardhure ose shpenzim dhe në pikën nr. 51 "**Besueshmëria e matjes**" nënvizohet që "Kriteri i dytë për njohjen e një zëri është që kosto ose vlera që ai ka të mund të matet me besueshmëri. Në shumë raste, kostoja ose vlera e një zëri njihet. Në raste të tjera ajo duhet të vlerësohet. Përdorimi i vlerësimeve të arsyeshme është një pjesë thelbësore e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe nuk dëmton besueshmërinë e tyre. Zëri nuk njihet në pasqyrat financiare, në rastet kur nuk mund të kryhet një vlerësim i arsyeshëm."

✓ Pika 2, e Nenit 47 "**Evidentimi i të dhënave për armët**" të ligjit nr. 47/2014 "**Për armët**", ku nënvizohet se, "Personat fizikë dhe juridikë, të licencuar sipas dispozitave të këtij ligji, **mbajnë evidenca të sakta e të hollësishme, në formë të shkruar dhe elektronike, për të gjitha veprimtaritë e lejuara dhe të kryera me armët.**

✓ Pika 39, e Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme me nr. 04, datë 15.01.2015 "**Për përcaktimin e rregullave të riajtjes, administrimit të armatimit, municionit dhe pajisjeve speciale në strukturat e Policisë së Shtetit**", ku thuhet se "**Regjistri i Llogaritjes së Armatimit (mod.28) pasqyron gjendjen kontabile të armatimit, municionit dhe pajisjeve të njësive dhe strukturave të varësisë...**".

1. Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë dispozitë ligjore, ku të përcaktohej se vlera e armatimit nuk duhet kontabilizuar në bilanc.
2. Në përbërje të Sektorit të Armatimit është Llogaritari i armatimit, i cili ndjek rakordimin dhe administrimin material për armët dhe municionet me depot dhe njësitë, por vetëm në aspektin sasior dhe pa vlerë.
3. Nga ana e Sektorit të Armatimit u disponuan disa norma (shkresa me nr. 3868, datë 14.12.1992 të Ministrisë së Mbrojtjes "Mbi ndryshimin e çmimeve të shitjes me pakicë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

diosa artikujve të armatimit dhe municionit” (për efekt zhdëmtimi të tyre) si dhe shkresa me nr.1550 datë 27.9.1993 e Ministrise se Rendit Publik “Mbi çmimet e shitjes me pakicë (për efekt zhdëmtimi), të disa artikujve të armatimit dhe municionit”, që kanë synuar forcimin e mirë administrimit material dhe mirëmbajtjen e vlerave materisale të shërbimit të armatimit.

4. Mungojnë rakordimet kontabile (vlerore) të sektorit të armatimit me sektorin e financës së GR.

Për sa më sipër, GR duhet të marrë masa që të pasqyrojë në evidencën kontabile vlerën e armatimit, sipas çmimit së blerjes, apo dhe referuar çmimeve të tregut për armatimin e trashëguar në vite apo të dhuruar, konform rregullave kontabile , dspozitave të ligjit nr. 10296/2010 dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Procedurat e inventarizimit të armatimit:

Procedurat e invenatirizimit të armatimit janë iniciuar në zbatim të Urdhrit të Komandantit të GR nr.378, datë 12.02.2018 “Për inventarizimin e vlerave materiale në shërbimin e armatim municionit”, janë ngritur Komisione Qendror për inventarizimin e armatim dhe municionit me perberje,, dhe, si dhe 9 nenkomisone pranë njësive, objekteve te kohes se vecante etj.

Nga komisionet,bazuar në Grafikun e kuadrimin dhe int uinventarizimti tçë armatimit (miratuar nga ana e Komandantit te GR) është kryer inventari fizik i armatimit, municioneve dhe paisjeve sipas sektorëve të varësisë dhe në depo (për ato të dhëna në përdorim sipas VKM nr.830, datë 11.12.2003 “Për pajisjen e punonjësve të GR me armatim e mjete teknike të posaçme, i ndryshuar, Udhëzimit të MRP nr.1288, datë 09.08.2000).

Sa sipër, bazuar në “Raportin mbi perfundimin e inventarit të vlerave materiale te sherbimit te armatimit, municioneve dhe paisjeve” me nr. 156/1, datë 30.6.2018 derguar Shefit të Shtabit te GR z..... inventari fizik ka rezultuar pa diferenca, **me përjashtim të armëve të munguara (të pa dorzuara) të evidentuara edhe në inventarizimet e mëparshme për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse, por pa veprim.**

Në një dosje të vecantë janë administruar fletet e inventarit per cdo njesi e strukture, te nenshkruara rregullisht nga komisioni dhe pergjegjesi material. Dokumentacioni i inventarizimit është i rregullt, me deklaratë të përgjegjësit material, fletët e inventarit të firmosura, me nr.matrikullor të armëve dhe pasqyrës së armatimit të dhënë efektive.

Kosntatim:

Sipas te dhënave te institucionit (sektori armatimit), **deri më 30.06.2019, rezulton me 50 armë të pa kthyer në depot e GR dhe pa marra personave të ndryshëm.** Për këto armë duke qënë se, dokumentacioni i dhënies dhe regjistrimit në ditarët e llogarisë është i arkivuar dhe i përket periudhave të hershme.

Sa i përket armëve të evidentuara më parë të pa dorzuara nga shtetasit e paisur, gjatë procesit të inventarizimit të kryer në Shkurt-Qershor 2018 rezulton se, Institucioni GR aktualisht ka pa administruar sipas përcaktimeve ligjore mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe të pa grumbulluara e administruara pranë këtij institucioni gjithsej 49 armë, për të cilat edhe pse janë lënë rekomandime të përsëritura nga Ministria e Brendshme, të pranuar, por të pa zbatuara plotësisht.

Institucioni (sektori armatimit) i GR, nuk ka marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për gjetjen e adresave të personave, bërjen dhe dokumentimin e kallzimit penal për të gjithë personat si dhe nuk ka kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës së armës nga personat e rezultuar me armatim të pa dorzuar apo të humbur.

Analizuar në mënyrë të detajuar,armët e pa administruara nga institucioni, bazuar në dokumentacionin e administruar nga sektori armatimit si dhe gjendjes procedurale e ligjore të tyre rezulton sa vijon:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës



14 armë janë të bllokuara nga Prokuroria dhe Policia si prova materiale në kuader të hetimeve të kryera. (Me hollësisht, janë 4 copë pistoleta mod.54 TT, 2 cop Pistoleta 9 mm “Berett”, 2 cop Pistoleta 9 mm “Makarov” dhe 6 copë Auto pistolet MP-5). Për sa siper referuar raportit të Komisionit të inventarizimit rezulton se në 8 raste ato janë administruar sipas akteve të sekuestrimit nga Prokuroria e Rrethit Tiranë, (me aktet e sekuestrimit datë 22.01.2011, 23.03.2011, 23.03.2011, 28.06.2011 dhe 30.06.2011) dhe shkresave të konfirmuara me nr.192/1, datë 19.04.2012 të Drejtorisë së Policisë Tiranë dhe me nr.2224, datë 11.05.2015 të Drejtorisë së Policisë së Shtetit.

Në mënyrë të detajuar ky informacion paraqitet si vijon:

Armatim luftarak, pjesë e inventarit të institucionit të GR, bllokuar në cilësinë e Provave Materiale për nevoja të hetimit dhe të qyqimit në çështjet penale, referuar inventarit të kryer si dhe ecurisë së metejshme:

- | | |
|-------------------------|--------|
| • Pistolet mod 54 TT | copë 4 |
| • Pistolet 9mm “Berett” | copë 2 |
| • Pistolet 9mm makarov | copë 2 |
| • Aut Pistolet MP-5 | copë 6 |

Gjithesëj në momentin e inventarizimit: 14 armë sikundër paraqiten në ANEKSIN 6, bashkëngjitur këtij raporti.

(Burimi: GR. Sektori i Armatimit)

Sipas shpjegimeve të Sektorit të Armatimit në institucion e GR, sasia e armatimit të bllokuar në komisarate si prova materiale janë konfirmuar periodikisht dhe me shkresat me Nr. 192/1, datë 20.05.2010, Nr. 985/3, datë 19.04.2012 nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Vendore e Policisë së Qarkut Tiranë dhe të akteve të sekuestrimit të datave 22.01.2011, 23.03.2011, 23.03.2011, 28.06.2011, dhe datë 30.06.2011

Konstatimi:

Pra, për këtë kategori, nga data e inventarizimit të fundit deri në datën e mbajtjes së këtij dokumenti nga ana e grupit të auditimit të KLSH-së rezultuan se aktualisht nga 14 armë të rezultuara pa kthyer para inventarizimit, rezultojnë të pakthyera në fakt 11 (njëmbëdhjetë) armë luftarake. Konstatuam se:

- ✓ janë administruar dhe bërë hyrje tre armë me FH nr. 231, 232 dhe 234 datë 29.05.2019;
- ✓ është konfirmuar gjetja e një arme (bazuar në përgjigjen e DPPSH me nr. 2967/1 prot., datë 13.06.2016, ku në pikën nr. 5 të saj konfirmohet se “pistoleta 9 mm mod 1959 makarov me nr. BO 1355-56 administrohet nga Drejtoria e Policisë Vendore Shkodër;
- ✓ janë administruar me akt sekuestrimi nga organi i prokurorisë municionet e armatimi lidhur me zërat shtabi dhe njësia speciale në tabelë (numrat rendor 7-14), vërtetuar se, për shkresën me nr. 533, dt 07.03.2019 të GR për DPPSH me object “Kërkesë për konfirmimin e armatimit të bllokuar në cilësinë e provave materiale”, është kthyer përgjigje nga DPPSH me nr. 2492/1 datë 04.04.2019 janë administruar nga prok. Pranë Gjykatës së Shk.Parë Tiranë
- ✓ për shtetasin nuk ka asnjë veprim nga ana e institucionit për tërheqjen e armatimit.
- ✓ Për numrin rendor nr. 10 në tabelën e mësipërme, nuk ka përgjigje se ku gjendet armatimi i administruar sipas aktit të sekuestrore datë 22.1.2011, pasi mungon kjo armë në përgjigjen zyrtarë të dërguar nga Instituti i Policisë Shkencore siaps shkresës me nr. 2492/1 prot., datë 4.4.2019 (protokolluar në GR me nr. 290 datë 08.04.2019):

Njesia	MP-5	03244	Akt	22.01.	Prokurori	Nuk perfshihet ne
--------	------	-------	-----	--------	-----------	-------------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	Speciale			Sekues	2011	a Tirane	shkrese ne pergjigjet e DPSH tek kthimi i pergjigjes
--	----------	--	--	--------	------	----------	---

Nga ana e grupit të auditimi u administrua akti i sekuestrimit “Procesverbal për sekuestrimin e sendeve”, të datës 22 Janar 2011 (nga oficeret e policise gjyqesore), ku përfshihet dhe kjo armë. Ky numer matrikullimi i armes është shënuar e pasqyruar dhe në piken nr. 24, faqe 9, e Vendimi të Gjykatës së Rretht Gjyqësor Tiranë me nr. 793, datë 18.09.2013, bazuar në akt ekspertimin tekniko-kimik dhe atij balistik të armës MP-5 kalibër 9 mm me nr. 244, gje që konfirmon tërheqjen e saj nga policia gjyqësore për të kryer ekspertimin ligjor.

Gjatë periudhës së kryerjes së auditimit në terren, nga ana e institucionit të GR, me shkresën me nr. 1390, datë 04.07.2019 i është dërguar DPP Shtetit kërkesa për konfirmimin e kësaj arme luftarake (Pistoletë automatike MP-5A2 me nr.1-03244).



4 armë “Pistoleta mod.54 TT”, si armatim me procedim penal, por pa konfirmim zyrtar nga ana e Drejtorisë së Policisë, për të cilat institucioni nuk ka marrë masat e duhura për gjetjen e adresave të këtyre personave si dhe nuk ka ndjekur procedurat ligjore për kthimin e armëve apo të arkëtimit të vlerës përkatëse të armës. Në lidhje me këto mungesa ga këto katër armë institucioni **nuk ka bërë kallzim penal për dy shtetas (..... dhe)** siç dhe ka vepruar për dy shtetasit e tjerë (..... dhe për të cilët është bërë procedimi penal nr.69/125, datë 18.02.2005 dhe nr.480, datë 25.09.2006.

Në mënyrë të detajuar ky informacion paraqitet si vijon:

- Pistoletë mod 54 TT , copë 4 sipas tabelës se mëposhtme

Nr	Emer mbiemer	Lloji arme	Numuri	Nr procedim i	Data	Vendi ku ndodhet	Prsaktika shkresore vijuese
1		PTT	16011385-69	69/125	18.02.2005	Nuk gjendet	Është dërguar shkresa me nr. 613, dt 05.03.2013 të GR për DPPSH me objekt “Rikerkohet informacion mbi disa armë”. Nuk ka pergjigje nga ana e DPSH për këtë rast
2		PTT	KL 1716	Vetvrare		Nuk gjendet	Është dërguar shkresa me nr. 613, dt 05.03.2013 të GR për DPPSH me objekt “Rikerkohet informacion mbi disa armë”. Nuk ka pergjigje nga ana e DPSH për këtë rast
3		PTT	32078555	480	25.09.2006	Nuk gjendet	Nga ana e Komisioariatit ter Ploicise Fier me shkresen nr. 3202 datë 06.10.2006 është k1rkuar informacion për shtetasin H.Malaj per pajisjen e tij me arme zjarri. Është dërguar shkresa me nr. 1677, dt 09.07.2012



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

						të GR për Prokurorinë e rrethit Fier me objekt “Kërkohet informacion mbi një pistoletë”.
						Rezulton se nuk ka pergjigje nga ana e Prokurise apo DPSH për këtë rast.
4		PTT	32064443		Nuk gjendet	Është dërguar shkresa me nr. 613, dt 05.03.2013 të GR për DPPSH me objekt “Rikërkohet informacion mbi disa armë”. Nuk ka pergjigje nga ana e DPSH për këtë rast

(Burimi: GR. Sektori i Armatimit)

Konstatimi:

Pra, për këtë kategori, nga data e inventarizimit të fundit deri në datën e mbajtjes së këtij dokumenti nga ana e ekipit të audituesve të KLSH-së rezulton se nga 4 armë luftarake si armatim me procedim penal por pa përgjigje zyrtare përfundimtare nga autoritet shtetërore përkatëse, rezultojnë aktualisht të pakthyera **4 (katër) armë luftarake**:

- ✓ Nuk janë gjetu dhe nuk bërë hyrje 4 (katër) armë sipas personave që i kanë patur ato ligjerisht në ngarkim.
- ✓ Titullarët dhe nivelet e tjera përgjegjëse menaxheriale në institucionin e GR janë mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresës me nr. 613, dt 05.03.2013 të GR për DPPSH me objekt “Rikërkohet informacion mbi disa armë”, si dhe në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë të shkresave (nr.16667, datë 09.07.2012 dhe nr.613, datë 05.03.2013) për konfirmim, pa kërkuar në vijimësi dhe në zbatim edhe të rekomandimeve të lëna nga Ministria e Brendshme mbi përgjigjet zyrtare dhe vendimet përkatëse të procedimit penal nga organi i Prokurorisë, gjë e cila mbete detyrë në vijimësi



1 armë “Pistolet makarov me nr. BN 339”, në ngarkim të shtetasit, institucioni është mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresës me nr. 613, dt 05.03.2013 të GR për DPPSH me objekt “Rikërkohet informacion mbi disa armë” si dhe konfirmimin e Prokurorisë së Përgjithshme për regjistrimin e fillimit të procedimit penal nr.1662, datë 26.06.2015, pa kërkuar ecurinë e këtij procesi si dhe nuk ka ndjekur rrugën ligjore për të arkëtuar vlerën përkatëse të armës.

Në mënyrë të detajuar ky informacion paraqitet si vijon:

Konstatimi:

- ✓ Pistoleta makarov me Nr. BH 339, referuar dokumentacionit të inventarizimit të mbajtur nga ana e GR rezulton e humbur nga, për të cilën GR ka administruar deklaratën e z..... të konfirmuar më nënshkrimin e Komandantit të Grupit të Shogërimit z..... dhe urdhër zhdëmtimin e miratuar (me nr. 12, pa datë, lëshuar nga ish-Komandantit GR për vlerën 429,200 lekë), por nuk ka vendimin gjyqësor për këtë qëllim pas shkresave dërguar prokurorisë si dhe nuk ka shkarkim nga librat e llogarisë.

Pra, për këtë kategori, nga data e inventarizimit të fundit deri në datën e mbajtjes së këtij dokumenti nga ana e ekipit të audituesve të KLSH-së rezulton se 1 armë luftarake e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

humbur, e pa gjetur dhe pa përgjigje zyrtare përfundimtare nga autoritet shtetërore përkatëse, aktualisht e pakthyer në depot e armatimit të GR 1 (një) armë luftarake:

- ✓ Për këtë nga ana e institucionit janë dërguar dy shkresa Prokurorise se rrethit Gjyqësor Tiranë me nr.1667 prot, datë 09.07.2012 dhe nr.613, datë 05.03.2013, por nuk ka patur kthim të përgjigjes, Sipas shkresës me nr.1662, datë 26.06.2015 të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme rezulton se për këtë rast është regjistruar procesi penal dhe nuk ka përgjigje për ecurinë e kësaj praktike.



34 armë të ndryshme, të painventarizuara nga Komisioni në kushtet e pamundësisë sepse janë armë të dhëna personave subjekte politike dhe shoferëve të tyre para vitit 2011, kjo në referim të Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik me nr.1288, datë 09.08.2000, “Per kriteret e dhënies, heqjes, dhe administrimit te armeve te dhena me leje”, kreu IV, sipas së cilës furnizoheshin me armatim funksionaret e shtetit si dhe kryetaret e partive politike, pikë kjo e ndryshuar sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm me nr. 369, datë 11.10.2011 “Për një ndryshim në Udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik me nr.1288, datë 09.08.2000, “Per kriteret e dhënies, heqjes, dhe administrimit te armeve te dhena me leje”,
(Përkatësisht, 23 copë “Pistoleta mod 54”, 9 copë “Pistoleta mod. 59 makarov”, 1 pistoletë “MKEK” dhe 1 cop “Pistoletë 9 mm makarov 20-she”),
Në mënyrë të detajuar ky informacion paraqitet si pas perdoruesve të furnizuar ndër vite, si vijon:

Armatim i pa inventarizuar

- Pistoletë mod 54..... copë 23
- Pistoletë mo 59 makarovcopë 9
- Pistoletë MKEK..... copë 1
- Pistolet 9mm makarov 20-she.....copë 1

Gjithsej

34 armë

Nr.	Emri dhe mbiemri i personit te furnizuar me armatim	Pozicioni / funksioni	Lidhja librit 35	Sasia	G e r m a	Numri armës	Praktikat shkresore
1		Vdekur	20/2	1		16012988	1676, datë 09.07.1912
2		Vdekur	28/2	1		14045677	1676, datë 09.07.1912
3		K/P	33/3	1	L O	480	1676, datë 09.07.1912
4		Shofer	3/1	1		33011954	1676, datë 09.07.1912
5		shofer	9/1	1		16015349	1676, datë 09.07.1912
6		shofer	10/1	1		14048122	1676, datë 09.07.1912
7		shofer	14/1	1		33009515	1676, datë 09.07.1912
8		shofer	26/2	1		32077082	1676, datë 09.07.1912
9		shofer	32/2	1		16014279	1676, datë 09.07.1912
10		shofer	37/3	1	N B	193	1676, datë 09.07.1912
11		shofer	39/3	1	L P	801	1676, datë 09.07.1912
12		shofer	40/3	1		32005534	1676, datë 09.07.1912
13		shofer	54/3	1		33002653	1676, datë 09.07.1912



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

14		shofer	56/3	1		16015538	1676, datë 09.07.1912
15		shofer	61/4	1		15008851	1676, datë 09.07.1912
16		shofer	79/5	1		6495994	1676, datë 09.07.1912
17		K/P	87/5	1		14065707	1676, datë 09.07.1912
18		shofer	107/7	1		16018499	1676, datë 09.07.1912
19			12/184	1	L T	3553	1676, datë 09.07.1912 Shkrese prokurorise se Tiranes nr 613, date 05.03.2013.
20						1604	1676, datë 09.07.1912
21						32074235	1676, datë 09.07.1912
22						33008395	1676, datë 09.07.1912
23						32074235	1676, datë 09.07.1912

- Libri Llogarisë mod.28, 35, Pistolet 9 mm Makarov

Nr.	Emri dhe mbiemri i personit te furnizuar me armatim	Pozicioni / funksioni	Lidhja librit 35	Sasia	Germa	Numri armës	Praktikat shkresore
1		K/P	½	1		2025069	
2		K/P	1/5	1	BO	2214	
3		K/P	1/6	1	BO	1398	
4		K/P	1/7	1	BO	1819	
5		K/P	1/8	1		1000212	
6		K/P	3/47	1		1000551	
7					BO	1616	
8					BO	2125	
9					BO	2187	

- Libri Llogarisë mod.28, 35). Pistolet 9 mm Mkek

1.....	mkek			01102342	
--------	------	--	--	----------	--

(Burimi: GR, Sektori i Armatimit)

- ✓ Pistoletë 9 mm makarov 20-she copë 1, rezulton tek përmbledhja e inventarit sipas llojit te armatimit, i cili mbyllet me nr. rendor 34, por nga kontrolli anatik rezulton se janë 33 armë (23+9+1), që evidentohet analitikisht nga tabela, prandaj tabela mbyllet me nr. rendor 33.
- ✓ Nga verifikimet dhe krahasimi i të dhënave, si dhe intervista me Shefin e Sektorit të Armatimit z..... rezulton se, në dokumentin “Raport mbi përfundimin e inventarit të vlerave materiale të shërbimit të armatimit, municionit e pajisjeve”, totali i armatimeve jashtë GR është 34 armë të pa administruara, që sipas grupeve të titulluara nga Garda e Republikës paraqiten si vijon:

Emërtimi	Armatim i pa administruar në depot e GR
Grupi A - bllokuar nga organet e hetimit-gjyqimit penal	11 armë
Grupi B - armatim me procedim penal, por i pa konfirmuar nga DP Policise,	4 armë
Grupi C- armatim i pa shkarkuar nga librat e llogarisë	1 armë
Grupi D – armatim funksionarëve politikë	33 armë
Shuma	49 armë

Konstatime:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

✓ 1. Rezulton se, armatimi “Pistoletë makarov 9 mm me nr. BH 339”, 20-tëshe, copë 1, në ngarkim të shtetasit është trajtuar në raportin për Shefin e Shtabit të gardës z..... në dy pozicione, përkatësisht: në grupin C-A”armatim i pa shkarkuar nga librat e llogarisë” si dhe në përmbledhësen e grupit D-”Armatim i pa inventarizuar”. Ky dublikim është sqaruar nga ana e Shefit të Sektorit të Armatimit .

✓ Referuar “Proces verbalit të sekuestrimit të datës 22 janar 2011 të mbajtur nga oficeri i Policese Gjyqësore z., në faqen e dytë të tij përvec numrave të armëve autmatike të sekuestruara, është vënë shënimi se për “ 6 armë automatike me sistem optik” të cilave sistemi optik nuk u lejon leximin e numrave serial të armëve, pasi janë të montuar në trupin e armëve , konkretisht mbi numrin serial të tyre”.

✓ Nga ana e ekipit të audituesve të KLSH u verifikua “Libri i Inventarit të Armatimit të GR” për vitin 2018 dhe për vitin 2019. Rezulton se në faqen nr. 1, kolona 3 e emërtorit “Makarov 20-tshe” janë të mbartua nga v.2018 8 (tetë) copë. Gjithashtu, referuar “Librit të Numrave dhe germave M 37”, sekretuar me nr. 98/ të vitit 2008, pistoleta Makarov 20-tshe me nr. 339 është regjistruar në numrin 8 (tetë), me të cilin mbyllet ky regjistër.

✚ **Pra, për këtë kategori personash politike e funksionarësh nga 34 armë, si pasojë e dublimit të një rekordi, (pistoleta makarov e), rezultojnë në fakt 33 raste të mosdorëzimit të armatimit të kategorive të ndryshme, të cilat janë të painventarizuara nga Komisioni i ngarkuar për këtë qëllim nga GR, në kushtet e pamundësisë sepse janë armë të dhëna personave subjekte politike dhe shoferëve të tyre para vitit 2011, kjo në referim të Udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik me nr.1288, datë 09.08.2000, “Per kriteret e dhënies, heqjes, dhe administrimit të armëve të dhëna me leje”, kreu IV, sipas së cilës furnizoheshin me armatim funksionarët e shtetit si dhe kryetaret e partive politike, kjo e ndryshuar sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm me nr. 369, datë 11.10.2011 “Për një ndryshim në Udhëzimin e Ministrit të Rendit Publik me nr.1288, datë 09.08.2000, “Per kriteret e dhënies, heqjes, dhe administrimit të armëve të dhëna me leje”.**

✓ 2.Pas shfuqizimit të UMRP rezulton se, për këto armë institucioni i GR nuk ka mundur të zbatojë detyrimin e kthimit të këtyre armatimeve në institucionin furnizues të GR, pavarësisht kërkesave shkresore dërguar institucioneve dhe autoriteteve shtetërore mbi dokumentimin dhe marrjen e masave për identifikimin e adresave të shtetasve të pajisur me këto armatime e municione. Rezulton se nuk janë ndjekur të gjitha rrugët administrative ligjore e penale ndaj shtetasve që posedojnë këto armatime në kundërshtim me përcaktimet e këtij Udhëzimi. Institucioni është mjaftuar vetëm me dërgim shkresash në DV Policisë Tiranë dhe Durrës (nr.760 dhe 760/1, datë 03.04.2012 dhe nr.611 e 612, datë 05.03.2013, dhe shkresa me nr. 524/1 prot, datë 13.02.2015 drejtuar ish-drejtorit të pergjithshmette Policisë së Shtetit, “Kërkesë për identifikimin e vendbanimeve të personave të pajisur me armatim nga Garda e Republikës”) për të identifikuar personat, por pa veprim.

Konkluzion:

Sa i përket armëve të evidentuara më parë të pa dorzuara nga shtetasit e paisur, gjatë procesit të inventarizimit të kryer në Shkurt-Qershor 2018 rezulton se, Institucioni GR aktualisht, në datën e përfundimit të auditimit, ka pa administruar sipas përcaktimeve ligjore mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe të pa grumbulluara e administruara pranë këtij institucioni, gjithsej 49 (dyzetë e nëntë) armë, për të cilat edhe pse janë lënë rekomandime të përsëritura nga Ministria e Brendshme, të pranuar, por të pa zbatuara plotësisht, nuk është mundësuar kthimi dhe administrimi i tyre në depot ushtrake të këtij institucioni.

Sektori i armatimit i GR, nuk ka marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për gjetjen e adresave të personave, bërjen dhe dokumentimin e kallzimit penal për të gjithë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

personat si dhe nuk ka kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës së armës nga personat e rezultuar me armatim të pa dorzuar apo të humbur.

Konstatime të tjera nga shqyrtimi i dokumentacionit të inventarizimit të armatimit:

- ✓ Nga auditimi i procedurave të inventarizimit rezulton se në Njesinë e Parë nga 109 artikuj inventari nuk ka rezultuar asnjë diferencë inventarit fizik me atë kontabël, mirëpo nga auditimi i Listës Matrikullore të kësaj njësie rezulton se në 32 raste, (për kategoritë e armatimit “Pistoletë mod 54, etj), është vënë shënimi “Depo”, por pa referuar asnjë dokument specifik apo FH respektive.
- ✓ Nga auditimi i procedurave të inventarizimit dhe dokumentacionit respektiv për Njesinë Nr.4, rezulton se dokumenti “Pasqyra e regjistrimit të armëve”, nga 8 persona të përfshirë, përmban parregulsi dhe mosplotësim të të dhënave të personave të pajisur me armatim; (nga këto në dy raste mungon viti i prodhimit të armës, dhe për numrin rendor 5 dhe 6 mungojnë të dhënat për identifikimin e gardistëve si dhe të dhënave të vendvbanimit apo të ID / certifikatës së lindjes.

ADMINISTRIMI I KARBURANTIT

Nga verifikimi i fletës së inventarit të mbajtur me datën 02.11.2018 në Sektorin e Transportit për institucionin e Gradës së Republikës, midis komisionit të ngarkuar për inventarizimin dhe magazinierit, rezulton se paraqiten si gjendje e këtij inventari tollonat e karburantit të OE “.....” sha, në bazë të kontratës së lidhur me datë 23.06.02009 midis Komandantit të GR z..... dhe sha me perfaqësues administratorin Sipas kontratës OE do të furnizoje me karburant AK në masën 50 % leng dhe 50 % tollona për gazoil dhe benzine pa plumb, për sasi të sipas kontratës. Referuar parashtrimeve të datës 07.05.2014 që GR ka paraqitur para Gjykatës, shoqëria “.....” paraqitet debitore ndaj këtij institucioni për 9670 litra benzinë dhe 5500 litra naftë (që rrjedhin nga shtesa e kontratës). Pavaresisht kërkesave zyrtare të dërguara në rrugë administrative OE me shkresat nr. 1220 datë 15.10.2010 dhe 1220/2 dt 15.11.2010, nuk janë përmbushur detyrimet e furnizimit për karburantin e likuiduar.

Konkretisht:

- a.-artikulli nr. 12, i fletës së inventarit: Benzinë tollona, 9,670 litra x 122.304 lekë/litrë = 1,182,679 lekë.
- b.-artikulli nr. 21, i fletës së inventarit: Eurodizel tollona, 5,500 litra x 3136.690 lekë/litrë = 751,795 lekë.

Gjithësej: 1,934,474 lekë.

Bazuar në padinë e ngritur nga Garda e Republikës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 4300 datë 22.4.2013 ka vendosur detyrimin e palës së paditur “.....” sh.a, për të përmbushur detyrimin kontraktor ndaj GR, duke i dorëzuar këtij të fundit sasinë prej 15,180 litra karburant (nga kjo 9670 litra benzine pa plumb dhe 5510 litra gazoil), që kapin vlefën prej **1,809,938 lekë.**

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e saj nr. 126, datë 28.01.2015 ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 4300, datë 22.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sa më sipër, me Vendimin nr. 1749, datë 23.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar **urdhër ekzekutimi** për Vendimin nr. 4300, datë 22.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Analizuar sa më sipër, rezulton se:

1. **Detyrimi financiar i palës së paditur “...” sh.a, i lëshuar nga gjykatat në vitin 2013 dhe konfirmuar e marrë formë të prerë në vitin 2015, me objekt përmbushjen e detyrimit kontraktor ndaj GR, duke i dorëzuar kësaj të fundit sasinë prej 15,180 litra karburant**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

(nga kjo 9670 litra benzine pa plumb dhe 5510 litra gazoil), që kapin vleften prej 1,809,938 lekë nuk është shlyer dhe përmbushur.

2. *vlera e detyrimit sipas vendimit gjyqësor është 1,809,938 lekë, kurse në bazë të të dhënave që administrohen në sektorin e karburanteve 1,934,474 lekë*
3. *Ky proces nuk është listuar në data basen e institucionit për çështjet gjyqësore dhe proceset në ndjekje. Audituesit e KLSH-së tërheqin vëmendjen për marrjen e sasisë së karburantit nga zbatim të Vendimit nr.126, datë 28.01.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.*

Nga ana e Gardës së Republikës, janë dërguar shkresa zyrtare në Zyrën Përmbartimore Tiranë (shkresat nr.1543 datë 29.08.2017 dhe nr.1946/1 datë 22.09.2017). Kjo zyrë, me shkresat nr.7468 datë 15.09.2017 dhe nr.7980 datë 26.09.2017, “Përgjigje shkresave Tuaja”, sqaron se kanë filluar procedurat për bllokim dokumentacioni për gjashtë automjete, pronë e këtij OE, për të cilat do të bëhet vlerësimi dhe shitja në ankand e tyre.

Ekstremitetet e shkresës së Gardes se Republikës		Drejtimi dhe lënda:
919/1	07.04.2015	Zyrës së Përmbartimit, kryetarit, Lënda: Kërkesë për ekzekutim
-	28.4.2017	Zyrës së Përmbartimit Lënda: Kërkesë për informacion
-	30.8.2017	Zyrës së Përmbartimit, MD Lënda: Kërkesë për informacion
1543	29.8.2017	Zyrës së Përmbartimit, MD Lënda: Kërkesë për informacion
238	28.1.2019	Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit, z....., Lënda: Rikërkesë për informacion. Përgjigja nga DPP: Sshkresa me bnr. 285/3 datë 26.02.2019 Nga ana e ZP Tiranë janë lëshuar urdhrat për vënien e sekuestros konservative , drejtuar Bankave të nivelit të Dytë, DSHTRR Tiranë, QK Biznesit Tiranë, ZVRPP Tiranë (nr. 1460 datë 06.02.2019), Shkresa me nr. 1537/1 datë 05.2.2019 i DPP për Komsariatit e Policisë së Qarkullimit Rrugor Tiranë, etj.

Rekomandim:

Nga ana e strukturave menaxheriale të Gardës së Republikës, të rikërkohet pranë Zyrës Përmbartimore Tiranë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë të lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit me nr. 126, datë 28.01.2015, ku është vendosur lënia në fuqi e Vendimit nr. 4300, datë 22.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe për të cilin me Vendimin nr. 1749, datë 23.3.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhër ekzekutimi.

Gjithashtu, çështja ti bëhet me dije Ministrisë së Drejtësisë me qëllim finalizimin e procedurave dhe veprimeve në zbatim të titujve ekzekutiv të lëshuar nga Gjykata për këtë qëllim.

Rregjistrimi i pasurisë në ZVRPP:

Me urdhër të titullarit, është bërë **rilevim i plotë** dhe janë përgatitur për çdo objekt dokumentet përkatëse me **sipërfaqe truall dhe sipërfaqe ndërtimi**, për të gjitha objektet në përdorim të këtij institucioni. Garda e Republikës në bashkëpunim me MPB, ka përgatitur projektvendimet për KM



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

për pronat në përdorim të këtij Institucioni. Mbi bazën e këtyre projektvendimeve, kanë dalë katër VKM për trajtimin e lites se inventarit të pronave në përdorim të kësaj njësie shpenzuese, respektivisht:

- **VKM nr.44, datë 25.01.2017** “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.250, datë 24.04.2003 të KM, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi MRP”, të ndryshuar “, në të cilin në ZK nr. 8280 janë përcaktuar **tre prona** me sipërfaqe totale të pronave 6,358.9 m² dhe nga kjo sipërfaqja totale të ndërtesave 1367.4 m² që i përkasin Njesisë Speciale të Pallati i Brigadave.
- **VKM nr.156, datë 01.03.2017** “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.1455, datë 21.05.2008 të KM....“, në të cilin është përcaktuar një pronë (ish repartit 1050, tek Komanda e Gardës së Republikës / Pallati i Brigadave) në ZK nr. 8280 me sipërfaqe totale të pronës (14,878.5 m²) dhe sipërfaqe totale të **shtatë ndërtesave** (prej 2,223.05 m²).
- **VKM nr.157, datë 01.03.2017** “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.815 datë 29.11.2007 të KM “, në të cilin janë përcaktuar **nëntë prona** me sipërfaqe totale të pronës dhe sipërfaqe totale të godinave.Ato lidhen me Repartin nr. 685 Tiran,e OKV linze, OKV Pika Dajt, pika Durres, pika Vlorë, Qendra e Stervitjes Mullet, Garnizoni, OKV Krrabë, dhe pika Pogradec. Me konkretisht:

Nr	Zona kadastrale	Vendndodhja, sipërfaqja totale dhe nr. i objekteve ndertimore	Nga kjo, sipërfaqja e ndërtesave
1.	ZK 8270	Reparti 685,Njesia e Trete, 6733,2 m ² 2 godina	767 m ²
2.	ZK 2460	Pika Linze, OKV, 22,571 m ² 4 godina	657 m ²
3.	Ska identifikim	Pika Dajt, sipas 600,446.8 m ² ; 14 godina	1864.7 m ²
4.	ZK 8513	Pika Durrës, sip.37,486 m ² ; 2 godina	610 m ²
5.	ZK 2074	Pika Vlore, sip 4,202 m ² ; 2 godina	236 m ²
6.	ZK 2947	Qendra Stervitore Zona Mullet, sip 46,301.5 m ² ; 15 godina	3014.2 m ²
7.	ZK 8270	Godina e garnizonit sip. 46,206 m ² , 13 godina	5,437 m ²
8.	ZK 3201	OKV Krrabë, sip. 3587.2 m ² ; 5 godina	1682 m ²
9.	ZK 8581	Pika Pogradec, sip 5270 m ² ; 1 godinë	347.5 m ²

- **VKM nr.406, datë 04.07.2018**, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe kalimin në pronësi të Bashkisë së Tiranës dtë pjesëve takuese të pronës me emertimin “Garda e Republikës,Garnizon”, me vendndodhje në ZK nr. 8270, me nr,. Pasurie 4/134dhe per një ndryshim në VKM nr. 815, datë 29.11.2007 “Per miratimin e listes shtese te inventarit te pronave te paluajtshme shtetërore, të cila kalojnë në përgjegjësi administrimi MB per GR”, të ndryshuar “, në të cilin janë përcaktuar **trembedhjetë prona që transferohen** me sipërfaqe totale të pronës 46,206.4 m² dhe sipërfaqe të godinave 5437.4m², qe hiqen nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

pergjegjiesine administrimit te MB dhe kalojnë: 21,229 m² nën pergjeggjiesine e administrimit te MFE dhe 25,004 m² në pronësi të Bashkisë së Tiranës.

Nga auditimi i bërë procedurave të ndjekura nga Garda e Republikës në zbatim të VKM-ve të mësipërme për hipotekimin e pasurisë shtetërore rezulton si më poshtë:

✓ Është bërë aplikimi mbi regjistrimin e pasurive të palujtshme të Gardës së Republikës në **Z.V.R.P.P Tiranë** me datë 12.04.2017 dhe është dorëzuar dokumentacioni përkatës sipas VKM -së dhe me datë 12.10.2017, është bërë aplikim shtesë dokumentacioni, me datë, 10.02.2018 regjistrim prone, si pronë e Gardës në Linzë, Zona Kadastrale 2380. Me datë, 16.11. 2018 është bërë përsëri aplikim shtesë dokumentacioni për VKM nr 44, si dhe kërkesë informacioni të përgjithshme për ecurinë e regjistrimit të pronave.

Institucioni është paisur me Çertifikatë për Vërtetim Pronësie (Nr.1694638, lëshuar me datë 05.04.2017) , e cila është përditësuar gjatë periudhës së kryerjes së auditimit me Çertifikatë për Vërtetim Pronësie Nr.1970183, lëshuar me datë 16.07.2019 nga ZVRPP Tiranë për Zonën Kadastrale Nr. 8280, Nr. pasurie 2/369 sipërfaqe trualli 14,879.86 m², nga kjo ndërtesa 3,490 m². Në kartelën e pasurisë së paluatjshme që shoqëron certifikaten, është vënë në kolonën e referencës VKM nr. 156, viti 2017.

Referuar përcaktimeve të VKM nr. VKM nr.157, datë 01.03.2017 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.815 datë 29.11.2007 të KM “, nga ana e Gardës së Republikës janë bërë aplikimet dhe institucioni është paisur me Çertifikatë për Vërtetim Pronësie me Nr.1970184, date 16.7.2019, Nr. pasurie 2/359, sipërfaqe trualli 6,733 m², nga kjo ndërtesa 767 m². Në kartelën e pasurisë së paluatjshme që shoqëron certifikaten, është vënë në kolonën e referencës VKM nr. 157, viti 2017.

Konstatohet se nuk ka mospërputhje të sipërfaqeve të pronës, sipas rregjistrimit në ZVRPP dhe sipërfaqeve të përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 156 /2017 dhe 157/2017.

✓ Është bërë aplikimi mbi regjistrimin e pasurive të palujtshme të Gardës së Republikës në **Z.V.R.P.P, Durrës** me datë 06.04.2017 dhe është dorëzuar dokumentacioni përkatës sipas VKM-së, si dhe me datë 13.10.2017 është aplikuar përsëri, duke bërë ndryshimin e zonës kadastrale nga zona nr.8513 në ZK 8518.

✓ Është bërë aplikimi mbi regjistrimin e pasurive të palujtshme të Gardës së Republikës në **Z.V.R.P.P Vlorë** me datë, 07.04.2017 dhe është dorëzuar dokumentacioni përkatës sipas VKM-së, me datë, 11.05.2017 janë kryer aplikime shtesë të dokumentacionit më datë, 13.10.2017 është aplikuar përsëri për ndryshimet nga Zona Kadastrale Kaninë në Zona Kadastrale Uji ftohtë. Me datën, 16.11.2018 është përsëri aplikim për paisje me çertifikatë pronësie. Për pronën me adresë të pasurisë në Vlorë në Zonën Kadastrale Nr. 8602, Nr. pasurie 43/48/4, sipërfaqe trualli 4006.39 m², nga kjo ndërtesa 211 m².

Institucioni është paisur me Çertifikatën me nr. 1903430 për vërtetim pronësie, lëshuar me datë 19.12.2018 për pasurinë me nr. 43/84/4, Nr. pasurie 43/48/4, sipërfaqe trualli 4006.39 m², nga kjo ndërtesa 211 m². Në kartelën e pasurisë së paluatjshme që shoqëron certifikaten, është vënë shënimi VKM nr. 157, datë 01.03.2017.

Konstatohet se:

Sipas regjistrimit në ZVRPP është pasqyruar sipërfaqja e truallit prej 4006.39 m², (dhe nga kjo ndërtesa 211 m²), ndërsa sipërfaqeve të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.157, datë 01.03.2017 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.815, datë 29.11.2007 të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

KM “, në të cilin sipërfaqja totale e pronave është 4202 m² dhe sipërfaqja totale e ndërtesave 196 m². Nga saktësimi i të dhënave të disponuara nga Sektori Logjistik dhe disponimi I dokumentacionit plotësues, rezulton se sipërfaqja prej 196 m², lidhet me efektet e VKM nr.519, datë 13.06.2013 “Për kalimin në fond banese të ish-objekteve të dala nga rrsitrukturimi i MB... “Ish Depo e pikës Autonome Vlorë... nga EKB” për shtetasin Bardhosh Nuraj.

✓ Është bërë aplikimi mbi regjistrimin e pasurive të palujtshme të Gardës së Republikës në **Z.V.R.P.P Pogradec** me datë 07.04.2017 dhe është dorëzuar dokumentacioni përkatës sipas VKM –së. Për pronën me adresë të pasurisë Pogradec në Zonën Kadastrale Nr. 8581, Nr. pasurie 12/345, sipërfaqe truall 5270 m², nga kjo ndërtesa 347 m², **Institucioni është paisur me Çertifikatë për vërtetim pronësie Nr 1682365, lëshuar me datë 07.11.2017.** Në kartelën e pasurisë së paluatjshme që shoqëron certifikaten, është vënë shënimi VKM nr. 157, datë 01.03.2017.

Konstatohet se:

Përputhen të dhënat mbi zonën kadastrale të pasurisë së regjistruar, sipas rregjistrimit në ZVRPP (ku është shënuar ZK 8581) dhe përcaktimeve të ZK nr. 8581 të caktuara në kartelën respektive që shoqëron Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.157, datë 01.03.2017 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.815 datë 29.11.2007 të KM ...”. Edhe sipërfaqeve të pronës, sipas rregjistrimit në ZVRPP (ku janë regjistruar sipërfaqja e truallit prej 5270 m², nga kjo ndërtesa 347.5 m²) përputhjen me të dhënat mbi sipërfaqet e përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.157, datë 01.03.2017 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.815 datë 29.11.2007 të KM”, në të cilin sipërfaqja totale e pronave është 5,270 m² dhe sipërfaqja totale e ndërtesave 347.5 m².

Si përfundim, në total me katër VKM të viteve 2017 dhe 2018, rezulton se kanë kaluar në përgjegjësi administrimi për Gardën e Republikës **sipërfaqja e përgjithshme prej 796,383 m² sipas objekteve ndërtimore respektive, referuar VKM-ve dhe kjo situatë e regjistrimit të tyre në Zurat Vendore të Regjistrimit të Pasurisë:**

VKM	Nr. pronave	Sipërfaqja totale	Nga kjo: Sipërfaqja e regjistruar në ZVRPP	Sipërfaqja e pa regjistruar
Nr. 44/ Janar 2017	3	6358.9 m ²	0 m ²	6,358.9 m ²
Nr.156/ Mars 2017	7	14,878 m ²	14,878 m ²	0 m ²
Nr.157/ Mars 2017	58 objekte	775,145 m ²	6,733 4,202 5,270 Total 16,205 m ²	758,940 m ²
Nr.406/ Korrik 2018	-13	- 46,233 m ²	0	xx
Gjithsej		796,383 m ² (pa reflektuar VKM nr. 406)	31,083 m ²	765,300 m ²

(Burimi: përgatitur nga Grupi I Auditimit)

Nga auditimi i kryer, rezultoi se nga gjithë pronat e mësipërme, **janë të regjistruara në ZVRPP, 4 (katër) prona:**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- trualli e godinat ne Garden e Republikes (VKM nr.156, dt 1.3.2017), për Komanden
- trualli e godinat ne Garden e Republikes (pjeserisht VKM nr.157, dt 1.3.2017), Njësia e Tretë

si dhe pikat autonome Pogradec dhe Vlorë, ndërsa pronat e tjera janë në proces hipotekimi. Siperfaqja e pergjithshme e regjistruar shënon 31,083 m² nga 796,383 m² të sipërfaqes së përgjithshme të GR (pa reflektuar VKM nr. 406/2018)

Grupi i auditimit të KLSH, sqaron se këto mosperputhje të vërejtura të zonave kadastrale sipas VKM dhe atyre të shënuara në certifikatat e regjistrimit të pronësisë, vijnë nga procesi i rilevimit të kryer nga ana e këtij institucioni.

Nga ana e institucionit janë ndjekur në vijimësi praktikatat si vijon:

- ✓ Me datë 12.10.2017, kemi bërë aplikim shtesë për plotësim dokumentacioni, e cila është vijuar me datë 10.02.2018 përmes një aplikimi shtesë në plotësim të dokumentacionit të regjistrimit të pronës së Gardës në Linzë, zona kadastrale 2380.
- ✓ Me datë 16.11.2018 është bërë aplikim nr.112964 dhe nr.112973, për shtesë dokumentacioni për VKM-në Nr.44, datë 25.01.2017, si dhe kërkesë informacioni të përgjithshëm për ecurinë e regjistrimit të pronave.
- ✓ Në përgjigje të shkresës suaj datë 26.11.2018 “Kthim përgjigje”, për “Depozitimin pranë sporteleve të ZVRPP kopje të aplikimit ku keni aplikuar për regjistrimin e këtyre VKM-ve, në mënyrë që të bëjmë të mundur identifikimin e dosjes”, nga ana GR me Nr.Aplikimi 124970, datë 21.12.2018 është bërë depozitimi pranë sporteleve të ZVRPP i aplikimeve të mëparshme.

Konstatim nr.1:


Ndonëse nga ana e institucionit të GR është zbatuar detyrimi i pikës nr.10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, meqenëse është përgatitur dhe dërguar në MB i inventarit të pronave shtetërore nën përgjegjësinë e tyre administrative, nuk janë regjistruar në ZVRPP të gjithë pronat e këtij institucioni. *Sa më sipër*, në kushtet nuk janë dokumentuar aktet e fitimit të pronësisë për çdo rast, nuk kanë gjetur zbatim të plotë përcaktimet e ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe kërkesat e ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Konstatim nr.2:

Pronat e institucionit GR janë pasqyruar vlerën **338,971,390 lekë**, (të tilla sipas regjistrimit kontabël me vlerën e tyre bruto në bilancin kontabël të datës 31.12.2017), mirëpor nga ana tjetër konstatohet se për zerin “toka troje e terrene” vlera e tyre në kontabilitet është zero lekë, Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore sa më lartë për regjistrimin e pasurisë shtetërore, përcaktimet e VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Kështu, vetëm për sipërfaqet e trojeve të pakontabilizuara dhe që nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare të GR, rezulton se, vetëm për pikat Vlorë dhe Pogradec, për sipërfaqen e truallit prej 9,276 m² kjo vlerë minimalisht duhet të ishte kontabilizuar për **52,320,218 lekë**. *Konkretisht:*

Për pikën Pogradec: referuar FZ nr. 14, viti 2016, rezulton se në ZK me nr. 8581 nuk është e listuar në agjendën që shoqëron pasuritë e opalujtshme, por referuar çmimeve në ZK 3664 për Tushemishtin, vlera paraqitet 1,640 lekë/ m, nga ku, vlera e tokës truall sipas hartës së miratuar të tokave është për sipërfaqen 5,270 m²= **8,642,800 lekë**, vlerë kjo që duhet të ishte pasqyruar në kontabilitetin e këtij institucioni.


Emërtimi: Harta mbi vlerën e pasurisë së paluajtshme, Bashkia Pogradec



(Burimi: Garda e Republikës)

Për pikën Vlorë: referuar FZ, faqe 903, rezulton se në ZK nr. 8602, vlera e tokës truall sipas hartës së miratuar të tokave është $10,903 \text{ lekë/m}^2 \times 4,006 \text{ m}^2 = 43,677,418 \text{ lekë}$, vlerë kjo që duhet të ishte pasqyruar në kontabilitetin e këtij institucioni.

Emërtimi: Harta mbi vlerën e pasurisë së paluajtshme, Bashkia Vlorë



(Burimi: Garda e Republikës)

Konstatim nr.3:

Ndonëse Vendimi i Këshillit të Ministrave me nr.406, është nxjerrë me datë 04.07.2018 me objekt “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe kalimin në pronësi të Bashkisë së Tiranës dtë pjesëve takuese të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

pronës me emertimin “Garda e Republikës, Garnizon”, me vendndodhje në ZK nr. 8270, me nr. Pasurie 4/134 dhe për një ndryshim në VKM nr. 815, datë 29.11.2007 “për miratimin e listës shtese të inventarit të pronave të **paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi MB për GR**”, të ndryshuar “, **rezulton se VKM nuk ka gjetur zbatim dhe nuk janë kryer procedurat e transferimit dhe dorëzimit zyrtarisht të aktiveve sipas përcaktimeve në këtë VKM duke pasqyruar në këtë mënyrë dhe efektet përkatëse në kontabilitetin e institucionit të GR**. Kështu, ende në kontabilitetin e GR janë përfshirë 13 (trembedhjetë) prona që transferohen me sipërfaqe totale të pronës 46,206.4 m² dhe sipërfaqe të godinave 5437.4m², që hiqen nga përgjegjësi administrative të MB dhe kalojnë: 21,229 m² në përgjegjësi administrative të MFE dhe 25,004 m² në pronësi të Bashkisë së Tiranës. Mosveprimet nga ana e institucionit të Gardës së Republikës lidhen me faktin se ka mosveprime nanga ane institucionit të qeverisjes së përgjithshme- Ministrisë së Brendshme, pasi nuk është nxjerrë urdhri i Ministrit të Brendshëm për të procedurë sipas VKM-së.

Titulli i Gjetjes 1:	Parregullsia e shkelje në lidhje me zbatimin e kontratës së furnizimit me nr. 45, datë 26 dhjetor 2017, si në respektimin e afateve të furnizimit, ashtu dhe në kontrollin cilësor në procesin e prodhimit dhe analizat e kampioneve për testimin e cilësisë së uniformave dhe veshmbathjeve për punonjësit e GR-së.
Situata:	<i>Konstatohet se,</i> - Në përbërje të Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave nuk ka ekspertë të fushës (inxhinierë të tekstilit). Komisioni përbëhet nga dy oficerë të logjistikës dhe një shofer, duke mos zbatuar përcaktimet e paragrafit nr.43, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku përcaktohet se “<i>Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material</i>”. - Nuk kanë gjetur zbatim kërkesat dhe përcaktimet e vëna në formularin nr. 10 “Specifikimet teknike”, në lidhje me kontrollin cilësor në procesin e prodhimit të uniformave dhe veshmbathjeve për punonjësit e GR. Ky kontroll i cilësisë është nënvizuar <i>pothuajse për çdo artikull që është prokuruar</i>, ku vendoset detyrimi i GR që për të siguruar përmbushjen e detyrimeve mbi cilësinë ajo do “të ndjekë dhe kontrollojë procesin e prodhimit në fabrikën prodhuese të atij artikulli”. - Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e vëna në specifikimet teknike të DST, paragrafi “Kolaudimi dhe marrja në dorëzim” për secilin nga 19 artikuj e prokuruar, duhet të zbatoheshin detyrimet e vendosura për kolaudimin dhe marrjen dorëzim të mallrave, ku përkatësisht thuhet se: “<i>Pranimi të gjithë sasisë së artikullit... të përcaktuar në kontratë dhe të dorëzuar në magazinën e porositësit do të bëhet vetëm në bazë të rezultateve që do të merren gjatë procesit të kolaudimit për të gjithë sasinë e produktit të gatshëm të dorëzuar në magazinë. Teknisht, kolaudimi do të bëhet mbi bazën e rezultateve të fletë analizave laboratorike të lëshuara nga institucionet e autorizuar , kryerjen direkt të matjeve dhe provave fizike të mostrave përfaqësuese të sasisë së mallit të dorëzuar , dhe krahasimin e të gjithë këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik, <u>kampionit të ofruar dhe modelit të miratuar</u>.</i> - Nuk ka gjetur zbatim neni 9, pika 1 “Kushtet e pranimi të mallit”, të kontratës, sipas të cilit, “Para pranimi të mallit, AK nëpërmjet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	Komisionit të Pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit, ekzaminon, <u>inspekton dhe teston mallrat brenda 10 ditëve nga dorëzimi i tij në vendin e AK</u> ". AK është mjaftuar vetëm me raportet e testimit të kryera dhe dorëzuara nga ana e OE, pa kryer testime dhe analiza në laboratorë te veçantë për cilësinë tyre.
Kriteri:	-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; -VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" -Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 të MF "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, paragrafi "Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara",
Ndikimi	Krijohet risku i anomalive dhe parregullsive në cilësinë e furnizimit të një nomenklature artikujsh shumë të rëndësishëm për institucionin.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	1. Institucioni i Gardës së Republikës të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë dhe shkeljet e dokumentuara për këtë procedurë furnizimi dhe në vijim për ngritjen e komisionit të pranimit të mallrave të gjejnë zbatim të plotë përcaktimet e paragrafit nr.43, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". 2. Për marrjen në dorëzim të artikujve të uniformave dhe veshmbathjeve për efektivet e GR, Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimit të mallit, të marrë masa që procedurat e ekzaminimit dhe testimit të mallrave të furnizuara të kryhen pranë laboratorëve të akredituar, dhe rezultatet e tyre, të krahasohen me rezultatet e analizave të dërguara nga OE furnizues".
Afati për zbatimin e rekomandimit:	Në vazhdimësi

Nga ana e GR për këtë çështje në observacionet e dërguara mbi Projektraportin e auditimit me shkresën nr. me shkresën e GR nr. 1122/3 prot., datë 29.08.2019 , "Dërgohet projektraporti i auditimit", protokolluar në KLSH me nr. 340/4 datë 29.8.2019, drejtuesit e institucionit kanë bërë komente dhe shpjegime si më poshtë:

"Komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave ka në përbërje dy oficerë të logjistikës, të cilët janë specialistë, pasi dhe në programet Universitare (për të cilat janë diplomuar), janë përgatitur për administrimin materialeve të veshmbathjes dhe shërbimeve të tjera (ushqim, karburant, kazermim (infrastrukturë), duke përfshirë dhe njohuri të mjaftueshme për tekstilet. Natyrisht baza e vlerësimit (krahas vlerësimit organo-leptik), mbeten analizat laboratorike (në laboratorë të akredituar të tekstileve).

Marrja e një inxhinieri tekstili në përbërje të komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave (nuk është në kontratë) nuk është praktikuar, pasi nuk është parë e nevojshme dhe në furnizimet e mëparshme në vite, në Gardën e Republikës, dhe deri tani nuk janë konstatuar probleme me cilësinë e artikujve të furnizuara.

Anëtari tjetër i komisionit të pritjes së mallit, nuk ka qenë thjesht Shofer, por detyra e tij funksionale ka qenë "Furnitor, shofer" posaçërisht për të ndjekur realizimin në sasi e cilësi të kontratave të lidhura, për furnizimin me punë, mallra e shërbime.", nuk është arsye e pranohet nga ana e grupit të auditimit të KLSH-së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

...“Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e vëna në Specifikimet Teknike të DST, paragrafi ‘Kolaudimi dhe marrja në dorëzim’, për secilin nga 19 artikujt e prokuruar..., “Nuk ka gjetur zbatim neni 9, pika 1 “Kushtet e pranimit të mallit”, të kontratës, **sqarojmë:**

Midis te tjerash, GR është shprehur se, referuar matjeve dhe vëzhgimeve organo-leptike të kryera, nisur dhe afati i limituar kohor nga lidhja e kontratës dhe afatit të dorëzimit të mallrave, Komisioni i pritjes së mallit, **nuk e ka gjykuar të arsyeshme dhe e ka patur pothuajse të pamundur kryerjen e analizave të tjera laboratorike**, por është bazuar në analizat laboratorike të sjella nga OE, duke pranuar mallin (që praktikisht nuk na ka rezultuar me probleme cilësore).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se përzgjedhja dhe caktimi i ekspertëve të fushës në përbërje të komisionit të pranimit dhe marrjes në dorëzim të mallrave është kërkesë e dispozitave ligjore në fuqi dhe shërben si mbrojtje për autoritetin kontraktor.

Grupi i auditimit konstaton se nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e paragrafit nr.43, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ku thuhet se “Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjës të punëgjegjësi material”. Fakti që nuk është vendosur në kontratë caktimi i një eksperti të fushës së tekstilit, nuk është arsyetim dhe nuk pengon drejtuesit e autoritetit kontraktor të marrin masa për forcimin e kontrolleve të brendshme dhe sigurimin e cilësisë së kërkuar të furnizimeve specifike. Nënvojzjmë se kontrolli i cilësisë së uniformave dhe veshmbathjeve të furnizuara nga OE për GR nuk është konfirmuar dhe certifikuar nga analiza laboratorike, duke krijuar risqe shtesë për subjektin

Për sa sipër, nga ana e komisionit të ngarkuar për kolaudimin e mallit nuk janë kryer analiza laboratorike për të konfirmuar përputhjen e cilësisë së mallit të kontraktuar me specifikimet teknike të shpallura për tender nga ana e Ministrisë së Brendshme, për të bërë krahasimin e të gjitha këtyre rezultateve me kërkesat dhe të dhënat teknike të këtij specifikimi teknik, të kampionit të ofruar dhe modelit të miratuar. Edhe fakti i referuar në observacion mbi “kohën mjaft të limituar nga lidhja e kontratës dhe afatit të lëvrimit të mallrave, komisioni nuk e ka patur të mundur për të kryer kontroll të cilësisë në procesin e prodhimit”, duhet listuar si një nga elementet e risqeve për tu konsideruar në kuadër të analizës së planifikimit dhe kohës së realizimit të prokurimeve që kryen institucioni dhe ministria për prokurimet e përqendruara.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar me objeksionet, ky koment i zyrtarëve të GR nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi është i pa bazuar ligjërisht.

Titulli i Gjetjes 2:	Nga ana e institucionit të GR janë nënshkruar dy kontrata (me nr. 46 dhe 47) me vlerë të përgjithshme 98,175,600 lekë, në datat 28 dhe 29 dhjetor 2017 për “Blerje autoveturash për Gardën e Republikës” duke ngurtësuar fondet në bankat e nivelit të dytë në formën e letër kredive në masën e plotë të investimit dhe kryer pagesa për investime që konsiderohen të realizuara brenda, por që janë furnizuar në vitin e ardhshëm, gjë që tregon për procese me mangësi serioze që nuk janë planifikuar siç duhet nga ana e strukturës përgjegjëse në institucionin e qeverisjes së përgjithshme.
Situata:	Mungon një përcaktim i saktë dhe rigoroz nga ana e MFE mbi rastet, tipologjitë dhe natyrën e investimeve që do të njihen si të rëndësishme së veçantë dhe do përdoren letërkredi, meqenëse investimet, kur prokurohen nuk kanë një referim të tillë. Ngurtësimi i fondeve dhe kryerja e pagesave për furnitura që konsiderohen të realizuara brenda vitit ushtrimor (sipas Regjistrimit të Realizimit të Prokurimeve Publike të AK), por që në fakt bëhen hyrje në njësinë shpenzuese vitin pasardhës, tregon për procese që nuk janë planifikuar siç duhet nga ana e strukturës përgjegjëse në institucionin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	qeverisjes së përgjithshme (Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme). Përdorimi i letër kredive nga institucioni, në masën e plotë të investimit, cënon parimin kryesor të realizimit të buxhetit atë të transparencës dhe besueshmërisë, të përcaktuara nga neni 4 i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe neni 40 i tij, ku thuhet përkatësisht se, “ <i>e drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës</i> ”, pasi institucioni ka deklaruar investime/shpenzime të kryera si të realizuara për vitin 2017, ndërkohë që transaksionet financiare (mekanizmi L/C dhe hyrja e mallrave dhe produkteve) janë kryer efektivisht gjatë vitit 2018.
Kriteri:	-Ligji nr..9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; -Udhëzimi i Ministrisë së Financave me nr.2, date 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kapitulli “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, paragrafi nr. 147.
Ndikimi	Përdorimi i letër kredive nga institucioni, në masën e plotë të investimit, cënon parimin kryesor të zbatimit të buxhetit brenda vitit dhe atë të transparencës dhe besueshmërisë.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Institucioni Gardës së Republikës, të kërkojë pranë Ministrisë së Brendshme, (si autoriteti ku është vendosur në strukturë Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara) që, në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të përgatitësin nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, duke specifikuar rastet, mënyrat dhe masën e përdorimit të letër kredive nga institucionet buxhetore, pasi mungon një përcaktim i saktë dhe rigoroz mbi tipologjitë dh natyrën e investimeve që do të njihen si të rëndësishme së veçantë dhe që mund të aktivizojnë përdorimin e instrumentit të letërkredive, për të shmangur përdorimin abuziv të tij.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Brenda një muaji.

Titulli Gjetjes 3:	i Nga auditimi i pasqyrave financiare si dhe verifikimi i dokumentacionit që administrohet nga Sektori i Armatimit, konstatohet se, nuk është pasqyruar në evidencën kontabile të njësisë, e gjithë vlera e armatimit që ka në administrim institucioni i Gardës së Republikës
Situata:	1. Evidentimi material e sasior i armatimit në Gardën e Republikës mbahet nga Sektori i Armatimit, ku janë pasqyruar armatimet në sasi dhe përdoruesit e tyre, referuar tipologjive së regjistrave të miratuara me udhëzime të veçanta të Ministrit të Brendshëm. Nga sektori armatimit të institucionit, dokumentacioni i hyrjes dhe daljes së mallrave e materialeve (armë, municione e pajisje), nuk plotësohet i rregullt sa i përket çmimit dhe vlerës së mallit, siç e përmban formati i miratuar i dokumentit (emërtesa, njësia, sasia, çmimi, vlera. etj.). Gjithashtu edhe regjistrimi i dokumentacionit në librat e llogarisë kryhet vetëm për lëvizjet sasiore të këtyre mallrave <u>pa përcaktuar sipas emërtesës së artikullit edhe çmimin përkatës.</u>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	Nga verifikimi i të dhënave me zgjedhje që janë shënuar në fletën e inventarit për armatim e municion të datës 26.6.2018, evidentohet se, nuk është regjistruar, kontabilizuar dhe përfshirë në llogaritë e aktiveve të GR kundërvlera për armët luftarake të tipit “pistoletë”, (përkatesisht <i>pistoletë mod. 54 janë 1071 copë, pistoletat 9 m/m makarov janë 136 copë; ato 9 m/m Kirikale janë 100 copë; cloock 17 janë 116 copë dhe cloock 19 për 70 copë; berreta FS 92 janë 395 copë, berreta stoeger janë 53 copë, etj.etj.</i>), që nuk janë vlerësuar me çmimin e tyre dhe nuk janë përfshirë në librat e kontabilitetit. Gjithashtu, evidentohet se, nuk është regjistruar, kontabilizuar dhe përfshirë në llogaritë e aktiveve të GR kundërvlera për armët luftarake të llojit automatikë (<i>mod 56 janë 161 copë, automatikët mod 56 q-druri janë 1454 copë, automatikët mod. 56 metal janë 749 copë, automatike scorpions 4 copë, automatike trofe 3 copë, Mitraloz i lehtë mod 56- copë 86, mitraloz MG 3 për 10 copë, mod. 57 për 17 cope, mod. 53 për 9 copë</i>), etj. 2. Përsa u përket armëve të evidentuara më parë të pa dorëzuara nga shtetasit e pajisur vite më parë në bazë të dispozitave që aktualisht janë shfuqizuar, për GR rezultojnë një numër armësh të pa grumbulluara e administruara pranë këtij institucioni, për të cilat edhe pse janë lënë rekomandime të përsëritura nga Ministria e Brendshme, të pranuar, por të pa zbatuara plotësisht, nuk është mundësuar kthimi dhe administrimi i tyre në depot ushtarake të këtij institucioni. Sektori i armatimit i GR, nuk ka marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për gjetjen e adresave të personave, bërjen dhe dokumentimin e kallëzimit penal për të gjithë personat si dhe nuk ka kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës së armës nga personat e rezultuar me armatim të pa dorëzuar apo të humbur.
Kriteri:	✓ Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, ✓ Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njërive që varen prej tyre si dhe njërive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.26, datë 28.12.2007 . ✓ Pika nr. 2.2, të VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, ✓ Pika nr. 36, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, ✓ Pika nr. 26, kreu III, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, ✓ Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr.1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	1.Komandanti i Gardës së Republikës të marrë masa, programojë detyrat sipas afateve dhe të ngrejë grupet e vlerësimit të armatimit dhe municionit që ka në inventar dhe administrim institucioni. Komisioni në bashkëpunim me Sektorin e Armatimit në GR, për mallrat e materialet (<i>armë, municione e pajisje</i>), të regjistruar në ditarët e llogarisë të bëjë menjëherë përcaktimin e çmimit të tyre dhe në vijimësi dokumentacionin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	hyrje dhe dalje ta plotësojë të rregullt duke përcaktuar çmimin e artikullit dhe vlerën e mallit në faturë. 2. Nga ana e Sektorit të Financës, rezultatet e vlerësimeve të kryera në shërbimin e armatimit, të pasqyrohen në evidencën kontabile që do të mbyllet për vitin 2019, duke evidentuar vlerën e plotë e të saktë të armatimit dhe municioneve, sipas çmimit së blerjes, apo dhe referuar çmimeve të tregut për armatimin e trashëguar në vite apo të dhuruar, konformë rregullave kontabile dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi armatimin. 3. Sektori armatimit dhe pajisjeve në GR, për armët që janë në administrim nga shtetas të ndryshëm (<i>ish punonjës të GR apo funksionarë të subjekteve politike</i>) që rezultojnë ende të pa dorëzuara (<i>pa u bërë hyrje në depon e GR</i>) si dhe armët që janë në proces hetimi e gjykimi penal, për të cilat nuk janë ndjekur rrugët e duhura ligjore për marrjen hyrje të tyre si rezultat edhe i dokumentimit e regjistrimit të tyre në ditarë të vjetër të llogarisë për periudhën para vitit 2000, të marrë masat e menjëhershme që këto armë: a. t'i evidentojë e regjistrojë në një libër të veçantë, në të cilin të përshkruaj të dhënat e plota të shtetasit dhe të armës, b. të bëjë rakordimin e shumave të përgjithshme në ditarët e llogarisë mod.28, si dhe të dokumentojë e administrojë edhe ecurinë e procesit administrativ e ligjor të ndjekur. Komandanti i GR tu kërkojë zyrtarisht drejtorive vendore të policisë së shtetit për të gjetur adresat e personave që janë pajisur me armët luftarake dhe të ndiqen procedurat deri në bërjen hyrje në depot e GR të armatimit dhe municionit të furnizuar sipas dispozitave që aktualisht kanë rënë nga fuqia.
Afati për zbatimin e rekomandimit	1.Menjëherë 2. Me mbylljen e llogarive vjetore. 3. Menjëherë dhe në vijimësi

Titulli i Gjetjes 4:	Është likuiduar shuma prej 289,014,709 lekë, që përfaqëson shpenzimet për ngjarjet e 21 janarit 2011, sa likuiduar për Vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për 46 raste / urdhër shpenzime, në shumën <u>289,014,709 lekë</u>, për të cilat nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Gardës së Republikës (<i>si palë të paditura</i>), nuk është bërë animimi dhe ndjekja në të gjithë shkallët e gjyqësorit
Situata:	Vlera e llogarisë 602/7 “Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale” paraqitet në shumën prej 289,770,037 lekë dhe nga kjo, vlera prej 289,014,709 lekë përfaqëson shpenzimet për ngjarjet e 21 janarit 2011. Konstatohet se janë kryer likuidime për Vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me 46 Urdhër Shpenzime në shumën 289,014,709 lekë, për të cilat nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Gardës së Republikës (<i>si palë të paditura</i>), nuk është bërë animimi dhe ndjekja në të gjithë shkallët e gjyqësorit.
Kriteri:	-Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 452 Kodit të Procedurës Civile, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, i ndryshuar. -Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. -Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr.2, datë 6.2.2012 “Për procedurat



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	standarde të zbatimit të buxhetit”. -Udhëzimi i MB nr.459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Të merren masa që në vazhdim për të gjithë proceset gjyqësore ku Garda e Republikës është palë, të ndiqen me rigorozitet duke ankimuar çështjet në të gjithë shkallët e gjykimit. Për likuidimin e vendimeve, të hartohet gjurma e auditimit për nxjerrjen e përgjegjësive administrative para likuidimit të vendimeve, në referim të pikës nr. 62, të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit dhe pikës nr. 38, të Udhëzimit të MB nr.459, datë 16.08.2013 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme”.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 5:	Janë konstatuar mangësi e parregullsi për vlerësimin e skrapit të bërë hyrje pa çmim dhe vlerë dhe që nuk është pasqyruar për rrjedhojë në pasqyrat financiare të GR për v.2017 dhe 2018.
Situata:	Nga shqyrtimi i kartelave dhe relacioneve konstatohet se, ka mangësi e parregullsi për vlerësimin e skrapit të bërë hyrje pa çmim dhe vlerë dhe që nuk është pasqyruar për rrjedhojë në pasqyrat financiare të GR për v.2017 dhe 2018. Referuar shkresave nr. 292 dhe 295 date 9.4.2019 vlerësohet se sipas sektorëve (<i>atij logjistik, te transportit dhe të armatimit</i>) janë gjendje hekur 29,134 kg; alumin 217 kg; plumb 1920 kg, dhe bateri 6995 kg. Krijimi i një nomenklature të tillë të artikujve pa vlerësim kontabël tregon për një proces që nuk është ndjekur në vijimësi sipas kërkesave të vlerësimit të aktiveve, përcaktuar në VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, aktet e tjera të dala nga Ministria e Financave për këtë qëllim si dhe përcaktimet e pikës nr. 19, të UMB me nr. 1151, datë 16.07.2007. Konstatohet se ka vonesa të pajustificuara në kryerjen e proceduarve të ankandit për shitjen e skrapit të përfituar nga asgjësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve (Mjete transporti, etj) , proces i kryer gjatë vitit 2016 dhe përfunduar pjesërisht gjatë vitit 2017.
Kriteri:	-VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, -Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, -Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 226, datë 08.05.2015 “Për përcaktimin e përgjegjësive në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, nxjerrjes nga përdorimi dhe kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësisë shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme”.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Të merren masa në kryerjen e proceduarve të ankandit për shitjen e skrapit të përfituar nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i aktiveve (<i>si mjete transporti, etj</i>), proces i kryer gjatë vitit 2016 dhe përfunduar pjesërisht gjatë vitit 2017 dhe 2018 dhe në vazhdim. Mbeturinat e përfituara nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve të administrohen në llogari të veçantë pasi të vlerësohen me çmimin e tregut. Çmimet të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	përcaktohen me komision të krijuar për çdo rast me urdhër të Komandantit të Gardës së Republikës.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi

Titulli i Gjetjes 6:	Nuk është finalizuar procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2018 në të gjithë komponentët e tij për vitin 2018
Situata:	1. Nuk është finalizuar procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2018 në të gjithë komponentët e tij, pasi rezulton se, me shkresën nr. 4138/1 prot, datë 11.12.2018 të institucionit të GR, i janë dërguar Ministrisë së Brendshme për kompetencë propozimet për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve, që sipas pikës nr. 12/1 të Ministrit të Brendshëm me nr. 226, datë 08.05.2015 “Për përcaktimin e përgjegjësisë në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisionit të inventarizimit, vlerësimit nxjerrjes nga përdorimi si dhe kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësisë shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme”. Në nomenklaturën e aktiveve të propozuara për nxjerrje nga përdorimi bëjnë pjesë dhe 32 automjete, mirëpo edhe pse kanë kaluar mbi 7 (shtatë) muaj, nuk ka asnjë veprim dhe përgjigje nga institucioni epror i MB.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar,
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Të merren masa dhe të ri kërkohet përgjigje dhe veprim mbi shkresën nr. 4138/1 prot, datë 11.12.2018 të institucionit të GR, ku i janë dërguar Ministrisë së Brendshme propozimet për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve, që sipas pikës nr. 12/1 të Ministrit të Brendshëm me nr. 226, datë 08.05.2015, janë kompetencë e kësaj Ministrie.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 7:	Nuk është arkëtuar detyrimi i palës së paditur “...” SH.A, për mos përmbushje të detyrimit kontraktor ndaj GR, duke mos i dorëzuar këtij të fundit sasinë prej 15,180 litra karburant me vleftën prej <u>1,809,938 lekë</u>, për të cilën janë kryer likuidimet nga ana e këtij institucioni, në bazë të kontratës së lidhur me datë 23.06.02009
Situata:	Bazuar në padinë e ngritur nga Garda e Republikës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 4300 datë 22.4.2013 ka vendosur detyrimin e palës së paditur “...” sh.a, për të përmbushur detyrimin kontraktor ndaj GR, duke i dorëzuar këtij të fundit sasinë prej 15,180 litra karburant (nga kjo 9670 litra benzine pa plumb dhe 5510 litra gazoil), me vleftën e përgjithshme <u>1,809,938 lekë</u> .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar,
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Të merren masat nga ana e strukturave menaxheriale të Gardës së Republikës, të rikërkohej pranë Zyrës Përmbarimore Tiranë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë të lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit me nr. 126, datë 28.01.2015, ku është vendosur lënia në fuqi e Vendimit nr. 4300, datë 22.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe për të cilin me Vendimin nr. 1749, datë 23.3.2015, kjo Gjykatë ka lëshuar urdhër ekzekutimi. Gjithashtu, çështja ti bëhet me dije Ministrisë së Drejtësisë me qëllim finalizimin e procedurave dhe veprimeve në zbatim të titujve ekzekutiv të lëshuar nga Gjykata për këtë qëllim.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 10:	Nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit të pasurisë në ZVRPP dhe pasqyrimi në kontabilitet i gjithë sipërfaqeve për trojet, tokat dhe terrenet që Garda e Republikës administron dhe ka në pronësi.
Situata:	1. Nga auditimi i kryer, rezultoi se nga gjithë pronat e mësipërme, janë të regjistruara në ZVRPP, vetëm 4 (katër) prona: -trualli e godinat ne Gardën e Republikës (VKM nr.156, dt 1.3.2017), për Komandën, -trualli e godinat ne Gardën e Republikës (pjesërisht VKM nr.157, dt 1.3.2017), Njësia e Tretë, si dhe - pikat autonome Pogradec dhe Vlorë, ndërsa pronat e tjera janë në proces hipotekimi. Sipërfaqja e përgjithshme e regjistruar shënon 31,083 m² kundrejt 796,383 m² të sipërfaqes së përgjithshme të GR (pa reflektuar VKM nr. 406/2018). 2. Pronat e institucionit GR janë pasqyruar vlerën 338,971,390 lekë, (të tilla sipas regjistrimit kontabël me vlerën e tyre bruto në bilancin kontabël të datës 31.12.2017), mirëpo konstatohet se për zërin “toka troje e terrene” vlera e tyre në kontabilitet është zero lekë. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore për regjistrimin e pasurisë shtetërore, përcaktimet e VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Kështu, vetëm për sipërfaqet e trojeve të pa kontabilizuara dhe që nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare të GR, rezulton se, vetëm për pikat Vlorë dhe Pogradec, për sipërfaqen e truallit prej 9,276 m² kjo vlerë minimalisht duhet të ishte kontabilizuar për <u>52,320,218 lekë</u>. 3. Ndonëse VKM me nr.406, është nxjerrë me datë 04.07.2018 me objekt “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe kalimin në pronësi të Bashkisë së Tiranës të pjesëve takuese të pronës me emërtimin “Garda e Republikës, Garnizon”, me vendndodhje në ZK nr. 8270, me nr., Pasurie 4/134 dhe për një ndryshim në VKM nr. 815, datë 29.11.2007 “Për miratimin e listës shtese te inventarit te pronave te paluajtshme



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	shtetërore, të cila kalojnë në përgjegjësi administrimi MB për GR”, të ndryshuar “, rezulton se VKM nuk ka gjetur zbatim dhe nuk janë kryer procedurat e transferimit dhe dorëzimit zyrtarisht të aktiveve sipas përcaktimeve në këtë VKM. Mosveprimet nga ana e institucionit të Gardës së Republikës lidhen me faktin se ka mosveprime nga ane institucionit të qeverisjes së përgjithshme- Ministrisë së Brendshme, pasi nuk është nxjerrë urdhri i Ministrit të Brendshëm për të procedura sipas VKM-së.
Kriteri:	-VKM nr. 89, datë 3.2.2016, ”Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë -VKM nr.156, datë 01.03.2017 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.1455, datë 21.05.2008 të KM....“ -Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.157, datë 01.03.2017 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.815 datë 29.11.2007 të KM “ -VKM nr.44, datë 25.01.2017 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin nr.250, datë 24.04.2003 të KM, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi MRP”, të ndryshuar “
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	1.Menaxhimi i lartë i institucionit, bazuar në Vendimet e Këshillit të Ministrave për pronat shtetërore që ka në përgjegjësi administrimi Garda e Republikës dhe në dokumentacionin që disponon, të saktësojë dhe kryejë regjistrimin e pronave në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. 2.Të merren masa për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi të institucionit,në referencë të hartës së vlerës së tokave, të miratuar sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016 3.Për sipërfaqet e përfshira në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.406, datë 04.07.2018 të kërkohet nga ana e Ministrisë së Brendshme lëshimi i urdhrit për transferimet e pronave, të procedohet me ngritjen e komisioneve të rregullta dhe pas kryerjes së transferimeve efektet e VKM-së të pasqyrohen në kontabilitetin e institucionit.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 1:	Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për shumën <u>1,896,101 lekë</u> nga vonesat në ekzekutimi i vendimeve gjyqësore / likuidimin e detyrimeve, situatë e shkaktuar si pasojë e mosçeljes së fondeve dhe bërjes së tyre efektive në kohë
Situata:	Nga ana e GR janë kryer detyrimet ligjore që rrjedhin nga zbatimi i : -VKM nr. 22, date 18.01.2017 „Për një shtese fondi në buxhetin e vitit 2017 për MPB nga fondi rezerve i BSH për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011” si dhe - VKM nr. 743, datë 13 dhjetor 2017 ”Për një ndryshim në VKM nr. 22, datë 18.01.2017 „Për një shtese fondi në buxhetin e vitit 2017 për MPB nga fondi rezerve i BSH për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011”. Është paguar shuma prej <u>1,896,101 lekë</u> si një detyrim shtesë nga ana e shoqërisë përmbarimore „... Group”, pasojë e shpenzimeve të pa



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	likuiduara nga mosçelja e fondeve dhe bërja e tyre efektive në kohë . Kjo pagesë përbën një shpenzim pa efektivitet për fondet e buxhetit të shtetit, e lidhur me veprimet dhe mosveprimet e strukturave përgjegjëse, me vonesën në hartimin dhe miratimin e projekt vendimit për KM si dhe faktit se fondet janë bërë efektive më 27 dhjetor 2017, dhe po këtë datë janë prokurat e familjarëve (shiko shkresa nr. 2594/2 date 7/6/2018 e GR për MB).
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar .
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Institucioni i Gardës së Republikës të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumatat e shpenzuara sa më lartë për ekzekutimin vendimeve gjyqësore, si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit dhe të mos lejojë kryerjen e pagesave të kësaj kategorie pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdimësi

Titulli i Gjetjes 2:	<i>Nuk është përlogaritur dhe arkëtuar vlera e detyrimit prej 46,802 lekë, që përbën detyrim për arkëtim nga subjekti privat “.....” shpk.</i>
Situata:	Nuk ka gjetur zbatim të plotë kontrata e lidhur midis palëve, me objekt “Blerje artikuj të ndryshëm për marrëdhëniet me publikun” pasi AK është furnizuar me 41 artikuj, nga 54 artikuj sipas Dokumenteve Standarde dhe Aneksit të Kontratës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 1, pika 2, të Kontratës me nr.25, date 13.6.2018 të lidhur midis AK. Si përfundim nuk janë furnizuar sipas FD nr. 1121, date 01.10.2018 gjithsej 13 artikuj me vlerë <u>265,920 lekë</u> brenda afatit 150 ditë. Në këto kushte AK, bazuar në nenin 14 të Kontratës, duhet të kishte ndërprerë kontratën meqenëse operatori ekonomik ka dështuar në furnizimin me mallra brenda afatit të përcaktuar dhe rënë dakord dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 4 të Kontratës, duhet të ishte llogaritur dëmi për dorëzimin e vonuar në masën 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës”. Rezulton se, nga data 09.11.2018 deri më datën 24.12.2018: vlera e pa furnizuar 265,920 x 44 ditë (nga data 9/11/2018 - 24.12.2018) x 4/1000= 46,802 lekë, që përbën detyrim për arkëtim nga subjekti privat “Sakuli” shpk.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Rëndësia	I Lartë
Rekomandimi	Institucioni i Gardës së Republikës të analizojë dhe vendosë në kushtet e arkëtimit shumën 46,802 lekë, si dëm për dorëzimin e vonuar të mallrave në masën 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, që përbën detyrim për arkëtim nga subjekti privat “...” Sh.p.k për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me përcaktimet e nenit 1, pika 2, të Kontratës me nr.25, datë 13.6.2018 të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe këtij operatori ekonomik.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Brenda 60 ditëve

4. Auditimi i llogarive vjetore të institucionit (Pasqyrat financiare).

Nga auditimi u konstatua se:

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Pasqyrat financiare për vitin 2018 janë hartuar dhe depozituar me shkresën nr. 15/2, datë 28.02.2018 brenda afatit ligjor.

Pasqyrat financiare kanë të plotësuar; pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare ose pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; pasqyrën e flukseve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. Pasqyrat financiare vjetore janë shoqëruar me pasqyrat statistikore, si pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto dhe pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës dhe të ndryshme.

Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhornuar, si dhe i llogarive inventarjale të magazinës dhe është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Titulli i Gjetjes 1:	Mos përfshirja në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ)
Situata:	Mbajtja e evidencës kontabël me programin Financa 5. Mos përfshirja në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) ku mund të mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit; të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike; të dhëna për raporte financiare dhe statistika; etj. Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të IT. (p.sh. Ndryshohen fjalëkalimet rregullisht, fireëall-et, hyrje e kufizuar në të dhënat IT, etj.). Sistemi i IT, mbulohet tërësisht nga struktura e brendshme, Sektori i Komunikimit dhe Elektronikës në vartësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Brenda Gardës së Republikës nuk ka një sistem rezervë (back-up) IT të përshtatshëm, plan rekuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë.
Kriteri:	Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Ndikimi/Efekti	Mos përfshirja në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) pa mundëson mbajtjen e të dhënave të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit; në përputhje me bazën ligjore për financat publike për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.
Rëndësia	I ulët
Rekomandimi	Nga Garda e Republikës në kuadër të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masat për identifikimin dhe analizën e risqeve të mundshme, për arritjen e objektivave dhe përcaktimin e mënyrave se si ky rrezik mund të shmangët ose të minimizohet, duke pasqyruar, angazhimin e drejtpërdrejtë në evidentimin, regjistrimin, shqyrtimin, përgatitjen dhe raportimin e masave të programuara për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive
Afati për zbatimin e rekomandimit:	Menjëherë dhe në vijimësi

Auditimi i aktiveve afatgjata:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve afatgjata; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

Nëse aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre. Lidhur me këto aktive, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nëse kanë analizuar e rakorduar investimet e tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e ndërmarrjeve të tjera (publike ose jopublike). Për këtë qëllim, nga njësia a janë saktësuar regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar.

b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve afatgjata, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata;

U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas koston së tyre të prodhimit.
- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- *Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;*
- *Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);*
- *Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.*

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2018 rezultoi:

Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata materiale” në vlerën 711,209 mijë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
47	21,23,24,28	2. Aktivet afatgjata materiale	710,158,714	533,758,917
48	210	Toka, troje, terrene		
49	211	Pyje, plantacione		
50	212	Ndërtesa e konstruksione	283,894,337	284,806,744
51	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,035,870	1,132,938
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	159,046,892	42,921,313
53	215	Mjete transporti	254,350,260	182,138,380
54	216	Rezerva shtetërore	0	0
55	217	Kafshë pune e prodhimi	245,383	253,732
56	218	Inventar ekonomik	11,585,972	22,505,810
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara		
58	28	Caktime të aktiveve afatgjata		
59	25-26	3. Aktive afatgjata financiare	0	0
60	25	Huadhënie e nën-huadhënie		
61	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		

Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) për vlerën 283,894 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Rrugë, rrjete, vepra ujore” (llog. 213) për vlerën 1,036 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike i cili përbehet nga 7 objekte dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” (llog. 214) për vlerën 159,047 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Mjete transporti” (llog. 215) është për vlerën 254,350 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Kafshë pune e prodhimi” (llog. 217) për vlerën 245 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe përbehet nga 5 qen shërbimi i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218) për vlerën 11,586 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Titulli i gjetjes 2:	Mosparaqitja në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale; “studime dhe kërkime”.
Situata1:	<u>Në analizë aktivet (neto):</u> Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata jo materiale” në vlerën 1,050 mijë janë të pasqyruara në llog. 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 1,050 mijë lekë ndarë sipas zërave më poshtë: - Projekt për komandën e gardës, viti 2011, në vlerën 2,411,400 lekë. (Ka mbaruar investimi) - Azhurnim dhe rilevim plan vendosje, viti 2015, në vlerën 466,800 lekë. (Ka mbaruar investimi) - Projekt rikonstruksioni Garda dhe Qendra e përgatitjes Mullet, viti



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	2015, në vlerën 2,777,777 lekë. Për dy nga aktivet e mësipërme: - Projekt për komandën e gardës, viti 2011, në vlerën 2,411,400 lekë. - Azhurnim dhe rilevim plan vendosje, viti 2015, në vlerën 466,800 lekë. Rezulton se investimi për të cilat janë hartuar projekti dhe plan vendosja në vlerën 2,878,200 lekë ka përfunduar si rezultat duhej që vlerës së investimit ti shtohet dhe vlera e projektit (2,411,400 lekë) dhe rilevimit të plan vendosjes (466,800 lekë). Për sa më lart vlera e aktiveve afatgjata “Ndërtim e konstruksione” duhet të rritet me vlerën 2,878,200 lekë.
Kriteri:	Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje
Rëndësia	I ulët
Rekomandime	Nga Garda e Republikës, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e aktiveve afatgjata jomateriale “studime dhe kërkime”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale; Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të Gardës së Republikës-së, për vitin 2019.

- Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata:

Në pasqyrën anekse statistikore formati 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” kolona 2 “blerje e krijuar me pagesë” për vlerën 221,826 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve afatgjata, “Ndërtim e konstruksione” në vlerën 8,709 mijë lekë, “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 99,521 mijë lekë, “Mjete transporti” në vlerën 113,596 mijë lekë,

Në kolonën 3 “shtesa pa pagesa jashtë sistemit” për vlerën 22,856 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve, “Ndërtim e konstruksione” në vlerën 8,709 mijë lekë, “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 99,521 mijë lekë, “Mjete transporti” në vlerën 113,596 mijë lekë.

Në kolonën 4 “shtesa pa pagesa brenda sistemit” për vlerën 541 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve, “Kafshë pune e prodhimi” në vlerën 60 mijë lekë, “Inventar ekonomik” në vlerën 481 mijë lekë.

Formati 7/a, kolona 8 pakësime gjatë vitit ushtrimor “shitje” janë pasqyruar pakësime të aktiveve, “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 16,323 mijë lekë, “Inventar ekonomik” në vlerën 13,791 mijë lekë.

Formati 7/a, kolona 7 pakësime gjatë vitit ushtrimor “Nxjerrje jashtë përdorimit” janë pasqyruar pakësime të aktiveve:

a. “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 1,005,583.03 lekë sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Ilogaria	Emërtimi	Çmimi	sasia	Vlera
1	2140110	Fibër optike 12 SM me shtyllëzim metalik	2,100	250	525,000
2	2140290	Kuti drite 29283.03 (prozhektor)	29283.03	1	29,283
3	2140320	Lente 14 mm 2.8	72,000	1	72,000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

4	2140110	Shtylla metalike	9,700	37	358,900
5	2140320	Pompë uji	20,400	1	20,400
		shuma			1,005,583.03

Aktivitetet e mësipërme janë nxjerrë jashtë përdorimit me fletëdaljet dhe procesverbalet përkatëse si më poshtë:

- 1- *“Fibër optike 12 SM me shtyllëzim metalik”* për vlerën 525,000 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit me Fletë daljen nr. 74, dt. 31.10.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 31.10.2018 në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës nga komisioni i përbërë nga Kapter, Kapter Mjeshtër, Rreshtere dhe N/kolonel, shefi i Sektorit të Komunikimit dhe Elektronikës i pa miratuar nga Komandanti i Gardës..
- 2- *“Kuti drite 29283.03 (prozhektor)”* për vlerën 29,283 lekë, është nxjerrë jashtë përdorimit me Fletë daljen nr. 24, dt. 30.03.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 30.03.2018 në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës nga komisioni i përbërë nga Kapter, togër, Rreshtere dhe N/kolonel, shefi i Sektorit të Komunikimit dhe Elektronikës i pa miratuar nga Komandanti i Gardës..
- 3- *“Lente 14 mm 2.8”* për vlerën 72,000 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit me Fletë daljen nr. 02, dt. 09.02.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 09.02.2018 në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun nga komisioni i përbërë nga Major, Togere, Rreshter i pa miratuar nga Komandanti i Gardës..
- 4- *“Shtylla metalike”* për vlerën 358,900 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit të materialeve me Fletë daljen nr. 49, dt. 27.11.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 27.11.2018 për riparimin e mirëmbajtjes së infrastrukturës të kryera në ambientet e Komandës së gardës gjatë muajit nëntor 2018 nga komisioni i përbërë nga kapiteni i IV,, Kapiten IV, etj dhe Major i pa miratuar nga Komandanti i Gardës.
- 5- *“Pompë uji”* për vlerën 20,400 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit me Procesverbalin nr. 4195/4, datës 17.12.2018 mbi nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të shërbimeve të OKV-së Dajt, Linzë miratuar nga komandanti i gardës.

Për sa më lart rezultojnë se janë nxjerrë jashtë përdorimit *“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”* në vlerën 1,005,583 lekë nga të cilat 4 zëra në vlerën 985,183 lekë janë të pa miratuara nga titullari Komandanti Gardës së Republikës. Materialet e mësipërme duhej të kalonin si shpenzime gjatë kohës kur janë përdorur dhe në rastin konkret duhej të konsideroheshin si diferenca inventari dhe më tej të procedohej nga titullari nëse do të kalonin në shpenzime ose do të konsideroheshin si mungesa inventari.

b. *“Inventar ekonomik”* në vlerën 66,360 lekë sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Ilogaria	Emërtimi	Çmimi	sasia	Vlera
1	2187100	Pllaka dysHEMEJE	1,440	20.5 m ²	29,520
2	2181100	Trofe MIXGD 06 (2520)	2,520	3 copë	7,560
3	2181100	Karrige druri me llustër.	1,680	2 copë	3,360
4	2187100	Makinë shkrimi	8,000	1 copë	8,000
5	2181100	Kolltukë tek (Damasku) me krahë.	6,760	2 copë	13,520
6	2181100	Karrige kashte	1,100	4 copë	4,400
		Shuma			66,360

Aktivitetet e mësipërme janë nxjerrë jashtë përdorimit me fletëdaljet dhe procesverbalet përkatëse si më poshtë:

- 1- *“Pllaka dysHEMEJE”* për vlerën 29,520 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit me Fletë daljen nr. 6, dt. 30.03.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 30.03.2018 në Departamentin e Përgatitjes dhe Kualifikimit nga komisioni i përbërë nga Kapiten, Kapte IV,, Kapter III-të, Major i pa miratuar nga Komandanti i Gardës.
- 2- *“Trofe MIXGD 06 (2520)”* për vlerën 7,560 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit me Fletë daljen nr. 5, dt. 01.06.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 01.06.2018 në Zyrën e Marrëdhënieve me publikun nga komisioni i përbërë nga Major i pa miratuar nga Komandanti i Gardës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- 3- “Karrige druri me lustër”, në vlerën 3,360 lekë, “Makinë shkrimi”, në vlerën 8,000 lekë, “Kolltukë tek (Damasku) me krahë”, në vlerën 13,520 lekë, “Karrige kashte” në vlerën 4,400 lekë janë nxjerrë jashtë përdorimit me Procesverbalin nr. 4195/4, datës 17.12.2018 mbi nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të shërbimeve të OKV-së Dajt, Linzë miratuar nga komandanti i gardës.

Për sa më lart rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimit “*Inventar ekonomik*” në vlerën 66,360 lekë nga të cilat 2 zëra në vlerën 37,080 lekë janë të pa miratuara nga titullari Komandanti Gardës së Republikë.

c. Aktive të shkarkuara me fletë dalje sipas procesverbaleve të mbajtura nga komisionet në vlerën 2,627,840.4 lekë si më poshtë:

1- Me Fletë daljen nr. 74, dt. 31.10.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 31.10.2018 janë shkarkuar aktive në vlerë 718,917 lekë në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës nga komisioni i përbërë nga Kapter, Kapter Mjeshtër, Rreshtere dhe N/kolonel, shefi i Sektorit të Komunikimit dhe Elektronikës i pa miratuar nga Komandanti i Gardës.

2- Me Fletë daljen nr. 24, dt. 30.03.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 30.03.2018 janë shkarkuar aktive në vlerën 37,283 lekë në Sektorin e Komunikimit dhe Elektronikës nga komisioni i përbërë nga Kapter, toger, Rreshtere dhe N/kolonel, shefi i Sektorit të Komunikimit dhe Elektronikës i pa miratuar nga Komandanti i Gardës..

3- Me Fletë daljen nr. 02, dt. 09.02.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 09.02.2018 janë shkarkuar aktive në vlerën 115,924.80 lekë në Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun nga komisioni i përbërë nga Major ..., Togere, Rreshter i pa miratuar nga Komandanti i Gardës..

4- Me Fletë daljen nr. 49, dt. 27.11.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 27.11.2018 janë shkarkuar aktive në vlerën 1,513,439.20 lekë për riparimin e mirëmbajtjes së infrastrukturës të kryera në ambientet e Komandës së gardës gjatë muajit nëntor 2018 nga komisioni i përbërë nga kapiten i IV,, Kapiten IV, etj dhe Major i pa miratuar nga Komandanti i Gardës.

5- Me Fletë daljen nr. 6, dt. 30.03.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 30.03.2018 janë shkarkuar aktive në vlerën 154,771.20 lekë në Departamentin e Përgatitjes dhe Kualifikimit nga komisioni i përbërë nga Kapiten, Kaptere IV,, Kapter III-të, Major i pa miratuar nga Komandanti i Gardës.

6- Me Fletë daljen nr. 5, dt. 01.06.2018, bashkëngjitur Procesverbalin e datës 01.06.2018 janë shkarkuar aktive në vlerën 87,505.20 lekë në Zyrën e Marrëdhënieve me publikun nga komisioni i përbërë nga Major i pa miratuar nga Komandanti i Gardës.

Titulli i gjetjes 3:	Mosparaqitja në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata
Situata1:	Janë nxjerrë jashtë përdorimit “<i>Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune</i>” në vlerën 1,005,583 lekë nga të cilat 4 zëra në vlerën 985,183 lekë janë të pa miratuara nga titullari Komandanti Gardës së Republikë. -Janë nxjerrë jashtë përdorimit “<i>Inventar ekonomik</i>” në vlerën 66,360 lekë nga të cilat 2 zëra në vlerën 37,080 lekë janë të pa miratuara nga titullari Komandanti Gardës së Republikës. - Janë shkarkuar nga magazina aktive me 6 fletë dalje sipas procesverbaleve të mbajtura nga komisionet në vlerën 2,627,840.40 lekë pa miratuar nga Titullari, Komandanti i Gardës
Situata 2	Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e Komandantit të Gardës nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme drejtuesit. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	të aktivitetit, apo mallrave e materialeve.
Kriteri:	Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe inventarizimi në përputhje me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 38. “Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve”, pika 39. “Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë.....”.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje dhe inventari nuk është kryer në përputhje me UMF nr. 30, dt. 27.12.2019.
Rëndësia	I mesëm.
Rekomandime	Nga Titullari i Gardës së Republikës, Sektori i Financës të merren masat për shqyrtimin e procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimit të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe shkarkimit të aktiveve të shpenzuara në periudhat e mëparshme të cilat duhej të kalonin si shpenzime për periudhën kur janë përdorur. Në rastin konkret duhej të konsiderohen si diferenca inventari dhe më tej të procedohet nga titullari nëse do të kalojnë në shpenzime ushtrimi ose do të konsiderohen si mungesa inventari. - Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. - Në rast miratimi, nga sektori i financës, të bëhet reflektimi, në pasqyrat financiare të periudhës raportuese të vlerës së aktiveve afatgjata materiale të vlerësuar për dalje jashtë përdorimit dhe/ose asgjësimin e tyre nga komisionet përkatëse si ngjarje të ndodhura në periudhën e raportimit financiar si një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese.

Komente dhe shpjegime:

Për sa konstatuar më sipër subjekti i audituar Garda e Republikës me shkresën nr. 340/4 dt. 02.09.2019 ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin, konkretisht:

Gjetje Nr.4, Në pasqyrat financiare Formatit 7/a, kolona 7 pakësime gjatë vitit ushtrimor “Nxjerrjen jashtë përdorimit” janë pasqyruar pakësime të aktiveve:

- a. “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune”, të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit me fletë daljet dhe procesverbalet përkatëse pa u miratuar nga titullari Gardës, si më poshtë;
- “Shtylla metalike” për vlerën 358,900 lekë, është nxjerrë jashtë përdorimit të materialeve me Fletë daljen nr.49, datë 27.11.2018, bashkëngjitur procesverbalin e datës 27.11.2018 për riparimin e mirëmbajtjen e Infrastrukturës të kryera në ambientet e Komandës së Gardës gjatë muajit nëntor 2018 nga komisioni i përbërë nga Kapter i Katërt, Kapter i Katërt, etj dhe Major i pa miratuar nga Komandanti i Gardës.
- b. “Inventar ekonomik” janë nxjerrë jashtë përdorimit me fletë daljet dhe procesverbalet përkatëse pa u miratuar nga titullari Gardës si më poshtë;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- *“Pllaka dysHEMEJE” për vlerën 29,520 lekë është nxjerrë jashtë përdorimit të materialeve me Fletë daljen nr.6, datë 30.03.2018, bashkëngjitur procesverbalin e datës 30.03.2018 në Departamentin e Përgatitjes dhe Kualifikimit, nga komisioni i përbërë nga Kapiten ..., Kapter e Katërt ..., Kapter i Tretë ..., Major i pa miratuar nga Komandanti i Gardës, sqarojmë:*

Aktivet e mësipërme të shkarkuara me procesverbal, nuk janë dhe nuk mund të konsiderohen mungesa inventari, pasi ato janë materiale të siguruara më parë, të bëra hyrje dhe të magazinuara, ose pas një procedure prokurimi ose të përfutuara nga një praktikë tjetër mbi bazën e së cilës janë bërë hyrje në magazinë.

Në rastin konkret shtyllat metalike (profile), janë marrë hyrje nga Sektori i Komunikimit dhe Elektronikës, dhe pasi janë vlerësuar nga grupi i punës, specialistë punonjës civilë të shërbimit të infrastrukturës, si materiale të përshtatshme dhe të nevojshme për t’u përdorur për ndërtimin e skeletit metalik të Oficinës së Mjeteve në Komandën e Gardës, janë preventivuar nga Tekniku i Ndërtimit, dhe pas matjeve në vend për çdo rast dhe material të përdorur, janë situacionuar dhe shkarkuar, me të njëjtën procedurë si gjithë materialet e tjera ndërtimore që përdoren për kryerjen e punimeve të riparimit, meremetimit e mirëmbajtjes së gjithë infrastrukturës së Gardës.

Sqarojmë se për të gjitha rastet e përdorimit dhe shkarkimit të materialeve në punime të ndryshme të kryera në strukturat e Gardës, procedohet mbi bazën e kërkesës së bërë nga struktura përkatëse për nevojat që ka për kryerjen e punimeve në ambientet e brendshme apo të jashtme të saj. Në kërkesë kryesisht specifikohen zërat e punimeve që vetë struktura mendon se duhet të kryhen. Pas kësaj grupi i punës i përbërë nga Specialisti i Infrastrukturës, Teknikja e Ndërtimit dhe Përgjegjësi i punëtorisë, bën verifikimin në vend dhe harton procesverbalin e konstatimit të defektit apo nevojës për punime të ndryshme që duhet të kryhen në strukturën që ka paraqitur kërkesën. Mbi këtë bazë Teknikja e Ndërtimit bën zërtimin e volumeve dhe harton preventivin e materialeve që nevojiten për kryerjen e punimeve. Referuar preventivit, nga Specialisti i Infrastrukturës lëshohet urdhërdorëzimi (i cili siglohet dhe nga Shefi i Sektorit) për magazinierin, i cili bën furnizimin e strukturës ku do kryhen punimet, me materialet e preventivuara, pret fletë daljen në të cilën nëshkruan përgjegjësi material i strukturës ku do kryhen punimet. Kjo bazë materiale vendoset në objekt, pra punimet kryhen nga specialistët përkatës sipas llojit të punës së kryer, si hidraulik, elektrikist, saldator, murator, bojaxhi etj. Për materialet e harxhuara gjatë kryerjes dhe realizimit të punimeve, mbahet procesverbali përkatës i cili nëshkruhet nga punëtorët që kanë kryer punimet, Përgjegjësi i Puntorisë, Teknikja e Ndërtimit, Specialisti i Infrastrukturës dhe Përgjegjësi Material i strukturës ku kryhen punimet, ose Përgjegjësi Material i Seksionit Ekonomik, kur punimet kryhen në ambientet e komandës e shtabit. Për zërat e punimeve të kryera, hartohet situacioni, i cili nëshkruhet nga Përgjegjësi i Puntorisë, Teknikja e Ndërtimit, Specialisti i Infrastrukturës, Shefi i Sektorit Logjistik, drejtuesi ose zv/drejtuesi i strukturës ku kryhen punimet, Drejtori ose Zv/Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse. Gjithë ky dokumentacion i bashkëlidhet fletë-daljes që pritet për shkarkimin e materialeve të përdorura për kryerjen e punimeve në infrastrukturë.

Kjo bazë materiale ndërtimore që sigurohet e përdoret posaçërisht për kryerjen e punimeve të ndryshme dhe mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore dhe infrastrukturën në tërësi, nuk është konsideruar si aktive materiale afatgjatë, ndaj dhe gjithnjë është ndjekur kjo praktikë administrimi e tyre dhe jo si praktika e nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve afatgjatë, sipas përcaktimve të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr.226, datë 8.5.2015 “Për përcaktimin e përgjegjësisë në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisioneve të inventarizimit, vlersimit, nxjerrjes jashtë përdorimit si dhe të kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësive shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar për projekt raportin me shkresën nr. 340/4 dt. 02.09.2019 grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë komentet dhe shpjegimet e dhëna mbasi:

Nga auditimi rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimit “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 1,005,583 lekë nga të cilat 4 zëra në vlerën 985,183 lekë janë të pa miratuara nga titullari Komandanti Gardës së Republikës. Materialet e mësipërme duhej të kalonin si shpenzime gjatë kohës kur janë përdorur dhe në rastin konkret duhej të konsideroheshin si diferenca inventari dhe më tej të procedohej nga titullari nëse do të kalonin në shpenzime ose do të konsideroheshin si mungesa inventari.

Gjithashtu rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimit “Inventar ekonomik” në vlerën 66,360 lekë nga të cilat 2 zëra në vlerën 37,080 lekë janë të pa miratuara nga titullari Komandanti Gardës së Republikës.

Gjykojmë se Pasqyrat financiare nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje dhe inventari nuk është kryer në përputhje me UMF nr. 30, dt. 27.12.2019.

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit duhet të jetë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe inventarizimi në përputhje me UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 38. “Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve”, pika 39. “Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë.....”.

Gjithashtu të merren masat për shqyrtimin e procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimit të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe shkarkimit të aktiveve të shpenzuara në periudhat e mëparshme të cilat duhej të kalonin si shpenzime për periudhën kur janë përdorur. Në rastin konkret duhej të konsiderohen si diferenca inventari dhe më tej të procedohet nga titullari nëse do të kalojnë në shpenzime ushtrimi ose do të konsiderohen si mungesa inventari.

- Në rast miratimi, nga sektori i financës, të bëhet reflektimi, në pasqyrat financiare të periudhës raportuese të vlerës së aktiveve afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit dhe/ose asgjësimin e tyre nga komisionet përkatëse si ngjarje të ndodhura në periudhën e raportimit financiar si një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese.

Në kolonën 9 pakësime gjatë vitit ushtrimor “Pakësime të tjera” janë pasqyruar pakësime të aktiveve, “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 3,033 mijë lekë, “Mjete transporti” në vlerën 64,481 mijë lekë, “Kafshë pune e prodhimi” në vlerën 60 mijë lekë, “Inventar ekonomik” në vlerën 34 mijë lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 20) në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike” kolona 11 “Gjendja në mbyllje të ushtrimit” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), kolona 8 “Kosto historike” 5,655,977 lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike” kolona 11 “Gjendja në mbyllje të ushtrimit” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kolona 8 “Kosto historike” 1,286,950,240 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 20) në formatin nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” kolona 10 “Teprica neto” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Ushtrimi i mbyllur” llogaria 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 1,050 mijë lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” kolona 10 “Teprica neto” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Ushtrimi i mbyllur” llogaria 20 “Aktive afatgjata materiale”, 710,159 mijë lekë.

Pasqyra krahasuese e pozicionit financiar me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata:

Në lekë

Llog.	Emërtimi	Ushtrimi paraardhës	Ushtrimi mbyllur	Formati 7/b, (Gjendja dhe ndryshimet)	Diferenca (4-5)
1	2	3	4	5	6
201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave	0	0	0	
202	Studime dhe kërkime	1,898,619	1,050,222	1,050,222	
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme	0	0	0	
210	Toka, Troje, Terrene	0	0	0	
211	Pyje, Plantacione	0	0	0	
212	Ndërtesa e Konstruksione	284,806,744	283,894,337	283,894,337	
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,132,938	1,035,870	1,035,870	
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	42,921,313	159,046,892	159,046,892	
215	Mjete Transporti	182,138,380	254,350,260	254,350,260	
216	Rezerva Shtetërore	0	0	0	
217	Kafshë pune e prodhimi	253,732	245,383	245,383	
218	Inventar ekonomik	22,505,810	11,585,972	11,585,972	
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0	
28	Caktime të Aktiveve Afatgjata	0	0	0	
	TOTALI	535,657,539	711,208,940	711,208,941	

Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata mbi të cilat është aplikuar përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi (Pasqyra anekse statistikore Formatit 7/b) është e barabartë me:

- Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore; (vlera 535,657,536 lekë). Amortizimi i akumuluar 610,520,985 lekë.
- Shtesën e kostos së blerjes dhe kostos së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; (vlera 245,222,662 lekë). Amortizimi i llogaritur 40,408,318 lekë, si dhe
- Zbritjen e vlerës kontabël neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit apo të humbura për kategorinë përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore. (vlera 98,794,966 lekë). Amortizimi i llogaritur 69,532,022 lekë.

Amortizimi i vitit 2018 është (69,532,022 – 40,408,318 = 29,123,704 lekë).

Amortizimi i aktiveve afatgjata është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përpunje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

36. Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.

Nga auditimi i kartelës së llogarisë 209 “Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale”; dhe 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale”, (formati nr. 1) dhe pasqyrës statistikore formati 7, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë:

Llog. nr. 202 “Amortizim, studime dhe kërkime” = 848,397 lekë.

Llog. nr. 212 “Amortizim ndërtime dhe konstruksione” = 14,941,807 lekë.

Llog. nr. 213 “Amortizim Rruge, Ura, Rrjete, Rezervuare” = 34,520 lekë,

Llog. nr. 214 “Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” = (16,421,568) lekë,

Llog. nr. 215 “Amortizim Mjete transporti” = (18,589,194) lekë,

Llog. nr. 217 “Amortizim Kafshe pune e prodhimi” = 4,935

Llog. nr. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” = (9,962,601) lekë.

Aktivet afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues, llog. 31, zëri “Materiale” në shumën prej 127,554 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

Aktivet afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues llog. 32, zëri “Inventari i imët” në shumën prej 52,300 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

“Llogari të arkëtueshme” (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formatin nr. 1 për vlerën 146,075 mijë lekë detyrime ku:

- “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” (llog. 423,429) zënë shumën **30,233** mijë lekë,

Në analizë përbëhet nga 251 persona “debitorë pa shpresë arkëtimi” për detyrimin në vlerën 21,270,217 lekë debitorë të cilët datojnë që nga viti 1997. Vlera tjetër prej 7,706,825 lekë ju përket 5 personave të cilët janë evidentuar si debitorë nga KLSH. Me vendim të gjykatës së apelit këta punonjës e fituan çështjen por gjykata e lartë e ktheu çështjen për rigjykim në shkallën e parë. Vlera prej 446,820 lekë përbëhet nga 7 punonjës të cilët janë debitorë si rezultat i dëmtimit të materialeve armatimit etj. Vlera prej 809,255 lekë përbëhet nga detyrimi i 23 personave debitorë për paradhënie, debitorë pagash si rezultat i gradave të dhëna dhe urdhër zhdëmtime të ndryshme.

- “Debitorë të ndryshëm” (llog. 468) në vlerën 1,896 mijë lekë përbëhen në analizë nga 6 persona debitorë për llogari të tretëve (zyrat përmbarimore).

Llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” zënë shumën 113,945 mijë e cila në pasiv në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2018 si “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) për 4,104 mijë lekë, “Detyrime ndaj personelit” (llog. 421-423) për 71,607 mijë lekë, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” (llog. 431) për 4,119 mijë lekë, për “sigurime shoqërore” (llog. 435) në vleftën 27,883 mijë, “sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vleftën 3,232 mijë. (Diferenca 3,000,000 lekë)

Shuma 113,945 mijë lekë korrespondon me llogarinë 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti” në Formatin nr. 2, “Pasqyra e performancës financiare”.

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
66	Klasa 4	I. Pasivet afatshkurtra	145,646,491	159,578,760
67		1. Llogari të pagueshme		
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	4,104,209	4,894,310
69	42	Detyrime ndaj personelit	71,606,887	78,087,027
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	4,119,310	7,046,625
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	27,882,959	27,487,261
76	436	Sigurime Shëndetësore	3,231,795	3,184,231
77	437,438,	Organizma të tjerë shtetërorë		
78	44	Institucione të tjera publike		
79	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike		
80	464	Det. për tu paguar për bl. letrave me vlere		
81	466	Kreditorë për mjete në ruajtje	2,480,264	2,052,446
82	467	Kreditorë të ndryshëm	91,402	74,521

Titulli i gjetjes 4:	Mosparaqitja në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të Llog. 4342 “Të tjera operatione me shtetin (debitor)”, llog. 520 “Disponibilitete në thesar” llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”
Situata 1:	Shqyrtimi i llogarive të pagueshme “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) në vlerën 4,104,209 mijë lekë ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, kontrolluam rregullaritetin e operationeve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohemi se këto operatione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operationeve. E detajuar kjo llogari rezulton se përbëhet nga 35 fatura furnitorësh likuiduar gjatë muajit janar të vitit 2019 me fondet e buxhetit 2018 në vlerën 4,892,979 lekë e cila nuk përputhet me vlerën sintetike të llogarisë “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408). E detajuar llog. 42 “Detyrime ndaj personelit” është në vlerën 70,818,117 lekë për paga e tjera detyrime ndaj personelit likuiduar gjatë muajit janar të vitit 2019 me fondet e buxhetit 2018 e cila nuk përputhet me vlerën sintetike të llogarisë. E detajuar llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” është në vlerën 38,234,064 lekë për tatim taksa, sigurime shoqërore, sigurime shëndetësore likuiduar gjatë muajit janar të vitit 2019 me fondet e buxhetit 2018 e cila nuk përputhet me vlerën sintetike të llogarisë.
Situata 2:	Nga auditimi rezultoi se subjekti nuk i ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operationeve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër
Situata 3:	Në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 2,480,264 lekë të cila si fonde të mbetura pa përdorur që trashëgohen për vitin 2019 në pasivin e bilancit është paraqitur në llogaritë. (Llog. 466, në pasiv prej 2,480,264 lekë). Teprica e Llogarisë se likuiditeve në fund të vitit ushtrimor në Formatin nr. 3 “Pasqyra e flukseve monetare (Cash floë) është e barabartë me tepricën e llogarive të Likuiditeve në Formatin nr. 1, “Pasqyrën e pozicionit financiar” në vlerën 2,480,264 lekë. Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat nuk janë paraqitur dhe strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet
Situata 4:	Në pasqyrën e performancës financiare Formatin 2, “Shpenzime të tjera”, Llog. Nr. 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” paraqitet



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	në vlerën 14,926,139 lekë. Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës së mësipërme, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, <u>që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës.</u> Ndërsa, si tepricë debitore, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese. Në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësohej pozicioni i çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizohej transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” të vitit 2017 prej 3,819,815 në llogarinë 12, “Rezultatet e mbartura”.
Kriteri:	Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe pjesërisht nuk paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje
Rëndësia	I mesëm
Rekomandime	Nga Sektori i Financës të merren për saktësimin e detyrimeve afatshkurtra si detyrime, likuidimi i të cilave duhet të bëhet brenda një viti ose një cikli operativ (ekonomik) duke përdorur aktivet e veta afatshkurtra ose duke krijuar detyrime të tjera afatshkurtra. - Të kryhen veprimet përkatëse rregulluese kontabël në llogaritë kreditore për detyrimet ndaj furnitorëve, ndaj personelit e të ngjashme, ndaj sigurimeve shoqërore e të ngjashme, ndaj tatimeve e të tjera në vijimësi dhe pasqyrim i tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të Gardës së Republikës-së, për vitin 2019. - Drejtuesit e Gardës së Republikës, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të konfirmojnë (Rakordojnë) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve. - Të përcaktojnë rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigoroze mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen. - Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	<i>ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).</i> - Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” duhet të përfaqësojë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, <u>që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës</u> dhe si tepricë debitore, kjo llogari duhet të përfaqësojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese. - Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” nga viti i mëparshëm në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare. - Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore me informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve. Shënimet të japin përshkrime me fjalë apo zërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
Afati i zbatimit:	Menjeherë dhe ën vijimësi

Llog. (4341) “Të tjera operatione me shtetin (detyrime)” zënë shumën 32,130 mijë e cila përbëhet nga shumat e debitorëve e pa arkëtuar prej shumë vitesh në gardën e republikës (Shiko në aktivet llogarinë 423–429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” për vlerën 30,233 mijë lekë dhe llogarinë nr. 468 “debitorë të ndryshëm” në vlerën 1,896 mijë lekë).

Në llog. (467) “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 91 mijë lekë përbëhet nga 6 kreditorë të tjerë (Kryesisht zyra përmbartimore).

Në pasqyrën e pozicionit financiar C. “aktivet neto” janë të barabarta me D. “fondin e konsoliduar” në vlerën 893,971,022 lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivitetit 1,039,617,513 mijë lekë dhe B “detyrimet” të pasivit në vlerën 145,646,491 mijë lekë.

Formati 4 “pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”, totali i fondeve korrespondon me totalin e fondeve në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” në vlerën 893,971,022 lekë.

Si e theksuam edhe më sipër në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Fondi i konsoliduar” nuk është pasqyruar llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 3,819,815 lekë po kështu edhe në Formatin 4 “pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”, nuk është pasqyruar vlera e llog. 12 “Rezultatet e mbartura” në vlerën 3,819,815 lekë dhe vlera e llog. 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” për 14,926,220 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Në Formati nr. 2, “*pasqyra e performancës financiare*”, A “**Të ardhurat**” janë pasqyruar “*Të ardhurat jo tatimore*” llog. 7109, “*Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia*” për 824,171 lekë dhe sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë është po e njëjta vlerë.

Në lekë

34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	824,171	1,801,900
35	710	1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia	824,171	1,801,900
36	7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare		
38	7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	824,171	1,801,900
39	711	2.Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	0	0
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41	7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh		
42	7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
43	7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve		
44	7114	Të ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestreime e zhdëmtime		
46	7116	Të ardhura nga transferimi pronës, Legalizimi i ndërtimeve pa leje		
47	719	3.Të tjera të ardhura jo tatimore	0	0

Në Formati nr. 2, “*pasqyra e performancës financiare*” B. “**Shpenzimet**” janë pasqyruar shpenzimet korrente të konstatuara në vlerën 1,487,890 mijë lekë si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të ndara sipas zërave si;

Llog. (600) “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*” në vlerën 1,059,036 mijë lekë ose 71.2% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm në vlerën 1,059,036 mijë lekë, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2018.

llog. (601) “*Kontribute të sigurimeve*” për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 183,728 mijë lekë ose 12.3% të totalit të shpenzimeve.

llog. (602) “*Blerje mallra e shërbime*” në vlerën 225,714 mijë lekë ose 15.2% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2018.

Llog. (606) “*Transferta për buxhete familjare e individët*” në vlerën 33,514 mijë lekë ose 1.3% të totalit të shpenzimeve.

Llog. (63) “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit*” në vlerën –14,102 mijë lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Vlerat e shpenzimeve paraqitura në pasqyrat financiare F2 “*Pasqyrën e performancës financiare*” paraqiten në vlerën 1,487,890,286 lekë dhe sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë është po e njëjta vlerë si më poshtë:

lekë

Nr.	Nr. llog.	PERSHKRIMI I OPERACIONEVE	Viti Ushtrimor	Viti i mëparshëm
a	b	c	1	2
74	B	SHPENZIMET	1,487,890,286	1,632,537,366
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	1,059,036,010	992,493,816
76	6001	Paga, personel i përhershëm	1,059,036,010	992,493,816
77	6002	Paga personel i Përkohshëm		
78	6003	Shpërblime		
79	6009	Shpenzime të tjera për personelin		
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	183,727,990	164,274,908
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	165,648,926	145,554,908
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	18,079,064	18,720,000
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	225,714,329	454,926,990
84	602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
85	6020	Materiale zyre e të përgjithshme	4,816,875	2,865,000
86	6021	Materiale dhe shërbime speciale	73,855,148	39,817,192
87	6022	Shërbime nga të trete	13,343,222	11,320,000
88	6023	Shpenzime transporti	45,331,132	48,000,000
89	6024	Shpenzime udhëtimi	56,703,702	45,036,000
90	6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	25,004,108	17,500,000
91	6026	Shpenzime për qiramarrje		144,000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

92	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	5,328,102	290,066,898
93	6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua		
94	6029	Shpenzime të tjera operative	1,332,040	177,900
95	603	IV.SUBVEZIONE	0	0
96	6030	Subvecione për difference çmimi		
97	6031	Subvecione për të nxitur punësimin		
98	6032	Subvecione për të mbuluar humbjet		
99	6033	Subvecione për sipërmarrjet individuale		
100	6039	Subvecione të tjera		
101		V.TRANSFERIME KORENTE	33,514,096	22,859,567
102	604	1.Transferime korente të brendshme	0	0
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë		
104	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme		
105	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore		
106	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse		
107	605	2.Transferime korente me jashtë	0	0
108	6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare		
109	6052	Transferime Për Qeveritë e Huaja		
110	6053	Transferime Për institucionet jo fitimprurëse të huaja		
111	6059	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit		
112	606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	33,514,096	22,859,567
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	33,514,096	22,859,567
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0
116	65	1.Shpenzime Financiare të brendshme	0	0
117	650	Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte		
118	651	Interesa për huamarrje të tj. Brendshme		
119	652	Interesa Letra tjera vlere Qeverisë		
120	656	Shpenz .nga këmbimet valutore		0
121	66	2.Shpenzime Financiare të jashtme	0	0
122	660	Interesa për huamarrje nga Qeveritë e Huaja		
123	661	Interesa për financime nga Institucionet ndërkomb		
124	662	Interesa për huamarrje të tjera jashtme		
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIK	0	0
126	681	Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit	0	0
127	682	Vlera e mbetur e AAGJ, të nxjerra jashtë përdorim e të shitura		
128	683	Shuma të parashikuara të shfrytëzimit		
129	686	Shuma të parashikuara për aktivet financiare		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-14,102,139	-2,017,915

- Në “Pasqyrën e performancës financiare” rezulton se “Të Ardhurat” janë të barabarta me Shpenzimet + Rezultatit e vitit Ushtrimor (1,487,890,286 + 14,926,220 = 1,502,816,506 lekë)

- Në “Pasqyrën e performancës financiare” rezulton se Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 14,926,220 lekë është e barabartë me Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në Pasqyrën F1 “Pasqyra e pozicionit financiar”.

- Llog. 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” për vlerën – 14,102,139 lekë në Pasqyrën F2 “Pasqyrën e performancës financiare” është e barabartë me Ndryshimin e Gjendjeve të Klasës 3 në Pasqyrën F1 “Pasqyra e pozicionit financiar” (179,853,488 – 165,751,349 = 14,102,139 lekë).

Pasqyra statistikore formati nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit” zëri “Burimet për investime”, llog. 1050 “Grante kapitale nga buxheti” e plotësuar për shumën 221,825,957 lekë në analizë rakordon me vlerën 221,825,957 lekë në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Kosto historike)” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 7/a.

Gjithashtu teprica në fund e llogarive për shpenzimet për investime dhe burimet për investime në Formatin 6, janë të barabarta me llogaritë përkatëse në Pasqyrën F1 “Pasqyra e pozicionit financiar”.

Formati nr.6:

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI	Teprica Fillim viti	Transaksionet e vitit		Teprica në Fund
				Debi	Kredi	
a		b	c	d	e	f
1	I.	SHPENZIMET PER INVESTIME	0	222,367,131	222,367,131	0
2	230	Shpenzime për Aktive Afatgjata jo materiale				0
3	231	Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale		222,367,131	222,367,131	0
4	25,26	Shpenzime për Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0	0



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

5	25	Huadhënie dhe nenhuadhenie		0	0	0
6	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		0	0	0
7	II.	BURIMET PËR INVESTIME	0	222,367,131	222,367,131	0
8	105	1.Grante të brendshme kapitale	0	0		0
9	1050	Grante kapitale nga Buxheti	0	221,825,957	221,825,957	0
10	1051	Grante kapitale nga nivele të tjera	0	0	0	0
11	1052	Kontribute të treta për investime	0	0	0	0
12	1059	Grante të brendshme kapitale në natyrë	0	541,174	541,174	0
13	106	2.Grante të huaja Kapitale	0	22,855,531	22,855,531	0
14	1060	Nga qeveri të huaja	0	0	0	0
15	1061	Nga institucione ndërkombëtare	0	0	0	0
16	1069	Grante të huaja në natyrë	0	22,855,531	22,855,531	0
17	14	3.Grante kapitale për investime për të treta	0	0	0	0
18	145	Grante brendsh. kapitale për pjesm. në invest. në të treta	0	0	0	0
19	146	Grante të huaja kapitale për pjesm. në invest. në të treta	0	0	0	0
20	11	4.Fonde të tjera të veta.	0	0	0	0
21	111	Fonde rezerve	0	0	0	0
22	115	Caktim fondi për investime nga rezultati I vitit	0	0	0	0
23	116	Te ardhura nga Shitja e aktiveve të qëndrueshme	0	0	0	0
24	12	5.Rezultati I Mbartur				
25	16,17	6.Huamarrje	0	0	0	0
26	16	Huamarrje e Brendshme	0	0	0	0
27	17	Huamarrje e Huaj	0	0	0	0
29	III.	BALANCA (II-I)	0	0	0	0

Formati 5 “Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore” është plotësuar relacioni shpjegues por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

Mbyllja e bilancit për vitin 2018 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe plotësimi i tij është bërë në formatin elektronik (programi financa 5), duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse, veprimet janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur.

5. Prokurimet e fondeve publike:

Nga auditimi i procedurave të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave u konstatuan disa gjetje kryesore:

➤ Nga auditimi i hartimit të kontratave të furnizimit me karburante u konstatua se:

a. Midis bashkimit të operatorëve “....” sh.a dhe “....” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 25, datë 24.07.2017 për furnizimin me karburant diesel 10 ppm me vlerën 19,141,334 lekë pa tvsh me marzh fitimi 16.7% dhe karburant benzinë pa plumb me vlerën 6,525,000 lekë pa tvsh me marzh fitimi 17.7% për Gardën e Republikës. Kontrata e mësipërme është me afat lëvrimit deri 31.12.2017.

b. Midis bashkimit të operatorëve “....” sh.a dhe “....” shpk dhe autoritetit kontraktor (Gardës së Republikës) është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 9, datë 28.02.2018 për furnizimin me karburant diesel 10 ppm me vlerën 19,430,333 lekë pa tvsh me marzh fitimi 16.7% dhe karburant benzinë pa plumb me vlerën 1,928,500 lekë pa tvsh me marzh fitimi 17.7%. Kontrata e mësipërme është me afat lëvrimit deri 31.12.2018.

Në nenin 1, “Objekti” cilësohet si më poshtë:

1.5: Përlllogaritja e çmimit do të bëhet sipas bursës së fundit të karburanteve i cili publikohet çdo të hënë në buletin e APP-së.

1.6: në përlllogaritjen e çmimit do të pasqyrohet dhe ndryshimi i çmimit të taksës së qarkullimit mbi benzinë pa plumb dhe gazoil, sipas ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008, “Për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

taksat Kombëtare”, të ndryshuar, si dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 497, dt. 30.05.2013.

Sa më lart është hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 31 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”;

Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

- a. çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- b. elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- c. marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

Gjithashtu kontratat e mësipërme janë hartuar duke mos respektuar Dokumentet Standarde të Tenderit.

➤ Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezultoi se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzinën e likuiduar në vlerën **1,012,927** lekë me tvsh e cila duhet të arkëtohet nga subjekti “....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

➤ Nga projektuesi Studio “.....” Tiranë është hartuar projekti dhe preventivi Rikonstruksioni i Njësisë speciale në Gardën e Republikës” me vlerën 21,973,753 lekë pa tvsh. Zërat e preventivit janë hartuar zërat referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015. Një pjesë zërash të punimeve çmimet janë hartuar me analiza punimesh në përputhje me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” por analizat nuk janë bashkëngjitur preventivit. Kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 9 “Preventivat, pa përjashtim, për objektet e reja, me financimin, publik ose privat, të projektuara nga subjekte, shtetërore apo private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, bazuar në analizat teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit, të përfshira në manual”.

➤ Nga auditimi rezultoi se një pjesë zërash të preventivit të ofertës nuk shoqërohen me analizat e çmimeve në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10. “Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr. 2, date 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave”.

5/a. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nr.	Autoriteti kontraktor dhe procedurat e zgjedhura	Procedurat e zhvilluara gjithsej		Procedura të audituara	
		Sasi	Vlera në mijë/lekë	Sasi	Vlera pa TVSH në mijë/lekë
	TOTALI				
A	Viti ushtrimor 2017				
	Procedurë e hapur;	1	21,974	1	21,974
	Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;	11	7,548	1	4,329
	Kërkesë për propozime;	11	38,111	2	16,905
	Prokurim me vlerë të vogël.	30	4,784		
	Tendera të përqendruara Ministria e brendshme	14	11,200		
	Zbatim kontrata karburanti			1	26,666
B	Vitet 2018				
	Procedurë e hapur;	1	9,000		
	Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;	5	2,098		
	Kërkesë për propozime;	10	35,497	4	22,795
	Prokurim me vlerë të vogël.	25	7,687		
	Tendera të përqendruara Ministria e brendshme	5	7,0410		
	Zbatim kontrata karburanti			1	21,359

Në zbatim të pikës pesë të programit të auditimit nr. 340/2, datë 29.05.2019, u auditua procedura elektronike e prokurimit dhe dokumentacioni në dosjet e prokurimit për 8 procedura prokurimi:

Për vitin 2017.

1. “Blerje materiale të ndryshme për shërbimin e stërvitjes” vlera e kontratës 7,188,600 lekë, “Kërkesë për propozim”.
2. “Rikonstruksioni i njësisë speciale në Gardën e Republikës”, vlera e kontratës 9,716,928 lekë, “Kërkesë për propozim”.
3. “Ndërtim Zyre dhe ambiente pune në komandën e gardës”, vlera e kontratës 26,180,780 lekë, “Procedurë e hapur”.
4. “Punime shites në objektin “Ndërtim zyre dhe ambiente pune në komandën e gardës”, vlera e kontratës 5,183,388 lekë, “Me negociim pa njoftim kontrate”.

Për vitin 2018.

1. “Rikonstruksion i njësisë speciale dhe asfaltim i sheshit të njësisë së tretë” vlera e kontratës 7,133,051 lekë, “Kërkesë për propozim”.
2. “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”, vlera e kontratës 6,385,706 lekë, “Kërkesë për propozim”.
3. “Blerje pjesë këmbimi”, vlera e kontratës 4,839,120 lekë, “Kërkesë për propozim”.
4. “Blerje materiale ndërlidhje”, vlera e kontratës 4,437,583 lekë, “Kërkesë për Propozim”.

Në analizë tenderat si më poshtë:

1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i Njësisë speciale në Gardën e Republikës”, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Njësia e Prokurimi
a	b	c
-Urdhër Prokur. nr. 602/1, datë 21.03.2017 -Fondi limit pa tvsh 8,148 mijë lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 03.04.2017 -Firma fituese “SNKA/L” sh.p.k -Data e lidhjes së kontratës 15.05.2017 -Vlera e kontrat. 8,097 mijë lekë pa tvsh -Diferenca nga fondi limit 51 mijë lekë.	..., Kryetar ..., Anëtar ..., Anëtar	

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës nr. 602/4, dt. 15.04.2017 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operator i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues operator “....” sh.p.k. me të cilin është lidhur kontrata nr. 16, datë 15.05.2017.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Me urdhrin e prokurimit nr. 602/1, datë 21.03.2017 nxjerrë nga z. është përcaktuar fondi limit 8,147,704 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “Kërkesë për propozim” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 602/3, datë 21.03.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit....”.

Nga projektuesi Studio “.....” Tiranë është hartuar projekti dhe preventivi me vlerën 8,147,704 lekë pa tvsh. Zërat e preventivit nuk janë hartuar zërat referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 (Çmim + Shpenzime të përgjithshme 8% + fitimi 10%). Një pjesë zërash të punimeve çmimet janë hartuar me analiza punimesh në përputhje me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” por analizat nuk janë bashkëngjitur preventivit. Kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 9 “Vlera e zërave të punës të preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik të projektuara nga subjekte, publike apo private, llogariten si prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit me çmimet për njësi të manualit teknik të çmimeve në fuqi. Vlera e zërave të punës të situacioneve të ndërtimit del nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike”.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali dt. 21.03.2017 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 602/1, dt. 21.03.2017 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, mungon data e zhvillimit të tenderit (dt. 03.04.2017), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, (fondi limit nga projektuesi Studio “.....” Tiranë) *specifikimet teknike si dhe kriteret teknike në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26 “Kontratat për punët publike”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.*

Me nr. 602/4, dt. 15.04.2017 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Kanë paraqitur ofertat dy operatorë:

1. “.....” shpk me vlerën 8,048,770 lekë pa tvsh.
2. “.....” shpk me vlerën 8,097,440 lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar:

1. operatori “.....” shpk me vlerën 8,048,770 lekë pa tvsh.

Me argumentimin se Operatori “.....” shpk nuk plotëson kriteret për kualifikim, pasi ky operator nuk ka paraqitur:

- Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore.
- Operatori ka paraqitur ekskavatorin me goma por kontrolli teknik dhe siguracioni kanë skaduar në datën 12.02.2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- Për materialet dyer, dritaret, nuk paraqitet certifikatën e normativitetit EN 13830: 2003 si dhe EN ISO 12631: 2012.

Janë kualifikuar:

1. Operatori “...” shpk me vlerën ofertë 8,097,440 lekë pa tvsh.

Nga auditimi rezultoi se një pjesë zërash të preventivit të ofertës nuk shoqërohen me analizat e çmimeve në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12. “Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese ...”.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezultoi:

Midis operatorit “...” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 16, datë 15.05.2017 për rikonstruksionin e njësisë speciale në gardën e republikës me vlerën 8,097,440 lekë pa t.v.sh. ose 9,716,928 lekë me tvsh me afat të përfundimit të punimeve brenda 75 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 31.07.2017).

Në datën 03.07.2017 me prot. 575/9 është bërë ndryshimi i projektit dhe zërave të punimeve duke ruajtur vlerën e ofertës i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor (9,714,984 lekë me tvsh). Me shkresën nr. 1059/2, dt. 31.07.2017 nga sipërmarrësi është njoftuar autoriteti kontraktor për përfundimin e punimeve.

Janë likuiduar me urdhër shpenzimet nr. 475, dt. 23.06.2017 vlera 4,309,759 lekë me tvsh me faturën tatimore nr. 7, dt. 16.06.2017, sipas situacionit pjesor nr. 1 deri datën 16.06.2017, nr. 554, dt. 02.08.2017 vlera 2,895,925 lekë me tvsh me faturën tatimore nr. 111, dt. 12.07.2017, sipas situacionit progresiv nr. 2 deri datën 12.07.2017, nr. 675, dt. 20.09.2017 vlera 2,509,300 lekë me tvsh me faturën tatimore nr. 116, dt. 08.09.2017, sipas situacionit progresiv nr. 3 deri datën 31.07.2017. (Likuiduar gjithsej 9,714,984 lekë me tvsh).

2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Ndërtim zyre dhe ambiente pune në Komandën e Gardës”, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Njësia e Prokurimi
a	b	c
-Urdhër Prokur. nr. 916, datë 09.05.2017	, Kryetar	
-Fondi limit pa tvsh 21,974 mijë lekë	, Anëtar	
-Proc. e Prok. (e hapur)	, Anëtar	
-Data e zhvillimit të tenderit 02.06.2017		
-Firma fituese “SNKA/L” sh.p.k		
-Data e lidhjes së kontratës 06.09.2017		
-Vlera e kontrat. 21,800 mijë lekë pa tvsh		
-Diferenca nga fondi limit 174 mijë lekë.		

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës nr. 916/3, dt. 15.06.2017 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operator i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues operator “.....” sh.p.k. me të cilin është lidhur kontrata nr. 31, datë 06.09.2017.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 916, datë 09.05.2017 nxjerrë nga z. është përcaktuar fondi limit 21,973,753 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “e hapur” ku është përcaktuar Njësia e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Prokurimit dhe me urdhrin nr. 916/2, datë 09.05.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit...”.

Nga projektuesi Studio “.....” Tiranë është hartuar projekti dhe preventivi me vlerën 21,973,753 lekë pa tvsh. Zërat e preventivit janë hartuar zërat referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015. Një pjesë zërash të punimeve çmimet janë hartuar me analiza punimesh në përputhje me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” por analizat nuk janë bashkëngjitur preventivit. Kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 9 “Vlera e zërave të punës të preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik të projektuara nga subjekte, publike apo private, llogariten si prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit me çmimet për njësi të manualit teknik të çmimeve në fuqi. Vlera e zërave të punës të situacioneve të ndërtimit del nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike”.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali dt. 09.05.2017 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 916, dt. 09.05.2017 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, mungon data e zhvillimit të tenderit (Formulari i njoftimit të kontratës nr. 916/1, dt. 09.05.2017 përcakton dt. 02.06.2017), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, (fondi limit nga projektuesi Studio “.....” Tiranë) specifikimet teknike si dhe kriteret teknike në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26 “Kontratat për punët publike”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Me nr. 916/3, dt. 15.06.2017 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor ...”, si më poshtë:

Ka paraqitur ofertat një operator i cili edhe është kualifikuar; Operatori “.....” sh.p.k ka paraqitur ofertën 21,800,650 lekë pa tvsh,

Nga auditimi rezultoi se një pjesë zërash të preventivit të ofertës nuk shoqërohen me analizat e çmimeve në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12. “Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese ...”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezultoi:

Midis operatorit “.....” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 31, datë 06.09.2017 për ndërtim zyre dhe ambiente pune në komandën e gardës me vlerën 21,800,650 lekë pa t.v.sh. ose 26,160,780 lekë me tvsh me afat të përfundimit të punimeve brenda 90 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 06.12.2017).

Në datën 05.10.2017 me prot. 1626/5 është bërë ndryshimi i projektit dhe zërave të punimeve duke ruajtur vlerën e ofertës i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor. Me shkresën nr. 2306, dt. 04.12.2017 nga sipërmarrësi është njoftuar autoriteti kontraktor për përfundimin e punimeve. Janë likuiduar me urdhër shpenzimet nr. 723, dt. 06.10.2017 vlera 6,576,480 lekë me tvsh sipas faturës tatimore nr. 118, dt. 02.10.2017, situacionit pjesor nr. 1 deri datën 02.10.2017, nr. 831, dt. 21.11.2017 vlera 14,714,994 lekë me tvsh sipas faturës tatimore nr. 124, dt. 21.11.2017, situacionit pjesor nr. 2 deri datën 17.11.2017, nr. 899, dt. 26.12.2017 vlera 4,851,672 lekë me tvsh sipas faturës tatimore nr. 129, dt. 15.12.2017, situacionit nr. 3 përfundimtar deri datën 04.12.2017.

2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Punime shitesë Ndërtim zyre dhe ambiente pune në Komandën e Gardës”, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Njësia e Prokurimi
a	b	c
-Urdhër Prokur. nr. 2294, datë 01.12.2017 -Fondi limit pa tvsh 4,329 mijë lekë -Proc. e Prok. (Negocim pa shpallje) -Data e zhvillimit të tenderit 04.12.2017 -Firma fituese “SNKA/L” sh.p.k -Data e lidhjes së kontratës 06.12.2017 -Vlera e kontrat. 4,319 mijë lekë pa tvsh -Diferenca nga fondi limit 10 mijë lekë.	, Kryetar, Anëtar, Anëtar	,,

U konstatuan:

Me operatorin fitues “.....” sh.p.k. është lidhur kontrata nr. 41, datë 06.12.2017.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 2294, datë 01.12.2017 nxjerrë nga z. është përcaktuar fondi limit 4,329,180 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 2294/2, datë 01.12.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit....”.

Nga operatori “SENKA/L” shpk është hartuar preventivi me vlerën 4,319,490 lekë pa tvsh.

Nga auditimi rezultoi se një pjesë zërash të preventivit të ofertës nuk shoqërohen me analizat e çmimeve në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12. “Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese ...”.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës shtesë rezultoi:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Midis operatorit “....” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata shtesë nr. 41, datë 06.12.2017 punime shtesë për ndërtim zyre dhe ambiente pune në komandën e gardës me vlerën 4,319,490 lekë pa t.v.sh. ose 5,183,388 lekë me tvsh me afat të përfundimit të punimeve brenda 25 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 31.12.2017). Punimet kanë përfunduar në datën 22.12.2017.

Është likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 915, dt. 27.12.2017 vlere 5,183,388 lekë me tvsh sipas faturës tatimore nr. 131, dt. 26.12.2017, situacionit përfundimtar nr. 1 deri datën 22.12.2017,

Titulli i gjetjes 5:	Nga auditimi i procedurave të prokurimeve publike rezultoi se një pjesë zërash të punimeve të preventivit për përcaktimin e fondit limit dhe të preventivit të ofertës çmimet janë hartuar me analiza punimesh referuar UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” por analizat nuk janë bashkëngjitur preventivit
Situata 1:	Nga projektuesi “.....” Tiranë është hartuar projekti dhe preventivi “Rikonstruksioni i Njësisë speciale në Gardën e Republikës” me vlerën 21,973,753 lekë pa tvsh. Zërat e preventivit janë hartuar referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015. Për një pjesë zërash të punimeve të preventivit çmimet janë hartuar me analiza punimesh referuar UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” por <u>analizat nuk janë bashkëngjitur preventivit</u> . Kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 9 “Vlera e zërave të punës të preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik të projektuara nga subjekte, publike apo private, llogariten si prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit me çmimet për njësi të manualit teknik të çmimeve në fuqi. Vlera e zërave të punës të situacioneve të ndërtimit del nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike.”.
Situata 2:	Nga auditimi i procedurave të prokurimeve rezultoi se operatorët ekonomikë ofertues një pjesë <u>zërash të preventivit të ofertës të nuk e kanë shoqëruar me analizat e çmimeve</u> kjo në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12. “Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”
Ndikimi/Efekti	Mos paraqitja e analizës teknike nga subjektet ofertuese në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe me formatin e unifikuar bën që preventivat dhe ofertat e paraqitura të mos paraqesin vlerën e saktë të fondit limit dhe të ofertave të punimeve të ndërtimit.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandime	Nga njësitë e prokurimit dhe KVO të kërkohet që gjatë procedurave të hartimit të projekteve, preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik dhe vlerësimit të ofertave gjatë procedurës së prokurimit vlera e zërave të punës të ndërtimit të llogariten mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike. Në rast kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike

3- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale të ndryshme për shërbimin e stërvitjes”, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Njësia e Prokurimi
a	b	c
-Urdhër Prokur. nr. 2144, datë 06.11.2017 -Fondi limit pa tvsh 5,996 mijë lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 17.11.2017 -Firma fituese Blerina Kapedani -Data e lidhjes së kontratës 07.12.2017 -Vlera e kontrat. 5,990 mijë lekë pa tvsh -Diferenca nga fondi limit 6 mijë lekë.	, Kryetar, Anëtar, Anëtar	,,

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës nr. 2144/4, dt. 30.11.2017 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operator i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “.....” person fizik me të cilin është lidhur kontrata nr. 43, datë 07.12.2017.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 2144, datë 06.11.2017 nxjerrë nga z. është përcaktuar fondi limit 5,996,000 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “Kërkesë për propozim” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 2144/2, datë 06.11.2017, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit....”.

Me Urdhrin nr. 2072, dt. 27.10.2017 është ngritur komisioni për testimin e tregut i cili me procesverbalin e datës 03.11.2017 ka përlllogaritur fondin limit prej 5,996,000 lekë pa tvsh mbështetur në tre ofertat duke përcaktuar çmimin më të ulët.

Me shkresën dt. 03.11.207 drejtuar zyrës së prokurimeve Komandanti i njësisë speciale z. ka përcaktuar specififikimet teknike dhe preventivin për përcaktimin e fondit limit.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali dt. 06.11.2017 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 2144, dt. 06.11.2017 ku janë përcaktuar procedura e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

prokurimit, mungon data e zhvillimit të tenderit (dt. 17.11.2017), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, *specifikimet teknike si dhe kriteret teknike* në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 “Kontratat e mallrave”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Me nr. 2144/3, dt. 17.11.2017 në zyrën e prokurimit janë dorëzuar mostrat për artikujt e kërkuar në DST

Me nr. 2144/4, dt. 30.11.2017 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Kanë paraqitur ofertat një operator:

1., me vlerën 5,990,500 lekë pa tvsh.

Ky operator ka paraqitur:

- Vërtetimin nga administrata tatimore Berat se ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuar sipas ftesës së bërë nga enti prokurues Sha me objekt prokurimi “Blerje rroba pune për vitin 2017 me vlerën 13,392,000 lekë”.
- Vërtetimin nga administrata tatimore Berat ku ofertuesi duhet të paraqesë dokument ku të vërtetohet xhiro mesatare vjetore e realizuar gjatë tre viteve të fundit është të lëshuar sipas ftesës së bërë nga enti prokurues Sha me objekt prokurimi “Blerje rroba pune për vitin 2017 me vlerën 13,392,000 lekë”.

Nga auditimi rezultoi:

Midis operatorit “.....” person fizik dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 43, datë 07.12.2017 për furnizimin me blerje materiale të ndryshme për shërbimin e stërvitjes në gardën e republikës me vlerën 5,990,500 lekë pa t.v.sh. ose 7,188,600 lekë me tvsh me afat të furnizimit të materialeve brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 14.12.2017).

4- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pjesë këmbimi”, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Njësia e Prokurimi
a	b	c
-Urdhër Prokur. nr. 278, datë 29.01.2018 -Fondi limit pa tvsh 4,878 mijë lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 09.02.2018 -Firma fituese ALSTEZO -Data e lidhjes së kontratës 03.05.2018 -Vlera e kontrat. 4,839 mijë lekë pa tvsh -Diferenca nga fondi limit 39 mijë lekë.	, Kryetar, Anëtar, Anëtar	,,

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës nr. 278/5, dt. 03.04.2018 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim dy operatorë janë skualifikuar një dhe është kualifikuar, shpallur fitues operatori “.....” shpk me të cilin është lidhur kontrata nr. 14, datë 03.05.2018.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 278, datë 29.01.2018 nxjerrë nga z....ko është përcaktuar fondi limit 4,877,767 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “Kërkesë për propozim” ku është



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 278/2, datë 29.01.2018, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit....”.

Me Urdhrin nr. 22, dt. 04.01.2018 është ngritur komisioni për testimin e tregut i cili me procesverbalin nr. 43/4, dt. 18.01.2018 ka përlllogaritur fondin limit prej 64,877,767 lekë pa tvsh mbështetur në tre ofertat duke përcaktuar çmimin më të ulët.

Kryetari i Degës Mbështetjes Logjistike së bashku me komisionin kanë përcaktuar specifikimet teknike dhe preventivin për përcaktimin e fondit limit miratuar nga titullari..

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali dt. 29.01.2018 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 278, dt. 29.01.2018 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, nuk është data e zhvillimit të tenderit (dt. 09.02.2018), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, *specifikimet teknike si dhe kriteret teknike* në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 27 “Kontratat e mallrave”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Me nr. 278/5, dt. 03.04.2018 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës..... dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Kanë paraqitur ofertat tre operatorë;

1. Operatori “...” shpk, me vlerën 4,150,570 lekë pa tvsh.
2. Operatori “...” shpk, me vlerën 4,839,120 lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar:

1. Operatori “.....” shpk, me vlerën 4,150,570 lekë pa tvsh.

Operatori i mësipërm është skualifikuar pasi:

- Për pajisjet e sinjalistikës rrugore për rastet e emergjencës kërkohet të plotësohen të gjitha parametrat e kërkuara në DT. Këto pajisje kërkohet të jenë të homologuara dhe duhet të plotësojnë të gjitha parametrat teknik të kërkuara nga normativat e CE. Operatori ekonomik për këtë kërkesë ka paraqitur një deklaratë individuale por jo çertifikatat e homologimit për këto pajisje.
- Nuk paraqet katalogjet për Mitsubishi 3.2 LNV, BMC, Toyota, Fiat Croma, Ford Otosan dhe Renault.

Nga operatori i mësipërm ka ankimuar skualifikimin dhe Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 141/2018dt. 20.03.2018 ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “....” sha.

Janë kualifikuar:

2. Operatori “.....” shpk me vlerën 4,839,120 lekë pa tvsh pasi rezulton se plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit..

Midis operatorit “.....” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 14, datë 03.05.2018 blerje pjesë këmbimi për gardën e republikës me vlerën 4,839,120 lekë pa t.v.sh. ose 5,806,944 lekë me tvsh me afat të furnizimit të materialeve brenda 90 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 03.07.2018).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Vlera e kontratës së mësipërme është likuiduar me urdhër shpenzime të cilat kanë bashkëngjitur Procesverbalin e hartuar nga komisioni i për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara gjatë vitit 2018 i ngritur me urdhërin e Komandantit të gardës nr. 2099, dt. 03.04.2018 ku citohet se i plotësojnë kriteret e përcaktuara në kontratë, faturat tatimore të subjektit, fletë hyrjet e magazinës. (Bashkëngjitur lista me Urdhër Shpenzimet)

5- Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Rikonstruksioni i Njesisë speciale dhe asfaltim sheshi i njësisë së tretë”*, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Njësia e Prokurimi
a	b	c
-Urdhër Prokur. nr. 1911, datë 28.03.2018 -Fondi limit pa tvsh 7,165 mijë lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 19.03.2018 -Firma fituese “.....” sh.p.k -Data e lidhjes së kontratës 11.04.2018 -Vlera e kontrat. 7,133 mijë lekë pa tvsh -Diferenca nga fondi limit 32 mijë lekë.	..., Kryetar ..., Anëtar ..., Anëtar	...,

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës nr. 1911/3, dt. 04.04.2018 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim një operator i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “.....” sh.p.k. me të cilin është lidhur kontrata nr. 13, datë 11.04.2018.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 1911, datë 08.03.2018 nxjerrë nga z. është përcaktuar fondi limit 7,165,170 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit *“Kërkesë për propozim”* ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 1911/2, datë 08.03.2018, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* kreu VII, neni 58 *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor”* dhe neni 60 pika 1 *“...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit....”*.

Nga Dega e logjistike, specialistët janë hartuar specifikimet teknike dhe preventivi me vlerën 7,165,170 lekë pa tvsh. Zërat e preventivit nuk janë hartuar zërat referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe testimit të tregut.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbal dt. 08.03.2018 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 1911, dt. 08.03.2018 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, mungon data e zhvillimit të tenderit (dt. 19.03.2018), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, (fondi limit dhe specifikimet teknike nga Dega logjistike e Gardës) *specifikimet teknike si dhe kriteret teknike* në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* neni 26 *“Kontratat për punët publike”*, neni 61 pika 2 *“Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”*.

Me nr. 1911/3, dt. 04.04.2018 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. Gramos Sako mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 68 *“Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...”* dhe 69 *“Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”*, si më poshtë:

Kanë paraqitur ofertat dhe kualifikuar një operator;

1. “....” shpk me vlerën 7,133,051 lekë pa tvsh.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezultoi:

Midis operatorit “....” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 13, datë 11.04.2018 për rikonstruksionin e njësisë speciale dhe asfaltimi i sheshit të njësisë së tretë në gardën e republikës me vlerën 7,133,051 lekë pa t.v.sh. ose 8,559,661 lekë me tvsh me afat të përfundimit të punimeve brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 11.06.2018).

Janë likuiduar me urdhër shpenzimet nr. 365, dt. 22.05.2018 vlera 2,462,491 lekë me tvsh, nr. 554, dt. 20.06.2018 vlera 5,666,044 lekë me tvsh, fatura tatimore nr. 141, dt. 06.07.2018, situacioni progresiv nr. 2.

6- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore”, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Njësia e Prokurimi
a	b	c
-Urdhër Prokur. nr. 2085, datë 29.03.2018 -Fondi limit pa tvsh 6,667 mijë lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 10.04.2018 -Firma fituese Gentian Horeti -Data e lidhjes së kontratës 15.05.2018 -Vlera e kontrat. 6,386 mijë lekë pa tvsh -Diferenca nga fondi limit 6281mijë lekë.	, Kryetar, Anëtar, Anëtar	,,

U konstatuan:

Sipas raportit përmbledhës nr. 2085/4, dt. 26.04.2018 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim tre operatorë janë skualifikuar dy është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori “....” person fizik me të cilin është lidhur kontrata nr. 16, datë 15.05.2018....

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 2085, datë 29.03.2018 nxjerrë nga z. është përcaktuar fondi limit 6,666,667 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “Kërkesë për propozim” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 2085/2, datë 29.03.2018, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 58 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor” dhe neni 60 pika 1 “...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit....”.

Me Urdhrin nr. 22, dt. 04.01.2018 është ngritur komisioni për testimin e tregut i cili me procesverbal ka përllogaritur fondin limit prej 6,666,667 lekë pa tvsh mbështetur në tre ofertat duke përcaktuar çmimin më të ulët.

Kryetari i Degës Logjistike së bashku me komisionin kanë përcaktuar specifikimet teknike dhe preventivin për përcaktimin e fondit limit miratuar nga titullari..

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbal i dt. 29.03.2018 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 2085, dt. 29.03.2018 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (dt. 10.04.2018), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, specifikimet teknike si dhe kriteret teknike në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26 “Kontratat për punët publike”, neni 61 pika 2 “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Me procesverbalin nr. 2085/3, dt. 10.04.2018 në zyrën e prokurimit janë dorëzuar mostrat për artikujt e kërkuar në DST nga operatori ekonomik “....” person fizik të listuar artikujt sipas specifikimeve teknike në DST.

Me nr. 2085/4, dt. 26.04.2018 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 68 “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...” dhe 69 “Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor”, si më poshtë:

Kanë paraqitur ofertat tre operatorë:

3. Operatori “....” shpki, me vlerën 6,286,946 lekë pa tvsh.
4. Operatori “.....” shpk, me vlerën 6,633,000lekë pa tvsh.
5. Operatori, person fizik, me vlerën 6,385,706 lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar:

3. Operatori “....” shpki, me vlerën 6,286,946 lekë pa tvsh.

Operatori i mësipërm është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur detyrimisht përpara hapjes së procedurës (deri më datë 10.04.2018 para orës 10.00) mostrat, për artikujt me numër rendor: 7,8,9,10,11,28,29,30,31,32,33,34,35,41,45,55,56,57 të specifikuar në specifikimet teknike (secili nga ofertuesit duhet të bëjë një listë me mostrat e artikujve, ku dhe dorëzimi i tyre do të bëhet në bazë të asaj liste). Ato duhet të dorëzoheshin pranë Sekretarisë në Komandën e Gardës së Republikës me adresë: Rruga e “Elbasanit”, Pallati i Brigadave, Tiranë.

4. Operatori “.....” shpk, me vlerën 6,633,000lekë pa tvsh.

Operatori i mësipërm është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur detyrimisht përpara hapjes së procedurës (deri më datë 10.04.2018 para orës 10.00) mostrat, për artikujt me numër rendor: 7,8,9,10,11,28,29,30,31,32,33,34,35,41,45,55,56,57 të specifikuar në specifikimet teknike (secili nga ofertuesit duhet të bëjë një listë me mostrat e artikujve, ku dhe dorëzimi i tyre do të bëhet në bazë të asaj liste). Ato duhet të dorëzoheshin pranë Sekretarisë në Komandën e Gardës së Republikës me adresë: Rruga e “Elbasanit”, Pallati i Brigadave, Tiranë.

Gjithashtu operatori nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit ose të distributorëve të autorizuar.

Janë kualifikuar:

5. Operatori person fizik, me vlerën 6,385,706 lekë pa tvsh.

Midis operatorit “.....” person fizik dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 16, datë 15.05.2018 shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore në gardën e republikës me vlerën 6,385,706 lekë pa t.v.sh. ose 7,662,848 lekë me tvsh me afat të furnizimit të materialeve brenda 90 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 17.08.2018).

Për zbatimin e kontratës së mësipërme janë kryer likuidime me urdhër shpenzimin nr. 376, dt. 29.05.2019 për vlerën 4,128,920 lekë me tvsh dhe urdhër shpenzimin nr. 534, dt. 19.07.2019 për vlerën 3,533,928 lekë me tvsh.

7- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje materiale ndërlidhje”, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Kom. i Vler. të Ofertave	Njësia e Prokurimi
a	b	c
-Urdhër Prokur. nr. 2136, datë 05.04.2018	, Kryetar	
-Fondi limit pa tvsh 5,000 mijë lekë	, Anëtar	
-Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim)	, Anëtar	
-Data e zhvillimit të tenderit 16.04.2018		
-Firma fituese “.....”		
-Data e lidhjes së kontratës 30.05.2018		
-Vlera e kontrat. 4,437 mijë lekë pa tvsh		
-Diferenca nga fondi limit 63 mijë lekë.		

U konstatuan:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Sipas raportit përmbledhës nr. 2136/3, dt. 07.05.2018 mbajtur nga KVO kanë paraqitur ofertat për konkurrim katër operatorë janë skualifikuar një kualifikuar tre dhe shpallur fitues operatori “....” shpk me të cilin është lidhur kontrata nr. nr. 19, datë 30.05.2018.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 2136, datë 05.04.2018 nxjerrë nga z.... është përcaktuar fondi limit 4,999,959 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “*Kërkesë për propozim*” ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 2136/2, datë 05.04.2018, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” kreu VII, neni 58 “*Komisioni i vlerësimit të ofertave, i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor*” dhe neni 60 pika 1 “*...titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit....*”.

Me Urdhrin nr. 323, dt. 02.02.2018 është ngritur komisioni për përgatitjen e fondit limit dhe specifikimet teknike i cili me procesverbalin e datës 28.03.2018 ka përlllogaritur fondin limit prej 5,999,959 lekë pa tvsh mbështetur në tre ofertat duke përcaktuar çmimin më të ulët dhe specifikimet teknike.

Nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbali dt. 05.04.2018 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 2136, dt. 05.04.2018 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, (data e zhvillimit të tenderit 16.04.2018), kriteret e kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kriteri i vlerësimit dhe kapacitetet teknike e kriteret profesionale, specifikimet teknike si dhe kriteret teknike në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 27 “*Kontratat e mallrave*”, neni 61 pika 2 “*Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*”.

Me nr. 2136/3, dt. 07.05.2018 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor z. mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 68 “*Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës..... dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor...*” dhe 69 “*Pas miratimit të raportit përmbledhës autoriteti kontraktor*”, si më poshtë:

Kanë paraqitur ofertat katër operatorë:

6. Operatori “....” shpk, me vlerën 4,798,750 lekë pa tvsh.
7. Operatori “....” shpk, me vlerën 4,940,00 lekë pa tvsh.
8. Operatori “.....” shpk, me vlerën 4,677,350 lekë pa tvsh.
9. Operatori “.....” shpk, me vlerën 4,437,853 lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar:

6. Operatori “.....” shpk, me vlerën 4,798,750 lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

-Operatori “....” shpk nuk i plotëson të gjithë kriteret për kualifikim pasi ofertuesi nuk disponon në staf 1 inxhinier elektronik (kjo duhej të deklarohej me kontratën e punës, CV dhe fotokopje të noterizuar të diplomës së këtij inxhinieri), operatori ka paraqitur dy punonjës Zotin dhe Zotin por asnjëri prej tyre nuk ka titullin inxhinier elektronik. Ofertuesi nuk disponon çertifikatën e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2008 ose ISO 9001:2015 si dhe nuk disponon çertifikatën e sistemit të menaxhimit të shërbimit ISO IEC 20000-1:2011. Ka paraqitur çertifikatat për subjektin por nuk egziston lidhja midis dhe operatorit shpk.

Janë kualifikuar:

1. Operatori “.....” shpk, me vlerën 4,940,00 lekë pa tvsh.
2. Operatori “.....” shpk, me vlerën 4,677,350 lekë pa tvsh.
3. Operatori “.....” shpk, me vlerën 4,437,583 lekë pa tvsh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nga KVO fitues është shpallur Operatori “.....” shpk, me vlerën **4,437,583** lekë pa tvsh.

Midis operatorit “.....” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 19, datë 30.05.2018 blerje materiale ndërlidhje për gardën e republikës me vlerën 4,437,583 lekë pa t.v.sh. ose 5,325,100 lekë me tvsh me afat të furnizimit të materialeve brenda 45 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (deri 15.07.2018).

Vlera e kontratës së mësipërme është likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 535, dt. 19.07.2018 për 5,325,100 lekë me tvsh e cila kanë bashkëngjitur Procesverbalin dt. 13.07.2018 hartuar nga komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara gjatë vitit 2018 i ngritur me urdhrin e Komandantit të gardës nr. 322, dt. 02.02.2018 ku citohet se materialet janë të rregullta sipas specifikimeve teknike të kërkuara në sasi dhe cilësi, faturat tatimore të subjektit me nr.: 83, dt. 13.07.2018, fletë hyrjet e magazinës nr. 10, dt. 13.07.2018.

5/b. Auditimi i zbatimit të kontratave të karburanteve.

b/1. Në zbatim të pikës pesë të programit të auditimit nr. 340/2, datë 29.05.2019, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. kontrata nr. 25, datë 24.07.2017 për furnizimin me karburant për vitin 2017.

2. Urdhër shpenzimet me nr. 658, dt. 14.09.2017, nr. 729, dt. 10.10.2017, nr. 820, dt. 20.11.2017, nr. 891, dt. 21.12.2017

Nga auditimi u konstatua se:

Midis bashkimit të operatorëve “....” sh.a dhe “....” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 25, datë 24.07.2017 për furnizimin me karburant diesel 10 ppm me vlerën 19,141,334 lekë pa tvsh me marzh fitimi 16.7% dhe karburant benzinë pa plumb me vlerën 6,525,000 lekë pa tvsh me marzh fitimi 17.7% për Gardën e Republikës. Kontrata e mësipërme është me afat lëvrimit deri 31.12.2017.

Në nenin 1, ‘Objekti’ cilësohet si më poshtë:

1.5: Përlllogaritja e çmimit do të bëhet sipas bursës së fundit të karburanteve i cili publikohet çdo të hënë në buletin e APP-së.

1.6: në përlllogaritjen e çmimit do të pasqyrohet dhe ndryshimi i çmimit të taksës së qarkullimit mbi benzinë pa plumb dhe gazoil, sipas ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008, “Për taksat Kombëtare”, të ndryshuar, si dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 497, dt. 30.05.2013.

Sa më lart është hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 31 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”;

3. Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni;

c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

Gjithashtu kontrata e mësipërme është hartuar duke mos respektuar Dokumentet Standarde të Tenderit.

Janë likuiduar vlera me urdhër shpenzimet si më poshtë:

1- Me Urdhër shpenzimin nr. 658, dt. 14.09.2017 është likuiduar vlera prej 8,920,500 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 63, dt. 08.09.2017 për 40,000 litra gazoil me vlerën 6,484,800 lekë me tvsh, dhe benzinë për 15,000 litra me vlerën 2,435,700 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 2, dt. 08.09.2017 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi dt. 30.07.2017 dhe 14.08.2017 por e pa shoqëruar me deklaratën doganore SAD sipas kushteve të kontratës,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 25.0.2017 referuar buletinit të APP.

Gazoil ($\text{Çmimi } 447+30=515 \text{ \$}/\text{ton} \times 0.8324 = (428.68 \times 112.34)/1000 = 48.15 \text{ lek/litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 19.23 lekë/litri çmimi del 134.38 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.87 lekë) në total çmimi del 161.25 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 25 gusht 2017 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 6,484,800 lekë për sasinë e gazoilit prej 40,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 161.25 lekë/litri që është 6,450,000 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **34,800** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës për datën 14.08.2017 referuar buletinit të APP.

Benzina ($\text{Çmimi } 549+30=579 \text{ \$}/\text{ton} \times 0.7433 = (430.37 \times 112.23)/1000 = 48.30 \text{ lek/litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.14 lekë/litri çmimi del 133.94 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (26.78 lekë) në total çmimi del 160.70 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 14 gusht 2017 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,435,700 lekë për sasinë e benzinës prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 160.70 lekë/litri që është 2,410,500 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **25,200** lekë.

Kjo vlefte në total prej **60,000** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD”.

Neni 31 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”

3. Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

- a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni;
- c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

2- Me Urdhër shpenzimin nr. 729, dt. 10.10.2017 është likuiduar vlera prej 9,345,900 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 66, dt. 04.10.2017 për 40,000 litra gazoil me vlerën 6,848,400 lekë me tvsh, dhe benzinë për 15,000 litra me vlerën 2,497,500 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 4, dt. 04.10.2017 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi dt. 12.09.2017 dhe 07.09.2017 por e pa shoqëruar me deklaratën doganore SAD sipas kushteve të kontratës,

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 12.09.2017 referuar buletinit të APP.

Gazoil ($\text{Çmimi } 518+30=548 \text{ \$}/\text{ton} \times 0.8385 = (459.49 \times 111.69)/1000 = 51.32 \text{ lek/litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 19.75 lekë/litri çmimi del 138.07 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (27.61 lekë) në total çmimi del 165.68 lekë/litri.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 12 shtator 2017 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 6,848,400 lekë për sasinë e gazoilit prej 40,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 165.68 lekë/litri që është 6,627,200 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **221,200** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës për datën 25.09.2017 referuar buletinit të APP.

Benzina (Çmimi $581+30=611$ \$/ton $\times 0.7489 = (457.57 \times 113.16)/1000 = 51.77$ lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.83 lek/litri çmimi del 138.10 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (27.62 lekë) në total çmimi del 165.72 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 25 shtator 2017 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,497,500 lekë për sasinë e benzinës prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 165.72 lekë/litri që është 2,485,800 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **11,700** lekë.

Kjo vlefte në total prej **232,900** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD”.

3- Me Urdhër shpenzimin nr. 820, dt. 20.11.2017 është likuiduar vlera prej 6,885,800 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 65, dt. 08.11.2017 për 30,000 litra gazoil me vlerën 5,205,600 lekë me tvsh, dhe benzinë për 10,000 litra me vlerën 1,680,200 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 7, dt. 08.11.2017 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi dt. 11.10.2017 dhe 15.09.2017 por e pa shoqëruar me deklaratën doganore SAD sipas kushteve të kontratës,

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 11.10.2017 referuar buletinit të APP.

Gazoil (Çmimi $530 + 30 = 560$ \$/ton $\times 0.8389 = (469.78 \times 113.37)/1000 = 53.25$ lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.08 lek/litri çmimi del 140.33 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.06 lekë) në total çmimi del 168.39 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 11 tetor 2017 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 5,205,600 lekë për sasinë e gazoilit prej 30,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 168.39 lekë/litri që është 5,051,700 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **143,900** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës për datën 15.09.2017 referuar buletinit të APP.

Benzina (Çmimi $584+30=614$ \$/ton $\times 0.7432 = (456.32 \times 111.95)/1000 = 51.08$ lek/litri.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.63 lek/litri çmimi del 137.21 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (27.40 lekë) në total çmimi del 164.61 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 15 shtator 2017 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 1,680,200 lekë për sasinë e benzinës prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 164.61 lekë/litri që është 1,646,100 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **34,100** lekë.

Kjo vlefte në total prej **178,000** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “Kastrati” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD”.

4- Me Urdhër shpenzimin nr. 891, dt. 21.12.2017 është likuiduar vlera prej 5,645,700 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 58, dt. 05.12.2017 për 25,402 litra gazoil me vlerën 4,429,854 lekë me tvsh, dhe benzinë për 7,185 litra me vlerën 1,215,845 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 8, dt. 05.12.2017 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi dt. 17.10.2017 dhe 15.09.2017 por e pa shoqëruar me deklaratën doganore SAD sipas kushteve të kontratës,

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 17.10.2017 referuar buletinit të APP.

Gazoil ($\text{Çmimi } 545 + 30 = 575 \text{ \$ / ton} \times 0.8360 = (480.70 \times 113.53) / 1000 = 54.57 \text{ lek / litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.30 lek/litri çmimi del 141.87 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.37 lekë) në total çmimi del 170.24 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 17 tetor 2017 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 4,429,854 lekë për sasinë e gazoilit prej 25,402 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 170.24 lekë/litri që është 4,324,436 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **105,418** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës për datën 15.09.2017 referuar buletinit të APP.

Benzina ($\text{Çmimi } 584 + 30 = 614 \text{ \$ / ton} \times 0.7432 = (456.32 \times 111.95) / 1000 = 51.08 \text{ lek / litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.63 lek/litri çmimi del 137.21 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (27.40 lekë) në total çmimi del 164.61 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 15 shtator 2017 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 1,215,845 lekë për sasinë e benzinës prej 7,185 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 164.61 lekë/litri që është 1,182,722 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **33,123** lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Kjo vleftë në total prej **138,541** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD”.

Në zbatim të kontratës nr. 25, dt. 24.07.2017 është kryer pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar në vlerën **449,441** lekë me tvsh e cila duhet të arkëtohet nga subjekti “....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD”.

-Konstatohet se për zbatimin e kontratës me subjektin e mësipërm nga autoriteti kontraktor është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim dhe ka procesverbal të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratës ku komisioni shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të shoqëruara me raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial por pa deklaratën doganore SAD, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritje, me kërkesë me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron në faturat periodike të shitjes çmimin e mallit, mbështetur në deklaratën doganore SAD” dhe pika 6, “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, duhet të kontrollojë përqindjen e rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”. Neni 31 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”, pika 3. Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

- a) çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- b) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni;
- c) marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

Gjithashtu është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 42 “Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar”, pika 54 “Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore.... financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës”.

b/2. Në zbatim të pikës pesë të programit të auditimit nr. 340/2, datë 29.05.2019, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. kontrata nr. 9, datë 28.02.2018 për furnizimin me karburant për vitin 2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

2. Urdhër shpenzimet me nr. 246, dt. 13.04.2018, nr. 314, dt. 09.05.2018, nr. 374, dt. 28.05.2018, nr. 425, dt. 22.06.2018, nr. 599, dt. 10.08.2018, nr. 602, dt. 24.08.2018, nr. 706, dt. 25.09.2018, nr. 765, dt. 19.10.2018, nr. 853, dt. 07.12.2018.

Nga auditimi u konstatua se:

Midis bashkimit të operatorëve "... sh.a dhe shpk dhe autoritetit kontraktor (Gardës së Republikës) është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 9, datë 28.02.2018 për furnizimin me karburant diesel 10 ppm me vlerën 19,430,333 lekë pa tvsh me marzh fitimi 16.7% dhe karburant benzinë pa plumb me vlerën 1,928,500 lekë pa tvsh me marzh fitimi 17.7%. Kontrata e mësipërme është me afat lëvrimi deri 31.12.2018.

Në nenin 1, 'Objekti' cilësohet si më poshtë:

1.5: Përlllogaritja e çmimit do të bëhet sipas bursës së fundit të karburanteve i cili publikohet çdo të hënë në buletin e APP-së.

1.6: në përlllogaritjen e çmimit do të pasqyrohet dhe ndryshimi i çmimit të taksës së qarkullimit mbi benzinë pa plumb dhe gazoil, sipas ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008, "Për taksat Kombëtare", të ndryshuar, si dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 497, dt. 30.05.2013.

Sa më lart është hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 31 "Kriteret për vlerësimin e ofertës";

Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

- d. çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- e. elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- f. marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

Gjithashtu kontrata e mësipërme është hartuar duke mos respektuar Dokumentet Standarde të Tenderit.

Janë likuiduar vlera me urdhër shpenzimet si më poshtë:

1- Me Urdhër shpenzimin nr. 246, dt. 13.04.2018 është likuiduar vlera prej 2,863,917 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 46, dt. 06.03.2018 për 15,000 litra gazoil me vlerën 2,612,685 lekë me tvsh, dhe benzinë për 1,500 litra me vlerën 265,232 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 14, dt. 06.03.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi dt. 07.02.2018 dhe 01.02.2018 sipas kushteve të kontratës).

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 07.02.2018 referuar buletin të APP.

Gazoil ($\text{Çmimi } 588 + 30 = 618 \text{ \$ / ton} \times 0.8322 = (514.29 \times 107.87) / 1000 = 54.47 \text{ lek / litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.28 lek / litri çmimi del 141.75 lekë / litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.35 lekë) në total çmimi del 170.10 lekë / litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 07 shkurt 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,612,685 lekë për sasinë e gazoilit prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 170.10 lekë / litri që është 2,551,500 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **61,185** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 26.02.2018 referuar buletin të APP.

Benzina ($\text{Çmimi } 632 + 30 = 662 \text{ \$ / ton} \times 0.7402 = (490.01 \times 107.08) / 1000 = 52.47 \text{ lek / litri}$).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.88 lekë/litri çmimi del 138.85 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (27.77 lekë) në total çmimi del 166.62 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 26 shkurt 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 265,232 lekë për sasinë e benzinës prej 1,500 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 166.62 lekë/litri që është 249,930 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **15,302** lekë.

Kjo vlefte në total prej **76,487** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “...” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

2- Me Urdhër shpenzimin nr. 314, dt. 09.05.2018 është likuiduar vlera prej 3,474,505 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 52, dt. 04.04.2018 për 15,000 litra gazoil me vlerën 2,619,225 lekë me tvsh, dhe benzinë për 5,000 litra me vlerën 855,280 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 15, dt. 04.04.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave për tregun e brendshëm nga Inspektorati Qendror Teknik për sasinë e produktit të tregtuar (paraqitur Raport analizimi dt. 07.03.2018 dhe 05.03.2018).

Referuar raporteve të analizave nga Inspektorati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar për gazoil të datës 07.02.2018 dhe benzinë të datës 01.02.2018 paraqitur në furnizimin e mëparshëm (U. Shpenzimi nr. 246, dt. 13.04.2018) çmimet e llogaritura janë si më poshtë:

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 07.02.2018 referuar buletinit të APP.

Gazoil (Çmimi $588+30=618$ \$/ton $\times 0.8322 = (514.29 \times 107.87)/1000 = 54.47$ lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.28 lekë/litri çmimi del 141.75 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.35 lekë) në total çmimi del 170.10 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 07 shkurt 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,619,225 lekë për sasinë e gazoilit prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 170.10 lekë/litri që është 2,551,500 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **67,725** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 01.02.2018 referuar buletinit të APP.

Benzina (Çmimi $669+30=699$ \$/ton $\times 0.7402 = (517.39 \times 107.33)/1000 = 55.53$ lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 21.42 lekë/litri çmimi del 142.45 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.49 lekë) në total çmimi del 170.94 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 01 shkurt 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 855,280 lekë për sasinë e benzinës prej 5,000 litra është më e larta se ajo e llogaritur me



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

çmimin 170.94 lekë/litri që është 854,700 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **580** lekë.

Kjo vlefte në total prej **68,307** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “...” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

3- Me Urdhër shpenzimin nr. 374, dt. 28.05.2018 është likuiduar vlera prej 2,901,660 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 58, dt.28.05.2018 për 15,000 litra gazoil me vlerën 2,724,690 lekë me tvsh, dhe benzinë për 1,000 litra me vlerën 176,970 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 16, dt. 08.05.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi dt. 03.04.2018 dhe 16.04.2018 sipas kushteve të kontratës).

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 03.04.2018 referuar buletinit të APP.

Gazoil ($\text{Çmimi } 621+30=651 \text{ \$ /ton} \times 0.8380 = (545.53 \times 105.87)/1000 = 57.75 \text{ lek/litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.83 lek/litri çmimi del 145.58 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (29.16 lekë) në total çmimi del 174.74 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 03 prill 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,724,690 lekë për sasinë e gazoilit prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 174.74 lekë/litri që është 2,621,100 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **103,590** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 16.04.2018 referuar buletinit të APP.

Benzina ($\text{Çmimi } 685+30=715 \text{ \$ /ton} \times 0.7471 = (534.17 \times 104.48)/1000 = 55.81 \text{ lek/litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 21.47 lek/litri çmimi del 142.78 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.55 lekë) në total çmimi del 171.43 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 16 prill 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 176,970 lekë për sasinë e benzinës prej 1,000 litra është më e larta se ajo e llogaritur me çmimin 171.43 lekë/litri që është 171,430 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **5,540** lekë.

Kjo vlefte në total prej **109,130** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “...” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

4- Me Urdhër shpenzimin nr. 425, dt. 22.06.2018 është likuiduar vlera prej 2,971,932 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 52, dt.06.06.2018 për 15,000 litra gazoil me vlerën 2,791,605 lekë me tvsh, dhe benzinë për 1,000 litra me vlerën 180,327 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 19, dt. 06.06.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave për tregun e brendshëm nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të tregtuar (paraqitur Raport analizimi dt. 22.05.2018).

Referuar raporteve të analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar për gazoil të datës 03.04.2018 dhe benzinë të datës 16.04.2018 paraqitur në furnizimin e mëparshëm (U. Shpenzimi nr. 374, dt. 28.05.2018) çmimet e llogaritura janë si më poshtë:

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 03.04.2018 referuar buletinit të APP.

Gazoil ($\text{Çmimi } 621+30=651 \text{ \$}/\text{ton} \times 0.8380 = (545.53 \times 105.87)/1000 = 57.75 \text{ lek}/\text{litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 20.83 lek/litri çmimi del 145.58 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (29.16 lekë) në total çmimi del 174.74 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 03 prill 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,791,605 lekë për sasinë e gazoilit prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 174.74 lekë/litri që është 2,621,100 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **170,505** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 16.04.2018 referuar buletinit të APP.

Benzina ($\text{Çmimi } 685+30=715 \text{ \$}/\text{ton} \times 0.7471 = (534.17 \times 104.48)/1000 = 55.81 \text{ lek}/\text{litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 21.47 lek/litri çmimi del 142.78 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (28.55 lekë) në total çmimi del 171.43 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 16 prill 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 180,327 lekë për sasinë e benzinës prej 1,000 litra është më e larta se ajo e llogaritur me çmimin 171.43 lekë/litri që është 171,430 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **7,897** lekë.

Kjo vlefte në total prej **178,402** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “...” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

5- Me Urdhër shpenzimin nr. 599, dt. 10.08.2018 është likuiduar vlera prej 2,877,831 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 65, dt.05.07.2018 për 15,000 litra gazoil me vlerën 2,700,360 lekë me tvsh, dhe benzinë për 1,000 litra me vlerën 177,471 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 20, dt. 05.07.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi gazoil dt. 18.06.2018 dhe benzinë dt. 29.05.2018 sipas kushteve të kontratës).

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 26.06.2018 referuar buletinit të APP.

Gazoil (Çmimi $649+30=679$ \$/ton $\times 0.8313 = (564.45 \times 107.96)/1000 = 60.93$ lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 21.36 lek/litri çmimi del 149.29 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (29.85 lekë) në total çmimi del 179.14 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 26 qershor 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,700,360 lekë për sasinë e gazoilit prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 179.14 lekë/litri që është 2,687,100 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **13,260** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 26.06.2018 referuar buletinit të APP.

Benzina (Çmimi $706+30=736$ \$/ton $\times 0.7493 = (551.48 \times 107.96)/1000 = 59.53$ lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 22.13 lek/litri çmimi del 147.16 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (29.43 lekë) në total çmimi del 176.59 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 26 qershor 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 177,471 lekë për sasinë e benzinës prej 1,000 litra është më e larta se ajo e llogaritur me çmimin 176.59 lekë/litri që është 176,590 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **881** lekë.

Kjo vlefte në total prej **14,141** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

6- Me Urdhër shpenzimin nr. 602, dt. 24.08.2018 është likuiduar vlera prej 2,921,191 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 75, dt.08.08.2018 për 15,000 litra gazoil me vlerën 2,740,455 lekë me tvsh, dhe benzinë për 1,000 litra me vlerën 180,736 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 21, dt. 08.08.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi gazoil dt. 24.07.2018 dhe benzinë dt. 27.06.2018 sipas kushteve të kontratës).

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 24.07.2018 referuar buletinit të APP.

Gazoil (Çmimi $667+30=697$ \$/ton $\times 0.8311 = (579.27 \times 107.55)/1000 = 62.30$ lek/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 21.59 lek/litri çmimi del 150.89 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (30.17 lekë) në total çmimi del 181.06 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 24 korrik 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

prej 2,740,455 lekë për sasinë e gazoilit prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 181.06 lekë/litri që është 2,715,900 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **24,555** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 30.07.2018 referuar buletinit të APP.

Benzina (Çmimi $737+30=767$ \$/ton $\times 0.7486 = (574.17 \times 107.72)/1000 = 61.84$ lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 22.13 lekë/litri çmimi del 149.87 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (29.97 lekë) në total çmimi del 179.84 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 30 korrik 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 180,736 lekë për sasinë e benzinës prej 1,000 litra është më e larta se ajo e llogaritur me çmimin 179.84 lekë/litri që është 179,840 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **10,896** lekë.

Kjo vlefte në total prej **35,451** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “.....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

7- Me Urdhër shpenzimin nr. 706, dt. 25.09.2018 është likuiduar vlera prej 2,966,476 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 22, dt.06.09.2018 për 15,000 litra gazoil me vlerën 2,785,530 lekë me tvsh, dhe benzinë për 1,000 litra me vlerën 180,946 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 21, dt. 08.08.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi gazoil dt. 26.07.2018 dhe benzinë dt. 16.08.2018 sipas kushteve të kontratës).

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 26.07.2018 referuar buletinit të APP.

Gazoil (Çmimi $672+30=702$ \$/ton $\times 0.8332 = (584.90 \times 107.43)/1000 = 62.83$ lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 21.68 lekë/litri çmimi del 151.51 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (30.30 lekë) në total çmimi del 181.81 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 26 korrik 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,785.530 lekë për sasinë e gazoilit prej 15,000 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 181.81 lekë/litri që është 2,727,150 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **58,380** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 16.08.2018 referuar buletinit të APP.

Benzina (Çmimi $698+30=728$ \$/ton $\times 0.7510 = (546.70 \times 110.44)/1000 = 60.37$ lekë/litri.

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 22.27 lekë/litri çmimi del 148.14 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (29.62 lekë) në total çmimi del 177.76 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 16 gusht 2018 pasi si



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 180,946 lekë për sasinë e benzinës prej 1,000 litra është më e larta se ajo e llogaritur me çmimin 177.76 lekë/litri që është 177,760 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **3,186** lekë.

Kjo vlefte në total prej **59,566** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “Kastrati” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

8- Me Urdhër shpenzimin nr. 765, dt. 19.10.2018 është likuiduar vlera prej 2,963,796 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 67, dt.03.10.2018 për 15,000 litra gazoil me vlerën 2,784,840 lekë me tvsh, dhe benzinë për 1,000 litra me vlerën 178,956 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 24, dt. 03.10.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi gazoil dt. 21.09.2018 dhe benzinë dt. 29.08.2018 sipas kushteve të kontratës).

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 21.09.2018 referuar buletinit të APP.

Gazoil ($\text{Çmimi } 694 + 30 = 724 \text{ \$ / ton} \times 0.8362 = (605.40 \times 107.30) / 1000 = 64.95 \text{ lek / litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 22.03 lek/litri çmimi del 153.98 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (30.79 lekë) në total çmimi del 184.77 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 21 shtator 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 2,784,840 lekë për sasinë e gazoilit prej 15,000 litra është më e larta se ajo e llogaritur me çmimin 184.77 lekë/litri që është 2,771,550 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **13,290** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 21.09.2018 referuar buletinit të APP.

Benzina ($\text{Çmimi } 720 + 30 = 750 \text{ \$ / ton} \times 0.7529 = (564.67 \times 107.30) / 1000 = 60.58 \text{ lek / litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 22.31 lek/litri çmimi del 148.39 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (29.67 lekë) në total çmimi del 178.06 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 21 shtator 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 178,956 lekë për sasinë e benzinës prej 1,000 litra është më e larta se ajo e llogaritur me çmimin 178.06 lekë/litri që është 178,060 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **896** lekë.

Kjo vlefte në total prej **14,186** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

9- Me Urdhër shpenzimin nr. 853, dt. 07.12.2018 është likuiduar vlera prej 1,689,042 lekë me tvsh.

Ky urdhër shoqërohet me faturën tatimore nr. 82, dt.06.11.2018 për 8228 litra gazoil me vlerën 1,556,893 lekë me tvsh, dhe benzinë për 753 litra me vlerën 132,147 lekë me tvsh, fletë hyrjen nr. 25, dt. 06.11.2018 sipas një çmimi të llogaritur nga operatori, e shoqëruar me raportin e analizave nga Inspektoriati Qendror Teknik për sasinë e produktit të importuar (paraqitur Raport analizimi gazoil dt. 08.10.2018 dhe benzinë dt. 27.08.2018 sipas kushteve të kontratës).

Llogaritja e çmimit të gazoilit është bërë për datën 30.10.2018 referuar buletinit të APP.

Gazoil ($\text{Çmimi } 708 + 30 = 738 \text{ \$ / ton} \times 0.8329 = (614.68 \times 109.82) / 1000 = 67.50 \text{ lek / litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 3 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitim 22.46 lek/litri çmimi del 156.96 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (31.39 lekë) në total çmimi del 188.35 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 30 tetor 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 1,556,893 lekë për sasinë e gazoilit prej 8228 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 188.35 lekë/litri që është 1,549.743 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **7,150** lekë.

Llogaritja e çmimit të benzinës është për datën 30.10.2018 referuar buletinit të APP.

Benzina ($\text{Çmimi } 674 + 30 = 704 \text{ \$ / ton} \times 0.7520 = (529.40 \times 109.82) / 1000 = 58.13 \text{ lek / litri}$).

Akciza 37 lekë, taksa e karbonit 1.5 lekë, taksa e qarkullimit 27 lekë, marzhi i fitimit 21.88 lek/litri çmimi del 145.51 lekë/litri pa t.v.sh. duke shtuar 20% t.v.sh (29.10 lekë) në total çmimi del 174.61 lekë/litri.

Nga llogaritja e furnizimit të likuiduar rezulton se nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën 30 tetor 2018 pasi si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë edhe vlefte e likuiduar prej 132,147 lekë për sasinë e benzinës prej 753 litra është më të larta se ajo e llogaritur me çmimin 174.61 lekë/litri që është 131,481 lekë duke sjellë një pagesë tepër për gazoilin prej **666** lekë.

Kjo vlefte në total prej **7,816** lekë si pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar duhet të arkëtohet nga subjekti “Kastrati” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

Në zbatim të kontratës **nr. 9, dt. 28.02.2018** është kryer pagesë e tepërt për gazoilin dhe benzinën e likuiduar në vlerën **563,486** lekë me tvsh e cila duhet të arkëtohet nga subjekti “...” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”.

-Konstatohet se për zbatimin e kontratës me subjektin e mësipërm nga autoriteti kontraktor është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim dhe ka procesverbal të marrjes në dorëzim të mallit sipas kontratës ku komisioni shprehen për cilësinë dhe plotësimin e specifikimeve teknike të shoqëruara me raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 77, pika 5, *“Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”*. Pika 6 *“Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”*.

Neni 31 Kriteret për vlerësimin e ofertës

Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

- a. çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- b. elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- c. marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

Gjithashtu është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, pika 42 *“Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues”*, pika 54 *“Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore.... financat duhet të kontrollojnë nëse fletëhyrja ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës ”*.

Titulli i gjetjes 6:	Nga auditimi i hartimit të kontratave të furnizimit me karburante u konstatua se në hartimin e kontratave të furnizimit me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje nuk janë marë parasysh kriteret për vlerësimin e furniturës, si çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF Shqipëri, elementeve fiskalë, etje, referuar rregullave të prokurimit publik dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit.
Situata1:	Nga auditimi i hartimit të kontratave të furnizimit me karburante u konstatua se: a. Midis bashkimit të operatorëve “....” sh.a dhe “...” shpk dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 25, datë 24.07.2017 për furnizimin me karburant diesel 10 ppm me vlerën 19,141,334 lekë pa tvsh me marzh fitimi 16.7% dhe karburant benzinë pa plumb me vlerën 6,525,000 lekë pa tvsh me marzh fitimi 17.7% për Gardën e Republikës. Kontrata e mësipërme është me afat lëvrimi deri 31.12.2017. b. Midis bashkimit të operatorëve “....” sh.a dhe “...” shpk dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	autoritetit kontraktor (Gardës së Republikës) është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 9, datë 28.02.2018 për furnizimin me karburant diesel 10 ppm me vlerën 19,430,333 lekë pa tvsh me marzh fitimi 16.7% dhe karburant benzinë pa plumb me vlerën 1,928,500 lekë pa tvsh me marzh fitimi 17.7%. Kontrata e mësipërme është me afat lëvrimi deri 31.12.2018. Në nenin 1, “Objekti” të kontratave cilësohet si më poshtë: 1.5: Përllogaritja e çmimit do të bëhet sipas bursës së fundit të karburanteve i cili publikohet çdo të hënë në buletin e APP-së. 1.6: në përllogaritjen e çmimit do të pasqyrohet dhe ndryshimi i çmimit të taksës së qarkullimit mbi benzinë pa plumb dhe gazoil, sipas ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008, “Për taksat Kombëtare”, të ndryshuar, si dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 497, dt. 30.05.2013. Sa më lart është hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 31 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”; Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në: a. çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; b. elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi; c. marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje. Gjithashtu kontratat e mësipërme janë hartuar duke mos respektuar Dokumentet Standarde të Tenderit.
Situata 2	Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletinet e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si “taksa e markimit” në kundërshtime me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77, pika 5, “Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”. Pika 6 “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”
Situata 3:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 25, dt. 24.07.2017 dhe nr. 9, dt. 28.02.2018 rezultoi se në likuidimin e sasisë së karburantit gazoil dhe benzol nga Garda e Republikës, nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	për datën e furniturës <i>lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment</i>, si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën 1,012,927 lekë me tvsh e cila duhet të arkëtohet nga subjekti “.....” sh.a. pasi është përfituar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “<i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i>”, neni 77, pika 5, “<i>Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment</i>”.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ”, dhe Dokumentet Standarde të Tenderit
Ndikimi/Efekti	Në likuidimin e sasisë së karburantit gazoil dhe benzol nga Garda e Republikës, nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datën e furniturës <i>lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment</i> , si element i çmimit është llogaritur edhe markimi i karburantit si rrjedhojë janë kryer pagesa të tepërta për gazoilin dhe benzolin e likuiduar në vlerën 1,012,927 lekë me tvsh.
Rëndësia	I lartë
Rekomandime	Autoriteti Kontraktor Garda e Republikës, në hartimin e kontratave të furnizimit me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje të marrin parasysh kriteret për vlerësimin e furniturës, si çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF Shqipëri, elementeve fiskalë, etje, referuar rregullave të prokurimit publik dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit. - Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe kushteve të kontratës. - Autoriteti kontraktor, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furniturës, sipas <i>sipas kushtit CIF-Shqipëri</i>, raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj. - Nga Garda e Republikës, sektori i financës të merren masat të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej 1,012,927 lekë nga OE “....” sha. përfituar padrejtësisht si rezultat i mos respektimit të çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturat bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, në kundërshtim me VKM



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

6. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

U shqyrtua dokumentacioni dhe rezultoi si më poshtë:

1. Strukturat përgjegjëse të Gardës së Republikës (GR), kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin për MFK-në, (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010) dhe Manualin e ri, (miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016) si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Politikat institucionale janë bazuar në Strategjinë Sektoriale 2019-2021 dhe PBA 2019-2021.

Me urdhrin e Komandantit të Gr nr. 22, datë 04.01.2019 është miratuar dokumenti Strategjia e GR për periudhën 2019-2021.

2. Për periudhën objekt auditimi nuk ka qenë ngritur grupi i menaxhimit strategjik (për vitet 2017 dhe 2018). Nga ana e institucionit të GR, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për v.2019, në cilësinë e një Komiteti që duhet të evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, sipas përcaktimit të nenëve 8, 10 dhe 27/2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe kreut III, të Manualit “Për MFK”. Edhe në kreun II, pika 2.2.6 të Manualit të ri të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, nënvizohet se:

“GMS luan një rol kyç përse i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike”.

Konstatimi:

Me urdhrin e brendshëm të Komandantit të Gardës së Republikës Z. ... me nr. 682, datë 26.03.2019 është ngritur GMS me këtë përbërje:,,, dhe

Nuk ka produkte të dokumentuara të veprimtarisë së GMS për periudhën objekt auditimi, por ky proces është korigjuar për v.2019.

Nga ana e auditimit konstatohet se me shkresën nr. 599/1, datë 21.03.2017 (dërguar MPB), është ngritur Ekipi menaxhues i Punës së programeve me 5 antëarë, i cili është përtërirë me shkresën nr. 2206/1 prot., datë 16.04.2018. Gjithashtu rezulton se, nga ana e institucionit të GR është hartuar dokumenti “Plan Veprimi për MFK”, miratuar me urdhrin nr. 181, datë 21.01.2019.

3. Nga auditimi i kryer në lidhje me **politikat, procedurat dhe kuadrin ligjor e rregullativ në fuqi dhe aktet e politikave vijuese të dala në zbatim të tij**, konstatohet se ekzistojnë disa mangësi dhe mospërputhje, dhe më konkretisht:

Garda e Republikës ushtron veprimtarinë mbështetur në **ligjin nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për gardën e RSH”** e ndryshuar me ligjin nr. 9445, datë 16.11.2005 si dhe **Rregulloren e brendshme të GR**, miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 2594, datë 24.10.2006, në fuqi për periudhën objekt auditimi dhe aktualisht.

Në dokumentin Rregullorja e Brendshme e GR, trajtohen rregullat e punës dhe shërbimit dhe aspekte të tilla si misioni dhe vartësia, betimi, flamuri i gardës, veprimtaria, kompetencat, organizimi i strukturave, emërtimi, perberja dhe detyrat e tyre, rregullat e pergjithshme, rregulat e administrimit, funksionet dhe detyrat e çdo hallke dhe niveli, komunikimi i dokumentacionit, etj.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Sipas Vendimit nr. 445, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, limit organik, dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në GRSH””, ndryshuar me VKM nr. 66, datë 07.02.2018.

Neni 8, i ligjit nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për gardën e RSH”, ndryshuar me ligjin nr. 9445, datë 16.11.2005 ka përcaktuar shprehimisht se:

1. Garda përbëhet nga **komanda qendrore, drejtori dhe struktura te tjera vartëse.**
2. **Struktura, organizimi, varësia strukturore dhe limiti organik i Gardës se Republikës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit te Brendshëm.**

Mbi këtë bazë, është hartuar dhe miratuar nga titullari i institucionit të audituar, rregullorja e brendshme, ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore për çdo sektor, sipas strukturës dhe organikës së institucionit, në përputhje me misionin dhe objektivat e tij.

Duke analizuar përmbajtjen e ligjit, si dhe pozicionet e rolet e vendura në rregulloren e brendshme të institucionit, konstatohet se **mungon një përputhje dhe harmonizim i akteve dhe dispozitave** (akteve ligjore e nënligjore si dhe strukturave),.

Konstatime:

3.1. Këto akte nuk janë në koherencë me dispozitat ligjore që normojnë kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar publik, pasi rregullorja nuk është rishikuar pas miratimit të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015.

3.2. Disa pozicione dhe emërtesa funksionesh dhe pozicionesh të përfshira dhe referuara në Rregulloren e Brendshme, (miratuar nga Ministri Brendshëm me Urdhrin nr.2594, datë 24.10.2006), si dhe Rregulloren e Personelit (miratuar nga këshilli i Ministrave me VKM nr.66, datë 14.01.2014) nuk përputhen ose mungojnë në Vendimit nr. 445, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, limit organik, dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në GRSH””, ndryshuar me VKM nr. 66, datë 07.02.2018. Referuar Manualit të MFK, Struktura organizative është korniza me anë të cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Struktura duhet të jetë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësisë dhe misionin e saj, duhet të vlerësohet kohë pas kohe dhe të modifikohet në rast se gjykohet e nevojshme.

Konkretisht:

<i>Emërtesa/ pozicioni ose funksioni sipas Rregullores se Brendshme te GSH</i>	<i>Emërtesa/ pozicioni ose funksioni sipas VKM për strukturën, përbërjen organike dhe numrin limit të funksioneve dhe pozicioneve në GSH</i>
Kapitulli I, Pika 1.4, Shefi i Shtabit të gardës, faqe 17 e rregullores	Mungon ky pozicion në organigramën që shoqëron VKM.
Kapitulli I, Pika 1.5, Zyra ndihmëse, faqe 20 e rregullores; Shefi i Zyres ndihmese,	Mungon ky pozicion në organigramën që shoqëron VKM.
Sektori i planizimit dhe drejtimit operacional Pika 1,6, faqe 20 e rregullores	Drejtorja e Planifikimit Kooordinimit dhe Kontrollit
Dega e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së PLSH, Pika 1,8, faqe 21 e rregullores	Drejtorja për Sigurinë e afërt të PLSH dhe ruajtjen e familjeve të tyre
Qendra e Trajnimit, Pika 1,7, faqe 21 e rregullores	Qendra e Formimit dhe Kualifikimit profesional
Shefi i Planizimit dhe Drejtimit, Pika 2.2,	Drejtori i planifikimit, Koordinimit dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

faqe 21 e rregullores	Kontrollit
Mungojnë përshkrimet e këtij pozicioni në rregullore, meqenese strukturat e evetingut janë krijuar në vitin 2018.	Drejtoria e Mbrotjes së Organeve të Vettingut

3.3. Sistemi i masave disiplinore të referuara në ligj dhe atyre në rregulloren e personelit kanë disa ndryshime, si më poshtë vijon:

Neni 16, i ligjit nr. Nr.8869, datë 22.5.2003 ka përcaktuar se punonjësit e Gardës ndëshkohen me këto masa disiplinore:

- a) vërejtje;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) gjobe në masën e pagës deri në 5 dite pune;
- ç) shtyrje e afatit të gradimit deri në një vit;
- d) ulje në detyrë ose në funksion;
- dh) pezullim nga detyra ose nga funksioni deri në 3 muaj, ose deri në përfundimin e çështjes penale;
- e) përjashtim nga Garda e lirim, sipas pikës 2 të nenit 14.

Kurse në rregulloren e personelit gjejnë rregullim vetëm këto kategori masash ndërkohë:

- Në nenin 9, transferimi dhe levizja;
- Në nenin 11, pezullimi nga detyra
- Në nenin 12, venia në dispozicion
- Në nenin 13, largimet dhe përjashtimet nga GRSh

3.4. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të GRSh, nuk ka patur të inkuadruara për periudhën objekt kontrolli detyrat e për disa pozicioneve dhe kategorive, si drejtoria e shërbimeve mbështetëse, sektori shëndetësor, sektori i komunikimit dhe elektronikës, sektori i transportit, magazinieri dhe përgjegjësit e tij, etj në kuadër të zbatimit të parimeve dhe kërkesave të MFK, por ato janë korrigjuar dhe rregulluar me Manualin mbi Përshkrimet dhe përgjegjësitë e punës për funksionet organike të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse (DSHM), miratuar me urdhrin e Komandantit të Gardës me nr. 3965, datë 16.11.2018.

Grupi i auditimit vlerëson hartimin e këtij dokumenti, por ai duhet të ishte inkuadruar si pjesë e rregullores së gardës dhe të miratohej nga Ministri i Brendshëm.

3.5. Disa referenca ligjore të përfshira në dokumentin e titulluar “Rregullorja e Gardës së Republikës” janë akte të cilat janë shfuqizuar dhe nuk kanë fuqi ligjore në periudhën e audituar. Më konkretisht:

Në Kapitullin III “Rregullat e përgjithshme për jetën në GR”, në pikën nr. 9 të këtij kreu trajtohen “rregullat e shërbimeve të financës” (faqe 110-114 e rregullores), janë këto dispozita të shfuqizuara:

- Ligji nr. 7661, datë 19.01.1993
- Ligji nr. 6942, datë 25.12.1984
- Ligji nr. 7971, datë 26.7.1995
- VKM nr. 70, datë 11.3.1985
- VKM nr. 335, datë 23.6.2000, etj

Procesi i përshkrimit dhe vlerësimit të punës për çdo pozicion në GR bazohet në nenin 8, pika VI të Rregullores së personelit, miratuar me VKM nr.66, datë 14.01.2014 “Për miratimin e rregullores së personelit në GRSh”, ku sanksionohet se “vlerësimi i punës si rregull bëhet vjetor dhe çdo përfundim viti, brenda muajit janar të vitit pasardhës dhe për raste të vecanta edhe gjatë vitit kur punonjësi transferohet, lëviz nga detyra, etj”



Përfundimi:

Për sa më sipër, bëhet e domosdoshme rishikimi i Rregullores së Gardës së Republikës, të harmonizohet ajo me kuadrin përkatës ligjor dhe dipozitat e tjera në fuqi.

4. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se janë përcaktuar **nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ) ne pozicionin e Shefit te Sektorit të Financës, si vijon:**

Me shkresën nr. 2349 / 2 prot, datë 03.09.2014 i është dërguar Ministrisë së Financave (NJQMFK) caktimi i Nëpunësit të dytë autorizues për programin buxhetor garda e republikës (z.) dhe me shkresën nr. 2349 / 2 prot, datë 09.09.2014 ky institucion i ka kërkuar SP së ministrise së Punëve të Brendshme kërkesën për miratimin e nëpunësit të dytë autorizues.

Caktimi i NZ për këtë njësi shpenzuese (z.....) është kryer sipas shkresës me nr. 1363/1 prot., date 02.07.2012. Në funksion të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, (neni 12), nëpunësi zbatues, është niveli menaxherial në vartësi direkte të NA. Në funksionet e tij, Sektori i Financës mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Aktualisht z. kryen funksionet e përcaktuara më sipër dhe është në vartësi direkte të Komandantit të Gardës. Sa më sipër, janë përmbushur kërkesat e Nenit 12/1, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues” të ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar,

5. Nga ana e institucionit të GRSH janë përgatitur **Pyetësorët e Vetëvlerësimit dhe Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm për vitin 2017 dhe 2018. Përkatësisht:**

- ✓ Deklarata për cilësinë e sistemit të KB të GR për vitin 2017, sipas shkresës nr. 1 prot, datë 04.01.2018;
- ✓ Deklarata për cilësinë e sistemit të KB të GR për vitin 2018, sipas shkresës nr. 181 prot, datë 21.01.2019; (derguar MPB brenda afatit të plotësimit sipas Manualit të MFK që është deri me datën 28 shkurt 2019). Këto akte janë nënshkruar nga Komandanti i GR dhe i janë dërguar Ministrisë së linjës administrative.

Janë hartuar deklarata mbi sistemin dhe raportin përkatës për cilësinë kontrolleve të brendshme për vitin 2017, deklarata e nëpunësit autorizues për cilësinë e sistemit të kontrollit, në bazë të përgjegjësisë të kreut III, pika 3.3 e Manualit PMFK dhe cilësimeve të nenit 18 të ligjit nr.10296. Nga misioni i auditimit vërehet se Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm është dorëzuar brenda afatit ligjor, përcaktuar në nenin 18, të ligjit dhe pikat nr. 4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se *“deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave”*

Konstatim:

Nuk është përgatitur Raporti Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar që përcakton se nëpunësi autorizues i njësisë publike së bashku me deklaratën mbi SKB paraqet raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm.

Sa sipër nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e:

- ✓ **nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar,**

Manualit të MFK , kapitulli III, pika 3.5 “Raporti Vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm”, që përcakton se :

“ Çdo vit, NA i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport (Shih Aneksin nr.7) mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te NPA në MF. Kjo është një kërkesë e nenit 18 (paragrafi 1), të Ligjit për MFK-në.Raporti duhet të dorëzohet deri në fund të shkurtit dhe mbulon vitin e kaluar financiar (janardhjetor).Ai dorëzohet së bashku me deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

të brendshëm, e cili është gjithashtu një kërkesë e nenit 18 (paragrafi 1). Informacioni i dhënë në raportin vjetor duhet të jetë në përputhje me deklaratën. Në fakt, deklarata ofron njëpërmbledhje të konkluzioneve të raportit vjetor.

Përmes raportit vjetor, subjektet e raportimit raportojnë te DH/MFK për funksionimin e sistemit të MFK-së sipas komponentëve të tij”

- ✓ **detyrimet e pikës nr. 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.11.2008, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.**

Nga analiza e hollësishme e këtij dokumenti vërejmë se:

-Ky raport është përgatitur nga ana e NA, në koordinim me hallkat e tjera të këtij institucioni.

-Raporti duhet të sintetizojë arritjet dhe mangësitë e konstatuara në procesin e MFK duke listuar dhe disa rekomandime për përmirësim gjatë periudhave të ardhshme.

- Nga analiza e rubrikave të plotësuara të Pyetësorit sipas komponentëve mbi MFK, vlerësojmë se vlerësimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm (SKB) & Menaxhimit Financiar (Mf) janë kryer me pikë (1-4), por për vitin 2017, nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e pikës nr. 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pasi Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka të përfshira gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm (Ministrise se Brendshme) si dhe nuk referon një plan veprimi për të ardhmen, sikundër parashikohet në këtë udhëzim:

“ Raporti duhet të strukturohet sipas formatit të përshkruar në Shtojcën 2 të këtij udhëzimi, i cili përbëhet nga:

(a) Përmbledhja ekzekutive;

(b) Vlerësimi i sistemit ekzistues të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë;

(c) Gjetjet dhe rekomandimet nga auditimi i brendshëm dhe i Ministrise se linjës;

(ç) Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan-veprimin për të ardhmen;

(d) Rekomandime të përgjithshme për Ministrinë e Financave, lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor ekzistues mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.”

Grupi i auditimit të KLSH u fokusua në realizimin e objektivave të institucionit dhe përdorimin me efektivitet të fondeve të tij, për të gjithë komponentët si “mjedisi i kontrollit”, “menaxhimi i riskut”, “aktivitetet e kontrollit”, “informimi dhe komunikimi” dhe “monitorimi”. Nga shqyrtimi i **plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit** kanë rezultuar disa mangësi, pasi nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e kapitullit V, të Manualit për MFK. Analiza e të dhënave të pyetësorëve tregon se, nëpunësi autorizues dhe zbatues janë mjaftuar vetëm me vendosjen e pikëve sipas kriterëve të vetëvlerësimit (numrat nga 1-4 për çdo çështje), pa i shoqëruar rubrikat e pyetësorit që kanë vlerësimin më të dobët me shpjegimin e arsyeve dhe me komentet respektive, siç cilësohet në Kapitullin III, Hapi III, kreu “Procesi i Implementimit të MFK” dhe kreun V, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010, i ndryshuar. Me konkretisht, në pyetësorin e vetëvlerësimit për v.2017 nuk janë plotësuar me komente dhe arsyetim 3 rubrika në komponentin “mjedisi i kontrollit”, 3 rubrika në komponentin “menaxhimi i riskut”, 3 rubrika në komponentin “aktivitetet e kontrollit”, 5 rubrika në komponentin “informimi dhe komunikimi” dhe 5 rubrika në komponentin “monitorimi”.

Nga analiza mbi vetëvlerësimin e kryer nga ana e NA dhe NZ të GR për vitin 2017, vërejmë se elementet sipas vlerësimit paraqiten të strukturuar kundrejt modelit COSO si më poshtë:

- ✚ Për komponentin e parë të COSO, “Mjedisi i kontrollit”, nën komponenti “Politikat dhe praktikatat e burimeve njerëzore”, për kriterin “politikatat dhe praktikatat e burimeve njerëzore garantojnë mirëmbajtjen dhe përmirësimin e aftësive profesionale të stafit”, është dhënë vlerësimi në pyetësor me 60 pikë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- ✚ Për komponentin e dytë të COSO, “Menaxhimi i riskut”, ku për ekzistencën e strategjisë së riskut (kolona nr.12 e pyetësorit), ekzistencën e regjistrit të riskut, përfshirjen e drejtuesve të të gjitha niveleve në hartimin e regjistrit të risqeve, janë dhënë vlerësimet në pyetësor me 12 pikë.
- ✚ Për komponentin e tretë të COSO, “Aktivitetet e kontrollit”, ku për ekzistencën e *sistemit rezervë të back up* (kolona nr.29 e pyetësorit), janë dhënë vlerësimet në pyetësor me 27 pikë, informacioni dhe komunikimi me 23 dhe monitorimi 16.

Komponenti KB	Rezultatet e vetëvlerësimit sipas pyetësorit të vitit 2017 sipas shkresës nr.200/1 dt 15.02.2018	Rezultatet e vetëvlerësimit sipas pyetësorit të datës 2019
Mjedisi kontrollit	60	Ka ndryshuar formulari, bazuar ne parimet eCOSO te KB
Menaxhimi i riskut	12	x
Aktivitetet e kontrollit	27	x
Informacioni dhe komunikimi	23	x
Monitorimi	16	Ka ndryshuar formulari, bazuar ne parimet eCOSO te KB
totali	138 pikë	

6. Nga auditimi i detyrimeve që burojnë në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të GR, (parashikuar në pikën 8, neni 8, të ligjit nr.10296), konstatohet se, kanë gjetur zbatim detyrimet që lidhen me:

-*hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të Institucionit, të planeve vjetore dhe plan-veprimet për arritjen e objektivave;*
 -*miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.*

-*miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësi të tyre;*

Njësia nuk ka funksionin e auditimit të brendshëm dhe këto shërbime janë kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të MB. Auditimi i fundit i Ministrisë, është realizuar sipas programit nr. 7721/2 prot, datë 20.11.2017 dhe auditimit me nr. 9261 date 09.11.2018, ndërsa përfundimet janë dërguar nga Ministria e Brendshme përkatësisht me shkresat me nr. 7721/5 prot, datë 12.01.2018 dhe me nr. 9261/5 prot, datë 05.02.2019.

▪ **Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të buxhetit rezultoi se:**

Procedurat e buxhetimit kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në dispozitat ligjore të buxhetit të shtetit. Treguesit e detajuar buxhetorë të hartuar nga GR Tiranë janë diskutuar e analizuar në MPB dhe MF. Procedurat për hartimin e projekt-buxhetit i janë referuar akteve ligjore për hartimin dhe zbatimin e buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrit të Financave. *Nga auditimi u konstatua se:*

-Raporti i monitorimit për periudhën objekt auditimi si dhe raportet periodike që institucioni ne pergjithesi i ka dorëzuar Ministrise se linjës administrative, janë të plotësuar me një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

në baze të kreut IV “Monitorimi” të Udhëzimit plotësues të MoF për zbatimin e buxhetit të shtetit.

▪ **Nga analiza e sistemit të kontrolleve të kontabilitetit rezultoi:**

Janë hartuar rregullat bazë për organizmin kontabël dhe administrimin e pasurisë. Veprimet financiare janë autorizuar sipas rregulloreve dhe janë regjistruar e dokumentuar rast pas rasti. Mbajtja e kontabilitetit, aplikimi i rregullave kontabël nuk është mbështetur në parimin e kontabilitetit rrjedhës, pra mbi bazën e angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara. Procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit për dalje jashtë përdorimit janë përfunduar me raportin e grupit të punës dhe me ngritjen e komisionit të asgjësimit, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të M.F nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar dhe udhëzimit të MPB të dalë për këtë qëllim.

7. Audituesit e KLSH-së konstatojnë se janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e **Regjistrit të Risqeve**, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2018, në lidhje me Parimi nr. 8 të COSO në komponentin “menaxhimi i risqeve”, sipas së cilës, “njësia publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime “, audituesit e KLSH-së kanë vërejtur se nga drejtuesit e GR është vënë shënimi se “nuk janë ndeshur ndonjëherë me këtë lloj risku dhe se GR ofron siguri”. Në fakt, siopas parimeve COSO mbi SKB, çdo autoritet publik apo privat nuk mund të jetë imun dhe se mund të ofrojë vetëm siguri të arsyeshme se objektivat e vendosura nuk do të kërcënohen nga risqet e ndrsyhsmë, qofshin këto dhe risqet e mshtimit.

Në institucionin e GR është hartuar regjistri i riskut ku janë evidentuar risqet para kontrollit dhe përfshin zotëruesit e këtyre risqeve, si dhe rezultatet pas implementimit të KB.

Konstatohet se:

1. Ky dokument është hartuar pa referuar periudhën që i takon/ vitin referuar me qëllim përditësimi, duke evidentuar risqet që shtohen dhe ato që hiqen nga kjo matrice.
2. Nuk gjen pasqyrim risku nga mungesa e plotësimit të pozicioneve të punësimit, si një risk operacional dhe si faktor kërcënimi nepermbusjen e objektivave themelore të këtij sektori, (përfshij mangësitë dhe pengesat në zbatimin e legjislacionit mbi gradat, etj).
3. Nuk parashikohet niveli i ri i risqeve pas aplikimit të kontrolleve, referuar programit buxhetor afatmesëm, etj. Në disa raste, niveli i risqeve pas kontrollit të vendosur paraqitet në nivele të pandryshueshme si më parë (i lartë - i lartë), apo për më tej dhe duke u shtuar (në përkeqësim pas kontrollit), gjë që kërkon një punë më të kujdeshme nga hartuesit dhe miratuesit e tij.
4. Në lidhje me rubrikën nr. 22 të pyetësorit COSO për vitin 2018, “Drejtuesit e të gjitha niveleve a përfshihen në hartimin e regjistrit të riskut” si dhe nr. 23 “A ka nevojë për trajnim të mëtejshëm të drejtuesve në menaxhimin e rrezikut”, është vënë shënimi se kjo detyrë i besohet vetëm sektorit të buxhet- financës, duke treguar një moskuptim të drejtë të rolit të çdo aktori e faktori në institucion.

8. Për periudhën objekt auditimi, **nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve**, detyrimi i neneve 8 (pika 8/a), 10 dhe 21 (pika 2), të ligjit nr. 10296. Në mënyrë më të detajuar, përgjegjshmëria e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, rregullohet nga kjo dispozitë ligjore si më poshtë vijon:

“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e **objektivave të njësive publike** që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë **strategjinë e menaxhimit të riskut** dhe të **plan-veprimeve për arritjen e objektivave**;

b) ngritjen e **grupit të menaxhimit strategjik të njësive publike**, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

Neni 21. Menaxhimi i riskut:

2. Për t'i zbatuar veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësive publike miraton **një strategji**, e cila përditësohet **çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut**. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

si dhe përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016:

“Çdo NjQQ dhe NjQV duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut që përditësohet rregullisht (çdo tre vjet) ose kur në mjedisin e riskut ndodhin ndryshime të rëndësishme. Strategjia duhet të përgatitet nga NA në cilësinë e KR. Titullari i njësive miraton strategjinë e menaxhimit të riskut. NA analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit”.

9.Grupi i auditimi konstaton se në institucion ka dhomë të serverave, administrimi i të dhënave kryhet nga Sektori i TIK. Sistemi i teknologjisë së informacionit siguron një procedurë për hedhjen e të dhënave (data base) në një sistem rezervë, automatik e të sinkronizuar (backup), gjë që mundëson ruajtjen e një kopje të informacionit, **por kjo vetëm për pjesën e shërbimeve financiare, pa inkuadruar ende shërbimet e tjera dhe nuk është mundësuar digjitalizimi i tyre.**

Nga ana e institucionit zbatohet rregullorja specifike, e titulluar “Dokumenti punes per komunikimin me mjetet e nderlidhjes dhe eshte miruyar me urdhrin nr. 409, date 03.07.2015 te Komandantit te GR, sipas urdhrin te punes nr. 930 date 08.04.2015.

Në këtë rregullore jepen kërkesa për serverat, nderlidhjen, elektronikën, programet dhe softet, për përdorimin e postës elektronike dhe rregullorja e përdorimit të internetit në GR, (trajtuar në pikën nr. 28 të pyetësorit të vetëvlerësimit 2017 “Komunikimi elektronik” dhe Kapitulli “Detyrat e sektorit të Komunikimit dhe Elektronikës”, të trajtuara në manualin e përshkrimit të procesve dhe përgjegjësisë të punës për funksionet në organikë të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, miratuar me urdhrin e Komandantit të GR me nr. 3965, date 16.11.2018.

Përsa i takon mbrojtjes së informacionit të përdoruesve dhe kontrollit periodik të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar, institucioni zbaton udhëzimet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për këtë qëllim.

Konstatim: Nga GR është hartuar Rregullorja për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit, (konfirmuar dhe nga përgjigjet e pikës nr. 28 të pyetësorit të vetëvlerësimit), gjë që mbetet detyrim për tu zbatuar dhe përditësuar.

10.Nga ana e institucionit të GR **zbatohen rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e aktiveve**, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa “ç”, të ligjit nr. 10296/2010. Në pajtim me detyrimet e pikës nr. 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, titullari i njësive publike ka miratuar rregullat dhe procedurat për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike. Konstatohet se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, është hartuar regjistri i aseteve, detyrim nga pika nr. 26, kreu III, e Udhëzimit të MF nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të kreut IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, janë iniciuar procedurat e inventarizimit të pasurisë dhe të drejtave e detyrimeve 1 herë në vit, sipas urdhrave të veçantë të GR, por pa u finalizuar, trajtuar tek kapitulli mbi kontabilitetin dhe bilancin kontabël vjetor.

11. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 16, të ligjit nr.10296/2010, mbi përgjegjësitë e titullarit të subjektit publik për **përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit**, ku shprehimisht përcaktohet:

“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”.

Nga ana e nëpunësit zbatues iu dipzonua grupit të audituesve të KLSH një gjurmë auditimi me titull : “Vendimet gjyqësore për punonjës të larguar nga puna z.....”, dhe aty janë trajtuar etapat (nga urdheri i titullarit për përjashtim nga strukturat e GR, kërkesat drejtuar gjykatës, vendimet gjyqësore sipas shkallëve, lajmërimet për ekzekutivm vullnetarrekursi, përgatitja e dokumentacionit për ekzekutimin e pagesave, etj), përshkrimi i etapave, strukturat përgjegjëse dhe afatet e ndjekjes/ realizimit). Kjo gjurmë auditimi i takon një rasti konkret, specifik dhe është përgatitur nga nënkolonel dhe miratuar nga Komandanti i GR z.....

Grupi i auditimit sjell në vëmendje se:

- Sipas cilësimeve të pikës nr. 19, neni 4 të ligjit:

“Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. “

- Sipas kreut 3.3. “Aktivitetet e kontrollit” të Manualit të MFK

“Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveçkësaj, gjurma e auditimit (Shih Aneksin nr.4) jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Përgjegjësia për miratimin e e gjurmës së auditimit i takon titullarit. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga manaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to. Gjurmët e auditimit duhet të përfshijnë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumentave që përmban një proces.

Pra, janë ndërtuar disa harta të procesesh pune, por ata nuk janë të unifikuara për të gjithë institucionin, dhe janë kompozuar vetëm për disa procedura tek sektori i financës.

12. U verifikua zbatimi i kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016), mbi përgatitja e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës. Këto manuale garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Auditimi i KLSH-së vëren se,:



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

-nga ana e Drejtorisë së Sherbimeve Mbështetëse është hartuar manuali i përshkrimit të procesve dhe përgjegjësi të punës për funksionet në organikë të Drejtorisë së Sherbimeve Mbështetëse, miratuar me urdhrin e Komandantit të GR me nr. 3965, date 16.11.2018;

-nga ana e Drejtorisë së Planikimit, Koordinimit dhe Kontrollit është hartuar manuali i përshkrimit të detyrave funksionale dhe të përgjegjësi të funksioneve, miratuar me urdhrin e Komandantit të GR me nr. 2052, date 27.03.2018.

Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe KB:

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

a. Vendosja e objektivave

Për periudhën objekt auditimi, GR ka funksionuar në bazë të ligjit të saj organik. Në nenin 1 të Rregullores së Brendshme është përcaktuar “Misioni dhe bvarësia e GR”, ka përcaktuar deklaratën e misionit të njësisë në përputhje me ligjin nr. 8869, datë 22.05.2003, të ndryshuar

Sa sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e Manualit të MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010, (i ndryshuar), ka përcaktuar në kapitullin e III, detyrimet në lidhje me Deklaratën e misionit dhe vizionit.

Hapi I “Organizimi i procesit”, përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë të njësisë publike.

Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. GMS duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë një raport vjetor lidhur me këtë, gjë e cila nuk është realizuar.

- Për vitin 2018, janë kryer takime periodike të EMP (takime mujore dhe tre mujore) me stafin menaxherial mbi diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe janë trajtuar disa aspekte të risqeve (ndër të tjera kërkohej plan pune javor nga cdo sektor, dhe ndarja e detyrave specifike mes punonjësve brenda secilit sektor).

Punonjësit e institucionit për vitin 2017 dhe 2018 kanë ndërtuar skemën e trsnimeve bazuar mbi tre kolona:

- Trajnime në akademinë e sigurisë për rolin menaxherial,
- Trajnime në strukturat e gardë për nivelin zbatues dhe
- Trajnime jashtë vendit për specialitete të vecanta.

Konstatohet se **nivelet menaxheriale nuk kanë zhvilluar trajnime të dedikuara mbi njohuritë për menaxhimin financiar dhe kontrollin, (pasi në pyetesorin e vetëvlerësimit, pyetjes “a janë trajnuar punonjësit mbi MFK gjatë periudhës së raportimit, parimi nr.4, pyetja nr.28)**, ku këto fusha janë duke përfshirë trajnimin lidhur me aktivitetet e kontrollit të brendshëm hartimin e regjistrit të riskut si dhe të nxitjen ndaj parregullsive, raportimin e tyre si dhe hartimi i masave për parandalimin e këtyre risqeve, ka si përgjigje se janë kryer 3 trajnime dhe janë 4 persona të trajnuar, në një kohë që numri i personave të përfshirë në skemën e hartimit dhe mirëmbajtjes së kontrolleve të brendshme në GR është shumë i madh.

b. Etika personale dhe profesionale.

Njësia buxhetore në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, ka hartuar rregulloren e brendshme dhe ate të personelit, ku ka disa zera të rregullores së etikë për GR, Nga ana tjetër, në lidhje me zbatimin e Parimit 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike”, dhe se “Menaxherët e nivelit të lartë të njësisë publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë” hartuar sipas standardeve ndërkombëtare COSO dhe INTOSAI, konstatohet se nëpunësit e këtij institucioni duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit e GR këto norma në përgjithësi janë përcaktuar në rregulloren e brendshme të këtij institucioni, por ky institucion, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “ a” dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”, **nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje të miratur për periudhën objekt auditimi**, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Por sa më sipër, kjo situatë është korrigjuar, pasi nga ana e GR është hartuar një dokument së bashku me projekt urdhërin “Për Kodin e Etikës në GR”, dërguar për miratim Ministrit të brendshëm z.Sandër Lleshi më shkresën nr. 705 prot., datë 29.03.2019, **dokument ky i pa miratuar aktualisht**.

c. Struktura organizative.

Për periudhën e audituar (2017- 2018), si bazë ka shërbyer VKM nr. 445, datë 22.05.2017, për miratimin e strukturave organizative , i cili është ndryshuar me VKM nr.66/2018.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre sipas kuadrit ligjor mbi funksionet dhe gradat, kurse një numër i kufizuar punonjësish normohen me dispozitat e kodit të punës. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se funksionet dhe punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga eprorët, apo Komandanti i GR.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, janë përcaktuar përgjegjësitë për çdo zyrë dhe punonjës.

Manuali i MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr. 8980, datë 15.07.2010, ka përcaktuar në kreun II, faqe 21 në lidhje me strukturat organike ka vendosur si parakushte :

- Një procedure **transparente për rekrutimin** dhe emërimin e punonjësve;
- **Kritere dhe kërkesa të përshtatshme** në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
- Një sistem **trajnimi dhe kualifikimi** që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;
- Një **sistem për vlerësimin e performancës** që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;

Njësia ka programin buxhetor, drejtues i të cilit është Titullari i institucionit, që është dhe nëpunësi autorizues. Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit.

Nga ana e kësaj njësie publike për vitin 2017 - 2018, rezulton të jenë kryer vlerësime vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, në në përputhje me përcaktimet e rregullores se brendshme. Procesi i përshkrimit dhe vlerësimit të punës për çdo pozicion në GR bazohet në nenin 8, pika VI të Rregullores së Personelit, miratuar me VKM nr.66, datë 14.01.2014 “Për miratimin e rregullores së personelit në GRSH”, ku sanksionohet se “vlerësimi i punës si rregull bëhet vjetor dhe çdo përfundim viti, brenda muajit janar të vitit pasardhës dhe për raste të vecanta edhe gjatë vitit kur punonjësi transferohet, lëviz nga detyra, etj”

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale GR disponon plane të trajnimeve (sidomos në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit), dhe disponon një data-base mbi



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

trainimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik, për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e pikas nr. 3/1, nënçështja “Politikat dhe praktikrat që lidhen me burimet njerëzore”, të Kapitullit III të Manualit të MFK 2016, (fq. 26). Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime për gjithë stafin menaxhues në drejtim të në drejtim njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimit të fondeve publike së njësisë menaxhuese.

2.Vlerësimi i riskut (a bën njësia vlerësim risku, a është i plotë dhe përditësohet, a është i bazuar në analiza etj).

- Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në institucionin e GR, janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontroleve ekzistuese dhe nevojave për kontrole të reja, ***por nuk janë hartur për çdo zotërues e sektor, nuk është përditësuar regjistri i risqeve, nuk është caktuar koordinatori i risqeve dhe mungon një strategji me planin e veprimit për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.***

Auditimi konstaton se:

Vlerësimi i riskut është një proces i zhvilluar në metodologjitë e zbatuara në praktikë nga audituesit. Rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë sporadike dhe jo praktika të zakonshme të punës. Nga ana tjetër, për natyrën e veçantë të këtij subjekti publik, koncepti i “Manaxhimit të Riskut” dhe vendosjes së kontroleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e GR.

Nga ana e Komandantit të GR është miratar urdhri nr. 682, datë 26.3.2019 “Për ngritjen e Grupit të menaxhimit të riskut me 6 anëtarë me qëllim bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarive për menaxhimin e riskut si dhe Urdhri i Komandantit të GR me nr. 133, datë 16.01.2019 “Për përmirësimin e funksionimit të sistemit të MFKB nëpërmjet 5 komponenteve të tij”, për të cilin kanë rsaportuar gjithë drejtoritë e Gardës.

3.Aktivitetet e kontrollit: (a janë ndarë si duhet detyrat, a ka funksione të pajtueshme që kryhen nga i njëjti person, a dokumentohen si duhet të plota, të sakta e të kuptueshme transaksionet, a ka rregulla se si ruhen asetet, si përdoren si nxirren jashtë përdorimit, etj).

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësi lidhur me menaxhimin e aktiveve. Struktura aktuale i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi dhe pa mbivendosur detyrat. ***U konstatua se ekzistojnë dhe zbatohen procedurat përkatëse të shpallura mbi administrimin material të aktiveve, inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre, etj.***

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Në GR proceset kryesore të punës operationale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e institucionit. Nëpunësi autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor afatmesëm. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë.

Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit excel dhe në Financa 5.

Janë miratuar në zbatim të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” si të “Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, rregullat për menaxhimin, ruajtjen, dokumentimin e dosjeve dhe elementeve arkivor të fondkrijuesit, etj. Përsa i takon aspekteve të trajtimit të kërkesave të sekretit, rregullorja e brendshme e miratuar nga Ministri ka përcaktuar dispozita të veçanta.

4. Informacioni dhe Komunikimi (a ka rregulla të shkruara ku bazohet komunikimi brenda njësisë, si zbatohen ato).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Drejtuesi i GR, shefat e sektorëve dhe NZ i njësisë zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar. Titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme, ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme tek nëpunësi autorizues, me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë është i mirë, ky kontroll u kushton vëmendje të veçantë shpenzimeve administrative, prokurimeve me fonde publike, ndjekjes së çështjeve të deleguara, etj.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësiave.

Sistemi i IT-së, është i pajisur me një sistem rezervë (back-up) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ripërfitimin e tyre, në rast aksidenti për shërbimet financiare. Institucioni komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

5. Monitorimi (a ka një sistem të monitorimit të përditshëm të të gjitha operacioneve të punës, a janë të specifikuara se cili autoritet është i ngarkuar për monitorimin dhe kujt i raporton).

Në GR është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në **ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e zyrave që mbulojnë**. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike (me përjashtim të analizave vjetore) që institucioni i ka paraqitur në MB nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, gjithashtu edhe në faqen zyrtare të Ministrisë nëpërmjet lidhjes së vendosur në faqet zyrtare të GR.

Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, janë zbatuar kërkesat e kreut VI, paragrafi 257, nënpika 63 “Raportet e monitorimit”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku shprehimisht përcaktohet që: ***“Raportet e monitorimit të buxhetit të publikohen në faqen zyrtare të çdo ministrie të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë Financave nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive.***

Në institucionin e GR, titullari i njësisë informohet vazhdimisht nga drejtuesit dhe përgjegjësit e zyrave mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve periodike (javore, mujore dhe tremujore), me shkrim, apo verbalisht.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Në përgjithësi ka një sistem të konsoliduar të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në institucionin e GR, por për përmirësimin e punës në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për përmirësimi aspekteve të referuar më lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Titulli i Gjetjes 1:	Nevoja për rishikim të Rregullores së Brendshme për Gardën e Republikës, miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 2594, datë 24.10.2006, që të harmonizohet ajo me kuadrin përkatës ligjor dhe dispozitat e tjera në fuqi.
Situata:	Nga analiza e rregullores dhe përjasjes me legjislacionit në fuqi konstatohen mospërputhje dhe kontradiksione sepse : 1.1. Rregullorja e brendshme e GR është miratuar në vitin 2006 dhe nuk është në koherencë me dispozitat ligjore që normojnë kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar publik, pasi rregullorja nuk është rishikuar pas miratimit të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. 1.2. Disa pozicione dhe emërtesa funksionesh dhe pozicionesh të përfshira dhe referuara në Rregulloren e Brendshme, (<i>miratuar nga Ministri Brendshëm me Urdhrin nr.2594, datë 24.10.2006</i>), si dhe Rregulloren e Personelit (<i>miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.66, datë 14.01.2014</i>) nuk përputhen ose mungojnë në Vendimin nr. 445, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “<i>Për miratimin e strukturës, limit organik, dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në GRSH</i>”, i ndryshuar me VKM nr. 66, datë 07.02.2018. 1.3. Sistemi i masave disiplinore të referuara në ligji organik mbi Gardën e Republikës (<i>neni 16, i ligjit nr. Nr.8869, date 22.5.2003</i>) dhe atyre të parashikuara në Rregulloren e Personelit (<i>neni 9-13</i>) kanë disa ndryshime dhe mospërputhje. 1.4. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të GRSH, nuk ka të inkuadruar për periudhën objekt kontrolli, detyrat për disa pozicione dhe kategori, si drejtoria e shërbimeve mbështetëse, sektori shëndetësor, sektori i komunikimit dhe elektronikës, sektori i transportit, magazinieri dhe përgjegjësitë e tij, etj., në kuadër të zbatimit të parimeve dhe kërkesave të MFK, aspekte që janë korrigjuar dhe rregulluar me Manualin mbi Përshkrimet dhe Përgjegjësitë e Punës për funksionet organike të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, miratuar me urdhrin e Komandantit të Gardës me nr. 3965, datë 16.11.2018. 1.5. Disa referenca ligjore të përfshira në dokumentin “Rregullorja e Gardës së Republikës” janë akte të shfuqizuara. Më konkretisht: Në Kapitullin III “Rregullat e përgjithshme për jetën në GR”, në pikën nr. 9 të këtij kreu ku trajtohen “Rregullat e shërbimeve të financës” (faqe 110-114 e rregullores), janë pasqyruar dispozita ligjore që aktualisht janë të shfuqizuara, si Ligji nr. 7661, datë 19.01.1993, Ligji nr. 6942, datë 25.12.1984, Ligji nr. 7971, datë 26.7.1995, VKM nr. 70, datë 11.3.1985, VKM nr. 335, datë 23.6.2000, etj.
Kriteri:	-Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. -Ligji Nr.8869, date 22.5.2003”Për Gardën e Republikës”; -Vendimi nr. 445, datë 22.5.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës, limit organik, dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në GRSH” ”, i ndryshuar me VKM nr. 66, datë 07.02.2018.
Ndikimi/Efekti	Mos rishikimi dhe miratimi i rregullores së brendshme mbart risqe që lidhen me mos përditësimin e saj, përcaktimin e rregullave dhe detyrave të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	dhe funksioneve në GR.
Rëndësia	I lartë
Rekomandimi	Nga ana e strukturave përgjegjëse të Gardës së Republikës në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme të rishikohen dhe përmirësohen dispozitat e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit të Gardës së Republikës, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm me nr. 2594, datë 24.10.2006, që të harmonizohet ajo me kuadrin përkatës ligjor dhe dispozitat e tjera në fuqi dhe mbi këtë bazë të kryhet përmirësimi, azhurnimi i saj dhe miratimi i rregullores së re nga Ministri i Brendshëm.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	<i>Brenda 60 ditëve.</i>

Titulli i Gjetjes 2:	Në institucionin e GR nuk ka një Kod të Brendshëm Etik të miratuar, një Kod Sjellje të miratuar për periudhën objekt auditimi, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë të miratuar për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.
Situata:	Njësia buxhetore në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, ka hartuar rregulloren e brendshme dhe atë të personelit, ku identifikohen disa elementë të normave të etikës, por ky institucion, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli II, pika 2.5.1 “ <i>Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)</i> ”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”, nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje të miratuar për periudhën objekt auditimi, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.
Kriteri:	-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. -Manuali “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 1089, datë 17.11.2016;
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Të merren masa për miratimin e Kodit të Etikës për institucionin e Gardës së Republikës, dokument ky i hartuar nga ana e këtij institucioni së bashku me projekt urdhrin “Për Kodin e Etikës në Gardën e Republikës”, dërguar Ministrisë së Brendshme më shkresën nr.705 prot., datë 29.03.2019, mirëpo është akt i pa miratuar aktualisht.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

Titulli i Gjetjes 3:	Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në praktikë nga drejtuesit e programeve buxhetore, nuk është caktuar koordinatori i risqeve dhe mungon një strategji me planin e veprimit për
-----------------------------	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

	menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.
Situata:	Për periudhën objekt auditimi, nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve dhe plani i veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 8/a, 10 dhe 21/ 2, të ligjit nr. 10296/ 2010, i ndryshuar. Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në institucionin e GR, janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas kontrolleve ekzistuese dhe nevojave për kontrolle të reja, por nuk janë hartuar për çdo zotërues e sektor, nuk është përditësuar regjistri i risqeve dhe nuk është caktuar koordinatori i risqeve në fushat e këtij institucioni.
Kriteri:	-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar ; -Manuali “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 1089, datë 17.11.2016; - Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.16, datë 20.07.2016;
Ndikimi	Kërcënohen arritja e objektivave të institucionit
Rëndësia	I mesëm
Rekomandimi	Nëpunësit autorizues dhe zbatues të marrin masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Ministrinë e linjës administrative për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 “Menaxhimi i riskut”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Institucioni i GR të rishikojë çdo vit dhe përditësojë Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioritetëve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata bazë që ka ky institucion.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Në vazhdim

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Në përfundim të auditimin rezultuan gjetje si më poshtë vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e rregullores dhe përjasjes me legjislacionin në fuqi, konstatohen mospërputhje dhe kundërshti për arsyet e mëposhtme:

a. Rregullorja e brendshme e GR është miratuar në vitin 2006 dhe nuk është riparë më, pas miratimit të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Si pasojë ajo nuk është në koherencë me dispozitat ligjore që normojnë kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar publik, .



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Gjithashtu disa pozicione dhe emërtesa funksionesh dhe pozicionesh të përfshira dhe referuara në Rregulloren e Brendshme, *(miratuar nga Ministri Brendshëm me Urdhrin nr.2594, datë 24.10.2006)*, si dhe Rregulloren e Personelit *(miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.66, datë 14.01.2014)* nuk përputhen ose mungojnë në Vendimin nr. 445, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e strukturës, limit organik, dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë (GRSH)”*, i ndryshuar me VKM nr. 66, datë 07.02.2018.

b. Sistemi i masave disiplinore të referuara në ligjin organik mbi Gardën e Republikës *(neni 16, i ligjit nr. Nr.8869, datë 22.5.2003)* dhe atyre të parashikuara në Rregulloren e Personelit *(neni 9-13)* paraqesin disa ndryshime dhe mospërputhje.

c. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të GRSH, nuk ka të inkuadruar për periudhën objekt kontrolli, detyrat për disa pozicione dhe kategori, si drejtoria e shërbimeve mbështetëse, sektori shëndetësor, sektori i komunikimit dhe elektronikës, sektori i transportit, magazinieri dhe përgjegjësitë e tij, etj., në kuadër të zbatimit të parimeve dhe kërkesave të MFK, aspekte që janë korrigjuar dhe rregulluar me Manualin mbi Përshkrimet dhe Përgjegjësitë e Punës për funksionet organike të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, miratuar me urdhrin e Komandantit të Gardës me nr. 3965, datë 16.11.2018.

d. Disa referenca ligjore të përfshira në dokumentin “Rregullorja e Gardës së Republikës” janë akte të shfuqizuara. Më konkretisht, në Kapitullin III “Rregullat e përgjithshme për jetën në GR”, në pikën nr. 9 trajtohen “Rregullat e shërbimeve të financës”, ku pasqyrohen dispozita ligjore që aktualisht janë të shfuqizuara, si Ligji nr. 7661, datë 19.01.1993, Ligji nr. 6942, datë 25.12.1984, Ligji nr. 7971, datë 26.7.1995, VKM nr. 70, datë 11.3.1985, VKM nr. 335, datë 23.6.2000, etj. Mos rishikimi dhe miratimi i rregullores së brendshme mbart risqe që lidhen me mos përditësimin e saj, përcaktimin e rregullave dhe detyrave të organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve dhe funksioneve në GR.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 139-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Nga ana e strukturave përgjegjëse të Gardës së Republikës në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme të rishikohen dhe përmirësohen dispozitat e Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit të Gardës së Republikës, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm me nr. 2594, datë 24.10.2006, që të harmonizohet ajo me kuadrin përkatës ligjor dhe dispozitat e tjera në fuqi dhe mbi këtë bazë të kryhet përmirësimi, azhurnimi i saj dhe miratimi i rregullores së re nga Ministri i Brendshëm.

Brenda 2 muajve

2. Gjetje nga auditimi: Për çdo muaj Sektori i Burimeve Njerëzore të Gardës së Republikës ka përgatitur urdhrat mujorë “Për pagesën e pagave të personelit oficer, nënoficer, dhe punonjësve civil të GR për vitin 2018”, të cilët më pas janë miratuar nga Komandanti i Gardës së Republikës . Listë prezencat dhe pagesat e punonjësve të Gardës, u korrespondojnë periudhave nga data 1 e muajit deri më datën 28, kjo referuar përcaktimeve të pikës nr. 1, lidhja I, të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 387, datë 29.3.2007 “Për mënyrën e pasqyrit të prezencës në punë në ministrinë e brendshme”. Përcaktimet e urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 387, datë 29.0.2007 “Për mënyrën e pasqyrit të prezencës në punë në ministrinë e brendshme”, kanë disiplinuar dhe rregulluar procedura të menaxhimit të aparatit /stafit të Ministrisë së Brendshme në atë periudhë. Referuar lidhjes nr.1, “Mbi mënyrën e pasqyrit të prezencës në punë në MB” që shoqëron këtë urdhër, thuhet se “*çdo datë 28 (26 për muajin shkurt), të gjithë drejtorët e drejtorive duhet të dorëzojnë listë prezencat e drejtorive të tyre pranë drejtorëve të përgjithshëm nga të cilët varen*”. Ky përcaktim, duke lënë si datë të fundit të listë-prezencës datën 28 të çdo muaji, nuk pasqyron në mënyrë të drejtë dhe korrekte pjesëmarrjen dhe kontributin në punë të çdo punonjësi të Gardës së Republikës për gjithë periudhën e muajit, duke lënë jashtë këtij pasqyrimi në kohë periudhën 28-30 apo 28-31 të çdo muaji.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 25 -33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



2.1 Rekomandimi

Nga ana e Gardës së Republikës të kërkohet pranë Ministrisë së Brendshme rishikimi dhe përmirësimi i të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm me nr. 387, datë 29.3.2007 “Për mënyrën e pasqyrimit të prezencës në punë në ministrinë e brendshme”, i cili të ketë në fokus rregullimin e marrëdhënieve të punës edhe për njësitë e varësisë dhe jo vetëm aparatit të MB.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatuan disa ngjarje që mund të mbartin risqe të gabimit material:

- Evidenca kontabël mbahet me programin Financa 5, por nuk përfshihet në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) ku mund të mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit; të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike; të dhëna për raporte financiare dhe statistika etj.
- Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të IT. (*p.sh. Ndryshohen fjalëkalimet rregullisht, fireëall-et, hyrje e kufizuar në të dhënat IT, etj.*). Sistemi i IT, mbulohet tërësisht nga struktura e brendshme, Sektori i Komunikimit dhe Elektronikës në vartësi të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.
- Brenda Gardës së Republikës nuk ka një sistem rezervë (back-up) IT të përshtatshëm, plan rekuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11 -25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi:

Nga Garda e Republikës, Sektori i IT-së në kuadër të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të merren masat për identifikimin dhe analizën e risqeve të mundshme, për arritjen e objektivave dhe përcaktimin e mënyrave se si ky rrezik mund të shmanget ose të minimizohet, duke pasqyruar, angazhimin e drejtpërdrejtë në evidentimin, regjistrimin, shqyrtimin, përgatitjen dhe raportimin e masave të programuara për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

a. Gjatë përgatitjes së PBA-së, Faza II, treguesit e performancës për Objektivin 3 - “Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës”, paraqiten në numër total, në një kohë kur bëhet fjalë për produkte të ndryshëm, konkretisht: produkti B “Mjete transporti të reja të blera”, produkti C “Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime perëndimore”, dhe produkti G “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës”, të cilët duhen trajtuar si tregues të veçantë brenda objektivit përkatës. Vetëm kështu ato i shërbejnë qëllimit të planifikimit në vetvete, i cili nis me vendosjen e objektivave të qarta, të besueshme, të matshme dhe të arritshme.

b. Nga auditimi u konstatua se nga njëra PBA në tjetrën përgjithësisht ka vijueshmëri në përkufizimin dhe trajtimin e produkteve për secilin objektiv, përveç:

- Produktit 2 “Pajisje të ndryshme për funksionimin normal të përditshëm të aktivitetit në ambientet e punës në Gardën e RSH”, për objektivin 3⁹, i cili ishte Produkti G, në PBA-në e mëparshme;
- Produktit 3 “Godinë e ri konstruktuar dhe shesh i asfaltuar” / Objektivi 3, i cili ishte Produkti D në PBA-në e mëparshme;

⁹ Objektivi 3: “Modernizimi i infrastrukturës dhe mjeteve që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme duke synuar në rinovimin periodik të saj me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

- Produktit 4 “Magazinë dhe ofiçinë e ri konstruktuar në Komandën e Gardës”/ Objektivi 3, i cili në fakt në PBA 2018-2020 ishte Produkti F i të njëjtit objektivi.

- Produktet: C “Pistoleta të reja, më të lehta, prodhime përëndimore”, E “Rrugë të asfaltuara” nuk janë parashikuar më në PBA 2019-2020

Mospasja e vijueshmërisë edhe në listimin e produkteve respektive brenda të njëjtit objektivi, vështirëson krahasueshmërinë mes zërave, e cila merr rëndësi kur bëhet fjalë për monitorime dhe/ose vlerësime të parashikimeve.

c. Nga auditimi mbi realizimin e buxhetit për vitin 2017, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,729,622 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,634,555 mijë lekë (ose 95% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 5% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është buxheti në rritje nga viti 2016 në 2017, i cili pasohet edhe nga realizimi faktik në rritje për dy vitet të njëpasnjëshme. Edhe pse buxheti përfundimtar është rritur gjatë vitit ushtrimor 2017, realizimi faktik i zërave për këtë vit, ka qenë nën planin përfundimtar me 85,437 mijë lekë më pak.

Nga auditimi mbi realizimin e buxhetit për vitin 2018, rezultoi se u realizuan shpenzime në total 1,713,164 mijë lekë, nga të cilat shpenzime korrente janë 1,491,338 mijë lekë (ose 87% e total shpenzimeve) dhe shpenzime kapitale 95,067 mijë lekë (ose 13% e total shpenzimeve). Ajo që vihet re është që shpenzimet korrente dhe kapitale paraqesin më pak luhatje mes fazave, objekt vlerësimi, në krahasim me një vit më parë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11 – 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi:

Me qëllim respektimin e parimeve të qeverisjes buxhetore¹⁰ të cilat përbëjnë një “praktikë të mirë” për tu ndjekur dhe zbatuar, por edhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, rekomandojmë marrjen e masave nga subjekti që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore të mbahet parasysh:

- lidhja e ngushtë mes buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme; si dhe
- planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi aktiv.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata jo materiale” në vlerën 1,050 mijë janë të pasqyruara në llog. 202 “Studime dhe kërkime” ku ndër të tjera janë paraqitur aktivet:

- Projekt për komandën e gardës, viti 2011, në vlerën 2,411,400 lekë.

- Azhurnim dhe rilevim plan vendosje, viti 2015, në vlerën 466,800 lekë.

Rezulton se investimi për të cilat janë hartuar projekti dhe plan vendosja në vlerën 2,878,200 lekë kanë përfunduar, si rezultat duhej që vlerës së investimit t’i shtohet dhe vlera e projektit (2,411,400 lekë) dhe rilevimit të plan vendosjes (466,800 lekë). Për sa më lart vlera e aktiveve afatgjata materiale “Ndërtime e konstruksione” duhet të rritet me vlerën 2,878,200 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 92 -107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi:

-Nga Garda e Republikës, Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar vlerën e aktiveve afatgjata jo materiale “studime dhe kërkime”, kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale;

-Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse rregulluese kontabël në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të Gardës së Republikës-së, për vitin 2019.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare Formatit 7/a, te kolona 7 “Pakësime gjatë vitit ushtrimor” / “Nxjerrje jashtë përdorimit”, janë pasqyruar pakësime të aktiveve:

¹⁰ “Parimet e qeverisjes buxhetore”, sipas OECD



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

a. **“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerën 1,005,583.03 lekë nga të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit me fletëdaljet dhe procesverbalet përkatëse pa u miratuar nga titullari i Gardës në vlerën 985,183 lekë.

b. **“Inventar ekonomik”** në vlerën 66,360 lekë nga të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit me fletëdaljet dhe procesverbalet përkatëse pa u miratuar nga titullari i Gardës në vlerën 37,080 lekë.

c. **Aktive** të shkarkuara me fletë dalje (Gjashtë) sipas procesverbaleve të mbajtura nga komisionet në vlerën 2,627,840.4 lekë.

Aktivitetet e mësipërme duhej të kalonin si shpenzime gjatë kohës kur janë përdorur në rastin konkret duhej të konsideroheshin si diferenca inventari dhe më tej të procedohej nga titullari nëse do të kalonin në shpenzime ose do të konsideroheshin si mungesa inventari.

Për sa më lart është vepruar në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 38. “Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve”, pika 39. “Çdo hyrje-dalje në magazinë dokumentohet menjëherë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 92 -107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi

Nga Titullari i Gardës së Republikës, Sektori i Financës të merren masat për shqyrtimin e procesverbaleve të nxjerrjes jashtë përdorimit të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe shkarkimit të aktiveve të shpenzuara në periudhat e mëparshme të cilat duhej të kalonin si shpenzime për periudhën kur janë përdorur. Në rastin konkret duhej të konsiderohen si diferenca inventari dhe më tej të procedohet nga titullari nëse do të kalojnë në shpenzime ushtrimi ose do të konsiderohen si mungesa inventari.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” zënë shumën 113,945 mijë lekë;

Në pasiv në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2018 nuk rakordon në analizë në vlerën 3,000,000 lekë si më poshtë:

- Shqyrtimi i llogarive të pagueshme (llog. 401-408) “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 4,104,209 mijë lekë. E detajuar kjo llogari rezulton se përbëhet nga 35 fatura furnitorësh likuiduar gjatë muajit janar të vitit 2019 me fondet e buxhetit 2018 në vlerën 4,892,979 lekë e cila nuk përputhet me vlerën sintetike të llogarisë “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408).

- E detajuar llog. 42 “Detyrime ndaj personelit” është në vlerën 70,818,117 lekë për paga e tjera detyrime ndaj personelit likuiduar gjatë muajit janar të vitit 2019 me fondet e buxhetit 2018 e cila nuk përputhet me vlerën sintetike të llogarisë.

-E detajuar llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” është në vlerën 38,234,064 lekë për tatim taksa, sigurime shoqërore, sigurime shëndetësore likuiduar gjatë muajit janar të vitit 2019 me fondet e buxhetit 2018 e cila nuk përputhet me vlerën sintetike të llogarisë.

Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 92 – 107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

-Nga Sektori i Financës të merren për saktësimin e detyrimeve afatshkurtra si detyrime, likuidimi i të cilave duhet të bëhet brenda një viti ose një cikli operativ (ekonomik) duke përdorur aktivet e veta afatshkurtra ose duke krijuar detyrime të tjera afatshkurtra.

-Të kryhen veprimet përkatëse rregulluese kontabël në llogaritë kreditore për detyrimet ndaj furnitorëve, ndaj personelit e të ngjashme, ndaj sigurimeve shoqërore e të ngjashme, ndaj tatimeve e të tjera në vijimësi dhe pasqyrim i tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse të Gardës së Republikës, për vitin 2019.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, nga subjekti për vlerën e klientëve dhe furnitorëve nuk është dërguar letër konfirmimi për llogaritë e pagueshme, për të verifikuar nëse vlerat e tyre janë në përputhje me shënimet e kontabilitetit. Mosrakordimi me klientët dhe furnitorët mundëson edhe riskun e pagesave të parregullta, si dhe prezantimin jo të saktë e të plotë të detyrimeve në pasqyrat financiare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 92 -107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi:

-Drejtuesit e Gardës së Republikës, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të konfirmojnë (rakordojnë) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

-Të përcaktojnë rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigorozë mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në aktiv llog. 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet gjendja e fondeve të trashëguara në vlerën 2,480,264 lekë, të cilat si fonde të mbetura pa përdorur që trashëgoohen për vitin 2019 në pasivin e bilancit janë paraqitur në llogarinë 466, në pasiv prej 2,480,264 lekë). Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” si llogari specifike në sektorin publik, në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve dhe duhet të vërtetohen me akt-rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt-rakordim, tepricat nuk janë paraqitur dhe strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 92-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi:

Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” të vërtetohen me akt-rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt-rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrën e performancës financiare Formati 2, “Shpenzime të tjera”, Llog. 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” paraqitet në vlerën 14,926,139 lekë pa u saktësuar pozicioni i çeljes së llogarisë nga viti i mëparshëm, transaksioni i transferimit të tepricës së llogarisë 85, “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” të vitit 2017 prej 3,819,815 lekë lekë në llogarinë 12, “Rezultatet e mbartura”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” nuk përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës. Ndërsa, si tepricë debitore, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 92-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi:

-Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës kontabile, llogaria 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” duhet të përfaqësojë, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t’u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës dhe si tepricë debitore, kjo llogari duhet të përfaqësojë rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

-Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke tranzituar shumat e evidentuara në llogarinë 85, “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” nga viti i mëparshëm në llogarinë 12 “Rezultate të mbartura nga funksioni”, për një pasqyrim më të drejtë të kundër partisë së disponibiliteteve në thesar, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Formati 5 “Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore” është plotësuar relacioni shoqërues por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 92-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi:

Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore me informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve. Shënimet të japin përshkrime me fjalë apo zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e Komandantit të Gardës nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme drejtuesit. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 92-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1 Rekomandimi:

-Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

-Në rast miratimi, nga sektori i financës, të bëhet reflektimi, në pasqyrat financiare të periudhës raportuese të vlerës së aktiveve afatgjata materiale të vlerësuara për dalje jashtë përdorimit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

dhe/ose asgjësimin e tyre nga komisionet përkatëse si ngjarje të ndodhura në periudhën e raportimit financiar si një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i hartimit të kontratave të furnizimit me karburante u konstatua se:

a. Midis bashkimit të operatorëve “....” *SHA* dhe “.....” *SHPK* dhe autoritetit kontraktor është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 25, datë 24.07.2017 për furnizimin me karburant diesel 10 ppm me vlerën 19,141,334 lekë pa tvsh me marzh fitimi 16.7% dhe karburant benzinë pa plumb me vlerën 6,525,000 lekë pa tvsh me marzh fitimi 17.7% për Gardën e Republikës. Kontrata e mësipërme është me afat lëvrimit deri 31.12.2017.

b. Midis bashkimit të operatorëve “.....” *SHA* dhe “.....” *SHPK* dhe autoritetit kontraktor (Gardës së Republikës) është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 9, datë 28.02.2018 për furnizimin me karburant diesel 10 ppm me vlerën 19,430,333 lekë pa tvsh me marzh fitimi 16.7% dhe karburant benzinë pa plumb me vlerën 1,928,500 lekë pa tvsh me marzh fitimi 17.7%. Kontrata e mësipërme është me afat lëvrimit deri 31.12.2018.

Në nenin 1, “*Objekti*” të kontratave cilësohet si më poshtë:

1.5: Përlllogaritja e çmimit do të bëhet sipas bursës së fundit të karburanteve i cili publikohet çdo të hënë në buletin e APP-së.

1.6: në përlllogaritjen e çmimit do të pasqyrohet dhe ndryshimi i çmimit të taksës së qarkullimit mbi benzinë pa plumb dhe gazoil, sipas ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008, “*Për taksat Kombëtare*”, të ndryshuar, si dhe taksa e shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës sipas VKM nr. 497, dt. 30.05.2013.

Sa më lart është hartuar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Neni 31 “*Kriteret për vlerësimin e ofertës*”; Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

a. çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim, çdo javë, në Buletin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

b. elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;

c. marzhin e fitimit, të shprehur në përqindje.

Gjithashtu kontratat e mësipërme janë hartuar duke mos respektuar Dokumentet Standarde të Tenderit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën pikën 5, faqe 107-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1 Rekomandimi:

Autoriteti Kontraktor Garda e Republikës, në hartimin e kontratave të furnizimit me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje të marrin parasysh kriteret për vlerësimin e furniturës, si çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF Shqipëri, elementeve fiskalë etj., referuar rregullave të prokurimit publik dhe Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor për llogaritjen e çmimit të karburanteve nuk është mbështetur në buletin e APP në çmimet referuar bursës REUTERS për datën e zimitfurnizimit lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment, sipas raporteve të analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, gjithashtu janë shtuar elementë fiskalë si “*taksa e markimit*” në kundërshtime me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 77, pika 5, “*Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Reuters, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment”. Pika 6 “Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 107-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi:

Nga Garda e Republikës në zbatimin e kontratave dhe likuidimin e vlerës së mallrave të furnizuara të merren masat si vijon:

-Urdhër shpenzimet për vlerat e likuiduara nga autoriteti kontraktor për karburante, të shoqërohen me faturat tatimore, raportin e analizave nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar për të vërtetuar cilësinë dhe standardet e furniturës lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe kushteve të kontratës.

-Autoriteti kontraktor, në llogaritjen e çmimit të karburanteve, duhet të mbështetet në buletinet e APP, me çmimet referuar bursës REUTERS për datën e furnizimit, sipas kushtit CIF-Shqipëri, raporteve të analizave sipas datës respektive të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për sasinë e produktit të importuar, referuar elementëve fiskalë të përcaktuara me ligj.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi:

a. Nga projektuesi “...” Tiranë është hartuar projekti dhe preventivi “Rikonstruksioni i Njesisë speciale në Gardën e Republikës” me vlerën 21,973,753 lekë pa tvsh. Zërat e preventivit janë hartuar referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim. Për një pjesë zërash të punimeve të preventivit çmimet janë hartuar me analiza punimesh referuar UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” por analizat nuk janë bashkëngjitur preventivit. Kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave.

b. Nga auditimi i procedurave të prokurimeve rezultoi se operatorët ekonomikë ofertues një pjesë zërash të preventivit të ofertës të nuk e kanë shoqëruar me analizat e çmimeve, në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 107-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi:

Nga njësiti e prokurimit dhe KVO të kërkohet që gjatë procedurave të hartimit të projekteve, preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik dhe vlerësimit të ofertave gjatë procedurës së prokurimit vlera e zërave të punës të ndërtimit të llogariten mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike. Në rast kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nuk ka një sistem informatik informacioni, monitorimi që u siguron drejtuesve informacion rregullisht mbi arritjen e objektivave të njësisë. Aktualisht kryhet me një kordinator i cili mbledh dhe raporton tek drejtuesit dhe në Ministri, për nivelin e realizimit të objektivave të materializuara në produkte. Sa më lart në zbatim të UMF nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësinë e Qeverisjes Qendrore”.

- Nuk ka një procedurë të veçantë të shkruar nga menaxhuesit, përtej legjislacionit në fuqi për ruajtjen nga përdorimi i paautorizuar për aktivet e rëndësishme (me vlerë) dhe aktivet afatgjata (përfshirë të dhënat personale). Gjithashtu nuk ka manual procesesh ose rregullore për proceset kryesore operationale dhe financiare i cili të specifikojë qarkullimin e dokumentacionit në zbatim të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësiti e sektorit publik”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi:

Garda, strukturat menaxhuese të marrin masat të hartojnë rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, në përshtatje me strukturën dhe objektivat e institucionit duke e plotësuar dhe harmonizuar me kuadrin ligjor në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe miratuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se raportet e monitorimit nuk publikohen në **web-in e Gardës së** Republikës dhe as në **web-in** e Ministrisë së Brendshme, gjithashtu raportet e monitorimit nuk kanë informacionin e plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit. Mungon një analizë me argumentet e plota në lidhje me mosrealizimin e produkteve dhe masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre.

Nuk është e paraqitur performanca e produkteve, e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikës së programit ku të shpjegohen cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e çdo programi si dhe sa janë realizuar këto objektiva, në përputhje me përcaktimet e UMF nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësinë e Qeverisjes Qendrore”, paragrafi 49.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi:

Nga Garda e Republikës të hartohen Raportet e Monitorimit për zbatimin e buxhetit, të cilat duhet të përmbajnë një informacionin të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, raportimin lidhur me ecurinë e realizimit të qëllimit dhe objektivave të politikës që trajtojnë nëpërmjet treguesve të performancës përkatëse në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm si dhe çdo problematikë të rezultuar, duke specifikuar dhe masat e nevojshme për adresimin e tyre në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Sa i takon vlerësimit të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të tij rezultoi se:

- Njësia buxhetore në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, ka hartuar rregulloren e brendshme dhe atë të personelit, ku identifikohen disa elementë të normave të etikës, por ky institucion, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”, nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje të miratuar për periudhën objekt auditimi, apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 139-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

- Për periudhën objekt auditimi, nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve dhe plani i veprimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 8, pika 8/a, 10 dhe 21/ 2, të ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar. Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në institucionin e GR, janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat krahas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

kontrolleve ekzistuese dhe nevojave për kontrolle të reja, por nuk janë hartuar për çdo zotërues e sektor, nuk është përditësuar regjistri i risqeve dhe nuk është caktuar koordinatori i risqeve në fushat e këtij institucioni. Sa më sipër riskon mospërbushjen e objektivave të njësisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 139-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 Rekomandimi:

Të merren masa për miratimin e Kodit të Etikës për institucionin e Gardës së Republikës, dokument ky i hartuar nga ana e këtij institucioni së bashku me projekt urdhrin “Për Kodin e Etikës në Gardën e Republikës”, dërguar Ministrisë së Brendshme më shkresën nr.705 prot., datë 29.03.2019, mirëpo është akt i pa miratuar aktualisht.

Në vijimësi

16.2 Rekomandimi:

Nëpunësit autorizues dhe zbatues të marrin masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, regjistri i riskut, të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Ministrinë e linjës administrative për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 “Menaxhimi i riskut”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Në vijimësi

16.3 Rekomandimi:

Institucioni i GR të rishikojë çdo vit dhe përditësojë Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioritetëve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata bazë që ka ky institucion.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se:

- Në përbërje të Komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave për artikujt uniforma e veshmbathje nuk ka ekspertë të fushës (inxhinierë të tekstilit). Komisioni përbëhet nga dy oficerë të logjistikës dhe një shofer, duke mos zbatuar përcaktimet e paragrafit nr.43, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

- Nuk kanë gjetur zbatim kërkesat dhe përcaktimet e vëna në formularin nr. 10 “Specifikimet teknike”, në lidhje me kontrollin cilësor në procesin e prodhimit të uniformave dhe veshmbathjeve për punonjësit e GR. Ky kontroll i cilësisë është nënvizuar *pothuajse për çdo artikull që është prokuruar*, ku vendoset detyrimi i GR që për të siguruar përmbushjen e detyrimeve mbi cilësinë ajo do “të ndjekë dhe kontrollojë procesin e prodhimit në fabrikën prodhuese të atij artikulli”.

- Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e vëna në specifikimet teknike të DST, paragrafi “Kolaudimi dhe marrja në dorëzim” për secilin nga 19 artikuj e prokuruar, për të cilët duhet të zbatoheshin detyrimet e vendosura për kolaudimin dhe marrjen dorëzim të mallrave. Gjithashtu nuk ka gjetur zbatim neni 9, pika 1 “Kushtet e pranimi të mallit”, të kontratës, pasi AK është mjaftuar vetëm me raportet e testimit të kryera dhe dorëzuara nga ana e OE, pa kryer testime dhe analiza në laboratorë të veçantë për cilësinë tyre.

Sa më sipër krijon kushte që, të krijohet risku i anomalive dhe parregullsive në cilësinë e furnizimit të një nomenklature artikujsh shumë të rëndësishëm për institucionin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 Rekomandimi:

- Institucioni i Gardës së Republikës të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për parregullsitë dhe shkeljet e dokumentuara për këtë procedurë furnizimi dhe në vijim për ngritjen e komisionit të pranimi të mallrave të gjejnë zbatim të plotë përcaktimet e paragrafit nr.43, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për marrjen në dorëzim të artikujve të uniformave dhe veshmbathjeve për efektivët e GR, Komisioni i pritjes, kontrollit dhe pranimi të mallit, të marrë masa që procedurat e ekzaminimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

dhe testimi të mallrave të furnizuara të kryhen pranë laboratorëve të akredituar, dhe rezultatet e tyre, të krahasohen me rezultatet e analizave të dërguara nga OE furnizues”.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga ana e institucionit të GR janë nënshkruar dy kontrata (me nr. 46 dhe 47) me vlerë të përgjithshme 98,175,600 lekë, në datat 28 dhe 29 dhjetor 2017 për “Blerje autoveturash për Gardën e Republikës” duke ngurtësuar fondet në bankat e nivelit të dytë në formën e letër kredive në masën e plotë të investimit dhe kryer pagesa për investime që konsiderohen të realizuara brenda vitit buxhetor, por që janë furnizuar në vitin e ardhshëm, gjë që tregon për procese me mangësi serioze që nuk janë planifikuar siç duhet nga ana e strukturës përgjegjëse në institucionin e qeverisjes së përgjithshme.

Konstatohet se, mungon një përcaktim i saktë dhe rigoroz nga ana e MFE mbi rastet, tipologjitë dhe natyrën e investimeve që do të njihen si të rëndësishme të veçantë dhe do përdoren letër-kredi, meqenëse investimet, kur prokurohen nuk kanë një referim të tillë.

Ngurtësimi i fondeve dhe kryerja e pagesave për furnitura që konsiderohen të realizuara brenda vitit ushtrimor (*sipas Regjistrimit të Realizimit të Prokurimeve Publike të AK*), por që në fakt bëhen hyrje në njësinë shpenzuese vitin pasardhës, tregon për procese që nuk janë planifikuar siç duhet nga ana e strukturës përgjegjëse në institucionin e qeverisjes së përgjithshme (Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme). Përdorimi i letër kredive nga institucioni, në masën e plotë të investimit, cenon parimin kryesor të realizimit të buxhetit atë të transparencës dhe besueshmërisë, të përcaktuara nga neni 4 i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe neni 40 i tij, ku thuhet përkatësisht se, “*e drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës*”, pasi institucioni ka deklaruar investime/shpenzime të kryera si të realizuara për vitin 2017, ndërkohë që transaksionet financiare (mekanizmi L/C dhe hyrja e mallrave dhe produkteve) janë kryer efektivisht gjatë vitit 2018.

Përdorimi i letër kredive nga institucioni, në masën e plotë të investimit për aktive të pa furnizuara brenda atij viti ushtrimor, cenon parimin kryesor të zbatimit të buxhetit brenda vitit dhe atë të transparencës dhe besueshmërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 Rekomandimi:

Institucioni Gardës së Republikës, të kërkojë pranë Ministrisë së Brendshme, (*si autoriteti ku është vendosur në strukturë Agjencia e Prokurimeve të Përqendruara*) që, në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të përgatitësin nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, duke specifikuar rastet, mënyrat dhe masën e përdorimit të letër kredive nga institucionet buxhetore, pasi mungon një përcaktim i saktë dhe rigoroz mbi tipologjitë dhe natyrën e investimeve që do të njihen si të rëndësishme të veçantë dhe që mund të aktivizojnë përdorimin e instrumentit të letër-kredive, për të shmangur përdorimin abuziv të tij.

Brenda një muaji

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare si dhe verifikimi i dokumentacionit që administrohet nga Sektori i Armatimit, konstatohet se, nuk është pasqyruar në evidencën kontabile të njësisë, e gjithë vlera e armatimit që ka në administrim institucioni i Gardës së Republikës.

-Evidentimi material e sasior i armatimit në Gardën e Republikës mbahet nga Sektori i Armatimit, ku janë pasqyruar armatimet në sasi dhe përdoruesit e tyre, referuar tipologjive së regjistrave të miratuar me udhëzime të veçanta të Ministrit të Brendshëm. Nga sektori armatimit të institucionit, dokumentacioni i hyrjes dhe daljes së mallrave e materialeve (*armë, municione e pajisje*), nuk plotësohet i rregullt sa i përket çmimit dhe vlerës së mallit, siç e përmban formati i miratuar i dokumentit (*emërtesa, njësia, sasia, çmimi, vlera, etj.*). Gjithashtu edhe regjistrimi i dokumentacionit në librat e llogarisë kryhet vetëm për lëvizjet sasiore të këtyre mallrave pa përcaktuar sipas emërtesës së artikullit edhe çmimin përkatës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Nga verifikimi i të dhënave me zgjedhje që janë shënuar në fletën e inventarit për armatim e municion të datës 26.6.2018, evidentohet se, nuk është regjistruar, kontabilizuar dhe përfshirë në llogaritë e aktiveve të GR kundërvlera për armët luftarake të tipit “pistoletë”, që nuk janë vlerësuar me çmimin e tyre dhe nuk janë përfshirë në librat e kontabilitetit. Gjithashtu, evidentohet se, nuk është regjistruar, kontabilizuar dhe përfshirë në llogaritë e aktiveve të GR kundërvlera për armët luftarake të llojit automatikë, etj.

- Për sa u përket armëve të evidentuara më parë të pa dorëzuara nga shtetasit e pajisur vite më parë në bazë të dispozitave që aktualisht janë shfuqizuar, për GR rezultojnë një numër armësh të pa grumbulluara e administruara pranë këtij institucioni, për të cilat edhe pse janë lënë rekomandime të përsëritura nga Ministria e Brendshme, të pranuar, por të pa zbatuara plotësisht, nuk është mundur kthimi dhe administrimi i tyre në depot ushtarake të këtij institucioni. Sektori i armatimit i GR, nuk ka marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për gjetjen e adresave të personave, bërjen dhe dokumentimin e kallëzimit penal për të gjithë personat si dhe nuk ka kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës së armës nga personat e rezultuar me armatim të pa dorëzuar apo të humbur

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 34-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1 Rekomandimi:

a. Komandanti i Gardës së Republikës të marrë masa, programojë detyrat sipas afateve dhe të ngrejë grupet e vlerësimit të armatimit dhe municionit që ka në inventar dhe administrim institucioni. Komisioni në bashkëpunim me Sektorin e Armatimit në GR, për mallrat e materialet (*armë, municione e pajisje*), të regjistruar në ditarët e llogarisë të bëjë menjëherë përcaktimin e çmimit të tyre dhe në vijimësi dokumentacionin hyrje dhe dalje ta plotësojë të rregullt duke përcaktuar çmimin e artikullit dhe vlerën e mallit në faturë.

Menjëherë

b. Nga ana e Sektorit të Financës, rezultatet e vlerësimeve të kryera në shërbimin e armatimit, të pasqyrohen në evidencën kontabile që do të mbyllet për vitin 2019, duke evidentuar vlerën e plotë e të saktë të armatimit dhe municioneve, sipas çmimit së blerjes, apo dhe referuar çmimeve të tregut për armatimin e trashëguar në vite apo të dhuruar, konformë rregullave kontabile dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi armatimin.

Me mbylljen e llogarive vjetore.

c. Sektori i armatimit dhe pajisjeve në GR, për armët që janë në administrim nga shtetas të ndryshëm (*ish punonjës të GR apo funksionarë të subjekteve politike*) që rezultojnë ende të pa dorëzuara (*pa u bërë hyrje në depon e GR*) si dhe armët që janë në proces hetimi e gjykimi penal, për të cilat nuk janë ndjekur rrugët e duhura ligjore për marrjen hyrje të tyre si rezultat edhe i dokumentimit e regjistrimit të tyre në ditarë të vjetër të llogarisë për periudhën para vitit 2000, të marrë masat e menjëhershme që këto armë:

- t'i evidentojë e regjistrojë në një libër të veçantë, në të cilin të përshkruaj të dhënat e plota të shtetasit dhe të armës,

- të bëjë rakordimin e shumave të përgjithshme në ditarët e llogarisë mod.28, si dhe të dokumentojë e administrojë edhe ecurinë e procesit administrativ e ligjor të ndjekur.

Komandanti i GR tu kërkojë zyrtarisht drejtorive vendore të policisë së shtetit për të gjetur adresat e personave që janë pajisur me armët luftarake dhe të ndiqen procedurat deri në bërjen hyrje në depot e GR të armatimit dhe municionit të furnizuar sipas dispozitave që aktualisht kanë rënë nga fuqia.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, është likuiduar shuma prej 289,014,709 lekë, që përfaqëson shpenzimet për ngjarjet e 21 janarit 2011, sa likuiduar për Vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për 46 raste / urdhër shpenzime, në shumën 289,014,709 lekë, për të cilat nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Gardës së Republikës (*si palë të paditura*), nuk është bërë ankimi dhe ndjekja në të gjithë shkallët e gjyqësorit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34 -92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

20.1 Rekomandimi:

Të merren masa që në vazhdim për të gjithë proceset gjyqësore ku Garda e Republikës është palë, të ndiqen me rigorozitet duke ankimuar çështjet në të gjithë shkallët e gjykimit. Për likuidimin e vendimeve, të hartohet gjurma e auditimit për nxjerrjen e përgjegjësive administrative para likuidimit të vendimeve.

në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi e parregullsi për vlerësimin e skrapit të bërë hyrje pa çmim dhe vlerë dhe që nuk është pasqyruar për rrjedhojë në pasqyrat financiare të GR për vitin 2017 dhe 2018. Nga shqyrtimi i kartelave dhe relacioneve konstatohet se, ka mangësi e parregullsi për vlerësimin e skrapit të bërë hyrje pa çmim dhe vlerë dhe që nuk është pasqyruar për rrjedhojë në pasqyrat financiare të GR për v.2017 dhe 2018. Referuar shkresave nr. 292 dhe 295 date 9.4.2019 vlerësohet se sipas sektorëve (*atij logjistik, te transportit dhe të armatimit*) janë gjendje hekur 29134 kg; alumin 217 kg; plumb 1920 kg, dhe bateri 6995 kg. Krijimi i një nomenklature të tillë të artikujve pa vlerësim kontabël tregon për një proces që nuk është ndjekur në vijimësi sipas kërkesave të vlerësimit të aktiveve, përcaktuar në VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, aktet e tjera të dala nga Ministria e Financave për këtë qëllim si dhe përcaktimet e pikës nr. 19, te UMB me nr. 1151, datë 16.07.2007. Konstatohet se ka vonesa të pajustificuara në kryerjen e proceduarve të ankandit për shitjen e skrapit të përfituar nga asgjësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve (mjete transporti, etj), proces i kryer gjatë vitit 2016 dhe përfunduar pjesërisht gjatë vitit 2017.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34 -92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1 Rekomandimi:

Të merren masa në kryerjen e proceduarve të ankandit për shitjen e skrapit të përfituar nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i aktiveve (*si mjete transporti etj.*), proces i kryer gjatë vitit 2016 dhe përfunduar pjesërisht gjatë vitit 2017 dhe 2018 dhe në vazhdim. Mbeturinat e përfituara nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të administrohen në llogari të veçantë pasi të vlerësohen me çmimin e tregut. Çmimet të përcaktohen me komision të krijuar për çdo rast me urdhër të Komandantit të Gardës së Republikës.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk është finalizuar procesi i inventarizimit të aktiveve për vitin 2018 në të gjithë komponentët e tij, pasi rezulton se, me shkresën nr. 4138/1 prot., datë 11.12.2018 të institucionit të GR, i janë dërguar Ministrisë së Brendshme për kompetencë propozimet për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve, që sipas pikës nr. 12/1 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm me nr. 226, datë 08.05.2015 “Për përcaktimin e përgjegjësive në menaxhimin e aktiveve, krijimin e komisionit të inventarizimit, vlerësimit nxjerrjes nga përdorimi si dhe kompetencave për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të njësisë shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme”. Në nomenklaturën e aktiveve të propozuara për nxjerrje nga përdorimi bëjnë pjesë dhe 32 automjete, mirëpo edhe pse kanë kaluar mbi 7 muaj, nuk ka asnjë veprim dhe përgjigje nga institucioni epror i MB.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34 -92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 Rekomandimi:

Të merren masa dhe të ri kërkohet përgjigje dhe veprim mbi shkresën nr. 4138/1 prot., datë 11.12.2018 të institucionit të GR, ku i janë dërguar Ministrisë së Brendshme propozimet për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve, që sipas pikës nr. 12/1 të Ministrit të Brendshëm me nr. 226, datë 08.05.2015, janë kompetencë e kësaj Ministrie.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk është arkëtuar detyrimi i palës së paditur “.....” SH.A, për mos përmbushje të detyrimit kontraktor ndaj GR, duke mos i dorëzuar



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

këtij të fundit sasinë prej 15,180 litra karburant me vleftën prej 1,809,938 lekë, për të cilën janë kryer likuidimet nga ana e këtij institucioni, në bazë të kontratës së lidhur me datë 23.06.2009. Bazuar në padinë e ngritur nga Garda e Republikës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 4300 datë 22.4.2013 ka vendosur detyrimin e palës së paditur “....” sh.a, për të përmbushur detyrimin kontraktor ndaj GR, duke i dorëzuar këtij të fundit sasinë prej 15,180 litra karburant (nga kjo 9670 litra benzine pa plumb dhe 5510 litra gazoil), me vleftën e përgjithshme 1,809,938 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34 -92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 Rekomandimi:

Të merren masat nga ana e strukturave menaxheriale të Gardës së Republikës, të rikërkohet pranë Zyrës Përmbarimore Tiranë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë të lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit me nr. 126, datë 28.01.2015, ku është vendosur lënia në fuqi e Vendimit nr. 4300, datë 22.4.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe për të cilin me Vendimin nr. 1749, datë 23.3.2015, kjo Gjykatë ka lëshuar urdhër ekzekutimi.

Gjithashtu, çështja ti bëhet me dije Ministrisë së Drejtësisë me qëllim finalizimin e procedurave dhe veprimeve në zbatim të titujve ekzekutiv të lëshuar nga Gjykata për këtë qëllim.

Në vazhdim

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit të pasurisë në ZVRPP dhe pasqyrimi në kontabilitet i gjithë sipërfaqeve për trojet, tokat dhe terrenet që Garda e Republikës administron dhe ka në pronësi.

24. 1. Nga auditimi i kryer, rezultoi se nga gjithë pronat e mësipërme, janë të regjistruara në ZVRPP, vetëm 4 (katër) prona:

- trualli e godinat ne Gardën e Republikës (VKM nr.156, dt 1.3.2017), për Komandën,
- trualli e godinat ne Gardën e Republikës (pjesërisht VKM nr.157, dt 1.3.2017),Njësia e Tretë, si dhe

- pikat autonome Pogradec dhe Vlorë, ndërsa pronat e tjera janë në proces hipotekimi. Sipërfaqja e përgjithshme e regjistruar shënon 31,083 m²

24.2. Pronat e institucionit GR janë pasqyruar vlerën 338,971,390 lekë, (të tilla sipas regjistrimit kontabël me vlerën e tyre bruto në bilancin kontabël të datës 31.12.2017), mirëpo konstatohet se për zërin “toka troje e terrene” vlera e tyre në kontabilitet është zero lekë. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore për regjistrimin e pasurisë shtetërore, përcaktimet e VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Kështu, vetëm për sipërfaqet e trojeve të pa kontabilizuara dhe që nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare të GR, rezulton se, vetëm për pikat Vlorë dhe Pogradec, për sipërfaqen e truallit prej 9,276 m² kjo vlerë minimalisht duhet të ishte kontabilizuar për 52,320,218 lekë.

24.3.Ndonëse VKM me nr.406, është nxjerrë me datë 04.07.2018 me objekt “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe kalimin në pronësi të Bashkisë së Tiranës të pjesëve takuese të pronës me emërtimin “Garda e Republikës, Garnizon”, me vendndodhje në ZK nr. 8270, me nr. Pasurie 4/134 dhe për një ndryshim në VKM nr. 815, datë 29.11.2007 “Për miratimin e listës shtese te inventarit te pronave te paluajtshme shtetërore, të cila kalojnë në përgjegjësi administrimi MB për GR”, të ndryshuar “, rezulton se VKM nuk ka gjetur zbatim dhe nuk janë kryer procedurat e transferimit dhe dorëzimit zyrtarisht të aktiveve sipas përcaktimeve në këtë VKM. Mosveprimet nga ana e institucionit të Gardës së Republikës lidhen me faktin se ka mosveprime nga ane institucionit të qeverisjes së përgjithshme- Ministrisë së Brendshme, pasi nuk është nxjerrë urdhri i Ministrit të Brendshëm për të proceduar sipas VKM-së.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34 -92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

24.1. Rekomandimi:

Menaxhimi i lartë i institucionit, bazuar në Vendimet e Këshillit të Ministrave për pronat shtetërore që ka në përgjegjësi administrimi Garda e Republikës dhe në dokumentacionin që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

disponon, të saktësojë dhe kryejë regjistrimin e pronave në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

24.2. Rekomandimi:

Të merren masa për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi të institucionit, në referencë të hartës së vlerës së tokave, të miratuar sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016

24.3. Rekomandimi:

Për sipërfaqet e përfshira në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.406, datë 04.07.2018 të kërkohet nga ana e Ministrisë së Brendshme lëshimi i urdhrit për transferimet e pronave, të procedohet me ngritjen e komisioneve të rregullta dhe pas kryerjes së transferimeve efektet e VKM-së të pasqyrohen në kontabilitetin e institucionit.

Në vazhdim

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Gjetje e konstatime me dëm ekonomik në vlerën 46,802 lekë

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, nuk është përlogaritur dhe arkëtuar vlera e detyrimit prej 46,802 lekë, e cila përbën detyrim për arkëtim nga subjekti privat “...” shpk. Konkretisht nuk ka gjetur zbatim të plotë kontrata e lidhur midis palëve, me objekt “Blerje artikuj të ndryshëm për marrëdhëniet me publikun” pasi AK është furnizuar me 41 artikuj, nga 54 artikuj sipas Dokumenteve Standarde dhe Aneksit të Kontratës, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 1, pika 2, të Kontratës me nr.25, datë 13.6.2018 të lidhur midis AK. Si përfundim nuk janë furnizuar sipas FD nr. 1121, datë 01.10.2018 gjithsej 13 artikuj me vlerë 265,920 lekë brenda afatit 150 ditë. Në këto kushte AK, bazuar në nenin 14 të Kontratës, duhet të kishte ndërprerë kontratën meqenëse operatori ekonomik ka dështuar në furnizimin me mallra brenda afatit të përcaktuar dhe rënë dakord dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 4 të Kontratës, duhet të ishte llogaritur dëmi për dorëzimin e vonuar në masën 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës”. Rezulton se, nga data 09.11.2018 deri më datën 24.12.2018: vlera e pa furnizuar $265,920 \times 44$ ditë (nga data 9/11/2018 - 24.12.2018) $\times 4/1000 = 46,802$ lekë, që përbën detyrim për arkëtim nga subjekti privat “...” shpk.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34 -92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi:

Institucioni i Gardës së Republikës të analizojë dhe vendosë në kushtet e arkëtimit shumën 46,802 lekë, si dëm për dorëzimin e vonuar të mallrave në masën 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, që përbën detyrim për arkëtim nga subjekti privat “Sakuli” Sh.p.k për veprime dhe mosveprime në kundërshtim me përcaktimet e nenit 1, pika 2, të Kontratës me nr.25, datë 13.6.2018 të lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe këtij operatori ekonomik.

Brenda 60 ditëve

D. GJETJE ME EFEKTE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për shumën 1,896,101 lekë nga vonesat në ekzekutimi i vendimeve gjyqësore / likuidimin e detyrimeve, situatë e shkaktuar si pasojë e mosçeljes së fondeve dhe bërjes së tyre efektive në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

kohë. Konkretisht nga ana e GR janë kryer detyrimet ligjore që rrjedhin nga zbatimi i :

-VKM nr. 22, date 18.01.2017 „Për një shtese fondi në buxhetin e vitit 2017 për MPB nga fondi rezerve i BSH për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011” si dhe

- VKM nr. 743, datë 13 dhjetor 2017 ”Për një ndryshim në VKM nr. 22, datë 18.01.2017 „Për një shtese fondi në buxhetin e vitit 2017 për MPB nga fondi rezerve i BSH për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011”.

Është paguar shuma prej 1,896,101 lekë si një detyrim shtesë nga ana e shoqërisë përmbarimore “.... Group”, pasojë e shpenzimeve të pa likuiduara nga mosçelja e fondeve dhe bërja e tyre efektive në kohë . Kjo pagesë përbën një shpenzim pa efektivitet për fondet e buxhetit të shtetit, e lidhur me veprimet dhe mosveprimet e strukturave përgjegjëse, me vonesën në hartimin dhe miratimin e projekt vendimit për KM si dhe faktit se fondet janë bërë efektive më 27 dhjetor 2017, dhe po këtë datë janë prokurat e familjarëve (shiko shkresa nr. 2594/2 date 7/6/2018 e GR për MB). Rezulton se, e gjithë shuma për ekzekutimin e këtij detyrimi shtesë për llogari të shoqërisë përmbarimore private, përbën një shpenzim pa efektivitet për fondet e buxhetit të shtetit, duke qenë se i përket mosveprimeve nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme për akordimin e fondeve në kohë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 34 -92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi:

Institucioni i Gardës së Republikës të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumatat e shpenzuara sa më lartë për ekzekutimin vendimeve gjyqësore, si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit dhe të mos lejojë kryerjen e pagesave të kësaj kategorie pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë.

Në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE E ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

Mbështetur në nenin 16 të ligjit nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për gardën e RSH” , i ndryshuar, në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Gardës së Republikës, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 2594, datë 24.10.2006, në Rregulloren e Personelit, miratuar me VKM nr. 66, datë 14.01.2014 “Për miratimin e strukturës, limit organik, dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në GRSH”, si dhe kontratës individuale të punës, lidhur midis punonjësve dhe Gardës së Republikës, i rekomandojmë Titullarit të Gardës që: “Në varësi të analizës së përgjegjësisë, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, me qëllim fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore përkatëse.”

“Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi”

GRUPI I AUDITIMIT

.....
.....
.....
.....

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

.....



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

ANEKSI 1

LISTA E PROCESEVE GJYQESORE TE NDJEKUR NGA INSTITUCIONI

Nr.	Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë 2017
2.	Paditës ..., i paditur Komanda e Gardës së Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes`` (pushimi çështjes)

Nr.	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë 2017
1.	Vendimi nr 382 datë 09.02.2017, Paditës e paditur Garda e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme; (Pranimi i padisë)
2.	Vendimi nr 944 datë 10.03.2017, Paditës,Robert dhe (.....) e paditur Garda e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme; (Pranimi i padisë)
3.	Vendimi nr 179 datë 30.01.2017, Paditës, i paditur Garda e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme; (Pranimi i padisë)
4.	Vendimi nr 3176 datë 17.07.2017, Paditës e paditur Garda e Republikës (Rrëzimi i kërkesë padisë)
5.	Vendimi nr. 80-2017-4839, datë 11.12.2017, Paditës paditur Garda e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme (Pranimi e pjesshëm të kërkesë padisë,ankimuar)
6.	Paditës i paditur Garda e Repoublikës, (Pranimi i padisë,ankimuar)
7.	Paditës i paditur Garda e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme (pezullim)

Nr.	Gjykata Administrative e Apelit Tiranë (Ankim) 2017
1.	Vendimi nr.1146 datë 17.03.2017 , Paditës e paditur Garda e Republikës (Rrëzim i kërkesë padisë)
2.	Vendimi nr.69 datë 19.01.2017, Paditës e paditur Gardën e Republikës (Rekurs)
3.	Vendimit nr.368 datë 02.10.2017, Paditës dhe e paditur Garda e Republikës dhe Ministria e Brendshme; (Rekurs)
4.	Vendimi nr.3205, datë 05.07.2017, Paditës e paditur Garda e Republikës, (Rekurs)
5.	Vendimi nr.1858, datë 03.05.2017, Paditës dhe e paditur Garda e Republikës (Rekurs)
6.	Vendimi nr.3839, datë 20.09.2017, Paditës i paditur Garda e Republikës dhe Ministria e Brendshme (Rekurs)
7.	Vendimi nr.494 datë 09.02.2017, Paditës e paditur Garda e Republikes (Rrëzimi i padisë)

Nr.	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë 2018	Gjykata Adm. e Apelit Tiranë (Ankim) 2018	Gjykata e Lartë (rekurs) 2018
1.	Vendimi nr. 3741 datë 22.10.2018 paditës i paditur Garda e Republikës. (Pranimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

2.	Vendimi nr. 621 datë 22.02.2018 paditës i paditur Grada e Republikës. (Pranimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	
3.	Vendimi nr. 3116 datë 12.09.2018 paditës Garda e Republikës i paditur Përmbaruesi Gjyqësor Privat (Pushuar)		
4.	Vendim nr. 3548 datë 10.10.2018, paditës i paditur Komanda e Gardës së Republikës (Pushuar)		
5.	Vendim nr. 3996 datë 6.11.2018 paditës.... i paditur Garda e Republikës; (Pranimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	
6.	Vendimi nr.68 datë 15.01.2016 paditës (Pushuar)	Vendimi nr.1388 Datë 03.04.2018	Ankim i veçantë

Nr.	Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë 2018	Gjykata e Apelit Tiranë 2018	Gjykata e Lartë (rekurs) 2018
1.	Vendimi nr. 8256 datë 12.10.2018 paditës i paditur Garda e Republikës. (Pranimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	
2.	Vendimit nr.9121 datë 06.11.2018 paditës Garda e Republikës dhe i paditur (Shpallje Moskompetence)		Ankim i Veçantë
3.	Vendim 2846 datë 18.07.2018 paditës i paditur Komanda e Gardës së Republikës (Pushuar)		
4.	Vendimi nr.8687 datë 24.10.2018 paditësi i paditur Garda e Republikës; (Rrëzimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	

Nr.	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë 2019	Gjykata e Apelit Tiranë 2019	Gjykata e Lartë (rekurs) 2019
1.	Vendimi nr. 71, datë 21.01.2019 me paditës; (Pranimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	
2.	Çështja me paditës, (në proces)	Ankimuar (në proces)	
3.	Çështja me paditës, (në proces)		
4.	Vendimi nr. 874, datë 18.13.2019 me paditës; (Rrëzimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	
5.	Çështja me paditës, (në proces)		
6.	Vendimi nr. 1969, datë 24.04.2019, me paditës (Rrëzimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	
7.	Çështja me të paditur, në proces;		Ankim i Veçantë
8.	Çështja me të paditur, në proces;		
9.	Çështja me paditës, në proces;		
10.	Vendimi nr. 1553, datë 05.05.2019 me paditës Instituti i Presidentit të Republikës, ndërsa Person i tretë, Garda e Republikës; (Rrëzimi i Padisë)	Ankimuar (në proces)	Ankim i Veçantë

ANEKSI 2: MBI VLERËSIMIN E RISKUT.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (*analiza*), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

- U krye planifikimi dhe identifikimi i riskut të auditimit. Njohja me subjektin që auditohet për të kuptuar të gjithë elementët e mjedisit të kontrollit. U identifikuan dhe vlerësuan zonat kryesore të llogarisë dhe shënimeve shpjeguese për të përcaktuar pohimet kryesore të auditimit në bazë të materialitetit të përcaktuar.

-U përcaktua strategjia dhe vlerësimi i riskut duke identifikuar klasat e transaksioneve dhe kontrolleve kyçe. Kuptimi i proceseve të rrjedhjes së punës dhe kontrollet bazë të aplikuara. U përcaktuan kontrollet kryesore për tu testuar dhe vlerësimi paraprak i kombinuar i riskut (*i rishikuar përgjatë gjithë punës audituese*). U përcaktuan testet e kontrolleve dhe testet thelbësore të auditimit që do të kryhen në bazë risku.

- U ekzekutuan procedurat e testimit si testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

ANEKSI 3: SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

A. Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se, transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

1. Një **opinion i pakualifikuar** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar; dhe
- (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

1.1 Opinioni me theksim të çështjes. Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

B. Audituesi e modifikon opinionin, duke shprehur:

1. Opinioni i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

2. Opinioni negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

3. Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI 4 -QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër-shpenzimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- ✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogarinë 602 u vlerësua 0.7; dhe
- ✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e cështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlllogaritjes si më poshtë:

1. Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore (llogaria 600 dhe 601)

Klasa 6 (llog 600 + 601)	Pagat faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
Viti 2017	1,156,769	1,156,769	100
Viti 2018	1,242,764	1,242,764	100

2.Mbulimi me auditim i shpenzimeve operative (llogaria 602)

Klasa 6 (llog 602)	Shpenzime operative faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
Viti 2017	454,927	454,927	100
Viti 2018	225,714	225,714	100

3. Mbulimi me auditim i shpenzimeve kapitale (llogaria 231)



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

Artikulli 231	Shpenzime kapitale faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
2017	158,76	69,874	44
2018	221,826	44,154	20

4. Mbulimi me auditim i prokurimeve:

	Nr. i procedurave të realizuara	Vlera	Nr I procedurave të audituara	Vlera	Mbulimi ne %
Viti 2017	67	83,617	5	69,874	84
Viti 2018	46	124,692	5	44,154	35

Sa i takon auditimit të prokurimeve nën gjykimin profesional të audituesit, përzgjedhja e prokurimeve u krye nisur nga pesha specifike e secilës prej tyre ndaj total vlerës vjetore të prokurimeve të realizuara:

ANEKSI 5: VLERA E LLOGARISË 602/7 “SHPENZIME PËR DETYRIME DHE KOMPENSIME LEGALE”

Nr.	Urdhër Shpenzimi		Sghuma (në lekë)	Përshkrimi i veprimit	Ekstremitetet e Vendimit të Gjykatës Së Shkallës së Parë	
	Nr.	Datë			Nr.	Datë
1.	125	17.02.2017	1,116,742	Dëm pasuror	3968	28.07.2016.
2.	126	17.02.2017	1,116,742	Dëm pasuror	3968	28.07.2016.
3.	148	21.02.2017	3,819,623	Dëm moral	3968	28.07.2016.
4.	149	21.02.2017	3,819,623	Dëm moral	3968	28.07.2016.
5.	150	21.02.2017	3,819,623	Dëm ekzistencial	3968	28.07.2016.
6.	151	21.02.2017	3,819,623	Dëm ekzistencial	3968	28.07.2016.
7.	152	21.02.2017	1,292,845	Dëm pasuror	3968	28.07.2016.
8.	153	21.02.2017	1,292,845	Dëm pasuror	3968	28.07.2016.
9.	154	21.02.2017	5,312,250	Dëm moral	3968	28.07.2016.
10.	155	21.02.2017	5,312,250	Dëm moral	3968	28.07.2016.
11.	156	21.02.2017	5,312,250	Dëm ekzistencial	3968	28.07.2016.
12.	157	21.02.2017	5,312,250	Dëm ekzistencial	3968	28.07.2016.
13.	158	24.02.2017	10,491,513	Dëm ndaj si rezultat i humbjes së jetës së të ndjerit	6148	21.12.2016.
14.	159	24.02.2017	1,979,137	Dëm ndaj si rezultat i humbjes së jetës së të ndjerit	6148	21.12.2016.
15.	160	24.02.2017		Dëm jopasuror, për të ndjerin	6242	27.12.2016.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

			8,275,384			
16.	161	24.02.2017	8,275,384	Dëm jopasuror ..., për të ndjerin	6242	27.12.2016.
17.	162	24.02.2017	8,275,384	Dëm jopasuror, për të ndjerin	6242	27.12.2016.
18.	163	24.02.2017	8,275,384	Dëm jopasuror, për të ndjerin	6242	27.12.2016.
19.	164	24.02.2017	8,275,384	Dëm jopasuror, për të ndjerin	6242	27.12.2016.
20.	165	24.02.2017	8,275,384	Dëm jopasuror, për të ndjerin	6242	27.12.2016.
21.	166	24.02.2017	8,275,384	Dëm jopasuror, për të ndjerin	6242	27.12.2016.
22.	167	24.02.2017	8,275,384	Dëm jopasuror, për të ndjerin	6242	27.12.2016.
23.	168	24.02.2017	8,275,384	Dëm jopasuror, për të ndjerin	6242	27.12.2016.
24.	248	24.03.2017.	1,530,694	Dëm pasuror, për të ndjerin	6292	28.12.2016
25.	249	24.03.2017.	1,530,694	Dëm pasuror, për të ndjerin	6292	28.12.2016
26.	250	24.03.2017.	1,596,000	Shpenzime përkujdesje, për të ndjerin	6292	28.12.2016
27.	251	04.04.2017.	674,860	Taksë gjyqësore 3.000, Taksë gjyqësore 486.860, psikologu 40.000, Eksperti mjeku ligjor 25.000, ekspert vlerësim dëmsh shëndetësore 120.000, rasti i të ndjeritj.	3968	28.07.2016
28.	252	24.03.2017.	1,055,085	Taksë kërkesë padie 3.000, taksë njoftimi 300, Taksë gjyqësore 641.785, psikologu 50.000, ekspert vlerësim dëmsh shëndetësore 120.000, tarifë avokati 240.000, rasti i të ndjerit	6292	28.12.2016
29.	253	24.03.2017.	2,641,000	Shpenzime përkujdesje, për të ndjerin	6292	28.12.2016.
30.	254	24.03.2017.	2,775,007	Dëm moral, për të ndjerin	6292	28.12.2016.
31.	255	24.03.2017.	2,775,007	Dëm moral, për të ndjerin	6292	28.12.2016.
32.	256	24.03.2017.	2,775,007	Dëm ekzistencial....., për të ndjerin	6292	28.12.2016.
33.	257	24.03.2017.	2,775,007	Dëm ekzistencial, për të ndjerin	6292	28.12.2016.
34.	285	06.04.2017.	10,491,513	Dëm ndaj ...i si rezultat i humbjes së jetës së të ndjerit	6148	21.12.2016.
35.	833	18.12.2017.	657,733	Shpenzime gjyqësore rasti	6148	21.12.2016.
36.	834	22.11.2017.	115,300	Shpenzime gjyqësore rasti	6242	27.12.2016.
37.	901	26.12.2017.	23,334,741	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes ..	944	10.03.2017.
38.	906	27.12.2017.	7,916,549	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	382	09.02.2017.
39.	907	27.12.2017.	7,916,549	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	382	09.02.2017.
40.	908	27.12.2017.	8,473,709	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	382	09.02.2017.
41.	909	27.12.2017.	7,916,549	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	382	09.02.2017.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

42.	910	27.12.2017.	8,568,702	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	179	30.01.2017.
43.	911	27.12.2017.	8,568,702	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	179	30.01.2017.
44.	912	27.12.2017.	8,568,702	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	179	30.01.2017.
45.	913	27.12.2017.	8,568,702	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	179	30.01.2017.
46.	914	27.12.2017.	39,579,089	Dëmshpërblim për të afërmit e familjes	179	30.01.2017.
Shuma			289,014,709			

ANKESI 6: LISTA E ARMËVE

Nr	Emer mbiemer	Lloji armes	Numri I armes sipas inventarit	Nr procedim penal	Data	Vendi ku ndodhet	Kthimet ne GR FH nr. __ datë __
1.		PTT	16012979			Konfirmuar DPQ Tirane shkrese nr 1912 date 19.04.2012. ne DPQ Tirane	FH nr. 234, date 29.5.2019 sipas FD DVPTTr nr. 302, dt 20.05.2019
2.		PTT	9677176			Kerkese QFMT Mullet	<i>Shkrese e GR per DPPSH me nr. 533, date 07.03.2019, pa përgjigje</i>
3.		PTT	PB 1365			Kerkese Dr Burgjeve Tirane	Ska asnje veprim
4.			Б-13-46			Komisariat	FH nr. 231, date 29.5.2019 sipas FD DVPTTr nr.299, dt 20.05.2019
5.		Maka	BO 2002 - 56	3577	22.07. 2012	Komisariati nr 4	FH nr. 232, date 29.5.2019 sipas FD DVP TR me nr.300, dt 20.05.2019
6.			BO 1355-56			-Grabitur, object I proc. Penal me nr. 344, te prok. Shkalles se pare Elbasan (per ngjarjet e v.1997). -Shkresa e GR rikerkohet dorezimi i armatimit (shkresa me nr. 1694, dt 21.8.1999), (shkresa me nr. 134, dt	Referuar kerkeses se GR per DPSH me nr. 941, date 06.06.2016, është kthyer përgjigje nga DPSH me nr. 2967/1 prot., date 13.06.2016, kun ë pikën nr. 5 të saj konfirmohet se “pistoleta 9 mm mod 1959 makarov me nr. BO 1355-56 administrohet nga Drejtoria e Pol.Vndore Shkoder. Rekomandim: ***te rakordohet dhe behen sistemimet ne kontabilitet, ose duke e terhequr nga GR ose duke i prerë FD drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit Shkodër.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

						15.1.2015)	
7.	Shtabi	Beret	52796-Z	Akt Sekues	23.03.2011	Prokuroria Tirane	Është dërguar shkresa me nr. 533, dt 07.03.2019 të GR për DPPSH me object “Kërkesë për konfirmimin e armatimit të bllokuar në cilësinë e provave materiale”, është kthyer përgjigje nga DPPSH me nr. 2492/1 datë 04.04.02019 janë administruar nga prok. Pranë Gjykatës së Shk.Parë Tiranë
8.	Shtabi	Beret	52778-Z	Akt Sekues	23.03.2011	Prokuroria Tirane	Është dërguar shkresa me nr. 533, dt 07.03.2019 të GR për DPPSH me object “Kërkesë për konfirmimin e armatimit të bllokuar në cilësinë e provave materiale”, është kthyer përgjigje nga DPPSH me nr. 2492/1 datë 04.04.02019 janë administruar nga prok. Pranë Gjykatës së Shk.Parë Tiranë
9.	Njesia Speciale	MP-5	0057386	Akt Sekues	22.01.2011	Prokuroria Tirane	Është dërguar shkresa me nr. 533, dt 07.03.2019 të GR për DPPSH me object “Kërkesë për konfirmimin e armatimit të bllokuar në cilësinë e provave materiale”, është kthyer përgjigje nga DPPSH me nr. 2492/1 datë 04.04.02019 janë administruar nga prok. Pranë Gjykatës së Shk.Parë Tiranë
10.	Njesia Speciale	MP-5	03244	Akt Sekues	22.01.2011	Prokuroria Tirane	Sipas përgjigjes se dhene nga ana e Institutit të Policisë Shkencore me nr. 2492/1, date 04.04.2019 per GR, rezulton se nuk përfshihet kjo armë luftare në përgjien zyrtare për ekspertizën e kryer nga ana e Sektorit të Balistikës në kuader te proceditmi penal për ngjarjet e “21 Janarit” dhe që sipas përgjigjes janë administruar në prokurorinë pranë Gjyktaës së Shkallës së Parë.
11.	Njesia Speciale	MP-5	00577394	Akt Sekues	28.06.2011	Prokuroria Tirane	Është dërguar shkresa me nr. 533, dt 07.03.2019 të GR për DPPSH me object “Kërkesë për konfirmimin e armatimit të bllokuar në cilësinë e provave materiale”, është kthyer përgjigje nga DPPSH me nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Gardën e Republikës

							2492/1 datë 04.04.02019 janë administruar nga prok. Pranë Gjykatës së Shk.Parë Tiranë
12.	Njesia Speciale	MP-5	00577367	Akt Sekues	28.06.2011	Prokuroria Tirane	Është dërguar shkresa me nr. 533, dt 07.03.2019 të GR për DPPSH me object “Kërkesë për konfirmimin e armatimit të bllokuar në cilësinë e provave materiale”, është kthyer përgjigje nga DPPSH me nr. 2492/1 datë 04.04.02019 janë administruar nga prok. Pranë Gjykatës së Shk.Parë Tiranë
13.	Njesia Speciale	MP-5	0057402	Akt Sekues	28.06.2011	Prokuroria Tirane	Është dërguar shkresa me nr. 533, dt 07.03.2019 të GR për DPPSH me object “Kërkesë për konfirmimin e armatimit të bllokuar në cilësinë e provave materiale”, është kthyer përgjigje nga DPPSH me nr. 2492/1 datë 04.04.02019 janë administruar nga prok. Pranë Gjykatës së Shk.Parë Tiranë
14.	Njesia Speciale	MP-5	00577383	Akt Sekues	30.06.2011	Prokuroria Tirane	Është dërguar shkresa me nr. 533, dt 07.03.2019 të GR për DPPSH me object “Kërkesë për konfirmimin e armatimit të bllokuar në cilësinë e provave materiale”, është kthyer përgjigje nga DPPSH me nr. 2492/1 datë 04.04.02019 janë administruar nga prok. Pranë Gjykatës së Shk.Parë Tiranë